

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“LUIGJ GURAKUQI”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave ekonomiko-juridike

Viti VIII

2014

Shkodër, 2014

REDAKSIA

Prof. as. dr. Elez Osmani (kryeredaktor)
Dr. Entela Hoxhaj (sekretare shkencore)
Prof. dr. Arjeta Troshani, Prof.as.dr. Ilir Bërhani,
Prof. dr. Drita Kruja, dr. Emirjeta Bejleri,
LL.M. Roland ILIA (anëtarë)

DREJTORI REVISTËS

Prof. dr. Artan HAXHI

Korrektori dhe punoi në kompjuter:

Arta Bajrami

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e Shkencave ekonomiko-juridike
Tel fax: 00355 222 43747

PASQYRA E LËNDËS

Paulina HOTI

Përdorimi i mbikëqyrjes elektronike në fushën penale

The usage of electronic monitoring in criminal matters.....7

Irma BARAKU

Kuadri ligjor mbi shtypin dhe radiotelevizionin si mjete për ushtrimin e së drejtës për informim

Legal framework on the press and radio television as a tool to exercise the right to information.....17

Entela HOXHAI, Enriko KAPITI

Kufizimet e vendosura për rishikimin e Kushtetutës Shqiptare

The limits set to the revision of the Albanian Constitution.....29

Emanuela FURRAMANI

Pëlqimi pas informimit dhe rëndësia e tij në trajtimin mjekësor-kirurgjikal

Informed consent and it's relevance on medical – surgical treatment.....41

Klaudia PUPA, Ildir DUHANXHI

Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, një nga problematikat e sistemit gjyqësor shqiptar

The right to trial within a reasonable time, a problem of the albanian judicial sistem.....57

Ardian LEKA

Dënimet penale dhe alternativat e tyre

Criminal convictions and their alternatives.....73

Greta BARDELI

Dallimi ndërmjet kalimit me titull universal dhe me titull të veçantë të pasurisë trashëgimore

The difference between passing universal title and special titled inheritance..89

Romina KALI, Idir DUHANXHI

Shpenzimet gjyqësore si barrierë e aksesit të palëve në gjykatë (në proceset civile), në prizmin e procesit të rregullt ligjor

Court costs as barriers of party access to the court (in civil proceedings), through the prism of due process.....97

Brilanda LUMANAJ

E drejta për mbrojtjen e familjes me shërbime sociale në kontekstin ndërkombëtar dhe kombëtar

The right to protection of families with social services in international and national context.....109

Engjëll LIKMETA, Katrin TRESKA

Një ndalesë në statut

(Normat penale në statutet e Shkodrës)

"A short insight in the Statute"

(Criminal provisions in the Shkodra Statute).....117

Jetmira RRAGAMI

Reforma ligjore dhe risitë në procesin e licencimit të biznesit

Legal reform and innovation in the business licensing process.....131

Fatbardha OSMANAGA

Keqtrajtimi i fëmijës dhe pasojat e tij

Child maltreatment and its consequences.....147

Ardita BORIÇI, Albiona HOXHA

“Paga ime”, Banka Kombëtare Tregtare dhe konkurrenca në sistemin bankar në Shqipëri

"My salary", National Commercial Bank and the competition in the banking system in Albania.....157

Kleida TUFI (HETA), Sonila KRUJA

Ekspozimi ekonomik ndaj kurseve të këmbimit dhe mbrojtja ndaj tij
Economic exchange rate exposure and its hedging..... 169

Azis JATA

Marrëdhëniet e FMN-së me Shqipërinë gjatë viteve 1997- 2000 dhe
rekomandimet për stabilizimin e ekonomisë
*The relations between Albania and IMF during 1997-2000 and
recommendations for the stabilization of the economy*..... 181

Romina DAMINI

Raste të begatimit pa shkak
Cases of unjust enrichment..... 189

Veli LECAJ

Rëndësia strategjike e prodhimit të produkteve të reja për ekonominë
kosovare
*The strategic importance of the production of new products for the Kosovo
economy*..... 199

Labeat MUSTAFA

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Roli i tyre në zhvillimin ekonomik të
Kosovës
*Small and medium enterprises and their role in the economic development of
Kosovo*..... 209

Irma SHYLE

Përdorimi i medias sociale në industrinë e turizmit në Shqipëri. Rast
studimi i agjencive turistike në Tiranë
*The use of social media in the tourism industry in Albania - Case study of tourist
agencies in Tirana*..... 223

Sadije BUSHATI

Rast studimi: Krahasimi i vlerësimeve për mësimdhënie e mësimnxënie të studentëve të deges Financë dhe Informatikë të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Case study: comparison of evaluations for teaching and learning by students of Finance and Computing Branches of Shkodra’s University.....235

Arjeta FREGJAJ, Bledar PLORI, Arjeta ANAMALI

Lufta ndaj korrupsionit si faktor i rëndësishëm i rritjes së cilësisë në arsim
Fighting corruption as an important factor in increasing education quality.....245

Sanie DODA

Modelet e ndërvarësisë dhe rolet organizacionale

The models of interdependence and organizational roles.....257

PËRDORIMI I MBIKËQYRJES ELEKTRONIKE NË FUSHËN PENALE

Paulina Hoti

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Shkodrës

The usage of electronic monitoring in criminal matters

This paper addresses the use of a new technical mechanism in criminal matters. Through the presentation of objectives and experiences of the countries that apply electronic monitoring, and the legal conditions necessary for its application, the paper aims at giving to the Albanian readers an insight on this mechanism that has been introduced in usage recently in our country. Electronic monitoring enables the exercise of control over people whose freedom is restricted by judicial decision, and it can be applied in one of the cases explicitly provided for in the law. The application of this mechanism is expected to present advantages not only in terms of reducing the prison population and the cost of treatment of convicted persons, but also in terms of preventing recidivism.

Hyrje

Mbikëqyrja elektronike është një mekanizëm që mundëson përcaktimin e vendndodhjes së personit dhe mbledhjen e informacionit rreth tij. Ky mekanizëm mundëson gjithashtu verifikimin nëse respektohen detyrimet dhe ndalimet që i janë dhënë kur është vënë nën mbikëqyrje elektronike dhe zbulimin e menjëhershëm në rast mosrespektimit të tyre.

Zanafilla e mbikëqyrjes elektronike gjendet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1973 kur një gjyqtar amerikan, Jack Love, filloi aplikimin e mbikëqyrjes elektronike pas disa viteve prova që kishte bërë për të realizuar idenë e tij për të zhvilluar një sistem “monitorimi”¹.

¹ J.C. CERE: *La surveillance électronique : une réelle innovation dans le procès pénal ?*, Revista da Faculdade de Direito de Campos, AnoVII, N° 8, Junho de 2006, f.105, <http://jpcere.fr/Jean-PaulCere.pdf>.

Mbikëqyrja elektronike pati një zhvillim të shpejtë në SHBA dhe një numër i madh shtetesh filluan përdorimin e këtij mekanizmi. Zhvillimi i teknologjisë e favorizoi padyshim rritjen e përdorimit të mbikëqyrjes elektronike. Shumë vende të tjera aplikuan më pas mbikëqyrjen elektronike, si: Kanadaja, Anglia, Holanda, Suedia, etj.

Mbikëqyrja elektronike në terma teknikë realizohet me anë të një byzylyku i cili vihet zakonisht në këmbë nëpërmjet një kutie që është një përcjellës i lëvizshëm. Nëpërmjet satelitit GPS, në çdo kohë, mund të lokalizohet vendndodhja dhe të ndiqet zhvendosja e personit që e mban. Kur personi i afrohet një zone të ndaluar (p.sh., banesës së viktimës), ai merr menjëherë një mesazh në kutinë e tij si alarm. Ndërkohë që në shtëpi vendoset një receptor, i cili lejon të verifikohet nëse personi ndodhet në shtëpi në oraret që i ka vendosur gjykata.

Mbështetësit e përdorimit të këtij mekanizmi nënvizojnë rëndësinë e objektivave, që mundësojnë realizimin e tij duke qenë një mekanizëm, i cili mund të përdoret në të gjitha fazat e procesit penal. Kështu, mbikëqyrja elektronike, shihet si një përgjigje e re ndaj realitetit penal dhe konkretisht mbipopullimit të burgjeve dhe kostos së lartë të qëndrimit në të; ajo shihet si një mjet për të luftuar recidivizmin dhe si një mundësi për risocializimin dhe rikthimin e këtyre personave në shoqëri.

Konferencat e organizuara mbi mbikëqyrjen elektronike në kuadër të Konferencës Evropiane të Provës², në Holandë dhe në Portugali, kanë rekomanduar se aplikimi i mbikëqyrjes elektronike të realizohet nëpërmjet projekteve pilot, të cilët mundësojnë testimin në terren të këtij mekanizmi. Nisur nga këto rekomandime, neni 20, i Ligjit nr.10494, datë 22.12.2011 “*Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor*”, parashikon që mbikëqyrja elektronike në Shqipëri do të aplikohet vetëm nga gjykata e shkallës së parë dhe nga gjykata e apelit Tiranë. Është një sistem që ndërtohet me një teknologji moderne ndonëse përdoret si projekt pilot nga i cili mund të përfitojnë 300 të dënuar.

Ne propozojmë që këtë temë ta trajtojmë duke paraqitur fillimisht një panoramë të zhvillimit të mbikëqyrjes elektronike në vende të ndryshme (I) për të vijuar më pas me kuadrin ligjor të mbikëqyrjes elektronike në Shqipëri (II).

² CEP- Conference (organisation) Europeenne de Probation, themeluar në 1981 nga Franca, Anglia, Gjermania dhe Holanda me synim nxitjen e aplikimit të dënimeve penale, të dënimeve alternative, të punës në interes publik, të ndërmjetësimit, të pajtimit, të gjetjes së përgjigjeve ndaj recidivizmit.

I. Objektivat dhe zhvillimi i mbikëqyrjes elektronike

Mbikëqyrja elektronike është një model i përhapur tashmë në vendet e zhvilluara për shkak se garanton identifikimin e shpejtë dhe neutralizimin e individit që gjendet nën mbikëqyrje elektronike. Në të njëjtën kohë ky sistem monitorimi ka efektet e veta pozitive në aspektin financiar duke qenë se kostoja e aplikimit është relativisht e ulët.

A. Objektivat e mbikëqyrjes elektronike

Zhvillimi i shpejtë i mbikëqyrjes elektronike shpjegohet me nevojën e gjetjes së përgjigjeve të përshtatshme penale lidhur me mbipopullimin e burgjeve (a), me parandalimin e recidivizmit³ (b) dhe me nevojën e riinseririmit të personave të dënuar në shoqëri.

a. Mbikëqyrja elektronike si mënyrë për të luftuar mbipopullimin në burgje:

Mbikëqyrja elektronike ka si synim që t'i japë përgjigje problemit të mbipopullimit të burgjeve duke nxitur aplikimin e këtij mekanizmi ndaj personave që janë në fund të vuajtjes së dënimit të tyre, personave për të cilët vendoset një prej masave alternative të dënimit, jepet një dënim plotësues, një masë shtrënguese, një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje. Praktika e vendeve të tjera⁴ ka treguar se aplikimi i mbikëqyrjes elektronike mundëson uljen e numrit të të burgosurve dhe mund t'i japë përgjigje nevojave për kushte më të mira burgimi⁵.

b. Pse mendohet se mund të parandalojë recidivizmin ?

Byzylyku elektronik mundëson lokalizimin dhe ndjekjen e lëvizjeve të personave që e mbajnë, për rrjedhojë edhe vetë i dënuari e di që nuk ka asnjë mundësi t'i shpëtojë drejtësisë në rast se kryen një vepër tjetër penale. Çdo rast recidivizmi paraqet një fyerje ndaj viktimave dhe një dështim në politikën penale të ndëshkimit. Prandaj, edhe gjetja e mekanizmave penalë

³ Lévy R. et Pitoun A. : « L'expérimentation du placement sous surveillance électronique en France et ses enseignements (2001-2004) », *Déviante et Société*, 2004/4 Vol. 28, p 411 - 437.

⁴ J.C. CERE: *La surveillance électronique : une réelle innovation dans le procès pénal ?*, e cituar, f. 112.

⁵ Olivier Bloas: *Bracelet électronique: Le bilan contrasté du placement sous surveillance électronique*, SciencesPo Rennes, <http://scprennnes.hypotheses.org/134>, f.7.

që mund të shmangin recidivizmin është synim i vazhdueshëm i politikës penale. Ndonëse në institucionet e vuajtjes së dënimit zhvillohen programe trajtimi për personat e dënuar në mënyrë që qëllimi i dënimit të mos jetë vetëm ndëshkimi për veprën e kryer, por edhe parandalimi kryerjes së veprave të tjera penale, aplikimi i mbikëqyrjes elektronike shihet si një mekanizëm që lufton recidivizmin⁶ për shkak se i dënuari është nën kontroll të vazhdueshëm.

c. Një instrument për risocializimin dhe rifutjen në shoqëri të personave të dënuar që respektojnë liritë e tyre individuale. Risocializimi dhe rifutja në shoqëri e tyre është një sfidë e madhe për një politikë dënimi efikase. Lirimi me kusht nuk përjashton kontrollin, për këtë edhe mbikëqyrja elektronike, shihet si një vazhdim i shoqërimit të personit të dënuar, i cili në fund të dënimit duhet të rikthehet në shoqëri, të ketë një shtëpi dhe të gjejë një punë. Individu i vendosur nën mbikëqyrjen elektronike do të jetë shumë më i nxitur që të ndër marrë qetësisht një hap riinserimi, pikërisht sepse kështu mund të kthehet, jo në një individ që pëson, por në një aktor të ekzekutimit të masës së ndërmarrë ndaj tij. Mbikëqyrja elektronike i mundëson gjithashtu që të bëjë një jetë familjare dhe profesionale normale, pasi byzyluku elektronik nuk duket nga pamja e jashtme.

B. Eksperiencia e vendeve evropiane në aplikimin e mbikëqyrjes elektronike

Vendet e para evropiane që kanë aplikuar mbikëqyrjen elektronike janë Anglia e Uellsit, Suedia dhe Holanda. Edhe vende të tjera evropiane aplikojnë mbikëqyrjen elektronike. Franca dhe Belgjika⁷ e kanë adaptuar si instrument juridik në fushën penale në vitin 1998, por vetëm disa vite më pas kanë filluar përdorimin e tij. Vitet e fundit, programi i mbikëqyrjes elektronike po aplikohet edhe në Gjermani, Itali, Spanjë, Portugali, Zvicër, Hungari, etj.

Vendet që kanë integruar mbikëqyrjen elektronike në legjislativon e tyre përgjithësisht e mbështesin në parime të ngjashme. Nga analiza e kryer rezulton se në asnjërin nga vendet që e aplikojnë, mbikëqyrja elektronike nuk shihet si një dënim më vete, por si një mënyrë për ekzekutimin e dënimeve me burgim. Aplikimi i këtij instrumenti

⁶ Po aty, f. 7.

⁷ Devresse M.S. : *Innovation pénale et surveillance électronique : quelques réflexions sur une base empirique*, <http://champpenal.revues.org/1641>.

mbështetet mbi vullnetin e personit, mbi rrezikshmërinë e ulët të veprës penale, etj.

Anglia dhe Uells: Mbikëqyrja elektronike i ka fillimet e saj në vitin 1991 me *Criminal Justice Act*, pas një periudhë eksperimentimi prej gjashtë muajsh në vitin 1989, por aplikimi i saj për të gjitha gjykatat e të dy vendeve daton më 1 dhjetor 1999.

Më pas, në vitin 2001 me *Criminal Justice and Police Act*, përdorimi i këtij mekanizmi u shtri edhe te të miturit 12-16 vjeç që kryejnë qoftë edhe vepra të rënda penale, si dhe në rastet recidive. Duke qenë se kemi të bëjmë me një instrument elektronik, teknologjia mundëson detektimin e personave që janë me byzylykun elektronik nëpërmjet vidiokamerave të mbikëqyrjes që vendosen në qendër të qytetit. Mbikëqyrja elektronike në këto dy vende realizohet nga sektori privat dhe është një sistem që nuk parashikon ndjekjen sociale edukative të personit.

Suedia: viti 1994 shënon fillimin e përdorimit të mbikëqyrjes elektronike në disa rajone. Më pas, përdorimi i saj u shtri në të gjithë vendin në vitin 1997 dhe përdoret si mënyrë ekzekutimi e dënimeve me burgim (deri në tri vjet). Kjo masë përdoret ndaj personave që kanë një vendbanim të qëndrueshëm, një linjë telefoni dhe duhet të ndjekin një program social sistematik. Mbikëqyrja elektronike, shpesh përdoret për personat e dënuar për përdorim droge dhe alkooli, të cilët duhet të pranojnë të ndjekin një program pranë ndonjë shoqate që trajton probleme të tilla. Këto persona përgjatë kohës së dënimit nuk duhet të përdorin alkoolin ose drogën.

Hollanda: është një ndër vendet e para evropiane që filloi të përdorë mbikëqyrjen elektronike si një mënyrë për të evituar burgimin. Eksperiencia e mbikëqyrjes fillon në korrik 1995 pas një periudhe të gjatë reflektimi dhe gjatë dy vjetëve të para u fokusua në katër qarqe të mëdha. Mbikëqyrja elektronike shoqëron një saknsion tjetër, p.sh., punë në interesin publik ose jepet për ata që kanë vuajtur të paktën gjysmën e dënimit me burg. Mbikëqyrja elektronike aplikohet vetëm me vullnetin e të dënuarit, i cili ka një vendbanim dhe një punë të qëndrueshme. I dënuari nënshkruan angazhimin e tij në të cilin shënohen edhe kushtet dhe kohëzgjatja e mbikëqyrjes elektronike, e cila nuk mund të zgjasë më tepër se gjashtë muaj.

Franca: mbikëqyrja elektronike është parashikuar në të drejtën franceze⁸ me ligjet e viteve 1996, 1997. Mbikëqyrja elektronike mund të

⁸ <http://www.justice.gouv.fr/prison-et-reinsertion-10036/la-vie-hors-detention-10040/le-placement-sous-surveillance-electronique-11997.html>

aplikohet si mënyrë për ekzekutimin e dënimit me burg pa e burgosur të dënuarin, si një masë shtrënguese për të zëvendësuar masën e arrestit deri në pritje të gjykimit ose si një mbikëqyrje elektronike në fund të dënimit.

Ligji i 13 dhjetorit 2005, mbi recidivizmin e veprave penale, u parashikua në mënyrë specifike “mbikëqyrja elektronike e lëvizshme” dhe që prej vitit 2011 personat mund të përfitojnë nga “mbikëqyrja elektronike në fund të dënimit” në javët e fundit të dënimit, maksimumi katër muajt e fundit. Orët e daljes nga banesa në këto raste janë deri në katër orë në ditë me qëllim që të mundësojnë ndërmarrjen e hapave për risocializimin dhe rikthimin e tij në shoqëri (p.sh., të kërkojë punë).

II. Kuadri juridik i mbikëqyrjes elektronike në Shqipëri

Mbikëqyrja elektronike në Shqipëri bazohet në disa parime, si mbi: ligjshmërinë; mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike; garantimin e lirisë personale të të dëmtuarit nga vepra penale apo të viktimës; respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, dinjitetin njerëzor dhe sigurinë personale; mosdiskriminimin; proporcionalitetin e mbikëqyrjes elektronike me rrethanat e rastit dhe personalitetin e subjektit; objektivitetin dhe efektivitetin.

Për rrjedhojë implementimi i mbikëqyrjes elektronike është parë si një sistem që shkon në drejtim të përmirësimit të trajtimit të të dënuarve, të përdorimit të masave alternative dhe të modernizimit të sistemit të dënimit në Shqipëri, por edhe si një mekanizëm që ndihmon në parandalimin e rrezikut të recidivizmit.

A. Rastet kur mund të caktohet mbikëqyrja elektronike

Mbikëqyrja elektronike është parashikuar nga legjislacioni shqiptar si mekanizëm që lejon zbatimin e një vendimi gjyqësor që kufizon lirinë e personit: duke caktuar një nga alternativat e dënimit me burgim, duke caktuar një dënim plotësues, duke caktuar një prej llojeve të masave shtrënguese, apo një urdhër mbrojtjeje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje. Duke përcaktuar në kohë reale vendndodhjen e një personi, me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura në trupin e tij, mbikëqyrja elektronike garanton zbatimin efektiv të vendimit gjyqësor dhe ka për qëllim rritjen e sigurisë publike dhe garantimin e ekzekutimit efektiv të vendimeve gjyqësore⁹.

⁹ Neni 2 i Ligjit nr.10494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike...”.

Përdorimi i mbikëqyrjes elektronike urdhërohet nga gjykata në vendimin gjyqësor të dhënë ndaj subjekteve, në rastet kur ka vendosur një nga masat shtrënguese¹⁰; kur ka vendosur një nga alternativat e dënimit me burgim¹¹; kur ka vendosur dënim plotësues¹²; kur është lëshuar, me vendim gjyqësor, një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje¹³.

- Mbikëqyrja elektronike përdoret kur gjykata vendos një nga alternativat me burgim. Ajo synon modernizimin e sistemit të vuajtjes së dënimit, por është një proces që shkon drejt uljes së popullsisë në burgje, uljes së kostove për sistemin e burgjeve, shkon në favor të përmirësimit të të drejtave të të dënuarve, përmirëson më tej trajtimin e personave që kanë kryer ose dyshohen se kanë kryer një vepër penale, synon lehtësimin e procedurave të komunikimit të të dënuarve me të afërmit e tyre. Është një proces që shkon në favor të mbrojtjes së sigurisë publike.

Mbikëqyrja elektronike përdoret edhe në rastet e dhënies së një dënimi plotësues ose në rastet e vendosjes së një mase shtrënguese. Për shembull, mbikëqyrja elektronike, zbatohet për rastet e arresteve shtëpiake, gjë që shmang mundësinë e largimit dhe moszbatimit të masave të gjykatave. Mbikëqyrja elektronike përdoret edhe për personat që janë në shërbim prove për përdorim të lëndëve narkotike, në mënyrë që ato të mos i afrohen shkollave, masë e cila i shërben rritjes së sigurisë publike në shkolla.

- Mbikëqyrja elektronike aplikohet edhe për personat që ushtrojnë dhunë në familje. Ato persona që do të kenë urdhër mbrojtjeje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, nuk do kenë mundësi t'u afrohen banesave të bashkëshorteve, sipas një perimetri që do të caktojë gjykata, duke rritur sigurinë e subjekteve të dhunës në familje.

- Mbikëqyrja elektronike përdoret në rastet kur me vendim gjyqësor kufizohet liria dhe ndaj personit ushtrohet kontroll nëpërmjet pajisjeve elektronike por, në të njëjtën kohë, ky person ka mundësi të zhvillojë jetën e tij brenda familjes dhe të ndërmarrë iniciativa si p.sh., të kryejë kurse dhe stazhe për formimin e tij profesional apo të ndjekë edhe shkollën, mundësi këto që shërbejnë për lehtësimin e rifutjes së tij në shoqëri. Në këtë mënyrë mbikëqyrja elektronike do të jetë një favor për të dënuarit në moshë të re, të cilët duan të ndjekin shkollën apo kurset profesionale.

¹⁰ Të parashikuara nga shkronjat “a”, “c” dhe “d” të nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale.

¹¹ Të parashikuara nga nenet 58, 59, 59/a dhe 64 të Kodit Penal.

¹² Të parashikuar në paragrafin e shtatë të nenit 30 të Kodit Penal.

¹³ Sipas neneve 17 dhe 19 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

- Mbikëqyrja elektronike realizohet nëpërmjet vendosjes së një pajisjeje të posaçme në trupin e subjektit, e cila duhet: “a) të ketë përmasa të vogla, në mënyrë që të mbulohet lehtësisht nga veshjet dhe të mos shikohet nga të tretët; b) të mos lëshojë tinguj ose dritë; c) të përbëhet nga materiale të parrezikshme për jetën dhe shëndetin e subjektit dhe të të tretëve; ç) të vendoset në një pjesë të trupit që e bën të pamundur shikimin e saj nga të tretët; d) të lejojë subjektin të kryejë pa vështirësi të gjitha veprimtaritë e tij të zakonshme”¹⁴.

Ligi përcakton edhe kushtet teknike që duhet të përmbushë pajisja: “a) të jetë në gjendje të transmetojë sinjal nga çdo pjesë e territorit të Republikës së Shqipërisë; b) të ketë rezistencë të lartë ndaj elementeve natyrore, e cila mundëson funksionimin normal edhe gjatë ekspozimit ndaj tyre; c) të jetë e vështirë për t’u hequr; ç) të transmetojë sinjal të posaçëm nëse dëmtohet ose hiqet”¹⁵.

B. Kushtet dhe mënyra e aplikimit të mbikëqyrjes elektronike

Mbikëqyrja elektronike vendoset vetëm me vendim gjyqësor. Gjykata vendos përdorimin e mbikëqyrjes elektronike, kryesisht ose me kërkesën e prokurorit, subjektit, mbrojtësit të tij, të dëmtuarit nga vepra penale, viktimës apo prindërve ose kujdestarit të të miturit. Procedura e vendosjes nën mbikëqyrje elektronike parashikon që gjykata, përpara caktimit të masave shtrënguese, shpalljes së vendimit përfundimtar të gjykatës, apo lëshimit të urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, pyet subjektin nëse jep pëlqimin për përdorimin e mbikëqyrjes elektronike dhe i shpjegon atij të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i saj.

Duhet të kemi parasysh që përdorimi i mbikëqyrjes elektronike vendoset vetëm me pëlqimin e subjektit dhe pasi gjykata sigurohet se ai i kupton të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i mbikëqyrjes elektronike, me përjashtim të rastit kur vlerëson se është e domosdoshme për të garantuar të drejtat kushtetuese të të tretëve dhe ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova, se subjekti paraqet rrezikshmëri për cënimin e këtyre të drejtave¹⁶.

¹⁴ Neni 13 i Ligjit nr.10494, datë 22.12.2011, “Për mbikëqyrjen elektronike...”

¹⁵ Neni 13 i Ligjit nr.10494, datë 22.12.2011, “Për mbikëqyrjen elektronike...”

¹⁶ Këtu kemi parasysh rastet e dhunës në familje. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi, vetëm nëpërmjet ankimit të vendimit gjyqësor që lëshon urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, sipas parashikimeve të nenit 21 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Forma e dhënies së pëlqimit të subjektit për përdorimin e mbikëqyrjes elektronike është me shkrim ose nëpërmjet deklarimit në seancë gjyqësore. Në rastin e subjekteve të mitura, pëlqimi duhet të jepet në të njëjtën formë edhe nga prindërit ose kujdestari i tij ligjor. Nëse subjekti nuk jep pëlqimin ky fakt mbahet në konsideratë prej saj, së bashku me rrethanat e tjera të çështjes, në përcaktimin e masës shtrënguese apo dënimit.

Subjekti i cili jep pëlqimin për përdorimin e mbikëqyrjes elektronike ka disa detyrime:

- a) të zbatojë kushtet e përcaktuara në vendimin gjyqësor;
- b) të vendosë në dispozicion të gjykatës, prokurorit dhe organit që realizon mbikëqyrjen elektronike, adresën e saktë të banimit dhe të punës, si dhe numra telefonikë kontakti, të cilët duhet të jenë të pranishme në çdo kohë;
- c) të kthehet brenda zonës së lejuar të lëvizjes ose të largohet nga zona e ndaluar, brenda 30 minutave nga çasti kur është kontaktuar nga salla operative;
- ç) të mos dëmtojë ose të heqë në asnjë rast pajisjen;
- d) të njoftojë menjëherë organin që realizon mbikëqyrjen elektronike për çdo dëmtim aksidental të pajisjes ose funksionimin në kushte jonormale të saj.

Vendimi gjyqësor që urdhëron përdorimin e mbikëqyrjes elektronike, përveç sa parashikohet në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, të ndryshuar, duhet të përmbajë, sipas rastit, edhe: a) dhënien e pëlqimit nga subjekti, kur këtë e kërkon ligji, dhe/ose prindërit apo kujdestari i të miturit, për përdorimin e mbikëqyrjes elektronike; b) zonat e lejuara dhe zonat e ndaluara të lëvizjes së subjektit; c) detyrimin e subjektit për të qëndruar brenda zonës së lejuar ose për të mos hyrë në zona të ndaluara; ç) kohën e përdorimit të mbrojtjes elektronike, nëse gjykata urdhëron përdorimin e saj, sipas një afati të caktuar.

Gjykata, gjatë gjykimit përpara dhënies së vendimit, në rastet e dhënies së një nga alternativave të dënimit me burgim ose kur jep dënim plotësues i kërkon Shërbimit të Provës një raport vlerësimi për të pandehurin dhe nevojën e përdorimit të mbikëqyrjes elektronike. Shërbimi i Provës është organ përgjegjës për të kontrolluar mënyrën e realizimit të mbikëqyrjes elektronike, i cili në mënyrë periodike, informon Ministrinë e Drejtësisë për kontrollet e ushtruara për mënyrën e realizimit të mbikëqyrjes elektronike. Në realitet, pajisja vendoset dhe hiqet vetëm nga personat e autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

Shërbimi i Provës, menjëherë pas vendosjes së pajisjes, pasi verifikon rregullshmërinë e saj, njofton Prokurorinë dhe Policinë e Shtetit për fillimin e ekzekutimit të vendimit, zonën e lejuar dhe të ndaluar të lëvizjes së personit, si dhe kohën e përdorimit të mbikëqyrjes elektronike, nëse gjykata urdhëron përdorimin e saj, sipas një afati të caktuar.

Përdorimi i mbikëqyrjes elektronike mund të jetë me ose pa afat. Nëse gjykata nuk ka përcaktuar afat, kohëzgjatja e përdorimit të mbikëqyrjes elektronike është e barabartë me kohëzgjatjen e masës shtrënguese, alternativës së dënimit me burgim, urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

KONKLUSIONE:

Aplikimi i mbikëqyrjes elektronike në vendin tonë sapo ka filluar dhe është ende herët që të arrihet në një konkluzion përfundimtar, si dhe të metat që mund të paraqesë ky mekanizëm. Megjithatë avantazhet e këtij mekanizmi duhet të jenë ulja e popullsisë në burgje, eficienta e kostove dhe trajtimi më njerëzor i personave, parandalimi i recidivizmit.

Evidentimi i vështirësive teknike që mbikëqyrja elektronike mund të paraqesë në praktikë dhe impakti psikologjik që mund të ketë tek personi të cilit i vihet byzylyku elektronik, duhet të analizohen në një moment të dytë, gjë që do të mundësojë krahasimet me eksperiencën e vendeve të tjera që e aplikojnë prej vitesh atë.

Përdorimi i teknologjisë për të dhënë përgjigje sa më të përshtatshme penale ndaj situatave të kriminalitetit dhe të sistemit të vuajtjes së dënimit kërkon angazhimin e gjykatës, prokurorisë, policisë, shërbimit të provës, drejtorisë së burgjeve për njohjen dhe implementimin sa më efikas të saj.

LITERATURA:

1. DIGNEFFE F. & MOREAU TH. (dir.), *La responsabilité et la responsabilisation dans la justice pénale*, Bruxelles, De Boeck-Larcier, 2006.
2. Devresse M.S. : *Innovation pénale et surveillance électronique : quelques réflexions sur une base empirique*, <http://champpenal.revues.org/1641>; <http://droitcultures.revues.org/2509>.
3. Devresse M.S. : *Surveillance électronique et justice pénale : quelques éléments de pérennité et de changement*, <http://droitcultures.revues.org/2509>.
4. CAMILLE A., « Le placement sous surveillance électronique : espace et visibilité du châtement virtuel », *Champ pénal/Penal field* [En ligne], Vol. XI | 2014, URL : <http://champpenal.revues.org/8791> ; DOI : 10.4000/champpenal.8791.

5. J.C. CERE: La surveillance électronique : une réelle innovation dans le procès pénal ?, Revista da Faculdade de Direito de Campos, AnoVII, N° 8, Junho de 2006, fq.105, <http://jpcere.fr/Jean-PaulCere.pdf>.
6. Froment J.-C, 1998, La surveillance électronique à domicile : une nouvelle économie du pouvoir de punir ?, *Les cahiers de la sécurité intérieure*, 3, 149-168.
- 7.A. Kensey: *Prison et récidive, des peines de plus en plus longues, la société est-elle vraiment mieux protégée ?* Editions Armand Colin, 2007.
8. A. Kensey, A. Benaouda, « *Les risques de récidive des sortants de prison. Une nouvelle évaluation* », Cahiers d'études pénitentiaires et criminologiques, n°36, mai 2011.
9. Lévy R. et Pitoun A. : « L'expérimentation du placement sous surveillance électronique en France et ses enseignements (2001-2004) », *Déviance et Société*, 2004/4 Vol. 28, p 411-437.
10. MOREAU TH. ET REYNAERT P. : « *La surveillance électronique : liberté virtuelle ou prison virtuelle ?* » in Adrien Masset (dir.), *L'exécution des condamnations pénales*, Liège, Anthémis, 2008, p. 191-244.
- 11.Olivier Bloas: *Bracelet électronique : Le bilan contrasté du placement sous surveillance électronique*, SciencesPo Rennes, <http://scprennes.hypotheses.org/134>.
12. Poncela P : *La surveillance électronique de fin de peine*, RSC, Chroniques, Juillet-septembre 2011, p. 681-689.
- <http://www.cep-probation.org/>
- <http://www.justice.gouv.fr/>

KUADRI LIGJOR MBI SHTYPIN DHE RADIOTELEVISIONIN SI MJETE PËR USHTRIMIN E SË DREJTËS PËR INFORMIM

Irma Baraku

Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Drejtësisë

Legal framework on the press and radio television as a tool to exercise the right to information

One of the essential problems in an “information society” is related to the place of the individual (in this society), as a subject of fundamental rights and freedoms. In this regard freedom of information is placed in the spotlight. We can already say that the right to information means the freedom to provide information, as well as the freedom to receive information. Freedom to provide information underlies the freedom of media, and protects not only the right to information of the journalist or editor responsible for the information transmitted, but also the sources of information. Is it necessary for the state to regulate by law the functioning of the press, or it must follow its way as any other private enterprise? What are the models that different countries can offer us in this regard? Does the Radio and Television function in the same way as the press? Do we exercise the right to information, through these means, in an absolute or a limited manner? These are the questions to which we try to give answers through this paper, focusing on a comparative perspective of the legal framework of these communication tools.

1. Vështrim teorik mbi lirinë e shprehjes dhe të shtypit

Duke iu referuar shoqërisë në të cilën jetojmë, e kemi të pamundur të mos evidentojmë se informacioni është tashmë një kusht përcaktues për disa komponentë të saj, që kanë të bëjnë jo vetëm me zhvillimin ekonomik, por edhe me realizimin e disa funksioneve të rëndësishme të qenieve sociale, siç është formimi i opinionit publik, i lidhur ngusht me

vendimmarrjet politike, të cilat kondicionojnë pastaj edhe jetën sociale¹⁷. E drejta për të informuar ka gjetur rregullim ligjor kushtetues, duke u trajtuar edhe në kuadrin e lirisë së shprehjes. Shoqëria demokratike është e lidhur ngusht me respektimin e të drejtave themelore të njeriut, aq sa është kristalizuar ideja se “*Demokracia dhe liria e shprehjes kanë bashkëjetuar gjatë dhe nuk mund të ekzistojnë të ndara*”¹⁸; për më tepër, pavarësisht se në çfarë formë realizohet liria për të komunikuar dhe liria e shprehjes, ato nuk mund të trajtohen ndryshe përveçse si të drejta themelore të njeriut.

Rëndësia që ka e drejta për t’u informuar dhe për të qenë i informuar, s’do të thotë se kjo e drejtë nuk ka limite. Edhe në shoqëritë më demokratike, ka kufizime për shkaqe private dhe për shkaqe publike. Në këto kufizime, marrin rëndësi të veçantë ato, të cilat prekin disiplinimin e mjeteve të komunikimit. Përdorimi i mjeteve të informimit rrit efektet e vetinformacionit në mënyrë të atillë që gjeneron një pushtet të veçantë, të quajtur pushteti i katërt. Pra në “shoqërinë e sotme të informacionit”¹⁹, në diskutimet e përsiatjet filozofike e sociologjike, zë vend “*domosdoshmëria e një regjimi juridik për të disiplinuar prodhimin, mbledhjen, klasifikimin, përdorimin dhe komunikimin e informacionit*”²⁰.

Në ditët e sotme vërehet një prirje e përgjithshme (e dukshme në mënyrë të qartë në SHBA, Evropë e Japoni), për të pasur më pak rregulla dhe më shumë konkurrencë përsa i takon rregullimit të regjimit juridik të mjeteve të realizimit të lirisë së shprehjes dhe të informimit. Kjo tendencë shprehet në raport me shtypin dhe radiotelevizionin, megjithëse këto nuk janë të vetmet forma të realizimit të komunikimit. Kjo është karakteristikë kryesisht e “*demokracive që i mbeten besnike filozofisë liberale jo vetëm*

¹⁷ Në lidhje me këtë ide gjejmë qëndrime të ndryshme të analizuara nga Daniel Bell (Sociolog, shkrimtar, botues dhe profesor në Universitetin e Harvard-it) apo Alain Touraine (sociolog i njohur francez) cituar nga PIETRANGELO M. “La società dell’informazione tra realtà e norma”, Giuffrè Editore, 2007, f. 7.

¹⁸ GUIDI G., “La società dell’informazione: libertà, pluralismo, risorse”-DIRITTO PUBBLICO COMPARATO ED EUROPEO- Atti del convegno dell’Associazione di San Marino, 30 Settembre 2005, G.GIAPPICHELLI EDITORE, 2006, f. 2.

¹⁹ Mattelart, mendon se, ky term u përdor për herë të parë nga “Organizata për Kooperim dhe Zhvillim Ekonomik në vitin 1975, ndërsa për James Beniger, ky term përdoret për herë të parë nga ekonomisti Fritz Machlup gjatë studimeve të tij mbi sektorët e ekonomisë që kishin të bënin me prodhimin e shpërndarjen e njohurive; Manuel Castells pohon se ky term ka lindur në vitet 50 në Japoni dhe është zhvendosur drejt Evropës në vitin 1978.

²⁰ CORDINI G., Società dell’informazione e diritti costituzionali, në “La società dell’informazione: libertà, pluralismo, risorse”-Atti del convegno dell’ Associazione di Diritto Pubblico Comparato ed Europea, G.Giappichelli Editore, 2006 -Konferencë e mbajtur në San Marino, 30 Shtator 2005, f. 68-69.

*me fjalë*²¹. Zëvendësimi i rregulloreve autonome me dispozita antimonopol të shoqëruara me krijimin e transmetuesve privatë, po lëshon terren tashmë për realizimin e infrastrukturës së domosdoshme për qarkullimin e informacionit, si një element i domosdoshëm i shoqërive ku jetojmë, i cili qëndron në themel të proceseve globalizuese, ku gradualisht po zë vend revolucioni numerik²² në fushën e radiotelevizionit.

Mjetet për të realizuar lirinë e shprehjes gjenden mes respektimit të ligjeve të konkurrencës dhe disa përjashtimeve prej tyre, shmangies nga logjika e ekonomisë së tregut. Rregullat e funksionimit të shtypit pavarësisht se mbështeten në parimin e konkurrencës, ndryshojnë nga vendi në vend. Shtypi anglez është një shembull gati i përsosur i regjimit konkurrues, sepse duke mos qenë objekt i asnjë ligji të veçantë, i nënshtrohet rregullave që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe për të përcaktohen vetëm masa fiskale që mbrojnë konkurrencën. Të njëjtat parime vlejnë edhe për shtypin francez ku gjejmë *“mungesën e një autorizimi paraprak, konkurrencën ndërmjet burimeve të informacionit dhe të organeve të shprehjes”*²³, këtu vlen të evidentohet një qëndrim i konsoliduar tek studiuesit e mediave mbi dallimin mes *“informimit përmes shtypit”* dhe *“informimit përmes radio-televizionit”*: e para identifikohet me *“të drejtën e çdo personi për t’i komunikuar të tjerëve, pa ndërhyrje rezultatet e bindjeve të tij kulturore, artistike e politike”*, duke u ofruar mbrojtje ligjore atyre; tek e dyta *“subjekti të cilit i ofrohet mbrojtja e së drejtës për informim nuk është autori, por subjekti të cilit i drejtohet informacioni, që ka të drejtën për të marrë një produkt të karakterizuar nga pluralizmi, paanësia dhe plotësia”*²⁴.

2. Rregullimi ligjor i lirisë së shtypit

Zanafilla e lirisë së shtypit si një e drejtë e mbrojtur nga ligji, ndeshet për herë të parë në kushtetutën suedeze të vitit 1766, e cila sanksionon si parim bazë “ndalimin e censurës” për të vazhduar me ligjet e mëvonshme që sollën edhe një sërë principesh të tjera: caktimin e një përgjegjësi botimi, mbrojtjen e burimeve të informimit, parimin e aksesit të

²¹ BELLE F., Media dhe Shoqëritë- botim- shtyp- kinema- radio- televizion- internet, Papirus, UET press, 2011, f. 245.

²² Procesi i transmetimeve numerike audiovizuale.

²³ BELLE F., Media dhe Shoqëritë- botim- shtyp- kinema- radio- televizion- internet, Papirus, UET press, 2011, f. 247.

²⁴ Shih: GARRONE B. G., Appunti di diritto pubblico dell’ informazione e della comunicazione, Justutiam Colimos, Torino, 1998, f. 58.

lirë në dokumentet zyrtare, ligjin mbi shpifjen që mbron individët. Të njëjtin rregullim ka bërë Shteti i Virxhinias në Kartën e të Drejtave të Virxhinias në vitin 1776, e cila sanksionoi se *“Liria e shtypit është një nga mburojat e fuqishme të lirisë dhe s’mund të kufizohet, veçse nga qeveritë demokratike”*. Ky parim ripohohet në amendamentin e parë të vitit 1791 të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sipas të cilit *“Kongresi nuk do të nxjerrë asnjë ligj që kufizon lirinë e fjalës apo të shtypit”*. Në nenin 10 të Deklaratës të së Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit theksohet se *“Askush nuk duhet të ndëshkohet për opinionet e veta”*, gjë që përforcohet edhe me një dispozitë tjetër (neni 11), ku mbrohet liria e botimit e shoqëruar edhe me kufizime të natyrës legjislative. Ligji themelor gjerman²⁵ i vitit 1949 thekson se *“nuk ka censurë”*; Revolucioni francez i vitit 1789, për herë të parë, e përçon lirinë e shtypit përmes termave universale, ndërsa në shekullin XIX, bëhet një nga format e lirisë së shprehjes së opinioneve, që ligji francez i vitit 1881 e sanksionon. Në embrion kemi disa përpjekje për të konsoliduar mendimin liberal mbi lirinë e shtypit, gjithmonë brenda disa kornizave të caktuara që imponon koha²⁶.

Shekulli XIX shoqërohet nga lëvizje të reja në këtë fushë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtrinë mbrojtjen e lirisë së shprehjes nëpërmjet shtypit edhe mbi mjetet e tjera të shprehjes së opinioneve; disa vende s’kanë ligj mbi shtypin; disa e rregullojnë këtë nëpërmjet dispozitave kushtetuese (Italia, 1948, Suedia, 1949, Spanja, 1979); disa vende e rregullojnë nëpërmjet legjislacionit të landeve apo kantoneve (Zvicra dhe Gjermania Federale). Institucionet me autoritet moral në ushtrimin e profesionit të gazetarit, shpesh nuk konsiderohen si mjete të mirëfillta për lirinë e shtypit.

Të gjitha këto fakte tregojnë se ekzistenca e një ligji mbi shtypin, nuk është detyrues faktor përcaktues i lirisë së shtypit. Shembull i kësaj është dëshmia, e cila vjen nga historia e shtypit anglez. Pavarësisht se nuk ka një ligj për shtypin, Britania e Madhe, është vendi ku lindi shtypi i madh modern; ku u përdorën teknologjitë e reja; ku u futën formulat e reja (si ajo e cilësisë dhe e vërtetësisë së informacionit); ku lindi *“gazetaria e re”* që konsiston në një shumëllojshmëri rubrikash dhe paraqitjeje të re. Të gjitha

²⁵ Bëhet fjalë për Republikën Federale të Gjermanisë.

²⁶ Në vitin 1644 John Milton (poet anglez), kërkonte lirinë për të shtypur pa autorizim e pa censurë, brenda caqeve të kërkimit të së vërtetës kristiane; kjo ide e rikthyer në vitin 1965 nga Herbert Marcuse (sociolog, filozof dhe studiues i teorive politike gjerman), i konsideruar si autori i tolerancës represive sipas të cilit *“the telos of tolerance is truth”*. Për më tepër shih BELLE F., Media dhe Shoqëritë-botim-shtyp-kinema-radio-televizion-internet, Papirus, UET press, 211, f. 249.

këto nuk mund të shihen të lidhura me ekzistencën e një ligji, por me faktin se “*instrumentet e lirisë i përkasin kulturës politike të Britanisë së Madhe*”²⁷.

Një vend të veçantë zë teoria liberale e informacionit²⁸, e zhvilluar nga fundi i shekullit XVIII, deri në fillimin e shekullit XX, e cila vendos parime të rëndësishme si më poshtë:

Ekuivalenca mes lirisë së mendimit dhe lirisë së shtypit. Historia e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, ka treguar se përpjekjet për të ushtruar lirinë e shprehjes së mendimit, janë bërë njëkohësisht me përpjekjet për të mbrojtur mjetet me të cilat realizohet liria e shprehjes së opinionëve. Në këtë këndvështrim liria e shprehjes së mendimit, shihet tashmë si një liri që shkon paralel me lirinë e shtypit.

Kundërshtimi i parimit të autoritetit. Kundërshtimi i parimit të autoritetit, është i lidhur ngusht me konceptin se, e vërteta nuk mund të jetë monopol i askujt; çdokush ka të drejtën të shprehë opinionin e vet për realitetin dhe kjo s’ mund t’iu imponohet të tjerëve si një e vërtetë absolute. Duke u thelluar kjo ide shkon deri në mungesën e kërkimit të autorizimit, që do të hapte rrugën për një kontroll paraprak e censurë.

Pluralizmi. Pluralizmi është një parim që përfshin si pluralizmin në burimet e informimit, ashtu edhe në organet e informimit. Duke mbështetur këtë parim, liberalët vendosin konkurrencën në bazë të funksionimit të lirisë së shtypit; pra ky është një kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për funksionimin e lirisë së shtypit. Kjo është një teori që përshkohet nga optimizmi që pluralizmi do të ketë një rezultat të dukshëm; e vërteta do të ketë mundësi të evidentohet dhe lajmi i mirë do të triumfojë.

Kur flasim për lirinë e mediave, shpesh autorët mendojnë se kjo është një luftë që nuk mbaron kurrë. Teoria liberale e trajtuar më sipër, nuk i eliminoi dot sfidat e kësaj lirie gjatë kohës që ajo në fakt njohu mbështetje dhe elaborim. Mund të flasim për dy sfida të mëdha që duheshin përballuar në shekullin XX²⁹:

- Sfida që lidhej me lindjen e revolucionit bolshevik në vitin 1917 dhe efektet e saj, i shtriu deri në vitet ’90-të. Ajo karakterizohej nga

²⁷ BELLE “Media dhe Shoqëritë-botim-shtyp-kinema-radio-televizion-internet”, Papirus, UET press, 211, f. 263-266.

²⁸ Koncepti liberal i informimit gjendet i trajtuar hollësisht tek: BELLE F., Media dhe Shoqëritë- botim-shtyp-kinema-radio-televizion-internet, Papirus, UET press, 211, f. 249.

²⁹ Koncepti liberal i informimit gjendet i trajtuar hollësisht tek: BELLE F., Media dhe Shoqëritë- botim-shtyp-kinema-radio-televizion-internet, Papirus, UET press, 2011, f. 252-258.

rehabilitimi i parimit të autoritetit. Kjo ide evoluoi, nga ideja marksiste sipas të cilës *“përmbysjet e mëdha që sjellin revolucionet në çdo fushë duhet të shtrihen edhe tek liria e shtypit”* tek ideja leniniste se *“shtypi duhet të jetë një mjet propagande dhe një hallkë e transmetimit të saj tek publiku”*.

- Sfida me të cilën liria duhej të përballej pas vitit 1945, lidhet me qëndrimin e disa eseistëve amerikanë dhe evropianë, të cilët kanë në thelb idenë e *“përgjegjshmërisë shoqërore të mediave”*. E lindur njëkohësisht me shpikjen e televizionit, por edhe me nevojën për ndryshime të shumta pas katastrofës së Luftës së Dytë Botërore, me një sërë kritikash për rolin e shtypit dhe të shkeljes së shpeshtë të moralit publik e të jetës private të qytetarëve; nënshtrimin ndaj *“biznesit të madh”*, teoria liberale nuk mundi të shmangë e as të fitojë përballjen me sfidën në fjalë.

Vitet '80-të, u karakterizuan nga një zhvillim, që ka në thelb kundërshtimin dhe akuzat ndaj shtypit. Kjo situatë shoqërohet nga mundësia për të ndryshuar bashkë me të edhe qëndrimet ndaj tij. Vitet '90-të, shënojnë rilindjen e fuqishme të medieve nëpërmjet diskursit ideologjik. Ato ishin faktorë të padiskutueshëm në ndryshimet e sistemeve politike dhe shoqërore të një pjese të madhe të botës, konkretisht të regjimit të shteteve ish-komuniste në Evropën Lindore dhe Qendrore.

Luhatjet e mësipërme janë evidentuar edhe në raportet e Freedom of House, e cila monitoron ndër të tjera edhe lirinë e shtypit prej vitit 1980. Bazuar në indeksin *“Për lirinë e shtypit”* (Freedom of House) arrihet në përfundimin se *“Tani liria e shtypit është në rënie pothuajse në çdo vend të botës. Vetëm 15% e qytetarëve të botës jetojnë në vende që gëzojnë lirinë e shtypit. Në pjesën tjetër të botës, qeveritë dhe aktorët joshjetërorë kontrollojnë këndvështrimin e qytetarëve dhe shtypin brutalisht zërat e pavarur që synojnë të promovojnë llogaridhënien, qeverisjen e mirë dhe zhvillimin ekonomik”*³⁰.

Të njëjtin qëndrim mbajnë edhe *“Reporterët pa Kufij”*, kur analizojnë situatën aktuale të zhvillimit dhe respektimit të lirisë së shtypit. Në vitin 2010, Sekretari i Përgjithshëm i *“Reporterë pa kufij”*, tha se *“Më shumë se asnjëherë më parë ne mund të shohim se zhvillimet ekonomike, reformat institucionale dhe respektimi i të drejtave themelore të njeriut, jo domosdoshmërisht shkojnë dorë për dorë. Mbrojtja e lirisë së medias vazhdon të jetë një luftë, një luftë për ta ruajtur në vendet e Evropës së*

³⁰ Shkarkuar nga: www.freedomhouse.org/report-types/freedom-press, datë 23.01.2012.

vjetër dhe një luftë kundër shtypjes dhe padrejtësisë në regjimet totalitare përreth botës”.

Finlanda, Islanda, Holanda, Norvegjia, Suedia dhe Zvicra, janë në krye të listës si vende me nivelin më të lartë të respektimit të të drejtave të medias. Por, në raportin e vitit 2010, shprehet shqetësimi se shumë vende të Bashkimit Evropian, po bien në indeksin që tregon nivelin e respektimit të së drejtës së medias, duke rrezikuar që të humbë statusin e shembullit për t’u ndjekur, duke dobësuar dhe pozicionin e tij përballë kërkesave ndaj vendeve me regjime autoritare për të marrë masa. 13 vende nga 27 janë në 20 vendet e para të indeksit, ndërsa 14 të tjera janë në vende shumë më të ulëta, p.sh., Italia në vendin 49-të, Rumania në vendin e 52-të, Greqia dhe Bullgaria në të 70-in.

Nuk ka pasur progres në disa vende ku, “Reporterët pa kufij”, evidentojnë një sërë problemesh. Për Francën dhe Italinë, pasqyrohen probleme, të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e mbrojtjes së burimeve të gazetarëve, përqendrimin e vazhdueshëm të pronësisë mbi median, rritjen e ankimeve të nënpunësve qeveritarë ndaj gazetarëve dhe punës së tyre dhe padive gjyqësore.

3. Rregullimi ligjor i lirisë së radiotelevizionit

Vitet 70-të, 80-të, karakterizohen nga lidhja e debatit për liritë publike dhe mediat me liberalizimin e mjeteve audiovizuale në Evropë. Lindi një përprjekje e fuqishme që kjo fazë të karakterizohej nga mbështetja e asaj që quhet “e drejta për komunikim”, duke e konsideruar tashmë “lirinë e informimit”, si një aspekt të jetës së qytetarëve, e cila jo vetëm duhet zgjeruar, por edhe duhet pasuruar, duke përqendruar vëmendjen edhe tek mjetet e tjera të komunikimit. E gjitha kjo mbështetet në dy faktorë të rëndësishëm: mundësitë që sjellin teknologjitë e reja dhe krijimin tashmë të një shoqërie komunikimi, ku lind detyrimi i shtetit për hartimin e politikave të komunikimit”³¹.

Filozofi dhe sociologu francez, Jean Stoetzel mendon se, është e domosdoshme që të mbahet parasysh se shtypi ka një sërë funksionesh, ku njëri është funksioni “zyrtar” i informimit, por ka edhe funksione të tjera: shtypi nëpërmjet informacionit që shpërndan, lehtëson përfshirjen e individit dhe identifikimin e përkatësisë së tij në një grup të caktuar; ai është një mjet për t’u argëtuar; shtypi realizon funksionin katartik, ku

³¹ BELLE, F., Media dhe Shoqëritë-botim-shtyp-kinema-radio-televizion-internet, Papirus, UET press, 211, f. 261. Sqaro për inicuesin e eurovizionit për këtë koncept.

subjekti zhvishet nga pasionet apo realizon ndjenjën e tij të protestës³². Këto aspekte dhe funksione të tjera të lirisë së shtypit, tërheqin vëmendjen tek mjetet e tjera të komunikimit, të cilat krijojnë kushtet për një kapërcim cilësor të shoqërisë së sotme nga e drejta për informim në të drejtën për të komunikuar.

Zhvillimi i televizionit dhe rregullimi juridik i regjimit të tij juridik, ka karakteristika të ndryshme jo vetëm në shtete të ndryshme, por edhe në kontinente të ndryshme. Kështu televizioni në Evropë është i shumëllojshëm për sa u takon rregullave përmes të cilave rregullohet pozicioni i tyre juridik dhe motiveve të kuptimit të tyre. Por, ka një karakteristikë të përbashkët mes tyre, sepse ndryshe nga televizioni amerikan, televizioni evropian “*lindi në hije të monopoleve publike, përmes përpjekjes për një regjim juridik evropian që i karakterizon televizionet, por edhe bën dallimin mes tyre. Këto përpjekje kanë të bëjnë me nevojën për të përcaktuar organizimin, funksionimin dhe shkallën e lirisë që gëzojnë këto televizione*”³³. Duke iu referuar eksperiencës së shteteve evropiane, mund të pranojmë se zhvillimi i radiotelevizioneve, ka kaluar përmes tri fazave:

a. Futja e formave të monopolit publik. Legjislacioni evropian, është motivuar nga konsiderata principialisht teknike: para së gjithash nga nevoja për të planifikuar instalimin e impianteve të transmetimit me qëllim evitimin e ndërhyrjeve; futjen e një modeli të menaxhimit të shpërndarjes së valëve të radios dhe televizionit të tipit monopolist. Rezultati ishte që shumë iniciativa private më të dobëta u zhdukën, ndërsa emetuesit më të fuqishëm shndërrohen në shoqëri prevalente ose me kapital të plotë publik. Kontrolli shtetëror mbi konçensionarin publik shfaqen në dy drejtime:

- ✓ emërimin e organeve drejtuese dhe menaxhimit e buxhetit të tyre;
- ✓ hartimin dhe mbikëqyrjen e programacionit të tyre.

Thelbi i debatit politik dhe publik, ka të bëjë me nevojën për të shtrirë edhe mbi informimin (përmes radiotelevizionit), mbrojtjen kushtetuese dhe ligjore, që i bëhej lirisë së shtypit. Me fjalë të tjera, lindi si domosdoshmëri, që veprimtaria radiotelevizive të përfshihej brenda lirisë së shprehjes së mendimit.

³² BELLE F., Media dhe Shoqëritë-botim-shtyp-kinema-radio-televizion-internet, Papirus, UET press, 211, f. 625- 626.

³³ Sipas autorit, Evropa, ka kaluar në tri faza për të arritur tek situata sot: ekzistenca e një monopoli që imponon një program për të gjithë vendin; kur të njëjtët përgjegjës ofrojnë programe të ndryshme; pluralizmi në kuptimin e sotëm kur përgjegjës të ndryshëm ofrojnë secili programet e veta. Shih: BELLE, F., Media dhe Shoqëritë-botim-shtyp-kinema-radio-televizion-internet, Papirus, UET press, 2011, f. 246-347.

b. Reforma e regjimit ligjor të monopolit. Njohja e legjitimitetit të rolit të shtetit si menaxhues i drejtpërdrejtë i mjeteve, atje ku kërkesat për pluralizmin e informacionit nuk mund të kënaqen ndryshe.

c. Kriza e monopolit dhe zëvendësimi me një sistem të përzier publik e privat. Gjithë ky proces solli në një rezultat të pakundërshtueshëm të kalimit nga monopolizimi i informimit tek informimi i lirë dhe pluralist. Veçanërisht në fazën e tretë, mund të themi se shfaqen disa dukuri të rëndësishme, që nuk duhen anashkaluar si:

- kontrolli legjislativ merr përparësi ndaj atij ekzekutiv;
 - korrigjohet tashmë modeli i monopolit publik në këtë fushë;
 - vendosjen e një lidhjeje të ngushtë mes strukturave radiotelevizive dhe autoriteteve vendore;
 - përdorimin e radiotelevizionit në favor të grupeve sociale të veçanta.
- Ndërsa fazat e mësipërme ishin karakteristika të shteteve më të zhvilluara të Evropës. Mund të themi që shtetet e tjera kaluan në fazat e mëposhtme:
- liberalizimin e mjeteve të komunikimit me kabëll dhe me eter;
 - liberalizimin në nivelin lokal të radiofonisë;
 - ✓ liberalizimin në nivelin lokal të rrjeteve televizive me kabull
 - ✓ liberalizimin në nivelin kombëtar të radios dhe të televizionit.

Evidentohen tashmë iniciativa private të privuara nga qëllime fitimi (p.sh., në Belgjikë, Zvicër, Suedi, Norvegji, Holandë) ose shoqëri tregtare të vërteta (Angli, Francë, Gjermani, Spanjë). Këto iniciativa i nënshtrohen kontrollit të institucioneve, që derivojnë apo varen nga qeveria apo që funksionojnë si organe të pavarura.

Disiplinat anti-trust mbi bazën e direktivave komunitare parashikojnë³⁴:

- përcaktimin normativ të nivelit maksimal të përqendrimit;
- paracaktimin e një sërë detyrimesh për transparencë;
- vënien e reklamave nën kontrollin e grupeve sociale, apo të sipërmarrjeve, që veprojnë në fushën e teleradiodifuzionit.

Në Shqipëri, ka rregullim ligjor të detajuar në këtë fushë. Shqipëria duhet thënë se ka ndjekur të njëjtën rrugë me shtetet e tjera, përse u takon etapave të zhvillimit të transmetimeve radiotelevizive. Duke qenë se radiotelevizioni shqiptar shtetëror, ka ofruar për një kohë të gjatë produktet radiotelevizive, ai vazhdon të gjejë një rregullim të gjerë ligjor, si: “*institucioni që kryen shërbim publik në fushën e radios dhe të televizionit*”. Paraprakisht dëshirojmë të theksojmë se, pavarësisht legjislacionit ekzistues në fushën e politikës audiovizuale, ka nevojë për ndërhyrje të rëndësishme. Progres -

³⁴ GARRONE B.G., Appunti di diritto pubblico dell' informazione e della comunicazione, Justitiam Colimos, Torino, 1998, f. 68.

Raporti për vitin 2011 evidenton se “Legjislacioni shqiptar është akoma pjesërisht i harmonizuar me standardet evropiane për rregullimin e medias dhe me Direktivën e Shërbimeve të Medias Audiovizuale... Afati për kalimin në sistemin dixhital është shtyrë nga fundi i vitit 2012 në fund të 2015; deri tani nuk janë marrë masa konkrete për këtë kalim, si dhe nuk është miratuar ende strategjia e dixhitalizimit”³⁵.

Regjimi juridik i radiotelevizionit në Shqipëri përcaktohet me një ligj,³⁶ i cili ka si objekt të tij të rregullojë “veprimtarinë e radios dhe televizionit publik e privat në territorin e Republikës së Shqipërisë”(neni 1). Ka rëndësi të përcaktohen disa parime të rëndësishme për ushtrimin e veprimtarisë së radiotelevizionit, për të cilat ligji shqiptar mban qëndrim të ngjashëm edhe me legjislacionet e tjera të shteteve demokratike:

- Veprimtaria radiotelevizive është e lirë.
- Veprimtaria radiotelevizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, jetën private të njeriut, si dhe të drejtat e liritë themelore të tij.
- Në këtë veprimtari respektohen në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve.
- Veprimtaria radiotelevizive nuk lejohet të çenojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.

Legjislacioni parashikon lirinë editoriale, pavarësia e së cilës sigurohet me ligj, duke përcaktuar të drejtën e të punësuarve për të mos u diskriminuar për shkaqe të tilla, si: seksi, origjina, pikëpamjet politike, besimi fetar apo anëtarësia në sindikata. Qasja e legjislacionit shqiptar ndaj mënyrave të kontrollit të veprimtarisë radiotelevizive është e ngjashme me atë franceze ku, ky proces realizohet nëpërmjet krijimit të institucionit të pavarur siç është Autoriteti i Mediave Audiovizuale.

4. Profesionit i gazetarit mes pozitës së profesionistit dhe punëmarrësit

Duke iu rikthyer mendimit të autorit italian Garrone në raport me lirinë e shtypit, kuptojmë se ai bën një dallim të qartë mes ushtrimit të lirisë së shtypit nga ana e një personi të zakonshëm dhe ushtrimit të saj nga një

³⁵ Progres raporti 2011 për Shqipërinë që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2011-2012, COM(2011)666.

³⁶ Ligji Nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 8655, datë 31.07.2000, me ligjin nr. 8794 datë 10.05.2001, me ligjin nr.9016 datë 20.2.2003, me ligjin nr.9124 datë 29.07.2003, me ligjin 9531 datë 11.05.2006 dhe me ligjin nr. 9677, datë 13.01. 2007.

person i kualifikuar si gazetar, i cili e ushtron lirinë e shtypit me cilësinë e një profesionisti. Në Itali ky profesion rregullohet ligjërisht që në vitin 1925; nëpërmjet tij vendosen disa detyrime për gazetarët, si: nënshtimin e gazetarit italian ndaj një provimi kombëtar për t'u regjistruar në regjistrin e urdhrin profesional; klasifikimin në këto lista, sipas tipit të aktivitetit, duke evidentuar shumëllojshmërinë e figurës së gazetarit³⁷. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për detyrimin e gazetarëve në Spanjë për të mbajtur diplomën e njëres prej shkollave të gazetarisë. Vlen të theksohet se konkretizohet modeli organizativ i urdhrin të gazetarisë. Kjo shoqërohet me dhënien e konceptit të aktivitetit të gazetarit, i cili, duke iu nënshtuar parimeve të profesionit të lirë, është garant në raport me lirinë e ndërgjegjes së gazetarit. Gazetari, që është inicuesi i informacionit, por jo mbajtësi i vetëm i tij, ndodhet në një pozicion të dyfishtë dhe problematik. Liria e tij shpesh mund të rrezikojë të ndeshet me objektivat e sipërmarrjes ku ai ushtron profesionin. Kështu ai ka një status të dyfishtë: gazetari si profesionist, që i nënshtrohet rregullave që imponon komuniteti i organizuar i gazetarëve dhe gazetari si i punësuar që varet nga sipërmarrja.

Në shumë ligje, për këtë arsye, parashikohet që botuesi duhet të publikojë marrëveshjet e bëra me drejtuesit që janë përgjegjës, në lidhje me linjën editoriale të gazetës dhe të informojë paraprakisht redaktuesit; përfshirjen e sindikatave të gazetarëve në hartimin e politikave të sipërmarrjes editoriale; shpalljen e programit editorial nga drejtuesi që shërben për ta ruajtur autonominë e gazetës nga botuesi. Ka pasur diskutime që rrjedhin nga përpjekjet për t'i shpëtuar varësisë së veprimtarisë së gazetës nga financuesi. Ky debat u zhvillua edhe me miratimin e ligjit francez, ku përmes ndryshimeve kushtetuese parashikohet rezerva ligjore për të caktuar rregullat mbi "*lirinë, pluralizmin dhe pavarësinë e mediave*". (Belle), sugjeron se, do të ishte më i përshtatshëm përdorimi i konceptit "autonomi", sepse liria e mediave nuk mund të jetë absolute dhe gjithçka varet nga mënyra se si rregullohet dhe funksionon ajo.

KONKLUZIONE:

Shoqëria jonë shfaqet si një "shoqëri e informacionit", ku e drejta e komunikimit merr vëmendje të veçantë, si dhe shfaqet si një e drejtë që ka

³⁷Ligji Nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8655, datë 31.07.2000, me ligjin nr. 8794 datë 10.05.2001, me ligjin nr.9016 datë 20.2.2003, me ligjin nr.9124 datë 29.07.2003, me ligjin 9531 datë 11.05.2006 dhe me ligjin nr. 9677, datë 13.01. 2007, f. 42.

në themel informimin. Evidentojmë se informacioni është faktor determinant për formimin e opinionit publik që ndikon dukshëm në vendimmarrjet politike, të cilat reflektohen edhe në një shumëllojshmëri ndikimesh sociale. Ajo që shihet qartë në trajtimin e mësipërm mbi lirinë e shtypit dhe të radiotelevizionit, është fakti se, ato shkojnë paralelisht me të drejtën për informim, pikërisht sepse janë mjetet kryesore për realizimin e saj. Megjithatë, liria e shtypit dhe e radiotelevizionit, gjithnjë e më shumë po i nënshtrohen rregullimit ligjor si të drejta themelore të njeriut dhe rregullave të konkurrencës që i sheh ato thjesht si sipërmarrje. Eksperiencia ofron modele të ndryshme të rregullimit ligjor, ku përplasen në etapa të ndryshme tendenca për vendosjen e monopolit publik me gërshetimin e sistemit privat-publik. Mendojmë se paraqet interes, evidentimi i një realiteti tashmë në disa vende, të cilat kanë përcaktuar një status të gazetarit, që nuk është i thjeshtë për t'u gëzuar. Gazetari ndodhet në një dyzim të përditshëm; si profesionist që zbaton disa parime të rëndësishme për një informim korrekt të publikut dhe si punëmarrës tek botuesi, që tenton të ndikojë dhe ka mundësi reale të ndikojë në politikën editoriale të shtypit.

BIBLIOGRAFIA:

1. BELLE, F. (2011): Media dhe Shoqëritë- botim- shtyp- kinema- radio- televizion-internet, Papyrus, UET press.
2. CORDINI, G. (2006): "Società dell' informazione e diritti costituzionali", nw "La società dell' informazione: libertà, pluralismo, risorse"-Atti del convegno dell' Associazione di Diritto Pubblico Comparato ed Europea, G. Giappichelli Editore.
3. GARRONE, B. G. (1998): Appunti di diritto pubblico dell' informazione e della comunicazione, Justutiam Colimos, Torino.
4. GUIDI, G., (2006): "La società dell' informazione: libertà, pluralismo, risorse"- Diritto Pubblico Comparato ed Europeo- Atti del convegno dell' Associazione di San Marine, 30 Settembre 2005, G.Giappichelli editore.
5. PIETRANGELO, M. (2007): "La società dell' informazione tra realtà e norma", Giuffrè Editore.
6. Progres raporti 2011 për Shqipërinë që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2011-2012, COM(2011)666.
7. Ligji Nr. 8410, datë 30.9.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8655 datë 31.07.2000, me ligjin nr. 8794, datë 10.05.2001, me ligjin nr.9016, datë 20.2.2003, me ligjin nr.9124, datë 29.07.2003, me ligjin 9531, datë 11.05.2006 dhe me ligjin nr. 9677, datë 13.01.2007.
8. www.freedomhouse.org/report-types/freedom-press

KUFIZIMET E VENDOSURA PËR RISHIKIMIN E KUSHTETUTËS SHQIPTARE

Entela Hoxhaj, Enriko Kapiti

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë

The limits set to the revision of the Albanian Constitution

ABSTRACT

Constitutions are created to last in time. The provisions for the constitutional revision create the possibility for them to be changed in the future in order to be adopted with the requests related to the new needs or changes of the social-political situation of the country. They do not always change because of the need to adopt the constitutional framework, but sometimes constitutions are set in front of ‘certain attacks’ for changes imposed by political mechanisms that can affect the constitutional revision. This paper is organized in two main parts concerning: the reasons that bring to constitutional changes and the limits set on the power to revise the Albanian Constitution, especially because nowadays is discussed the near possibility for a constitutional reform in our country.

Hyrje

Përmbajtja e kushtetutave dhe mendimi juridik-politik për to ka ndryshuar dhe është zhvilluar përballë rrjedhës së kohës në raport qëllimet e tyre, por edhe në raport me evolucionin e kërkesave për ndarjen e pushteteve dhe për shtetin e së drejtës. Rishikimi i kushtetutës siguron mekanizmin e përshtatjes së saj me nevojat ose kërkesat e reja.

Rishikimi i kushtetutës konsiston në plotësimin, ndryshimin ose zëvendësimin e dispozitave të caktuara të kushtetutës ekzistuese, për ta përshtatur atë me realitetet e reja, të cilat nuk mund të parashikoheshin

gjatë procesit të hartimit. Nga ana procedurale formale, rishikimi i kushtetutës, bëhet duke ndjekur rregullat dhe procedurat e parashikuara nga kushtetuta në fuqi, e cila ndryshohet nga zbatimi i dispozitave të posaçme të rishikimit. Për këto dispozita në doktrinën kushtetuese gjejmë shpesh edhe përdorimin e termit ‘formula të rishikimit’, të cilat përcaktojnë procedurën e veçantë për të vështirësuar realizimin e ndryshimeve kushtetuese, në mënyrë që këto të pasqyrojnë jo vetëm mbrojtjen e kushtetutës, por edhe garantimin e qëndrueshmërisë së saj nëpërmjet një rishikimi që garanton gjithëpërfshirjen në procesin e rishikimit, por edhe maturinë në përmbajtjen materiale të dispozitave që rishikohen.

Fokusi i këtij artikulli përqendrohet në kufizimet materiale të vendosura në pushtetin për të rishikuar Kushtetutën tonë³⁸. Kufizimet formale të rishikimit janë procedurat specifike që duhen zbatuar për të realizuar plotësimin, ndryshimin ose zëvendësimin e dispozitave të caktuara të kushtetutës. Ato janë procedurat në përmbajtje të ‘formulës së rishikimit’ dhe pasqyrohen në nenin 177 të Kushtetutës tonë. Kufizimet materiale lidhen me përmbajtjen e dispozitivit përkatës.

Kushtetuta jonë e ngurtë e vitit 1998, është ndryshuar disa herë në një hark kohor të shkurtër, madje praktika e ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008³⁹ tregon për ndryshime kushtetuese të realizuara ‘brenda natës’. Pavarësisht se ndryshimet kushtetuese më të fundit, ato të vitit 2012, u realizuan në kuadër të zhvillimit të një debati të gjerë publik, tashmë në debatet publike flitet për rifutjen në diskutim të nevojës për një reformë kushtetuese, e cila të ‘riparojë’ problematikat e lindura nga ndryshimet kushtetuese të bëra në vitin 2008, prandaj vëmendja zhvendoset tashmë jo thjesht tek procedura e rishikimit, por tek përmbajtja materiale e dispozitave që kërkohet të rishikohen.

Me qëllim të prezantimit sa më të mirë të problematikave të parashtruara në kuadër të këtij punimi, propozojmë që trajtimi përkatës të organizohet i strukturuar në dy pjesë, të cilat paraqesin respektivisht arsyet

³⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998, e ndryshuar: miratuar me ligjin nr.8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” dhe e ndryshuar me ligjet vijuese:

- ligji nr.9675 datë 13.1.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë””;
- ligji nr.9904 datë 21.4.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;
- ligji nr. 88/2012 datë 18.9.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

³⁹ Referuar ligjit nr.9904 datë 21.4.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

që çojnë drejt ndryshimeve kushtetuese dhe kufizimet materiale në rishikimin e kushtetutës tonë.

1. Arsyet që sjellin kërkesën për ndryshime kushtetuese

Problematika e kushtetutave të ngurta shfaqet pikërisht në rastet kur lind apo bëhet i nevojshëm rishikimi i tyre dhe detyrimi për të ndjekur vetëm mënyrën e parashikuar në vetë atë. Në të tilla raste problemet shfaqen, përgjithësisht, në disa drejtime:

- Së pari, lidhur me zgjedhjen e procedurës që do të ndiqet për rishikimin -procedurë, opsionet për të cilën janë të parashikuara shprehimisht në tekstin kushtetues.
- Me rëndësi paraqitet edhe sigurimi i vullnetit politik për të kontrolluar organet që janë të përfshira në këtë procedurë.
- Në raste të tjera problematika e lidhur me rishikimin e kushtetutës, mund të shfaqet në dilemën e referimit në pushtetin kushtetues origjinar apo në atë derivativ, në varësi të faktit nëse nisemi nga zeroja apo nëse flasim për anulim të rregullave ekzistuese, për të krijuar të tjera në një sistem kushtetues që ekziston, por që mbart përsipër një traditë kushtetuese kontradiktore e problematike, por reale.⁴⁰

Në këtë çështje synojmë të paraqesim arsyet që çojnë drejt rishikimit të kushtetutës. Nisur nga kjo, teorikisht, shtrojmë pyetjen: a ka të drejtë, dhe nëse po, deri në çfarë mase mund të iniciohen dhe të bëhen ndryshimi kushtetues nga një shumicë që praktikisht është në pushtet për një mandat të caktuar?

Një nga kollosët e mendimit juridik, austriaku Hans Kelzen, në fund të viteve 20 të shekullit të kaluar argumentonte, “*se demokracia nga vetë natyra e saj është relative dhe se prandaj shumica ka të drejtë të bëjë ndryshime të çfarëdollojshme për të cilat bie dakord*”⁴¹. Pra, efektiviteti i kushtetutës, nuk duhet të shikohet ngushtësisht me pandryshueshmërinë e saj, por duhet të arrihet një shkallë më e lartë arsyetimi që të çon në përshtatjen e ndryshimeve kushtetuese me ato të sistemit shoqëror – politik të vendit.

Mundësia e kushtetutave për t’u përshtatur me nevojat dhe kërkesat e reja të evolucionit shoqëror dhe politik sigurohet nëpërmjet parashikimit të posaçëm në vetë tekstet kushtetuese të dispozitave për rishikimin e kushtetutes, në të cilat përcaktohen procedurat formale, nga zbatimi i të

⁴⁰ Hoxhaj E., “*E drejtë kushtetuese e krahasuar (Rishikimi i Kushtetutave në Evropë)*”, Tiranë, SHB “Gurten”, 2013, f. 72.

⁴¹ Zaganjori Xh., “*Demokracia dhe Shteti i së Drejtës*”, Tiranë, 2002, f. 63.

cilave mund të realizohet korrigjimi i mëvonshëm.⁴² Ideja e kësaj qëndron në faktin që ndryshimet kushtetuese, nuk duhen të bëhen vetëm nga shumica politike parlamentare e rastit, por duhet të arrihet një konsensus më i gjerë partiako – politik; jo thjesht dakordësia e dy partive kryesore antagoniste të hershme, por të përfshihen edhe të paktën njëra nga partitë më të vogla opozitare. Në thelb kushtetuta duhet të na japë garanci për jetëgjatësinë e saj dhe efikasitetin e saj, në mënyrë që mos të ndryshohet sipas dëshirës së shumicës politike të momentit. Në kuadër të kësaj shpesh jemi mosbesues ndaj ndryshimeve që mund të ndodhin nga një shumicë politike që është përkohësisht në pushtet.

Mundësia e rishikimit të kushtetutave elastike nëpërmjet procesit të zakonshëm legjislativ i bën ato të shfaqen, në raport me ligjet e tjera, me vlerë “politike” më të madhe, duke pasur maksimumi një karakter të tipit udhëzues për interpretimin e ligjeve të zakonshme, por jo me shumë.⁴³ Kushtetutë elastike ka pasur edhe Luksemburgu deri në vitin 2003, kushtetuta në fuqi e të cilit është ajo e vitit 1868 e rishikuar disa herë më saktësisht (në vitet 1919, 1948, 1956, 1972, 1979, 1983, 1988, 1989, 1994, 1996, 1997, 1998, 1999, 2000, 2003 (me amendimet e vitit 2003 u ndryshua edhe procedura për rishikimin e kushtetutës), 2004, 2005, 2006, 2007, 2008 dhe 2009⁴⁴). Në fillim ndryshohej për t’u përshtatur me kushtet dhe nevojat e kohës, gjë që shpjegon gjithashtu se përse, pavarësisht rishikimeve të bëra, ajo është akoma në fuqi, është ligji me fuqinë juridike më të madhe në vend. Pavarësisht se ka të gjitha karakteristikat e një ligji të zakonshëm dhe të njëjtat pasoja ligjore, ajo ka karakteristika dhe sjell pasoja të cilat e bëjnë të renditet më lart në sistemin e normave juridike. Pavarësisht këtyre ndryshimeve jo pak të rëndësishme, Kushtetuta rishikohej sipas rregullave të kompetencës dhe procedurës që ndiqen për një ligj të zakonshëm, ishte e detyrueshme njësoj si një ligj i zakonshëm, që mund të shërbejë si bazë për të përcaktuar procedurat ligjore dhe mund të zbatohet direkt nga gjykatat⁴⁵.

Në momentin që merret përsipër nga subjektet përkatëse për të rishikuar kushtetutën, ato vetë deklarojnë që ‘produkti’ i tyre nuk do jetë i

⁴² Hoxhaj E., “*E Drejtw Kushtetuese e Krahasuar (Rishikimi i Kushtetutave në Evropë)*”, vep.cit, f. 179.

⁴³ Morbidelli G., Pegoraro L., Reposo A., Volpi M., “*Diritto pubblico comparato*”, Torino, Giappichelli, 2004, f. 65.

⁴⁴ *Constitution du Luxembourg*, Ministere d’Etat, Luxembourg, Service Central de Législation, 2009, f. 9-10.

⁴⁵ Hoxhaj E., “*E Drejtë Kushtetuese e Krahasuar (Rishikimi i Kushtetutave në Evropë)*”, vep.cit, f. 22.

përhershëm por do të jetë për aq kohë sa do jetë në funksion të vendit. Kjo realizohet nëpërmjet formulës së rishikimit, e cila përcakton paraprakisht procedurën përkatëse të rishikimit të ardhshëm ose mundësinë e ardhshme për rishikim.

Pavarësisht pranimit të mundësisë së ndryshimit apo përshtatjes së kushtetutës me realitetet e reja, qëllimi kryesor i formulave të rishikimit në përmbajtje të tyre është mbrojtja e kushtetutës, garantimi i qëndrueshmërisë e saj që shprehet në vështirësimin e mundësisë së realizimit të rishikimit për të arritur konsensusin maksimal për përmbajtjen e ndryshimeve të synuara⁴⁶.

Duke analizuar formulat për rishikimin e kushtetutës nën dritën e forcave që qëndrojnë në bazë të kushtetutës nuk duket pa rëndësi dallimi mes kushtetutes-akt normativ dhe kushtetutes-kontratë. Në rastin e parë nuk është kështu i dukshëm në formulat e rishikimit ndikimi i forcave që kanë qenë përcaktuese në hartimin e kushtetutës dhe kërkesa e tyre për pjesëmarrje në modifikimet e mëvonshme, ndërsa në rastin e dytë është më e lehtë që në formulat e rishikimit të kushtetutës të identifikohet kërkesa për pjesëmarrjen në procedurën e rishikimit të ardhshëm të vetë forcave që kishin dhënë pëlqimin, nëpërmjet aderimit në paktin themelor, në momentin e themelimit të rendit juridik, madje mund të argumentohet vërtet që ngurtësia është një rezultat i karakteristikave specifike të kontratimit bashkëkohor⁴⁷. Prandaj ka parashikim specifik dhe të vështirësuar procedura e rishikimit të kushtetutës tek kushtetutat formale të ngurta, pasi pikërisht te këto kushtetuta shfaqet ‘kërkesa’ për të pasur një raport të qartë mes mazhorancës dhe opozitës.

Siç shihet, arsyet që sjellin nevojën për rishikim apo iniciativat për rishikimin e kushtetutës, mund të ndikohen jo vetëm nga kushtet e reja sociale apo ekonomike që diktojnë ndryshimin, por edhe nga kushtet e reja politike në përbërjen e parlamentit që kërkojnë ndryshimin për përshtatjen me nevojat e politikës. Në këtë këndvështrim, arsyet që paraqesin kërkesën për ndryshime kushtetuese gjenden ndërmjet ‘nevojës për përshtatje’ dhe ‘sulmeve për ndryshim’. Në diferencimin ndërmjet këtyre të dyjave, rëndësi të veçantë paraqet përmbajtja materiale e dispozitave rishikuese.

2. Kufizimet e vendosura për rishikimin e Kushtetutës shqiptare.

Praktika jonë kushtetuese e ndryshimeve të Kushtetutës së vitit 1998 ka treguar për mundësinë e realizimit të konsensusit të gjerë të nevojshëm

⁴⁶ Po aty, f. 26.

⁴⁷ Gambino S., D’ignazio G., “*La revisione costituzionale e i suoi limiti (Fra teoria costituzionale, diritto interno, esperienze straniere)*”, Milano, Giuffrè, 2007, f. 206

për ndryshimin përkatës në mënyrë ‘gati të lehtë’. Kujtojmë këtu arritjen e konsensusit të dy partive kryesore parlamentare në vitin 2008 për ndryshimet kushtetuese që u realizuan. Madje ndër kritikën e Komisionit të Venecias, kujtojmë vërejtjet përkatëse për këto ndryshime kushtetuese lidhur me “mënyrën e shpejtë në të cilën u miratuan këto amendime pa diskutim të gjerë publik”⁴⁸. Në këtë këndvështrim mendojmë se kufizimet formale të lidhura me procedurën e rishikimit të kushtetutës janë vërtetuar si të kapërcyeshme nga praktika jonë e deritanishme. Pavarësisht kësaj, theksojmë se, qëllimi i nenit 177 me shumicën e cilësuar të kërkuar në paragrafin 3, madje edhe me mundësinë e nënshtrimit për referendum të amendamentit të miratuar në kushtet e paragrafit 5⁴⁹, garanton gjithëpërfshirjen e kërkuar në raste të tilla për realizimin e amendamenteve kushtetuese.

Në kuadër të kufizimeve *formale* gjejmë edhe referendumin fakultativ kushtetues të parashikuar nga neni 177 paragrafët 4 e 5 të Kushtetutës tonë, respektivisht për: *i*) projektamendamentin kushtetues, kur për këtë ka vendosur Kuvendi me një shumicë të cilësuar prej dy të tretash të të gjithë anetarëve të tij; *ii*) amendamentin Kushtetues të miratuar kur këtë e ka kërkuar një e pesta e të gjithë anetarëve të Kuvendit.

Përveç parashikimit të kufizimeve formale që lidhen me procedurat më të rënduara për miratimin e amendimeve kushtetuese, neni 177 i Kushtetutës parashikon edhe dy kufizime *explicite*, të cilat lidhen me kohën gjatë së cilës nuk mund të ndërmerret rishikimi i Kushtetutës.

- Kufizimi i parë parashikohet në nenin 177 paragrafi 2, i cili përcakton se “*asnjë rishikim i Kushtetutës nuk mund të ndërmerret gjatë kohës kur janë vendosur masat e jashtëzakonshme*”. Pra, siç shihet rishikimi është i mundur para vendosjes së masave të jashtëzakonshme dhe, përkundrazi, nuk është i mundur për kohën gjatë të cilës janë vendosur këto masa, duke penguar kështu çdo veprim juridik për rishikimin e Kushtetutës për aq kohë sa vazhdon gjendja në fjalë. Ky është një kufizim *relativ*, përderisa mund të kapërcehet pas mbarimit të gjendjes në fjalë, kohë pas të cilës rishikimi është i mundshëm. Një çështje që shtrohet me këtë rast është përcaktimi i masave të jashtëzakonshme dhe i kohës gjatë së cilës ato janë në veprim. Edhe kjo çështje gjen zgjidhje në Kushtetutë, në pjesën e gjashtëmbëdhjetë (nenet 170 – 176). Masat e jashtëzakonshme sipas nenit 170 paragrafi 1 mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes

⁴⁸ Mendimi 491/2008 të Komisionit të Venecias “Për ndryshimet e Kushtetutës së RSH të miratuara me 21 prill 2008”, pika 5.

⁴⁹ “...nëse këtë e kërkon një e pesta e deputetëve”.

së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe zgjasin për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje.

- Kufizimi i dytë i vënë në procesin e rishikimit të Kushtetutës tonë të vitit 1998 parashikohet në neni 177 paragrafi 8, sipas të cilit ndalohet rishikimi i Kushtetutes për të njëjtën çështje pa kaluar një vit nga dita e rrëzimit të projektligjit në Kuvend dhe tre vjet nga dita e rrëzimit të tij në referendum. Edhe ky kufizim është *relativ*, pasi rishikimi bëhet i mundshëm pas kalimit të periudhës së përcaktuar në nenin 177 paragrafi 8.

Gjithashtu, në një interpretim të zgjeruar të nenit 175⁵⁰ të Kushtetutës mund të nxjerrim një kufizim tjetër të shprehur në procesin e rishikimit të Kushtetutës, kur legjislatori në kuptimin literal të dispozites ka përcaktuar si të drejta dhe liri absolute, e si të tilla të pamodifikueshme, ato të numëruara në përmbajtjen e nenit 175 paragrafi 1 kur përcakton se “...nuk mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet :15, 18, 19, 20, 21, 24, 25, 29, 30, 31, 32, 34, 39 paragrafi 1, 41 paragrafet 1, 2, 3 dhe 5, 42, 43, 48, 54, 55”. Pavarësisht se qëllimi i legjislatorit në dispozitën përkatëse ka qenë që të ndalojë kufizimin e këtyre të drejtave dhe lirive gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme (kohë gjatë së cilës siç e thamë më sipër nuk mund të ndërmerret asnjë rishikim i kushtetutës), është e nënkuptuar që këto të drejta dhe liri nuk mund të kufizohen as në kushtet e normalitetit, madje as nëpërmjet realizimit të një rishikimi të kushtetutës.

Kur flitet për rishikim të kushtetutës nënkuptohet ruajtja e bërthamës së kushtetutës së modifikuar, pra të asaj pjese që disa e quajnë si “bërthamë e ngurtë” e kushtetutës. Prandaj, dispozita të caktuara të kushtetutës mund të përjashtohen nga çdo rishikim, pasi atyre “u jepet” vlerë supra – kushtetuese.⁵¹ Kufizime të tilla paraqiten si kufizime *implicite* të vëna në procesin e rishikimit të Kushtetutës tonë, të cilat mund t’i gjejmë prej kuptimit të kushtetutës materiale apo prej identifikimit të dispozitave që përbëjnë bërthamën e ngurtë të saj. Konkretisht, flitet për ato nene të

⁵⁰ Neni 175 i Kushtetutës së RSH “1.Gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e paparashikuara nga nenet : 15, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 29, 30, 31, 32, 34, 49 paragrafi 1, 41 paragrafi 1, 2, 3 dhe 42, 43, 48, 54, 55.

⁵¹ Në kuadër të literaturës së gjerë të konsultuar në këtë rast përmendim: ARDANT P., “(Manuel) Institutions politiques & droit constitutionnel”, 6^e édition, Paris, 1994, f.82; Quaderni del “Gruppo di Pisa”, “Giurisprudenza costituzionale e principi fondamentali. Alla ricerca del nucleo duro delle costituzioni”, Torino, Giappichelli, 2006, f.41 Morbidelli G., Pegoraro L., Reposo A., Volpi M., “Diritto pubblico comparato”, vep.cit., f.77, Omari L., Anastasi A., “E drejta kushtetuese”, ribotim, Tiranë, SHB ABC, 2010, f. 37.

kushtetutës që garantojnë thelbin dhe përmbajtjen demokratike të shtetit. Përgjithësisht, si të tilla përmenden: a) ‘parimet politiko – juridike’ të vëna në themelet e kushtetutës, b) parimet në përmbajtje të ‘deklaratave të të drejtave’, c) dispozitat për ‘formën e qeverisjes’ apo ‘të shtetit’, c) dispozitat për ‘procedurat e rishikimit të kushtetutës’, e kështu me radhë. Mjaft kushtetuta e sanksionojnë shprehimisht ndalimin e rishikimit të dispozitave të sipërpërmendura. Gjithashtu, sugjerojmë që në reformat e mundshme dhe të ardhshme kushtetuese në vendin tonë, disa nga këto dispozita të mund të cilësohen si shprehimisht të pandryshueshme duke i bërë kufizime absolute *explicite*, siç gjenden në kushtetutat e disa shteteve të Evropës, në: Gjermani, Greqi, Itali, Spanjë etj.

KONKLUZIONE:

Arsyet që sjellin nevojën për rishikim apo iniciativat për rishikimin e kushtetutës gjenden ndërmjet ‘nevojës për përshtatje me kushtet e reja’ dhe ‘sulmeve për ndryshim të shumicave apo kompromiseve politike të momentit’. Ato mund të ndikohen jo vetëm nga kushtet e reja sociale apo ekonomike që diktojnë ndryshimin, por edhe nga kushtet e reja politike në përbërjen e parlamentit që kërkojnë ndryshimin për përshtatjen me nevojat e politikës.

Në kushtetutën tonë gjejmë shumëllojshmëri kufizimesh të vëna në procesin e rishikimit: përveç kufizimeve *formale* të procedurës së rishikimit, gjejmë edhe kufizime *explicite relative*; ndërkohë që rëndësi të veçantë kanë kufizimet absolute materiale *implicite*. Këto të fundit janë dispozitat që qëndrojnë në themel të rendit kushtetues, si parimet politiko – juridike të vëna në themelet e kushtetutës apo parimet në përmbajtje të deklaratave të të drejtave, për të cilat, në rast të reformave kushtetuese të ardhme, sugjerojmë vendosjen e ndalimit të shprehur për rishikimin e tyre.

LITERATURA:

1. Omari, L., Anastasi, A. (2010): “*E drejta kushtetuese*”, ribotim, Tiranë, SHB ABC.
2. Xhezair Zaganjori (2002): “*Demokracia dhe Shteti i së Drejtës*”, Tiranë.
3. Hoxhaj E. (2013): “*E drejtë kushtetuese e krahasuar (Rishikimi i Kushtetutave në Europë)*”, Tiranë, SHB “Gurten”.
4. Gambino, S., D’ignazio, G. (2007): “*La revisione costituzionale e i suoi limiti (Fra teoria costituzionale, diritto internor, esperienze straniere)*”, Milano, Giuffrè.

5. Quaderni del “Gruppo di Pisa”, “*Giurisprudenza costituzionale e principi fondamentali. Alla ricerca del nucleo duro delle costituzioni*”, Torino, Giappichelli, 2006.
6. Morbidelli, G., Pegoraro, L., Reposo A., Volpi M. (2004): “*Diritto pubblico comparato*”, Torino, Giappichelli.
7. ARDANT, P. (1994): “*(Manuel) Institutions politiques & droit constitutionnel*”, 6^e édition, Paris.
8. *Constitution du Luxembourg*, Ministere d’Etat, Luxembourg, Service Central de Législation, 2009.
9. Ligji nr.8417 datë 21.10.1998 “*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*”.
10. Ligji nr.9675 datë 13.1.2007 “*Për disa ndryshime në ligjin nr.8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”*”.
11. Ligji nr.9904 datë 21.4.2008 “*Për disa ndryshime në ligjin nr.8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar*”.
12. Ligji nr. 88/2012 datë 18.9.2012 “*Për disa ndryshime në ligjin nr.8417 datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar*”.
13. Mendimi 491/2008 të Komisionit të Venecies “*Për ndryshimet e Kushtetutës së RSH të miratuara me 21 prill 2008*”.

PËLQIMI PAS INFORMIMIT DHE RËNDËSIA E TIJ NË TRAJTIMIN MJEKËSOR – KIRURGJIKAL

Emanuela Furramani

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë

Informed consent and it's relevance on medical – surgical treatment

ABSTRACT

Recognizing on one hand the right for a health care service guaranteed by the Italian Constitution, the international and italian law ensure that each individual has the right to obtain the correct, complete and appropriate information before undergoing a medical – surgical treatment and at the same time must have complete information on alternative medical treatments, so to be able to make a free and conscious choice as an expression of his personal freedom.

The practice of informed consent, has a great importance because it impacts directly on the patient's awareness by giving relevant information on the risks that can come as a result of a medical treatment, despite the medical diligent behavior and the respect of all medical art rules (*Leges artis*). The lack of informed consent or an invalid consent, converts a medical – surgical treatment in arbitrary and as a result the doctor will be liable and responsible for all the damages suffered by the patient.

Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është analiza dhe ekzaminimi nëpërmjet referimeve të vazhdueshme të doktrinës dhe jurisprudencës, i çështjes së pëlqimit pas informimit dhe rëndësisë që ka për trajtimin mjekësor – kirurgjikal. Analiza do të bazohet tek çështja e pëlqimit pas informimit, i parë në këndvështrimin e kushtit të ligjshmërisë të trajtimit mjekësor – kirurgjikal dhe në të njëjtën kohë, si parim i lirisë së individit për vetëvendosje mbi bazën e vendimit të Gjykatës Kushtetuese Italiane nr. 438 të vitit 2008.

Shtysa për një temë të tillë lindi nga fakti se legjislacioni ndërkombëtar, ai i Bashkimit Evropian, si dhe ai i pjesës më të madhe të vendeve evropiane, e parashikojnë pëlqimin pas informimit në legjislacionin e tyre të brendshëm, si kusht të ligjshmërisë së trajtimit mjekësor, pasi vetëm në praninë e këtij të fundit, mjeku mund të përjashtohet nga përgjegjësia penale për të gjitha dëmet që mund t'i ketë shkaktuar pacientit.

Analiza ime do të fokusohet tek doktrina dhe jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit të shtetit italian, duke iu referuar në fund edhe legjislacionit shqiptar dhe parashikimeve të bëra nga legjislacioni aktual për pëlqimin pas informimit, si dhe rëndësinë që mund të marrë ky i fundit në perspektivë.

Pëlqimi pas informimit: kusht i ligjshmërisë së trajtimit mjekësor - kirurgjikal, apo shprehi e parimit të lirisë së individit për vetëvendosje?

Kushtetuta e Republikës Italiane, i garanton pëlqimit pas informimit një vlerë kushtetuese, duke u bazuar në interpretimin e neneve 2, 13 dhe 32, ashtu si është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese Italiane në vitin 2008: “*pëlqimi pas informimit është një e drejtë e individit që e gjen bazën e tij në nenet 2, 13 dhe 32 të Kushtetutës*”⁵²

Mbi bazën e nenit 13 të kushtetutës italiane: “*Liria personale është e pakufizuar. Nuk është e pranueshme asnjë formë e kufizimit të lirisë personale që nuk është e parashikuar në ligj*”. Nga ana tjetër neni 32 përmban një garanci për të drejtën e kujdesit shëndetësor e parashikuar për të gjithë qytetarët si një e drejtë themelore e individit⁵³. Në paragrafin e dytë të këtij neni parashikohet se “... *askush nuk mund të jetë i detyruar t'i nënshtrohet një trajtimi sanitar nëse nuk është e parashikuar në ligj. Ligji në asnjë mënyrë nuk mund të shkelë kufijtë e vendosur për respektimin e njeriut*”. Mbi bazën e një leximi të kombinuar të dy neneve të cituara më sipër së bashku me nenin 2 të kushtetutës italiane, mund të arrihet me përfundimin se kushtetuta e shtetit italian është ajo, e cila i vendos kufij trajtimit sanitar / mjekësor, si p.sh., respektimin e lirisë së individit për të shprehur pëlqimin e vet të informuar dhe të lirë në lidhje me trajtimin mjekësor, të cilit duhet t'i nënshtrohet dhe si rjedhojë, kushtetuta i njeh individit të drejtën për të vendosur në lidhje me integritetin e vet fizik dhe

⁵² Corte Cost, 23-12-2008, n. 438. (marrë nga: <http://www.cortecostituzionale.it>.)

⁵³ I njëjti parim është i shprehur edhe në vendimin gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese Italiane, datë 26.07.1979, nr. 88 marrë nga “*Giurisprudenza Italiana*” 1980, I, 1, f. 9.

psikik⁵⁴. Mbi bazën e këtij parimi çdo individ ka të drejtën të marrë pjesë në mënyrë të lirë dhe të ndërgjegjshme në zgjedhjen e mjekimit dhe të trajtimit mjekësor, të cilit duhet t'i nënshtrohet, duke pranuar apo refuzuar trajtimin mjekësor, por gjithmonë, pasi ai të ketë marrë informacionin e saktë dhe të plotë në lidhje me të mirat apo rreziqet e ndërhyrjes mjekësore -kirurgjikale⁵⁵.

Nëse do të analizojmë me hollësi vendimin gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese Italiane nr. 438/2008, pëlqimi pas informimit përbën një sintezë të dy të drejtave themelore të individit, të drejtës së individit për vetëvendosje dhe së drejtës për kujdesin shëndetësor: “...nëse është e vërtetë që çdo individ ka të drejtë të marrë kujdesin shëndetësor që i nevojitet, ai ka njëkohësisht të drejtën për të marrë informacionet e nevojshme në lidhje me natyrën dhe zhvillimet e mundshme të trajtimit mjekësor të parashikuar për këtë individ, si dhe për trajtimet alternative. Informacionet duhet të jenë sa më të plota të mundshme në mënyrë të tillë që individit t'i garantohet liria dhe zgjedhja e vullnetshme, pra të garantohet liria personale e individit konform nenit 32, par. 2 i kushtetutës. Si rrjedhojë pëlqimi pas informimit duhet të konsiderohet një parim themelor në temën e së drejtës për një kujdes shëndetësor.”⁵⁶

Pëlqimi pas informimit është i parashikuar në legjislacionin italian nga një sërë ligjesh të zakonshme, të cilat u referohen aktiviteteve mjekësore të veçanta dhe është i parashikuar si i detyrueshëm nga *Kodi Deontologjik Italian i Mjekëve* i vitit 2006, në nenet 33 dhe 35⁵⁷. Në veçanti neni 35 parashikon shprehimisht: “Mjeku nuk duhet të ndërmarrë aktivitete diagnostikimi apo terapi pa marrë më parë pëlqimin e lirë dhe të informuar të pacientit”. Ndërsa neni 33 i referohet natyrës së informacioneve që pacienti duhet të marrë nga ana e mjekut, para se të bëjë zgjedhjen e tij të lirë. Mbi bazën e legjislacionit italian pëlqimi i lirë dhe i informuar është një kusht themelor i trajtimit mjekësor - kirurgjikal, kur individit është në gjendje të aftësisë për të kuptuar dhe për të vepruar, ndërsa në rastin kur individit ndodhet në gjendje paaftësie për të shprehur pëlqimin e tij të lirë,

⁵⁴ M. BILANCETTI, *La responsabilità penale e civile del medico*, Cedam, Padova, 2006, f. 274.; Cass. Pen., Sez. Un. 18 dicembre 2008, n. 2437.; Cass. Pen., Sez. VI, 14 febbraio 2006, n. 11640.; Cass. Pen., Sez. IV, 26 maggio 2010, n. 34521.

⁵⁵ M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., f. 312. *Consenso e dissenso informati nella prestazione medica*, di M. N. GRIBAUDI, Giuffrè Editore, Milano, 2012, f. 5-6.

⁵⁶ Corte Cost., 23-12-2008, n. 438, vep. e cit.

⁵⁷ *Consenso e dissenso informati*, di M. N. GRIBAUDI, vep. e cit., f. 15.

mjeku mundet ta realizojë trajtimin mjekësor vetëm në rastet e urgjencës mbi bazën e nenit 54 të Kodit Penal italian.

Parimi i lirisë së individit për vetëvendosje i trajtuar më sipër, sjell si rrjedhojë që jo vetëm që për çdo trajtim mjekësor – kirurgjikal, duhet të jetë marrë më parë pëlqimi i informuar i pacientit, por ky i fundit ka të drejtën ta refuzojë një trajtim mjekësor ose ta ndërpresë, pasi ai të ketë filluar dhe pëlqimi pas informimit mund të tërhiqet në çdo moment. Kjo edhe sipas jurisprudencës së Gjykatës Italiane të Kasacionit të vitit 2008, e cila shprehet se “*duhet t’i njihet pacientit një e drejtë për të mos u kuruar edhe kur nga kjo sjellje i rrezikohet jeta*”⁵⁸.

Shprehja e pëlqimit të lirë dhe të informuar të pacientit për trajtimin mjekësor kirurgjikal, është një rregull i përgjithshëm, i cili e ka bazën në legjislacionin ndërkombëtar dhe evropian. Burimet ndërkombëtare që e parashikojnë si të detyrueshëm pëlqimin pas informimit janë të shumta, midis të cilave *Konventa e Oviedos mbi të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë* e viti 1997 dhe *Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian* (2000), kjo e fundit e bërë e detyrueshme me *Traktatin e Lisbonës* në vitin 2009. Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian e parashikon pëlqimin pas informimit në nenin 3, par. 2: “... në temën e mjekësisë dhe të biologjisë duhet të respektohet pëlqimi i lirë dhe i informuar i personit të interesuar mbi bazën e modaliteteve të përcaktuara nga ligji...”. Mbi bazën e këtij parashikimi, pëlqimi pas informimit është shprehje e së drejtës së individit për integritet fizik dhe psikik. Edhe *Konventa e Oviedos mbi të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë*, parashikon në nenin 5, pëlqimin e lirë dhe të informuar, i cili mund të tërhiqet në çdo moment në çdo trajtim mjekësor apo shëndetësor⁵⁹.

Jurisprudenca italiane⁶⁰ e konsideron pëlqimin pas informimit, si një kusht të ligjshmërisë së trajtimit mjekësor – kirurgjikal dhe shprehet se i

⁵⁸ Corte Cost., 23-12-2008, n. 438, vep. e cit.

⁵⁹ Convenzione per la Protezione dei Diritti dell’Uomo e la Dignità dell’Essere Umano Riguardo alle Applicazioni della Biologia e della Medicina (1997), art. 5: “*Un intervento in campo della salute non può essere effettuato se non dopo che la persona interessata abbia dato il consenso libero e informato. Questa persona riceve innanzitutto una informazione adeguata sullo scopo e sulla natura dell’intervento e sulle sue conseguenze e i suoi rischi. La persona interessata può, in qualsiasi momento, liberamente ritirare il proprio consenso.*”

⁶⁰ Assise di Firenze 8 novembre 1990, in *Giust. pen.*, 1991, f. 163, con nota di G. IADECOLA, *In tema di rilevanza penale del trattamento medico – chirurgico.*; Cass. Pen., 11 luglio 2001, n. 1572, in *Cass. Pen.*, 2002, p. 2041, con nota di G. IADECOLA, *Sugli effetti penali della violazione colposa della regola del consenso nell’attività chirurgica.*; Cass., Sez. I, 16.10.2007, n. 21748, “*Giust. civ. Mass.*”, 2007, f. 10.

vetmi rast kur mjeku mund të ndërhyjë në mungesë të pëlqimit të pacientit, është rasti i nevojës dhe urgjencës për t'i parandaluar dëme të rënda shëndetit të pacientit mbi bazën e nenit 54 të Kodit Penal italian. Kur mjeku realizon një ndërhyrje mjekësore - kirurgjikale në mungesë të pëlqimit të informuar dhe në mungesë të rastit të nevojës dhe urgjencës, trajtimi mjekësor rezulton arbitrar dhe në këto raste lind përgjegjësia penale e mjekut, ai përgjigjet për dëmet apo pasojat negative që i janë shkaktuar pacientit edhe kur trajtimi mjekësor është i realizuar në respektim të rregullave të artit mjekësor (*leges artis*)⁶¹ nga ana e mjekut. Mbi këtë çështje është shprehur edhe Gjykata Italiane e Kasacionit, e cila e konsideron pëlqimin pas informimit si të drejtën e individit për të vendosur vetë në lidhje me trajtimin mjekësor të cilit do t'i nënshtrohet. Në veçanti Gjykata Italiane e Kasacionit në vitin 2001 është shprehur në dy vendime, vendimi nr. 5172 dhe nr. 28132, në të cilat pëlqimi pas informimit nuk konsiderohet më si kusht i ligjshmërisë së trajtimit mjekësor⁶², por konsiderohet si shprehi e parimit të lirisë të individit për vendosur vetë në lidhje me integritetin e tij fizik dhe psikik, të garantuara këto të fundit nga vetë Kushtetuta e Republikës Italiane⁶³. Ndërsa në një vendim të po kësaj gjykate të datës 14 shkurt 2006, nr. 11640, shprehet mbi natyrën e dyfishtë të pëlqimit pas informimit, duke e konsideruar njëkohësisht kusht për ligjshmërinë e trajtimit mjekësor dhe shprehi të parimit të lirisë së individit për vetëvendosje: "...aktiviteti mjekësor, kërkon për ligjshmërinë e tij manifestimin e pëlqimit pas informimit të individit, i cili nuk identifikohet me konsensusin e individit sipas nenit 50 të Kodit Penal italian, por përbën kusht të ligjshmërisë së trajtimit mjekësor. Pëlqimi pas informimit i ka lidhje me lirinë morale të individit dhe me të drejtën e tij për vetëvendosje, përveç se me lirinë fizike... mungesa e pëlqimit pas informimit apo pavlefshmëria e tij e shndërrojnë trajtimin mjekësor në arbitrar dhe si rezultat lind përgjegjësia penale, pasi është e realizuar në shkelje të sferës personale të individit dhe e të drejtës së tij për të vendosur nëse do t'i nënshtrohet apo jo ndërhyrjeve mjekësore⁶⁴".

Kualifikimi i pëlqimit pas informimit si kusht i vlefshmërisë së trajtimit mjekësor rezulton edhe nga vendimet gjyqësore të Gjykatës

⁶¹ Cass. Sez. III, 09.02.2010, n. 2847, "*Resp. civ. e prev.*", 2010, 4, f. 781.

⁶² G. IADECOLA, *Consenso del paziente e potestà di curare*, in: A cura di D. AMMIRATI, *La responsabilità penale del medico*, Cedam, Torino, 2004, f. 28 e ss.

⁶³ M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., f. 298 e ss.

⁶⁴ Cass. Pen., sez. VI, 14. 02. 2006, n. 11640 (caso Caneschi). Nello stesso senso Cass. Pen., sez. IV, 11 luglio 2001, n. 1572, vep e cit.; Cass. Pen., Sez. Un., 18 dicembre 2008, n. 2437.

Italiane të Kasacionit të vitit 2008, nr. 11335, në të cilën gjykata është shprehur se “Pëlqimi i lirë i shprehur i pacientit, i dhënë pas një informacioni të plotë mbi efektet e mundshme anësore të trajtimit mjekësor, është kusht për ligjshmërinë e trajtimit mjekësor. Për ta legjitimuar trajtimin mjekësor, pëlqimi duhet të jetë i informuar⁶⁵”.

Kushtet e vlefshmërisë të pëlqimit të informuar

Doktrina dhe jurisprudenca bien dakord se, për përjashtimin nga përgjegjësia penale e mjekut që realizon një ndërhyrje mjekësore – kirurgjikale, nevojitet pëlqimi pas informimit i vlefshëm i pacientit ose të paktën mungesa e kundërshtimit të tij të shprehur⁶⁶.

Gjykata Italiane e Kasacionit në vendimin e datës 21 prill 1992⁶⁷ dhe në vendimet e tjera në kuadër të trajtimit mjekësor-kirurgjikal, shprehet se pëlqimi i pacientit për t’u konsideruar kusht i ligjshmërisë së trajtimit⁶⁸ mjekësor, duhet të jepet në mënyrë të vlefshme. Në mungesë të një disipline që përcakton shprehimisht kushtet e vlefshmërisë të pëlqimit të informuar, është e rëndësishme t’i referohemi doktrinës⁶⁹ dhe jurisprudencës italiane, sipas të cilave:

a) Kushti i parë i domosdoshëm është: pëlqimi pas informimit duhet t’i jepet në mënyrë të shprehur mjekut që do të realizojë trajtimin mjekësor⁷⁰. Për manifestimin e tij nuk parashikohet detyrimisht një formë e shkruar, ai mund të ketë qoftë formë të shprehur apo të heshtur⁷¹. Sipas jurisprudencës së fundit mjeku kurues është i detyruar të provojë që ka

⁶⁵ Cass. Pen., Sez. IV, 16 gennaio 2008, n. 11335, vep. e cit...

⁶⁶ G. MARRA, *La mancanza di un valido consenso del paziente nel trattamento medico – chirurgico non può trasformare la colpa del medico in dolo*, in Cass. Pen., 2007, f. 274.; Cass. Pen., sez. IV, 26 maggio 2010, n. 34521.

⁶⁷ Cass. pen., di 21 aprile 1992 con nota di G. MELLILLO, *Condotta medica arbitraria e responsabilità penale*, in Cass. Pen., 1993, f. 63 e ss.

⁶⁸ S. DEL CORSO, *Il consenso del paziente nell’attività medico – chirurgica*, in Riv. it. di med. leg., 1987, II, f. 5.

⁶⁹ M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., f. 369.; S. DEL CORSO, *Il consenso*, vep e cit., f. 540; Assise di Firenze 8 novembre 1990, vep. e cit., f. 170 con nota di G. IADECOLA, *In tema di rilevanza.*; Cass. pen., Sez. IV, 11 luglio 2001, n. 1572, vep. e cit., f. 2041, con nota di G. IADECOLA, *Sugli effetti penali.*; U. G. NANNINI, *Il consenso al trattamento medico*, Milano, 1989, f. 89.; A. BONELLI – A. GIANNELLI, *Consenso e attività medico – chirurgica: profili deontologici e responsabilità penale*, in Riv. it. di med. leg., 1991, f. 15.

⁷⁰ M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., f. 369.

⁷¹ A cura di D. BORDIGNON, *Informazione e consenso all’atto medico. Comitato nazionale per la Bioetica 2 giugno 1992*, in Riv. it. di med. leg., 1993, f. 178. ; G. IADECOLA, *Consenso del paziente*, vep. e cit., f. 30.

përmbushur detyrimin e informimit në mënyrë korrekte dhe të plotë të pacientit⁷².

Gjithashtu një pjesë e jurisprudencës së Gjykatës së Kasacionit në këtë temë⁷³, beson se pëlqimi pas informimit mund të shprehet pa kërkesa formale, që do të thotë edhe nëpërmjet një sjelljeje që shpreh pa mëdyshje dëshirën e pacientit për t'iu nënshtruar trajtimit mjekësor⁷⁴. Besohet gjithashtu se në qoftë mjeku që do të realizojë trajtimin mjekësor mendon gabimisht se ndodhet në kushtet e pëlqimit të informuar, ky i fundit përjashtohet nga përgjegjësia penale si rezultat i një gabimi mbi faktin sipas nenit 47 të Kodit Penal italian, por nëse ekzistenca e pëlqimit të informuar të pacientit vjen për shkak të një gabimi nga ana e mjekut, ai do të mbajë përgjegjësi penale për realizimin e veprës penale me pakujdesi, gjithmonë nëse ajo vepër penale është e parashikuar në ligj. Për shembull, nëse një kirurg operon një pacient, duke kujtuar gabimisht se pacienti ka shprehur pëlqimin e tij të informuar, do të përgjigjet për veprën penale të plagosjes nga pakujdesia⁷⁵.

b) Pëlqimi duhet të vijë nga i njëjti person, i cili do t'i nënshtrohet trajtimit mjekësor - kirurgjikal (parimi i personalitetit të pëlqimit⁷⁶). Nuk ka efekt ligjor shprehja e pëlqimit të informuar nga ana e familjes së pacientit, pasi asnjë ligj nuk parashikon që anëtarët e familjes,⁷⁷ mund të zëvendësojnë të sëmurin në manifestimin e pëlqimit të informuar, përveçse në rastet e ushtrimit të autoritetit prindëror ose të kujdestarisë të parashikuara në ligj.

Pëlqimi duhet të vijë nga një person i cili, përveç se është titullar i së drejtës së mbrojtur, është gjithashtu i aftë për të dhënë pëlqimin e informuar dhe që ka moshën e kërkuar për ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave të tij. Ka mendime kontradiktore të doktrinës në lidhje me moshën

⁷² Trib. Milano, 25.02.2005, n. 2331, in "*Resp. e risarcim.*", 6/2005, f. 71.; Trib. Roma, Sez. III, 11.04.2011, in "*Banca Dati Repertorio di Giurisprudenza*".

⁷³ Assise di Firenze 8 novembre 1990, vep. e cit., f. 163.; Cass. pen., 11 luglio 2001, n. 585 con nota di G. IADECOLA, *Sulla configurabilità*, vep. e cit., f. 517.; Cass. pen., Sez. I, 29 maggio 2002 – 11 luglio 2002 in *Riv. it. di dir. e proc. pen.*, 2003, con nota di G. LOZZI, *Intervento chirurgico con esito infausto: non ravvisabilità dell'omicidio preterintenzionale nonostante l'assenza di un consenso informato*, f. 604 e ss.

⁷⁴ Assise di Firenze 8 novembre 1990 con nota di, G. IADECOLA, *In tema di rilevanza*, vep. e cit., f. 170

⁷⁵ *Informazione e consenso*, (a cura di) D. BORDIGNON, vep. e cit., f. 193; S. DEL CORSO, *Il consenso*, vep. e cit., f. 556; M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., f. 368.

⁷⁶ *Informazione e consenso all'atto medico*, (a cura di) D. BORDIGNON, vep. e cit., f. 193; S. DEL CORSO, *Il consenso*, vep. e cit., f. 556.; M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., f. 368.

⁷⁷ Cass. pen., Sez. IV, 11 luglio 2001 con nota di G. IADECOLA, vep. e cit., f. 2047.

e kërkuar për shprehjen e pëlqimit pas informimit. Një pjesë e doktrinës,⁷⁸ zgjidh problemin që lind në shprehjen e pëlqimit nga ana e të miturve, duke iu referuar Kodit Civil italian, duke u shprehur se në këtë rast, shprehja e këtij të fundit, u takon prindërve që ushtrojnë autoritetin prindor. Në rast të konfliktit në mes të dy prindërve konsiderohet si i zbatueshëm neni 316 i Kodit Civil italian, sipas të cilit çdo prind mund të marrë të gjitha masat e emergjencës në rast të rrezikimit apo të dëmtimit të rëndë të shëndetit të fëmijës.

Është i preferueshëm për shumicën e doktrinës⁷⁹ argumentimi se për dhënien e një pëlqimi të vlefshëm është e nevojshme arritja e moshës madhore, pra kërkohej mosha tetëmbëdhjetë vjeç. Kjo doktrinë i referohet nenit 2 të Kodit Civil italian, i cili parashikon shprehimisht se “*me moshën madhore fitohet aftësia për të kryer të gjitha veprimet për të cilat nuk kërkohet një moshë e ndryshme*”.

Në rast se pacienti është i mitur, ose një person në gjendje paaftësie për të vepruar, pëlqimi i tij mund të shprehet në mënyrë të vlefshme nga përfaqësuesi i tij ligjor⁸⁰. Kur vullneti i fëmijës është në kontrast me atë të përfaqësuesit ligjor, mjeku nëpërmjet departamentit të shëndetësisë mund të kërkojnë urdhrin urgjent të gjykatës në pajtim me nenin 333 të Kodit Civil italian.⁸¹

c) Pëlqimi pas informimit duhet të jetë një shprehje e lirë dhe nuk duhet të jetë rezultat i një mashtrimi apo i një gabimi⁸². Nuk konsiderohet i vlefshëm pëlqimi pas informimit i një pacienti, i cili ka qenë i mashtruar, si p.sh., në rastin ku mjeku e drejton pacientin në një ndërhyrje mjekësore - kirurgjikale krejtësisht të padobishme, duke paraqitur një rrezik për shëndetin e këtij të fundit.

e) Pëlqimi duhet të jepet para se të fillojë trajtimi mjekësor - kirurgjikal. Si rrjedhojë pëlqimi i shprehur pas këtij trajtimi nuk përben kusht të ligjshmërisë së trajtimit mjekësor - kirurgjikal⁸³.

⁷⁸ Assise di Firenze 8 novembre 1990 con nota di G. IADECOLA, *In tema di rilevanza*, vep. e cit., f. 171.; Cass. pen., Sez. IV, 11 luglio 2001 con nota di G. IADECOLA, vep. e cit., f. 2047.

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ *Informazione*, (a cura di) D. BORDIGNON, vep. e cit., f. 175.

⁸¹ V. DI LEMBO, *Il consenso informato al trattamento medico chirurgico*, in *Riv. pen.*, 2007, f. 1195; *Informazione*, (a cura di) D. BORDIGNON, vep. e cit., f. 171; M. Di PIRRO, *La responsabilità*, vep. e cit., p. 86.

⁸² Cass. pen., Sez. IV, 11 luglio 2001 con nota di G. IADECOLA, vep. e cit., f. 2047.

⁸³ Cass. pen., Sez. II, 23 marzo 1973, in *Giust. pen.*, 1974, II, f. 116.; Cass. pen., Sez. IV, 27 febbraio 1973 in *Mass. Cass. pen.*, 1973, f. 809.

f) Pëlqimi mund të revokohet nga pacienti⁸⁴ në çdo moment, prandaj mjeku duhet të sigurohet se pacienti është konscient përgjatë gjithë kohëzgjatjes së trajtimit. Nëse pacienti shpreh dëshirën e tij për tërheqjen e pëlqimit për trajtim, mjeku duhet të ndalet dhe nuk mund të vazhdojë. Kur trajtimi mjekësor nuk mund të ndërpritet materialisht, tërheqja e pëlqimit nuk ka efekt juridik pikërisht për shkak të pamundësisë nga ana e mjekut për të ndaluar veprimin e tij. Aktiviteti në këtë rast duhet të konsiderohet i ligjshëm⁸⁵. Në qoftë se ndërprerja është e mundur, por shëndeti i pacientit pëson një dëmtim serioz, mjeku mund të vazhdojë më tej, i justifikuar nga gjendja e nevojës dhe urgjencës, sipas nenit 54 të Kodit Penal italian.

g) Pëlqimi i pacientit nuk duhet të jetë në kundërshtim me rregullin publik apo me parimet morale. Ky parim është i bazuar në nenin 5 të Kodit Civil italian, i cili shprehimisht ndalon aktet e disponimit të trupit të personit, kur ato janë në kundërshtim me rendin publik dhe moralin, dhe madje edhe nenin 31 të “*Dispozitave të përgjithshme të ligjit*”, ku thuhet se “*rregullimet ose marrëveshjet private nuk mund të jenë efektive kur ato janë në kundërshtim me rendin publik dhe normat morale*”.

h) Pëlqimi i pacientit i është drejtuar një marrësi të veçantë⁸⁶, që është mjeku prej të cilit ai dëshiron të kurohet. Marrëdhënia midis pacientit dhe mjekut është identifikuar si një marrëdhënie besimi, pacienti jep pëlqimin e tij për cilësitë e veçanta personale dhe profesionale të mjekut. Në këtë rast shtrohet pyetja nëse është i vlefshëm pëlqimi pas informimit, kur mjeku, të cilit i ka shprehur pëlqimin zëvendësohet me një tjetër, pa marrë paraprakisht pëlqimin e pacientit.

i) Pëlqimi i pacientit ka vlerë të veçantë dhe i referohet një ndërhyrjeje të veçantë⁸⁷, që do të thotë se një veprim i ndryshëm nga ai i lejuar nga pacienti nuk është i ligjshëm, përveç rasteve të nevojës dhe urgjencës. Ligji gjithashtu thekson se në rast se trajtimi mjekësor është i përbërë nga disa faza, të cilat mund të paraqesin rrezik për jetën e pacientit, secila prej tyre ka nevojë për një pëlqim autonom të marrë nga mjeku për të vazhduar trajtimin⁸⁸.

⁸⁴ M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., f. 385 e ss.

⁸⁵ Assise di Firenze 8 novembre 1990 con nota di G. IADECOLA, *In tema di rilevanza*, cit., f. 171.

⁸⁶ M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., f. 409.

⁸⁷ Cass. pen., Sez. IV, 11 luglio 2001 con nota di G. IADECOLA, cit., f. 2047; M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., p. 409.

⁸⁸ G. IADECOLA, *Consenso del paziente*, vep. e cit., f. 32.

k) Një tjetër element thelbësor i pëlqimit të informuar, është informacioni i plotë dhe i saktë, që duhet të marrë pacienti para se t'i nënshtrohet trajtimit mjekësor. Jo vetëm pacienti duhet të jetë i lirë në zgjedhjen e tij, por duhet gjithashtu të jetë të vetëdijshëm për këtë të fundit⁸⁹. Plotësia e informacionit i referohet diagnostikimit, mjekimit ose terapisë farmaceutike, ndërhyrjes kirurgjikale, prognozës dhe komplikimeve të mundshme gjatë operacionit edhe pse kjo e fundit vazhdon të jetë objekt diskutimesh juridike ende sot. Mjeku ka për detyrë të informojë pacientin⁹⁰ për kushtet e shëndetit dhe sëmundjen që ai vuan, rreziqet të cilave iu nënshtrohet si rezultat i ndërhyrjes kirurgjikale apo kurimit mjekësor⁹¹. Informacioni që merret nga pacienti duhet të jetë i vërtetë, i plotë dhe duhet të përfshijë edhe informacionin në lidhje me terapisë alternative, duke i dhënë pacientit mundësinë për të bërë një zgjedhje të lirë dhe të informuar. Detyrimi për të informuar në detaje pacientin është i mjekut, i cili ka për të bërë trajtim mjekësor, bazuar në marrëdhënien e krijuar midis mjekut dhe pacientit⁹². Përveç kësaj, informacioni i dhënë nuk duhet të influencojë vullnetin e personit, ashtu siç është shprehur edhe Komiteti Kombëtar i Bioetikës në Itali në datë 20 qershor 1992⁹³: “*Informacioni nuk duhet të jetë vetëm një transmetim i të dhënave por duhet të japë informacionn pacientit mbi alternativat terapeutike dhe jo terapeutike, që janë të mundshme*”. Në fakt, informacioni ka për qëllim t'i japë mundësi pacientit, që të shprehë vullnetin e tij të lirë dhe të bëjë zgjedhjen e duhur⁹⁴.

Pëlqimi pas informimit në Shqipëri

Legjislacioni shqiptar e parshikon pëlqimin pas informimit në disa ligje të zakonshme, të cilat u referohen trajtimeve mjekësore të veçanta. Të tilla janë *Ligji për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë*, nr. 10454 datë 21 korrik 2011, në nenin 15, ku parashikohet shprehimisht dhënia e pëlqimit të lirë nga dhuruesi, Ligji “*Për ndërprerjen e shtatzënësisë*”, nr.8045, datë 7 dhjetor 1995 në nenin 2, par. 6, nenin 4 dhe 6, të cilët trajtojnë informimin e pacientit dhe marrjen e

⁸⁹ A. CRISTIANI, *Le omissioni del medico e il giudizio penale*, Giappichelli Editore, Torino, 2006, f. 102.

⁹⁰ S. DEL CORSO, *Il consenso*, vep. e cit., f. 548 e ss; M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., f. 378, 398 e ss.

⁹¹ G. IADECOLA, *Consenso del paziente*, vep. e cit., f. 33.

⁹² Cass. Sez. III, 27.06.2011, n. 14110 (in: www.legge-e-justizia.it.)

⁹³ *Informazione*, (a cura di) D. BORDIGNON, vep. e cit., f. 185.

⁹⁴ M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., f. 399.

pëlqimit të lirë gruas që dëshiron të ndërpresë shtatzënësinë, si dhe nga neni 3 dhe 4 i *Kartës Shqiptare të të Drejtave të Pacientit*⁹⁵, në të cilët parashikohet e drejta për informim dhe e drejta për pëlqim. Më konkretisht në nenin 3 të Kartës thuhet se “Çdo pacient ka të drejtën për akses ndaj çdo lloj informacioni lidhur me gjendjen e tij shëndetësore, për shërbimet shëndetësore dhe mënyrën e përdorimit të tyre, si dhe për çdo kërkim shkencor apo inovacion teknologjik që mund të jetë i përdorshëm”, neni 4 vazhdon: “...çdo pacient ka të drejtën për akses ndaj të gjithë informacionit që i mundëson atij ose asaj pjesëmarrje aktive në vendimet e tij ose të saj lidhur me shëndetin; Ky informacion është një kusht paraprak për çdo trajtim dhe procedurë, përfshirë dhe pjesëmarrjen në kërkim shkencor.” Si dhe në nenin 5 të po kësaj karte parashikohet e drejta e zgjedhjes së lirë: “...çdo pacient ka të drejtën e zgjedhjes së lirë ndërmjet trajtimeve, procedurave dhe ofruesve të ndryshëm bazuar në informacion adekuat.”

Pëlqimi pas informimit është i parashikuar si i detyrueshëm edhe nga *Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore*, në të cilin kërkohet shprehimisht respektimi i së drejtës së pacientit në zgjedhjen e mjekut, si dhe në pjesëmarrjen e tij në vendimet klinike për trajtimin e tij mjekësor. Më konkretisht Kodi i Etikës parashikon në nenin 28 pëlqimin pas informimit ose ndryshe konsentin e informuar: “Është detyrim për çdo mjek marrja e pëlqimit të të sëmurit përpara çdo ndërhyrjeje, ekzaminimesh apo mjekimesh të propozuara, pasi ta ketë informuar me hollësi dhe të jetë bindur se i sëmuri e ka kuptuar. Kur i sëmuri, në gjendje për të shprehur vullnetin e tij, refuzon ndërhyrjen e propozuar, mjeku duhet të pranojë vullnetin e të sëmurit, pasi ta ketë informuar dhe bindur për pasojat e pritshme. Në qoftë se i sëmuri është nën 16 vjeç, ose i paafte për të shprehur vullnetin e tij apo për të marrë vendime, mjeku nuk mund të ndërhyjë pa njoftuar të afërmit e të sëmurit apo personin përgjegjës legjitim, me përjashtim të rasteve urgjente apo të pamundësisë për të kontaktuar këta persona. Informimi i të sëmurit dhe marrja e pëlqimit apo refuzimi i tij, shprehen me shkrim në dosjen klinike të të sëmurit dhe firmoset nga ai apo personat legjitim që e kanë në kujdestari.”⁹⁶

⁹⁵ *Karta Shqiptare e të Drejtave të Pacientit* (marrë nga:

http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/KARTA_SHQIPETARE_E_TE_DREJTAV_E_TE_PACIENTIT.pdf)

⁹⁶ Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve me vendimin nr. 9 të datës 11 nëntor 2011. (marrë nga: <http://www.qsut.gov.al/index.php/rreth-nesh/kuadri-ligjor/kodi-i-etikes-dhe-deontologjise/>)

Pavarësisht parashikimeve legislative, pëlqimi i informuar nuk ka qenë në qendër të diskutimeve doktrinale apo të vendimeve të jurisprudencës shqiptare, ashtu siç ka ndodhur dekadat e fundit për pjesën më të madhe të vendeve evropiane e më gjerë. Kjo nuk do të thotë që është më pak i rëndësishëm, përkundrazi duke u mbështetur edhe në ndërhyrjet e fundit legislative, vërehet se gjithmonë e më tepër në vendin tonë, po i jepet rëndësi çështjes së pëlqimit të informuar të pacientit dhe të pjesëmarrjes së tij në vendimet që kanë lidhje me trajtimet mjekësore apo kirurgjikale, të cilave duhet t’iu nënshtrohet. Gjithashtu, e rëndësishme është të theksohet se, pëlqimi pas informimit, përbën një element thelbësor në temën e kujdesit shëndetësor, prandaj mungesa e tij apo një pëlqim i pavlefshëm që vjen si rrjedhojë e kushteve të analizuara më sipër, do të çojë detyrimsht drejt një trajtimi mjekësor arbitrar edhe pse në legjislacionin aktual kjo nuk sjell përgjegjësi penale për mjekun. Mbështetur në *Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore*, për mjekët të cilët nuk respektojnë parimin e pëlqimit pas informimit, lind përgjegjësia disiplinore dhe profesionale⁹⁷, bazuar kjo e fundit edhe në nenin 13 të Ligjit “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”⁹⁸ dhe në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional të Urdhrit të Mjekëve⁹⁹.

PËRFUNDIME:

Ky punim kishte për qëllim një analizë të detajuar të çështjes së pëlqimit pas informimit, të kushteve të vlefshmërisë së tij, të nevojshme për të analizuar dhe shqyrtuar përgjegjësinë penale të mjekut si rezultat i realizimit të një trajtimi mjekësor - kirurgjikal arbitrar, pra në mungesë të pëlqimit të informuar. Hulumtimi është i bazuar si në orientimet e jurisprudencës ashtu dhe të doktrinës, duke u fokusuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Italiane të Kasacionit.

Duke marrë parasysh pëlqimin pas informimit si një element të rëndësishëm për trajtimin mjekësor - kirurgjikal, ndonjëherë i klasifikuar si një shkak i legjitimitetit të këtij trajtimi dhe herë tjetër shprehi e parimit të lirisë së individit për vetëvendosje, ia vlen të theksohet se mungesa e pëlqimit pas informimit apo një pëlqim i pavlefshëm, bën që mjeku të

⁹⁷ Neni 68 të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, vep. e cit.

⁹⁸ Ligjin “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”⁹⁸, nr. 8615 datë 1 qershor 2000, Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 15, qershor 2000.

⁹⁹ Rregullore për Gjykimin Disiplinor Profesional, 8 qershor 2012, (marrë nga: <http://www.ufsh.org.al/content/uploads/2014/may/17/rregullore-per-gjykimin-disiplinor-profesional.pdf>)

mbajë përgjegjësi për veprën penale të realizuar dhe përgjigjet për të gjitha dëmet që ka pësuar pacienti.

Drejtimi mbizotërues i jurisprudencës italiane konsideron se mjeku për të realizuar një trajtim mjekësor -kirurgjikal të ligjshëm, ka nevojë për pëlqimin e informuar të pacientit, si një kufi ligjor për sigurimin e aktivitetit mjekësor¹⁰⁰. Rrjedhimisht, pëlqimi pas informimit në trajtimin mjekësor-kirurgjikal, konsiderohet një parim kyç i garantuar nga kushtetuta italiane, që legjitimon dhe mbron të mirën e shëndetit, si një e drejtë ligjore e garantuar me kushtetutë¹⁰¹.

Në qoftë se do t'i referohemi situatës aktuale në vendin tonë, mungon një legjislacion i orientuar drejt përgjegjësisë penale të mjekut në rastet e dëmtimeve fizike, të ardhura si rezultat i trajtimeve mjekësore kirurgjikale arbitrare, pra në mungesë të konsentit të informuar të pacientit, apo në rastet e një konsenti të pavlershëm. Nga *Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore*, parashikohet vetëm një përgjegjësi disiplinore profesionale ndaj mjekut që nuk ka respektuar pëlqimin e informuar të pacientit.

BIBLIOGRAFIA:

Literaturë e huaj:

1. M. Di PIRRO (2013): *La responsabilità del medico*, Edizioni Giuridiche Simone, Napoli.
2. *Consenso e dissenso informati nella prestazione medica*, di M. N. GRIBAUDI, Giuffrè Editore, Milano, 2012.
3. F. MARZANO (2007): *Assenza del consenso del paziente, rilevanza del mancato consenso o solo esplicito dissenso?*, in *Cass. pen.*
4. V. DI LEMBO (2007): *Il consenso informato al trattamento medico chirurgico*, in *Riv. pen.*, f. 1195.
5. M. BILANCETTI (2006): *La responsabilità penale e civile del medico*, Cedam, Padova.
6. A. CRISTIANI (2006): *Le omissioni del medico e il giudizio penale*, Giappichelli Editore, Torino.
7. DASSANO: *Il consenso informato al trattamento terapeutico tra valori costituzionali, tipicità del fatto di reato e limiti scriminanti*, in *Scritti in onore di Marcello Gallo. Scritti degli allievi*, Giappichelli, Torino, 2004. G. IADECOLA, *Consenso del paziente e potestà di curare*, in: A cura di D. AMMIRATI, *La responsabilità penale del medico*, Cedam, Torino, 2004, f. 28 e ss.
8. FERRANDO G. (1998): *Consenso informato del medico e responsabilità del medico, principi, problemi e linee di tendenza*, in *Riv. crit. di dir. priv.*, f. 37 e ss.
9. E. POSTORINO (1993): *Ancora sul consenso del paziente nel trattamento medico – chirurgico*, in *Riv. pen.*

¹⁰⁰ G. IADECOLA, *Consenso del paziente*, vep. e cit., f. 28 e ss.

¹⁰¹ M. BILANCETTI, *La responsabilità penale*, vep. e cit., f. 298 e ss.

10. A cura di D. BORDIGNON, *Informazione e consenso all'atto medico. Comitato nazionale per la Bioetica 2 giugno 1992*, in *Riv. it. di med. leg.*, 1993, f. 171.
11. A. BONELLI – A. GIANNELLI (1991): *Consenso e attività medico – chirurgica: profili deontologici e responsabilità penale*, in *Riv. it. di med. Leg.*, f. 15.
12. U. G. NANNINI (1989): *Il consenso al trattamento medico*, Milano.
13. S. DEL CORSO (1987): *Il consenso del paziente nell'attività medico – chirurgica*, in *Riv. it. di med. Leg.*, II, f. 5.
14. RIZ: *Il consenso dell'avente diritto*, Cedam, Padova, 1979.
15. F. MANTOVANI (1966): voce *Esercizio di un diritto*, in *Enc. dir.*, vol. XV, Milano.
16. FROSALI: in *Sistema penale. Parte prima. Diritto sostanziale*, Utet, Torino, 1958.
17. G. MARRA: *La mancanza di un valido consenso del paziente nel trattamento medico – chirurgico non può trasformare la colpa del medico in dolo*, in *Cass. Pen.*, 2007, f. 274.

Jurisprudenza e huaj:

18. Trib. Roma, Sez. III, 11.04.2011, “Banca Dati Repertorio di Giurisprudenza”.
19. Cass. Pen., Sez. IV, 26 maggio 2010, n. 34521.
20. Cass. Sez. III, 09.02.2010, n. 2847, “*Resp. civ. e prev.*”, 2010, 4, f. 781.
21. Corte Cost, 23-12-2008, nr. 438. (marrë nga: <http://www.cortecostituzionale.it>.)
22. Cass. Pen., Sez. Un. 18 dicembre 2008, n. 2437.
23. Cass. Pen., 14 marzo 2008, Sez. IV, 11335,
24. Cass., Sez. I, 16.10.2007, n. 21748, “*Giust. civ. Mass.*”, 2007, f. 10.
25. Cass. Pen., Sez. VI, 14 febbraio 2006, n. 11640.
26. Trib. Milano, 25.02.2005, n. 2331, in “*Resp. e risarcim.*”, 6/2005, f. 71
27. Cass. Pen., 11 luglio 2001, n. 1572, in *Cass. Pen.*, 2002, p. 2041, con nota di G. IADECOLA, *Sugli effetti penali della violazione colposa della regola del consenso nell'attività chirurgica*.
28. Cass. pen., Sez. I, 29 maggio 2002 – 11 luglio 2002 in *Riv. it. di dir. e proc. pen.*, 2003, con nota di G. LOZZI, *Intervento chirurgico con esito infausto: non ravvisabilità dell'omicidio preterintenzionale nonostante l'assenza di un consenso informato*, f. 604 e ss.
29. Cass. Pen., 9 marzo 2001, in *Cass. Pen.*, 2002, p. 517 con nota di G. IADECOLA, *Sulla configurabilità del delitto di omicidio preterintenzionale in caso di trattamento medico con esito infausto praticato al di fuori dell'urgenza e senza il consenso del paziente*.
30. Cass. Civ., Sez. III, 15 gennaio 1997, in *Foro it.*, 1997, I, f.771, con nota di PALMIERI.
31. Cass. pen., di 21 aprile 1992 con nota di G. MELLILLO, *Condotta medica arbitraria e responsabilità penale*, in *Cass. Pen.*, 1993, f. 63 e ss.
32. Assise di Firenze 8 novembre 1990, in *Giust. pen.*, 1991, f. 163, con nota di G. IADECOLA, *In tema di rilevanza penale del trattamento medico – chirurgico*.
33. Gjykata Kushtetuese Italiane, vendimi i datës 26.07.1979, nr. 88 tek “*Giurisprudenza Italiana*” 1980, I, 1, p. 9.
34. Cass. pen., Sez. IV, 27 febbraio 1973 in *Mass. Cass. pen.*, 1973, f. 809.
35. Cass. pen., Sez. II, 23 marzo 1973, in *Giust. pen.*, 1974, II, f. 116.

Ligje dhe dokumente:

1. *Ligji për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë* nr. 10454 datë 21 korrik 2011.

2. Ligji “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, nr. 8615 datë 1 qershor 2000, Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr. 15, qershor 2000.
3. Ligji “Për ndërprerjen e shtatëzanisë”, nr.8045, datë 7 dhjetor 1995.
4. Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, miratuar nga Këshilli Kombëtar me vendimin nr. 9 të datës 11 nëntor 2011. (marrë nga:
<http://www.qsut.gov.al/index.php/rreth-nesh/kuadri-ligjor/kodi-i-etikes-dhe-deontologjise/>)
5. Rregullore për Gjykimin Disiplinor Profesional, 8 qershor 2012, (marrë nga:
<http://www.ufsh.org.al/content/uploads/2014/may/17/rregullore-per-gjykimin-disiplinor-profesional.pdf>)
6. Karta Shqiptare e të Drejtave të Pacientit (marrë nga:
http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/KARTA_SHQIPETARE_E_TE_DREJTAVE_TE_PACIENTIT.pdf)
7. Convenzione per la Protezione dei Diritti dell’Uomo e la Dignità dell’Essere Umano Riguardo alle Applicazioni della Biologia e della Medicina (1997).

**GJYKIMI BRENDA NJË AFATI TË ARSYESHËM,
NJË NGA PROBLEMATIKAT E SISTEMIT
GJYQËSOR SHQIPTAR**

Klaudia Pupa, Ildir Duhanxhi

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë

**The right to trial within a reasonable time, a problem
of the albanian judicial system**

ABSTRACT

During the last two decades, in the Albanian judicial system are made significant improvements in terms of legal and organizational aspects. However, it has yet to improve efficiency, transparency, impartiality and time trials, in order to fulfill international standards, thus assisting in restoring the confidence of individual institutions and the consolidation of democracy and rule of law. Is exactly the development of a trial within a reasonable time, one of the key points of our justice reform to be undertaken in our judicial system. The right to trial within a reasonable time is a fundamental right constitutional and procedural, that is foreseen in the European Convention on Human Rights and Fundamental Freedoms (ECHR). The issue of the deadline or trial within a reasonable time, is identified with an old Roman maxim "*justice delayed, justice denied ..*". Respect of this very important democratic principle constitutes an important element for the existence of the rule of law, and is one of the tools that guarantee the protection of human rights and fundamental freedoms. The right to trial within a "reasonable time" or "the right to a speedy trial", seen as a guarantee for the protection of parties from unreasonable delays of the procedures. However, during the evaluation of the request for trial within a reasonable time should be taken on the whole, a set of circumstances that affect in the development of criminal trials, civil and administrative, which will be treated further in this paper.

Key words: reasonable time, state, law, democratic principle, reforms.

1. Kuptimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, si një element i procesit të rregullt ligjor.

“Kohëzgjatja optimale dhe e parashikueshme e procedurave gjyqësore duhet të jetë përgjegjësi e të gjitha institucioneve dhe personave që marrin pjesë në hartimin, rregullimin, planifikimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore.”¹⁰²

Një nga elementet me ndikim që çënon në mënyrë të drejtpërdrejtë parimin e procesit të rregullt ligjor, është edhe gjykimi i çështjeve brenda afatit të arsyeshëm. Parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, gjen rregullim kushtetues dhe i bashkohet edhe disa të drejtave dhe lirive themelore të tjera të njeriut. Zbatimi i parimit të shtetit të së drejtës, në jetën e përditshme tek ne, ka hasur dhe vazhdon të hasë vështirësi. Është kjo arsyeja, që me të drejtë theksohet, se zbatimi në praktikë i elementeve apo standardeve të parimit të shtetit të së drejtës, përbën një nga sfidat kryesore me të cilat përballet sot shteti dhe shoqëria shqiptare. Në këtë prizëm, respektimi i parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, përfaqëson një detyrim kushtetues dhe ligjor për gjykatat tona, ashtu si dhe parimet e tjera që janë në themel të shtetit të së drejtës.

Çështja e dhënies së drejtësisë nuk do të kuptohej si e tillë, nëse gjykimi i çështjes do të vijonte pafundësisht apo për një kohë shumë të gjatë. Kjo do sillte situata në të cilën palët e interesuara: 1) *nuk do kenë mundësinë që të realizojnë mbrojtje të të drejtave që ato pretendojnë apo të marrin drejtësinë që kërkojnë*; 2) *do humbin interesin gjatë gjykimit, që mund të shoqërohet edhe me heqjen dorë nga vazhdimi i gjykimit*; 3) *apo nuk do kërkonin që të mbronin të drejtat e tyre nëpërmjet një procesi gjyqësor apo nëpërmjet gjykatave*. Kjo, përfaqëson një situatë në të cilën do të kishim humbje të besimit në raport me gjykatat, për në një zgjidhje të shpejtë dhe të efektshme, brenda një kohe të arsyeshme, ku kjo e fundit (*koha/afati i gjykimit*) merr një rol shumë të rëndësishëm në kuptimin e asaj se çfarë përfaqëson procesi i dhënies së drejtësisë.

Ashtu siç edhe u citua më sipër, parimi i afatit kohor të arsyeshëm, që do t'i duhet gjykatës të zgjidhë çështjen dhe të japë vendimin, gjen një sërë parashikimesh (*rregullimesh*), ku mund të përmenden; neni 42 i Kushtetutës së RSH-së,¹⁰³ neni 6 i KEDNJ-së,¹⁰⁴ apo dhe parashikimet në

¹⁰² Udhëzimet SATURN për menaxhimin e kohës së gjykimit, pjesa I.E, pika 1.

¹⁰³ “Kushdo, ..., ka të drejtën e një gjykimi...brenda një afati të arsyeshëm...”

¹⁰⁴ “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet...brenda një afati të arsyeshëm...”

nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile të RSH.¹⁰⁵ Duke evidentuar përcaktimin në mënyrë të shprehur dhe krejt të qartë të detyrimit që ka gjykata në “*shpejtësinë*” e gjykimit dhe dhënies së vendimit, evidentohet qartë rëndësia që merr një element i tillë procedural, në kuadër të parimit të procesit të rregullt ligjor. Kjo haset dhe në praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, çështje e cila është shqyrtuar në prizmin e parimit të mbrojtjes kundër kufizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Sipas qëndrimit të GJEDNJ-së, shtetet nënshkruese të Konventës janë të obliguara që të organizojnë sistem juridik efikas, ku gjykatat do të jenë në gjendje që qytetarëve t’u garantojnë të drejtën e dhënies së vendimit brenda afatit të arsyeshëm. Jo në pak raste, GJEDNJ-ja në praktikën e saj, ka evidentuar faktin që një proces “*të kualifikohet*” i drejtë, ai duhet të kryhet “*brenda një kohe të arsyeshme*”.¹⁰⁶ Në fakt, parashikimet e nenit 6 të KEDNJ-së, mbi afatin e arsyeshëm të gjykimit të çështjes, i ka dhënë shkas konstatimit nga ana e GJEDNJ-së, të një numri të madh shkeljesh të ndeshura gjatë zbatimit të nenit 6.¹⁰⁷

2. Kohëzgjatja e një gjykimi të arsyeshëm dhe elementet e vlerësimit të afateve kohore

Fakti nëse një afat është i arsyeshëm, ose jo, vlerësohet rast pas rasti. Koha që llogaritet si afat i arsyeshëm fillon të rrjedhë nga momenti i fillimit të procedurës përkatëse, e deri në momentin e përfundimit të saj në instancën më të lartë të mundshme. Por, dy janë pyetjet që lindin për të vlerësuar nëse është plotësuar kushti për një gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm:

Së pari, kur ka filluar dhe kur ka mbaruar gjykimi i çështjes?

Së dyti, çfarë përbën një afat kohor “*të arsyeshëm*” për çështjen në gjykim?

Në lidhje me llogaritjen e kohëzgjatjes së një gjykimi, në çështjet civile, llogaritja fillon që nga çasti kur çështja i kalon autoritetit gjyqësor kompetent¹⁰⁸. Në rast se është e domosdoshme që fillimisht t’i bëhet një kërkesë një autoriteti administrativ, atëherë kohëzgjatja e gjykimit llogaritet që nga momenti i paraqitjes së kësaj kërkesë. Gjykimi konsiderohet i

¹⁰⁵ “Gjykata duhet të shprehet.....brenda një afati të arsyeshëm.”

¹⁰⁶ Gilles Dutertre & Jakob van der Velde, “Fragmente Kryesore të GJEDNJ” – Këshilli i Evropës, vep. e cit., f. 72.

¹⁰⁷ Roberta Medda & Federica Donati, Prezenca e OSBE-së “Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut”, f. 123.

¹⁰⁸ *Scopelliti kundër Italisë*, GJEDNJ, 23 nëntor 1993, paragrafi 18, dhe *Deweer kundër Belgjikës*, GJEDNJ, 27 shkurt 1980, paragrafi 42.

përfunduar pas marrjes së një vendimi të formës së prerë. Kështu, GJEDNJ në çështjen **Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës** (13 korrik 1983, Seria A, Nr. 66, f.11) përcakton se “*E arsyeshmja e kohëzgjatjes së procesit që përfshihet brenda fushës së zbatimit të Nenit 6 paragrafi 1 duhet të vlerësohet në çdo rast sipas rrethanave të veçanta (shih gjykimin e çështjes Buchholz, 6 maj 1981, Seria A Nr. 42, f. 15, paragrafi 49). Gjykata duhet të marrë parasysh ndër të tjera kompleksitetin e problemeve faktike ose ligjore të ngritura në çështje, sjelljet e ankuesve dhe autoriteteve kompetente, si dhe atë që rrezikojnë për të parët; krahas kësaj, vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund ta justifikojnë konstatimin e moszbatimit të kërkesës së “kohës së arsyeshme” (shih, mutatis mutandis, gjykimin e çështjes König, 28 qershor 1978, Seria A Nr.27, f. 34-40, paragrafët 99, 102-105 dhe 107-111, dhe gjykimin e çështjes së mësipërme Buchholz, Seria A Nr. 42, f. 16, paragrafi 49)...”¹⁰⁹*

Pavarësisht praktikës, në një sërë vendesh të kontinentit, dhe jo vetëm në këto, hasen vështirësi të menaxhimit të drejtësisë nga pikëpamja kohore, duke cënuar kështu këtë parim (“*të gjykimin brenda një kohe të arsyeshme*”). Kështu, kryesisht në vende, si: Franca, Italia, Spanja apo dhe Portugalia, shihen vështirësi në gjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, kjo e ndikuar nga shumë faktorë. Në Francë, për shkak të një “*shpërthimi*” në aspektin e volumit të çështjeve, shihet se sistemi vuan nga mungesa e besimit ndaj strukturës gjyqësore,¹¹⁰ duke evidentuar vonesa në dhënien e drejtësisë. Në Itali,... mekanizmi i procesit civil është kthyer në një kompleks festimi i ritualeve të errëta dhe shpesh të papërshtatshme, që vonojnë drejtësinë.¹¹¹

¹⁰⁹ Gilles Dutertre & Jakob van der Velde, “Fragmente Kryesore të GJEDNJ” – Këshilli i Evropës, vep. e cit., f. 72.

Edhe në çështjen **Ekner dhe Hofauer kundër Austrisë** (23 Prill 1987 - Seria A Nr. 117, f.61-62, parag. 64-65) gjykata shpalli: “*...Në procesin civil, “koha e arsyeshme” e përmendur në Nenin 6 paragrafi 1 normalisht fillon të veprojë nga momenti kur ndërmerret procesi para “gjykatës”; është e konceptueshme, sidoqoftë, që në rrethana të caktuara koha mund të fillojë të veprojë herët...periudha në të cilën pëfshihet koha e arsyeshme e shqyrtimit zë tërë procesin në fjalë, përfshirë edhe ndonjë apelim. Për rrjedhojë, kjo periudhë e shtrin të drejtën deri në vendimin që jep fund konfliktit...”*. Shih edhe çështjen Silva Ponte kundër Portugalisë (23 Mars 1994, Seria A, Nr.286-A, f. 14).

¹¹⁰ Adrian A. Zuckerman, Sergio Chiarloni, Peter Gottwald, “Civil Justice in Crisis. Comparative Perspectives of Civil Procedure” (*E drejta Civile në Krizë, Perspektiv krahasuese e Procedurës Civile*), Oxford University Press, N.Y. (USA), 1999, f. 13.

¹¹¹ Po aty.

Në shumë raste, në praktikën tonë gjyqësore, evidentohen të tilla zgjatje të afateve, në disa raste, edhe pa arsye apo të pakuptimta. Përveç praktikës së GJEDNJ-së,¹¹² një punë të mirë, në këtë drejtim, mund të thuhet se është bërë edhe nga Gjykata Kushtetuese, që ka konstatuar dhe trajtuar duke evidentuar njëkohësisht, që një situatë të tillë (*të gjykimit brenda një afati kohor të arsyeshëm*) shoqërohet dhe me shkeljen e parimit të procesit të rregullt ligjor. Ajo ka theksuar se “...përcaktimi i afateve kushtetuese e ligjore në ushtrimin e së drejtës së ankimit, përfshirë këtu edhe të drejtën e paraqitjes së kërkesës për rishikimin, nuk është qëllim në vetvete, por është në funksion të parimit të rëndësishëm të sigurisë juridike, si një nga përbërësit themelorë të shtetit të së drejtës.”¹¹³

¹¹² Por, kjo nuk ndalet këtu, pasi GJEDNJ e shtrin konceptin e procesit të arsyeshëm gjyqësor deri në ekzekutimin e vendimit të gjykatës, pra duke përfshirë këtu edhe konceptin që e drejta konsiderohet e vendosur jo vetëm në vendimin e gjykatës, por kur ajo çfarë është përcaktuar në këtë të fundit është bërë realitet. GJEDNJ është shprehur për këtë çështje edhe për rastet që i janë paraqitur ndaj Shqipërisë, ku ajo ka konstatuar në pjesën më të madhe vonesa të paarsyeshme apo të pakuptimta në dhënien e drejtësisë. Këtu mund të përmenden çështjen Beshiri kundër Shqipërisë (Ankimi nr. 7352/03 - 22 gusht 2006); çështjen “Gjyli kundër Shqipërisë” (Ankimi nr. 32907/07, dt. 29 shtator 2009); apo përcaktimet që bën në çështjen Marini kundër Shqipërisë (Ankimi nr. 3738/02 – 18 dhjetor 2007) ku evidenton se “...(ii) Afati i arsyeshëm i zgjatjes së procesit... 141. Sipas nenit 6 të Konventës, çdo person ka të drejtë që për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile të jepet vendim i formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Për këtë arsye shtetet kontraktuese kanë detyrimin të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që t’i mundësojnë gjykatat të përmbushin këtë kërkesë (shiko *Unión Alimentaria Sanders S.A. k. Spanjës*, vendim i datës 7 korrik 1989, Seria A, nr. 157, f.14-15, § 38). 142. Gjykata përsërit që kohëzgjatja “e arsyeshme” e procesit duhet vlerësuar në bazë të rrethanave të çështjes dhe në lidhje me kriteret e mëposhtme: kompleksiteti i çështjes, qëndrimi i ankuesit dhe i autoriteteve përkatëse dhe interesat e ankuesit në mosmarrëveshje (shiko, përveç burimeve të tjera zyrtare, *Comingersoll S.A. k. Portugalisë [GC]*, nr. 35382/97, § 19, GJEDNJ 2000-IV)...”

¹¹³ Vendimi i GjK të RSh, nr. 25, dt. 10.11.2006. Gjithashtu në vendimin e saj **nr. 18, dt. 19.07.2005**, kjo gjykatë shprehet se “... e drejta për një proces të rregullt ligjor, luan rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Realizimi i kësaj të drejte shfaqet në aspekte të ndryshme, ndërmjet të cilave, një vend të rëndësishëm ze edhe respektimi i parimeve të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e caktuar me ligj. Për të verifikuar nëse është shkelur parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata Kushtetuese e sheh me vend të aplikojë kriteret që ka zhvilluar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në këtë drejtim ka adaptuar një trajtim in concreto, duke u shprehur se, “arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh, sidomos, kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit si dhe sjelljen e autoriteteve kompetente”...”

Nga praktika e zhvilluar nga GJEDNJ-ja, koncepti i gjykimit brenda një “*afati kohor të arsyeshëm*”, shihet i lidhur ngusht apo i kushtëzuar nga disa elemente të tjera. Them i kushtëzuar, pasi çdo çështje dhe ecuria e saj varion në varësi të: **a.** kompleksitetit të çështjes; **b.** sjelljen e vetë aplikuesit; **c.** interesit që mund t’i jetë cënuar aplikuesit; **d.** mënyrën e shqyrtimit të çështjes nga autoriteti gjyqësor.

- **Kompleksitetin e çështjes.**

Shqyrtimi i kompleksitetit përfshin si aspektet faktike, ashtu edhe aspektet ligjore të çështjes, si:¹¹⁴ natyrën edhe rëndësinë e çështjes, numrin e detyrimeve që përbëjnë një proces të vetëm, numrin e dëshmitarëve dhe të problemeve të lindura në lidhje me mbledhjen e provave,¹¹⁵ detyrimet e veçanta procedurale që gjykata është e detyruar të zbatojë, respektimin e procedurës së njoftimeve, ankimet në shkallë të ndryshme të gjyqësorit etj. Në vlerësimet e bëra rreth natyrës e kompleksitetit të çështjes, Gjykata Evropiane, ka diferencuar raste me zvarritje të përkohshme dhe ato që ndonëse kanë vazhduar gjatë apo shumë gjatë, në to është evidentuar ekzistenca të faktorëve objektivë (*Shih Beshiri kundër Shqipërisë - Ankimi nr. 7352/03 - 22 gusht 2006*).

- **Sjelljen e kërkuarit dhe interesit që mund t’i jetë cënuar kërkuarit.**

Në lidhje me sjelljen e kërkuarit mund të ndikojnë një sërë faktorësh, si: mungesa e mbrojtësit, sigurimi i provave dhe paraqitja në rregull e tyre. Sjellja e palëve, përfshirë edhe faktin nëse palët kanë kërkuar apo jo shtyrje të procesit, ose nëse kanë përdorur taktika për të krijuar vonesa. Në gjykimet civile, pritjet që palët të kenë një qëndrim më aktiv sesa palët në një proces penal. Për shembull, një palë nuk mund të presë deri në çastin e fundit për t’i dërguar një përgjigje gjykatës, dhe sjellja e kësaj palë gjatë procesit gjyqësor (*përfshi edhe qëndrimin e saj ndaj veprimeve të një personi të tretë*), merret parasysh për të përcaktuar se çfarë mund të konsiderohet vonesë e arsyeshme. Përgjithësisht, ankuesi (paditësi) në një çështje civile duhet të tregohet i gatshëm për të ndërmarrë hapat procedurale përkatëse, për të mos përdorur taktika vonese, si dhe për të përfituar nga hapësira që ofron legjislacioni vendas për shkurtimin e procedurave.

- **Sjelljen e autoriteteve përkatëse**

Sa i përket qëndrimit të autoriteteve gjyqësore, duhet të ndërmarrë hapat e nevojshme për të shmangur çdo vonesë të panevojshme apo

¹¹⁴ Alban Abaz Brati, “*E Drejta Procedurale Civile*”, Tiranë, 2008, f. 40.

¹¹⁵ Roberta Medda & Federica Donati, Prezenca e OSBE-së “Mbrotjtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut”, vep. e cit., f. 124.

abuzime procedurale nga palët e përfshira në proces, pasi qëndrimi që duhet të mbajnë vetë organet gjyqësore, nuk duhet të jetë i tillë që të shtyjë pa shkaqe afatet e gjykimit të çështjeve¹¹⁶. Në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procedurave, gjykata duhet të marrë në konsideratë parimin e ushtrimit të duhur të drejtësisë, pra faktin që gjykatat kanë detyrimin për të trajtuar në mënyrën e duhur çështjet që i paraqiten.¹¹⁷ Autoritetet gjyqësore kanë për detyrë të tregojnë një gatishmëri të veçantë, ndër të tjera, për çështjet që lidhen me marrëdhëniet e punës, me kujdesin për fëmijët dhe titujt e pronësisë së tokave. Konventa e të drejtave të njeriut, vendos mbi çdo shtet anëtar të saj, detyrimin e organizimit të sistemit ligjor në mënyrë të tillë, që gjykatat e tij të plotësojnë kërkesat e nenit 6 të saj, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm¹¹⁸. Këtë detyrë të gjykatave e gjen edhe në dispozitat procedurale civile shqiptare, e konkretisht në nenin 4 të KPC, sipas të cilit: “... gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor...”, si dhe në nenin 171/a sipas të cilit, “... gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor.”

Pra, siç evidentohet, përcaktimi i kohës së arsyeshme të gjykimit është produkt i trajtimit dhe i përfshirjes të një kompleksiteti faktorësh, që ndikojnë drejtpërdrejt në ecurinë e procesit gjyqësor dhe për të konsideruar nëse një gjykim i tillë është apo jo tej këtij afati të arsyeshëm, duhen marrë në konsideratë të gjithë këta faktorë që japin një panoramë të plotë mbi këtë

¹¹⁶ Këtu i referohemi, afateve kohore që duhen në gjykimin në shkallë të parë dhe vonesat që shkaktohen nga ana e gjykatësve që gjykojnë çështjen si angazhimet të tjera; lëvizjet horizontale apo vertikale të tyre për në gjykatat të tjera të të njëjtit nivel apo dhe niveleve më të larta, që pasqyrohen në shtyerjen e seancave gjyqësore. Po kështu, një çështje tjetër është edhe mos plotësimi me trupë gjyqësore në kohë që shkakton ngarkesë të madhe, me çështje, në gjyqtarët e tjerë, duke ndikuar në afatet e gjykimit të çështjes. Do donim të evidentonim një eksperiencë me Gjykatën e Apelit Shkodër, ku si rezultat i largimit të gjyqtarëve në përbërje të saj, dhe mosplotësimit me trupë gjyqësore në kohë, ka sjellë një ngarkesë të jashtëzakonshme me çështje, pasi nuk arrinte të funksiononte normalisht me trupat gjyqësore, ç’ka shkaktoi dhe pasojat vazhdojnë edhe sot, në vonesa të jashtëzakonshme të gjykimit të çështjeve që shkojnë deri në 1 vit apo diçka më shumë, duke shkaktuar realisht pakënaqësi të ndjeshme edhe në palët e interesuara apo të përfshira në proceset gjyqësore. E njëjta situatë me atë që përmenda me Gjykatën e Apelit Shkodër, evidentohet edhe në Gjykatën e Lartë. Duke qenë një gjykatë e vetme dhe me trupë gjyqësore të reduktuar, shkaktoi pamundësinë e gjykimit të çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, duke shtyrë shqyrtimin e rekurseve nga 1 vit e gjysmë deri në mbi dy vjet.

¹¹⁷ Manual i të Drejtave të Njeriut nr.3, “E drejta për një proces të drejtë gjyqësor”, 2001, f.24.

¹¹⁸ Alban Abaz Brati, vep. e cit., f. 42.

çështje. Megjithatë, theksi vihet që këto vonesa nuk duhet të vijnë si shkak i qëndrimeve të organeve apo strukturave që merren me dhënien e drejtësisë.

3. Qëllimi i zhvillimit të gjyqimit brenda kohës së arsyeshme dhe pasojat e vonesës

Me qëllim mundësimin e një zgjidhjeje të drejtë dhe efikase të çështjeve, gjykata duhet që të mbajë nën kontroll ritmin e procesit gjyqësor¹¹⁹. Detyra themelore e gjykatave është zgjidhja e mosmarrëveshjeve që vijnë para tyre me drejtësi, me shpejtësi dhe në mënyrë sa më ekonomike. Menaxhimi i frytshëm është ose duhet të jetë fokusi kryesor i administrimit të gjykatës¹²⁰. Menaxhimi i çështjeve gjyqësore është një proces kompleks që përfshin brenda vetes shumë aktorë, që nuk duhet të lihen jashtë kësaj veprimtarie, si palët pjesëmarrëse në një proces gjyqësor dhe avokatët e tyre apo edhe institucionet e tjera. Gjykatat që të jenë të suksesshme në menaxhimin e këtyre çështjeve duhet të ndërthurin një sërë përbërësish të ndryshëm, me qëllim zvogëlimin e kohës së pritjes. Qëllimet e përgjithshme të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe të zvogëlimit të kohës së pritjes janë: eliminimi i çdo kohe të harxhuar, përveç asaj që me të drejtë duhet për mbrojtjen, hetimin gjyqësor dhe ngjarjet e tjera gjyqësore, të mundësojë zgjidhje të drejta dhe të frytshme të çështjeve etj¹²¹. Vonesat në gjykimin e çështjeve sjellin zhvlerësimet e gjykimeve, mund të krijojnë ankth tek palët, humbje apo shpërbërje të provave gjyqësore, konfuzion në oraret e caktuara nga gjykatat dhe shumë pasoja të tjera për palët ndërgjyqëse. Palët në një proces gjyqësor meritojnë dhe presin drejtësi të shpejtë, por edhe të përballueshme ekonomikisht. Vonesat sinjalizojnë dështimin e drejtësisë dhe sjellin për gjykatën humbjen e besimit në paanshmërinë dhe dobinë e saj. Mënjanimi i vonesës varet shumë nga përkushtimi ndaj kësaj aksiome të vetme: *Gjykata duhet të marrë iniciativën për të eliminuar shkaqet e vonesës*¹²². Gjithmonë, nga ana e gjykatës duhet të jenë nën kontroll lista e gjyqeve dhe të krijohet një planifikim që të sigurojë përfundime të shpejta. Për këtë arsye, një gjyqtar, duhet të mbikëqyrë planifikimin dhe progresin e të gjitha hapave të çështjes dhe të ketë fuqinë e domosdoshme për të çuar avokatët dhe palët drejt zgjidhjes së çështjes dhe shmangies së vonesave.

Disa nga shkaqet e vonesës që kanë lidhje me administrimin e çështjes nga gjykatat mund të përmendim:

¹¹⁹ Pamela Ryder- Lahey, Vangjel Kosta, Toni Gogu, "Administrimi i Gjykatave, Shtëpia botuese "Kristalina-KH", Tiranë, 2005, f. 170.

¹²⁰ Pamela Ryder- Lahey, Vangjel Kosta, Toni Gogu, vep. e cit, f.132.

¹²¹ Po aty.

¹²² Po aty, f.133.

- *Ngarkesen administrative dhe zyrtare të gjyqtarëve.*
- *Ngarkesën administrative të kryetarit.*
- *Mungesën e ndihmës së hulumtimit ligjor.*
- *Veprimatrinë e dobët nga personeli i gjykatës.*
- *Mungesën e përgatitjes së vazhdueshme të gjyqtarëve.*
- *Mungesën e etikës së punës midis gjyqtarëve.*
- *Paaftësinë e dhënies të informacionit për çështjen.*
- *Procesin e njoftimit të ndërlikuar.*
- *Periudhën e zgjatur në mbledhjen e provave.*
- *Mosparaqitjen e dëshmitarëve.*
- *Mosparaqitjen e ekspertëve gjyqësorë.*¹²³

Duke u nisur nga shkaqet, mund të konkludojmë se, një përkushtim i fortë gjyqësor është thelbësor për zvogëlimin e vonesave dhe kjo do të arrihet atëherë kur nga ana e gjykatës do të mbahet një listë aktuale gjyqesh. Vetëm nëpërmjet zbatimit të atyre rregullave që kanë të bëjnë me të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, nga gjyqtari kërkohet drejtësi dhe efikasitet. Drejtësia ka kuptimin e verifikimit të fakteve dhe të zbatimit të drejtë të normave procedurale dhe materiale, ndërkohë që drejtësia efikase synon që këto qëllime të ligjshmërisë të arrihen në afat sa më të shkurtër, në mënyrë që subjekti që kërkon të drejtën dhe mbrojtjen juridike, ta realizojë atë sa më parë. Shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk e përjashton, përkundrazi, nënkupton kryerjen me cilësi të veprimeve nga gjykata.¹²⁴


4. Situata aktuale dhe masat që duhet të ndërmerren me qëllim të rritjes së shpejtësisë në gjykim

Dihet se një nga problematikat në gjykim të çështjeve në përgjithësi dhe atyre civile në veçanti, janë vonesat të cilat çenojnë të drejtën e palëve për një gjykim të drejtë. Vonesat në gjykimin e çështjeve janë një arsye thelbësore për rritjen e numrit të seancave. Në praktikë identifikohen një sërë arsyesh në lidhje me numrin shumë të lartë të seancave gjyqësore. Megjithatë, që nga viti 2003, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, ka asistuar reformën në drejtësi dhe ka identifikuar problemet procedurale e praktike dhe ka dhënë rekomandime për zgjidhjen e tyre. Një nga këto arsye të shtyrjes të seancave gjyqësore është fakti që gjykatat hasen me probleme për njoftimin e rregullt të palëve të thirrura. Mungesa e pjesëmarrësve në gjykim kontribuon në numrin

¹²³ Po aty, f. 35-40.

¹²⁴ Stavri Çeço, "E drejta procedurale Civile e RPSSH", Tiranë, 1989, f.28.

e lartë të seancave për çdo gjykim. Kriteret për sanksionet ndaj pjesëmarrësve që mungojnë në gjykim, janë shumë të paqartë. Edhe Kodi i Procedurës Civile nuk përcakton qartë një procedurë që duhet ndjekur nga gjykatat për të përcaktuar shkaqet e mosparaqitjes së pjesëmarrësve në gjykim. Kjo bën që gjyqtarët të hezitojnë për të vendosur sanksione ndaj pjesëmarrësve që mungojnë pa arsye. Ky sistem i njoftimit të palëve, duhet të përmirësohet. Kjo mund të realizohet në disa mënyra, ku gjykatat duhet t'u kërkojnë palëve dhe avokatëve të japin informacionin e detajuar në lidhje me mënyrën e kontaktimit të tyre, çka është përfshirë në dispozitat e KPC. Duke referuar sa më sipër, gjykatat për të eliminuar vonesat, duhet të përdorin mënyrat më të shpejta dhe me të besueshme për njoftimin e palëve. Por, problemi qëndron në rastin e thirrjes së palëve paditëse, ku për shkak të mungesës të një sistemi adresash, komunikimet që duhet të bëhen kryesisht me fletë-thirrje, janë të vështira për t'u realizuar, duke ndikuar drejtpërdrejt në vonesat për vijueshmërinë e mëtejshme të gjykimit të çështjes. Gjithashtu, mosveprimi i gjykatave në rastet e thirrjeve të pasuksesshme mund të çënojë të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshem. Në praktikën aktuale të gjykatave, mandatet e thirrjeve nga ftuesit e gjykatave ose zyra postare vendosen në dosjen e çështjes. Por, gjykatat nuk e vlerësojnë faktin nëse thirrjet kanë qenë të suksesshme apo jo, që në momentin kur mandati u dorëzohet nga nëpunësi apo shërbimi postar. Gjyqtari pret derisa të vijë momenti i seancës së planifikuar, kur vijnë në seancë të gjitha palët e tjera dhe dëshmitarët, për të vlerësuar nëse thirrja ishte apo jo e suksesshme¹²⁵. Duke u mbështetur në analizën e Raportit Drejt Drejtësisë, tri grupe kryesore shkaqesh për shtyrje të



seancave gjyqësore janë: mosparaqitja e pjesëmarrësve në gjykim, marrja e provave të tjera dhe çështjet që kishin të bënin me njoftimin e palëve. Grafiku i mëposhtëm paraqet në shifra këto shkaqe të grupuara¹²⁶:

Thirrja jo e suksesshme e pjesëmarrësve në gjykim është një shkak i vazhdueshëm i shtyrjes së seancave dhe si rrjedhim rrit në mënyrë të

¹²⁵ Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore, "Drejt Drejtësisë", OSCE 2012, f. 15.

¹²⁶ Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore, "Drejt Drejtësisë", OSCE 2012, vep. e cit., f. 13.

panevojshme kohëzgjatjen e proceseve. Gjykimi mund të zhvillohet vetëm nëse të gjitha palët janë thirrur ligjërisht. Kjo do të thotë që të gjitha seancat e shtyra për shkak të problemeve në lidhje me thirrjet kanë qenë plotësisht joproduktive.

Ndër problemet në lidhje me thirrjet e palëve janë mbi:

- Informacionin e paplotë rreth adresës;
- Vështirësinë për të gjetur adresën e saktë për shkak të sistemit të ri të adresave;
- Gjykatat nuk kanë mundësi të marrin dhe përdorin të dhënat e Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe të Regjistrin Kombëtar të Adresave;
- Gjykatat nuk kanë akses te RKGjC-ja dhe hartat bashkiake;
- Nëpunësit gjyqësor nuk mund të kontrollojnë identitetin e marrësit në letërthirrje;
- Gjykatat nuk përdorin mjetet më të shpejta të njoftimit të lejuara nga legjislacioni;
- Gjykatat qëndrojnë pasive nëse thirrja nuk është e suksesshme;
- Njoftimet me shpallje nuk bëhen publike online;¹²⁷

Por, në mënyrë që numri i seancave joproduktive të ulet, si pasojë e shtyrjes së seancave, duhet të merren një sërë masash :

- Pjesëmarrësit në gjyq duhet t'i japin gjykatës të dhëna të detajuara kontakti;
- Përmirësimin e mundësive të pjesëmarrësve në gjykim për të kontaktuar gjykatën;
- Kryetari i seancës është përgjegjës për garantimin e thirrjes së palëve në gjyq;
- Palët thirren ligjërisht duke përdorur të dhënat e kontaktit të lëshuara prej tyre;
- Kur është e mundur, gjykatat duhet t'i njoftojnë palët nëpërmjet mjeteve teknike;
- Njoftimet nëpërmjet mjeteve teknike dhe konfirmimi i marrjes së njoftimit duhet të jenë procedurë standarde;
- Gjykatat duhet të kenë akses në hartat ekzistuese të pushtetit qendror dhe atij vendor;
- Gjykatat duhet të kenë mundësi të përdorin Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe hartat me Numrat Zgjedhorë;
- Palët njoftohen ligjërisht nëpërmjet dërgimit të njoftimit në adresat e regjistruara;¹²⁸

¹²⁷ Po aty, f. 37-40.

Një çështje tjetër që meriton një vëmendje të rëndësishme, me qëllim minimizimin e kohës së gjykimit lidhet edhe me disa rrugëzgjdhje në rastin e mosparaqitjes së pjesëmarrësve në gjykim, si:

- Vendosjen e një detyrimi ligjor për pjesëmarrësit në gjykim që të njoftojnë gjykatën në rast se nuk janë të disponueshme;

Për këtë arsye duhet vendosur në KPrC një detyrim për pjesëmarrësit në gjykim, që ata të informojnë gjykatën sa më shpejt të jetë e mundur për rastet kur nuk kanë mundësi të marrin pjesë në seancat gjyqësore.¹²⁹

- Gjykatat duhet t'i njoftojnë pjesëmarrësit në gjykim sa më shpejt të jetë e mundur rreth anulimit të seancave gjyqësore;

Praktika që përdoret aktualisht duke pritur ardhjen e pjesëmarrësve të tjerë në gjykim përpara se të jepet njoftimi për anulim është shumë konsumuese dhe e shmangshme. Duhet që gjykatat, me çdo mjet në dispozicion, të kontaktojnë pjesëmarrësit e tjerë në gjykim me qëllim që të shmangin ardhjen e këtyre të fundit kot në gjykatë. Kjo procedurë duhet ndjekur pavarësisht nga arsyeja e anulimit, p.sh., nëse avokatët ose gjyqtarët kanë një përplasje seancash, janë sëmurë apo nëse një gjyqtar merr pjesë në një seminar. Nëse gjyqtarët nuk e kanë mundësinë të njoftojnë pjesëmarrësit në gjykim, sekretari/sekretarja e gjykatësit, duhet të autorizohet për ta përcjellë këtë mesazh. Kjo praktikë lejohet nga kuadri ligjor aktual dhe mund të zbatohet menjëherë.

- Duhet të vendoset një procedurë për hetimin e arsyeve të mungesës; Në fakt, një procedurë e tillë duhet të përmbajë dy komponente të ndryshme.

Së pari, duhet të vendoset një procedurë, e cila lejon gjykatën të kontrollojë vërtetësinë e çdo dokumentimi në lidhje me mungesën. Për shembull, në rastet kur dyshohet se ka abuzim, gjykata duhet të lejohet t'i kërkojë palëve të paraqesin raporte mjekësore të dhëna nga një doktor i emëruar nga gjykata dhe jo nga doktori i vetë palës, si dhe gjykatat duhet të kontrollojnë në mënyrë të rregullt listën e gjyqeve të gjykatës tjetër në rastet kur avokatët pretendojnë se kanë përplasje të seancave.

Së dyti, duhet të bëhen ndryshime në KPrC, për t'i kërkuar një pjesëmarrësi që mungon të shpjegojë mungesën e tij/saj. Nëse shpjegimi nuk jepet në gjykatë përpara seancës (së anuluar), shpjegimi duhet të jepet

¹²⁸ Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore, "Drejt Drejtësisë", OSCE 2012, Vep. e cit., f. 32-34.

¹²⁹ Shih rekomandimet e ngjashme të sugjeruara nga Euralius II në: Dhënia e prioritetit masave për shkurtimin e kohëzgjatjes së procedimeve gjyqësore (Aktiviteti 8.3.2), Tiranë, 23 Shkurt 2009, faqe nr. 5.

sa më shpejt të jetë e mundur pas seancës, p.sh., në rastet e mungesës për arsye të aksidenteve në trafik gjatë rrugës për në seancë.

- Llogaritja e kostove për vonesat e pajustificuara duhet të standardizohet; Për ta zgjidhur këtë problem, duhet të merret në konsideratë përcaktimi i një kostoje të standardizuar duke u bazuar ndër të tjera tek kohëzgjatja e vonesës, fakti nëse gjykata apo pjesëmarrësit e tjerë janë informuar apo jo përpara seancës, shkalla e fajit dhe numri i pjesëmarrësve në gjykim¹³⁰.

- Vendosjen e gjobave për palët që mungojnë; Duhet të konsiderohet lejimi i gjykatave që të gjobisin palët që mungojnë në mënyrë të pajustificuar nën të njëjtat kushte si ekspertët dhe dëshmitarët. Kjo do t'i lejojë gjykatat të zbatojnë një sanksion më të ulët se vendimi automatik, duke mundësuar një reagim më fleksibël ndaj mosparaqitjes për shkaqe të pajustificuara.

E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm është një nga të drejtat thelbësore proceduriale të palëve dhe një gur themeli i një shoqërie të bazuar në shtetin e së drejtës. Qëllimi i kësaj garancie është mbrojtja e të gjitha palëve të përfshira në procedurat gjyqësore. Në çështjen *H kundër Francës*, prej *GJEDNJ*-së theksohet “rëndësia e dhënies së drejtësisë pa vonesa, vonesa të cilat mund të rrezikojnë efektivitetin dhe besueshmërinë e saj”¹³¹. Këto vonesa shkaktojnë për palët një sërë problemesh praktike, sepse me kalimin e kohës mund të ndodhë që të drejtat ligjore të kompromentohen në mënyrë të pandreqshme, p.sh., kur pala paditëse falimenton përpara se të ekzekutohen pretendimet e saj ose kur gjendja e sendit objekt gjykimi mund të përkeqësohet. Gjykimet e gjata i lënë palët në pasiguri për periudha të gjata kohore dhe mund të shkaktojnë rritje të kostove proceduriale. Si rezultat i gjetjeve të *GjEDNJ*-së për zgjatjen e tepërt të proceseve gjyqësore, disa shtete kanë ndryshuar rregullat e procedurës civile. Për shembull, në vitet ‘90, Italia krijoi një sistem afatesh kohore, p.sh., duke i kërkuar palëve t’i paraqisnin provat në seancën e dytë apo duke krijuar një autoritet të ri gjyqësor, atë të gjyqtarit të paqes (një gjyqtar i vetëm), i cili trajton, ndër të tjera paditë me vleftë më të ulët. Ndërkohë në Kroaci, gjykatat mund t’i shtyjnë afatet vetëm një herë, për jo më shumë se 45 ditë¹³².

¹³⁰ Një masë e tillë është sugjeruar nga gjyqtarët që morën pjesë në seminarin e EURALIUS II “Masa për shkurtimin e procedimeve gjyqësore” Tiranë, 6 maj 2009 zgjatjes së procedimeve gjyqësore (Aktiviteti 8.3.2), Tiranë, 23 Shkurt 209, faqe 5.

¹³¹ *H kundër Francës*, *GJEDNJ*, 24 tetor 1989, paragrafi 58.

¹³² Komisioni Evropian për Eficencën e Drejtësisë (CEPEJ) Length of court proceedings in the member states of the Council of Europe based on the case-law of the European Court of Human Rights [Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në shtetet anëtare të Këshillit të

Në përfundim, e drejta për një proces të rregullt ligjor, konsiderohet e lidhur ngusht me të drejtën e gjyqimit brenda afatit të arsyeshëm, si një e drejtë, e cila duhet t'i sigurohet çdo individ. Në përgjithësi, e drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, paraqitet si një standard thuajse universal dhe kushtetues e për rrjedhojë, personat që pretendojnë se janë prekur nga mosrespektimi i këtij parimi, nuk kanë pengesa ligjore që t'u drejtohen Gjykatave Kushtetuese me anë të një padie kushtetuese, për të kërkuar një gjykim kushtetues. Pra, kjo e drejtë paraqitet si një garanci për shtetasit ndaj veprimeve të padrejta të organeve të pushtetit nga njëra anë dhe si detyrim i këtyre të fundit për të mos cënuar të drejtat dhe liritë themelore.

Por, si kohëzgjatja e gjyqimit dhe cilësia, janë dy faktorë që ndikojnë në besimin e individëve tek sistemi i drejtësisë. Në këtë mënyrë, shpejtësia e gjykimeve duhet që të balancohet me efektshmërinë e procedurave gjyqësore, në mënyrë të tillë që palëve në proces t'u sigurohet një proces i rregullt e ligjor.

Në shumë raste, në praktikën tonë gjyqësore, evidentohen të tilla zgjatje të afateve, në disa raste, edhe pa arsye apo të pakuptimta, kjo edhe sepse gjykimi brenda afatit të arsyeshëm nuk konsiderohet si një kategori fikse dhe e përcaktuar në mënyrë strikte, por si një standard, të cilin gjykata duhet ta vlerësojë në mënyrë të veçantë për çdo rast konkret. Pra siç u evidentua, përcaktimi i kohës së arsyeshme të gjyqimit, është produkt i trajtimit dhe i përfshirjes të një kompleksiteti faktorësh, që ndikojnë drejtpërdrejt në ecurinë e procesit gjyqësor dhe për të konsideruar nëse një gjykim i tillë është apo jo tej këtij afati të arsyeshëm, duhen marrë në konsideratë të gjithë këta faktorë që japin një panoramë të plotë mbi këtë çështje. Megjithatë, theksi vihet që këto vonesa nuk duhet të vinë si shkak i qëndrimeve të organeve apo strukturave që merren me drejtësidhënien. Përfundimisht, kyçi për arritjen e suksesit në zhvillimin e gjykimeve brenda afatit, do të jetë një shpirt nxitës që e përkushton gjykatën apo gjyqtarin ndaj një liste të çliruar nga vonesat¹³³.

Evropës në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut], (Strasburg, Këshilli i Evropës, 2007), faqe. 72.

¹³³ Pamela Ryder- Lahey, Vangjel Kosta, Toni Gogu, Vep. E cit, f. 35.

BIBLIOGRAFIA:***Literaturë shqiptare:***

1. Stavri Çeço (1989): “*E drejta procedurale Civile e RPSSH*”, Tiranë.
2. Jani Vasili (2005): “*Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë*”, shtypur në shtypshkronjën “Gervis”, Tiranë.
3. Alban Abaz Brati (2008): “*E Drejta Procedurale Civile*”, Tiranë.
4. Av.Petraç Çuri (2007): “*E Drejta Procedurale Civile dhe Noteria*”, Tiranë.
5. Prof. dr. Faik Brestovci , “*E drejta Procedurale Civile*”, Prishtinë, 2006 (Universiteti i Prishtinës – Fakulteti Juridik).
6. Pamela Ryder- Lahey, Vangjel Kosta, Toni Gogu, “Administrimi i Gjykatave, shtëp.bot. “Kristalina-KH”, Tiranë, 2005.

Burime të tjera

1. Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore, “*Drejt Drejtësisë*”, OSCE 2012.
2. Manual i të Drejtave të Njeriut nr.3, “*E drejta për një proces të drejtë gjyqësor*”, 2001.
3. Roberta Medda & Federica Donati, Prezenca e OSBE-së “Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut”.
4. Gilles Dutertre & Jakob van der Velde, “Fragmente Kryesore të GJEDNJ” – Këshilli i Evropës..

Kushtetuta dhe akte ligjore

1. Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, bot. “Alb Juris”, Tiranë, 1998.
2. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr.8116 datë 29.03.1996 botuar në fletorën zyrtare nr.9/1996, ndryshuar së fundmi me ligjin 160/2013, Fletore Zyrtare 180/2013.
3. Ligji, nr.8811, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (në fuqi).
4. Përmbledhje e Vedimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Shqipërisë, QPZ, Tiranë, Qershor, 2010.

Aktet Ndërkombëtare

1. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) me protokolle. Miratuar me Ligj Nr. 8137, datë 31.07.1996, e ndryshuar.
2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

Jurisprudencë**Vendime të GJEDNJ.**

1. Çështja “*Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*”.
2. Çështja “*Ekner dhe Hofauer kundër Austrisë*”.
3. Çështja “*Beshiri kundër Shqipërisë*”.
4. Çështja “*Gjyli kundër Shqipërisë*”.
5. Çështja “*Marini kundër Shqipërisë*”.
6. Çështja “*Scopelliti kundër Italisë*”.
7. Çështja “*Silva Ponte kundër Portugalisë*”.

Vendime të Gjykatës Kushtetuese.

1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 18, dt. 19.07.2005.
2. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 25, dt. 10.11.2006.

DËNIMET PENALE DHE ALTERNATIVAT E TYRE

Adrian Leka

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë

Criminal convictions and their alternatives

ABSTRACT

Criminal sanctions are one of the fundamental issues of criminal justice; these are the most dynamic part of this branch of the law. Theories for the purpose of punishment have evolved from the concept of revenge and retribution against the author, to the concept of rehabilitation, resettlement and rehabilitation of the author .

Since these concepts practically put in place, it is not enough to drop them on paper, but requires an analysis of our system of punishment, identification of opportunities for reform and taking concrete steps in this direction.

Currently our system of criminal punishment does not offer the possibility of dialogue or communication between parties in conflict , but leaves their relationship strained and characterized by feelings of opposition or worse , the hostility between them .

The convict discharges its obligation to the state, which in the case of our system represents the “community”; he fails to repair the damage directly to the victim, the fully aware of the consequences of his action and actively act to regulate these effects .

The situation becomes even more troubling, if we consider the conditions of the penitentiary institutions, their overcrowding, respecting the rights of prisoners, etc. This problem cannot be solved only by establishing new institutions to serve the sentence or somewhat improved their conditions, but is required to improve the legislation, so that along with prison sentences, also apply sanctions or other measures that aimed at fostering the development of social skills and personal qualities of prisoners, so improving prospects contained in Chapter VII of the Criminal Code, under the heading " Alternatives to imprisonment " , but how is achieve, remains to be discussed .

1. Format e reagimit ndaj kriminalitetit

Format e reagimit ndaj kriminalitetit, kanë evoluar nga format e reagimit privat (përzënia, dëbimi, hakmarrja, gjakmarrja, pajtimi me shpërblim), në format e reagimit publik. Edhe vetë këto forma, kanë evoluar nëpër etapa të ndryshme, si: etapa e shpagimit dhe e frikësimit; etapa humanitare; etapa e individualizmit të dënimit dhe e riintegritit¹³⁴. Secila etapë ka qenë e karakterizuar nga lloje të ndryshme reagimesh ndaj kriminalitetit, pra lloje të ndryshme dënimesh.

Duke qenë se dënimi është forma e reagimit të shoqërisë kundër autorit të veprës penale, i përcaktuar si i tillë në norma të detajuara ligjore, ai duhet të studiohet si dukuri e veçantë. Me fjalë të tjera, nocioni i dënimit, shpreh në të njëjtën kohë thelbin e vet, rolin që luan si dukuri shoqërore dhe karakteristikat e veta ligjore, me formën në të cilën paraqitet. Duke u nisur nga uniteti i elementeve formale e materiale të tij, dënimi penal përcaktohet si masë e detyruar, e përcaktuar në ligj, të cilën gjykata e cakton kundër personit penalisht të përgjegjshëm për kryerjen e një vepre penale, në funksion të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, si dhe vlerave të tjera shoqërore të garantuara me kushtetutë dhe të drejtën ndërkombëtare¹³⁵.

Nga ky përkufizim i kuptimit të dënimit rezultojnë edhe elementet themelore të tij:

- 1) Dënimi, si masë e dhunshme, paraqet një të keqe që i bëhet personit, i cili ka kryer veprën penale, nëpërmjet heqjes apo kufizimit të lirive dhe të drejtave të tij¹³⁶.
- 2) Dënimi duhet të ketë një qëllim të caktuar që dëshirohet të arrihet nëpërmjet ekzekutimit të tij (dënimit). Ky qëllim përfshin shprehjen e gjykimit shoqëror ndaj autorit të veprës penale, ndikimin ndaj tij që në të ardhmen të mos kryejë më vepra penale, ndikimin ndaj të tjerëve që të mos kryejnë vepra penale, ndikimin ndaj vetëdijes së qytetarëve për pasojat e veprave penale, si dhe dënimin e arsyeshëm të autorëve të veprës penale¹³⁷.

134 Halili, R. Penalogjia, Blendi publishing, August (2000), Prishtina, Hysi. V, Kriminologjia, (2005), Crystallina-KH, Tirana, por edhe Hysi.V, Penologjia (2006), PEGI, Tirana.

135 Elezi, Ismet, "Mbrojtja juridike penale e jetës së njeriut në Republikën Popullore të Shqipërisë", Tiranë, 1962.

136 Elezi Ismet. "E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme I dhe II, Tiranë, 1999.

137 Halili, Ragip, "Kriminologjia", Prishtinë, 2005.

- 3) Dënimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj. Me fjalë të tjera, dënimi duhet t'i përmbahet parimit të ligjshmërisë, në mënyrë që të garantohen qytetarët nga keqpërdorimi i pushtetit dhe arbitrariteti. Dënimet penale përcaktohen vetëm me ligj dhe në asnjë rast, me akte nënligjore¹³⁸.
- 4) Ekzekutimi i dënimit penal varet nga ekzistenca e veprës penale dhe e përgjegjësisë penale të autorit të saj. Dënimi penal nuk mund t'i caktohet një personi që nuk ka kryer një vepër penale apo që nuk është i përgjegjshëm penalisht.
- 5) Dënimi penal mund të caktohet vetëm nga gjykata, pas përfundimit të një procedure shqyrtimi të përcaktuar me ligj.

Përveç elementeve thelbësore, tek disa dënime paraqiten edhe elementet relative, të cilat kanë karakter jo të përhershëm:

- 1) Dënimi penal duhet të jetë personal, pra duhet t'i drejtohet vetëm autorit të veprës penale dhe jo personave të afërt të tij, të cilët nuk kanë lidhje me veprën penale. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve për përmbushjen e kësaj kërkesë, pothuajse çdo dënim penal godet edhe persona të tjerë të afërt me autorin e veprës penale.
- 2) Dënimi penal duhet të jetë human (pra njerëzor), gjë që do të thotë se dënimi nuk mund të ketë elemente që të konsiderohen torturë, mundim apo sjellje çnjerëzore ndaj autorit të veprës penale¹³⁹.
- 3) Dënimi duhet të jetë i moralshëm, që do të thotë se dënimi nuk duhet ta demoralizojë autorin e veprës penale¹⁴⁰.
- 4) Dënimi duhet të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të autorit të saj.
- 5) Dënimi duhet të jetë i përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë, në mënyrë që dënimi për veprën konkrete të mund të jepet i ulët ose i lartë, në varësi të rëndësisë së veprës penale, rrethanave të kryerjes së saj dhe rrezikshmërisë së autorit.
- 6) Dënimi duhet të jetë i revokueshëm, që do të thotë se ekzekutimi i tij mund të ndërpritet në rastet, kur ai është caktuar në kundërshtim me ligjin. Kjo karakteristikë e dënimit ka rëndësi të madhe, për shkak të rëndësisë që ka e drejta për liri personale për individin dhe mbrojtja e tij nga gabimet gjyqësore.
- 7) Dënimi duhet të jetë i përmirësueshëm¹⁴¹, në mënyrë që të shmangen pasojat që mund të vijnë nga natyra e tij. Kjo karakteristikë është

¹³⁸ Halili, Ragip, "Kriminologjia", Prishtinë, tetor 2007, bot. V.

¹³⁹ Hysi, V, Kriminologjia (2005), Crystallina-KH, Tirana.

¹⁴⁰ 13. Pallazzo, F., Papa, M. "Lezioni di diritto penale comparato" (2000), Giappichelli editors, Padova.

¹⁴¹ Kambovski, V. Criminal Law, General part (2006), Print ISM, Skopje.

gjithashtu e rëndësishme për shkak të mundësisë së caktimit të dënimit të paligjshëm apo të bazuar në prova të rreme. Dënimi me gjobë është i përmirësueshëm, kurse ai me burgim nuk është, pasi koha e kaluar në burg nuk mund të kthehet. Megjithatë, për personin e burgosur me pa të drejtë, koha e kaluar në burg, mund t'i kompensohet në para.

- 8) Dënimi duhet të jetë i ndërrueshëm, në mënyrë që të mundësohet zëvendësimi i tij me një lloj më të lehtë dënimi se sa ai që është caktuar në vendimin fillestar.

2. Teoritë mbi bazën ligjore dhe shoqërore të ndëshkimit

Në teorinë e së drejtës penale qysh herët është parashtruar çështja e bazës juridike të dënimit, pra dhënia përgjigje pyetjes së çfarë qëndron në bazë të së drejtës të shtetit për të dënuar autorët e veprave penale. Gjatë procesit të gjetjes së përgjigjes të kësaj pyetjeje, janë zhvilluar shumë teori, nga të cilat më të njohurat janë:

- 1) Teoria idealiste;
- 2) Teoria e kontratës shoqërore;
- 3) Teoria juridike;
- 4) Teoritë sociologjike.

Sipas teorive idealiste, baza e së drejtës së shtetit për të dënuar është kërkesa e së drejtës absolute. E drejta absolute është kategori ideore, nga e cila rrjedh e drejta e shtetit në përgjithësi dhe, për rrjedhojë, edhe e drejta për zbatimin e dënimit. Me kryerjen e veprës penale, vjen edhe shkelja e së drejtës absolute, e cila mund të rivendoset vetëm, pasi të jetë zbatuar dënimi përkatës ndaj autorit të veprës penale. Drejtësia absolute mund të kuptohet në mënyra të ndryshme dhe, në kuadër të teorive të ndryshme¹⁴², veçohen tri qasje ndaj drejtësisë absolute:

- 1) Teoria e të drejtës së perëndisë;
- 2) Teoria e së drejtës morale;
- 3) Teoria e së drejtës zakonore.

Sipas teorisë të së drejtës së perëndisë, e drejta e dënimit është me prejardhje hyjnore, por, me krijimin e shtetit, kjo e drejtë u transferua nga perëndia tek shtetet. Prandaj, sipas kësaj teorie, shteti është vetëm një zbatues i thjeshtë i një të drejte së perëndisë, e drejtë që është e karakterit imperativ, sepse mbështetet në kërkesën që të dënohet çdo person që shkel rregullat nëpërmjet kryerjes së ndonjë veprë penale¹⁴³.

¹⁴² G. Fiandaca, E. Musco: "Diritto penale parte generale", Bologna, 1995, f. 648 e vijues.

¹⁴³ G. Fiandaca, E. Musco, op. cit., f. 648 e vijues.

Teoria e së drejtës morale konsideron se baza e së drejtës së shtetit në aplikimin e dënimit penal rrjedh nga normat morale, të cilat zotërojnë botën dhe të cilat gjenden në vetëdijen e secilit individ. Sipas Kantit, normat morale janë të përmbledhura në vetëdijen e secilit individ me mendje të shëndoshë, kështu që çdo njeri i arsyeshëm është në gjendje të vlerësojë veprimet e veta dhe të kuptojë se çfarë është e lejuar dhe çfarë jo¹⁴⁴. Personi që sillet në mënyrë të palejuar e kupton në vetëdijen e vet kërkesën për zbatimin e dënimit, e cila ka karakter të imperativitetit kategorik.

Teoria e të drejtës ligjore (Hegeli), konsideron se baza e të drejtës për dënim, qëndron në domosdoshmërinë dialektike. Në çdo shtet, si forma më e lartë e idesë absolute, ekziston një e drejtë ligjore e përcaktuar¹⁴⁵. Me kryerjen e veprës penale, kjo e drejtë refuzohet (sulmohet), kështu që ndaj personit që ka kryer veprën duhet të zbatohet dënimi, si kundërmasë përmes së cilës rivendoset e drejta. Pra, vepra penale është negacion i së drejtës, kurse dënimi është negacion i negacionit, përmes të cilit rivendoset rendi i shkelur juridik.

Teoria e kontratës shoqërore (Ruso, Grocius, Lok, Hobs), konsideron se individët, si pjesëtarë të shoqërisë në shkallën e caktuar të zhvillimit të saj, e kanë kuptuar se nuk janë në gjendje të kujdesen individualisht për mbrojtjen e të mirave dhe të interesave të tyre. Përpara se kriminaliteti të marrë në zotërim gjithçka, ata kanë vendosur të formojnë shtetin dhe t'i transferojnë atij të drejtat e tyre për mbrojtjen nga sjelljet e palejuara dhe të kundërligjshme. Në këtë mënyrë, duke hequr dorë nga e drejta për të dënuar në dobi të shtetit, individët gjithashtu kanë pranuar që edhe vetë të dënohen nëse shkelin ligjin dhe të kryejnë vepra penale. Kështu që, në bazë të kësaj teorie, del se baza juridike e dënimit gjendet në kontratën shoqërore të individit, nga e cila u themelua shteti.

Teoritë juridike mbi bazën juridike të dënimit e shohin përgjigjen e kësaj pyetjeje në normat e së drejtës pozitive. Shteti ka kompetenca të

¹⁴⁴ G. Fiandaca, E. Musco, op cit., f. 648, shënimi 37, ku pasqyrohet afirmimi i Kant-it, i cili në veprën "Die Metaphysik der Sitten", § 49 E I, Kant Studienausgabe der Wissenschaftlichen Buchgesellschaft, IV, 1956, f. 455, vijon: "Edhe nëse shoqëria civile do të shkrihej me konsensusin e të gjithë anëtarëve (për shembull, nëse populli që banon në një ishull vendos të ndahen, duke u shpërndarë në të gjithë botën), vrasësi i fundit, që gjendet në burg, duhet ekzekutuar paraprakisht në mënyrë që secili të marrë atë që veprimet e tij meritojnë dhe faji i gjakut të mos bjerë mbi popullin, që nuk ka kërkuar këtë dënim". Është e njohur gjithashtu formula dialektike e Heghel, Grundlinien der Philosophie des Rechts, § 104, sipas të cilit dënimi përfaqëson "mohimin e mohimit të së drejtës".

¹⁴⁵ G. Fiandaca, E. Musco, op. cit., f. 648 e vijues.

nxjerrë norma, përmes të cilave rregullohet jeta e njerëzve. Nga kjo rezulton edhe kompetenca e shtetit që të sigurojë zbatimin e ligjit. Kjo do të thotë se shteti ka të drejtë të nxjerrë norma, përmes të cilave do të rregullohet sjellja e individëve, kërkohet nga qytetarët bindje, si dhe ndëshkim për ata që nuk i respektojnë normat.

Njëri ndër përfaqësuesit e këtyre teorive është autori Binding, i cili vlerëson se shteti ka të drejtë për vetëmbrojtje kundrejt autorëve të veprave penale, të cilët kanë shkelur ndonjë normë juridike dhe kanë vënë në rrezik të mirat juridike të mbrojtura.

Teoritë sociologjike e shohin bazën juridike të dënimit në funksionin social të së drejtës penale. Sipas teorisë utilitare (Bentam), dënimi ka si arsyet, ashtu edhe dobinë e zbatimit të tij. Sipas Listit, baza juridike e dënimit rezulton nga nevoja për të ruajtur rendin juridik dhe sigurinë e shtetit. Nevoja e shtetit për të zbatuar dënimet rezulton nga nevoja e ruajtjes dhe sigurimit të të mirave dhe vlerave më të rëndësishme shoqërore nga të gjitha format e shkeljes dhe rrezikimit të tyre.

Në teorinë e së drejtës penale qysh herët është diskutuar edhe pyetja se cili është qëllimi i dënimit, pra çfarë dëshirohet dhe çfarë mund të arrihet nëpërmjet zbatimit të dënimit ndaj autorëve të veprave penale. Gjatë procesit të gjetjes së përgjigjes të kësaj pyetjeje janë zhvilluar teori të ndryshme:

- 1) Teori absolute;
- 2) Teori relative;
- 3) Teori të përziera (eklektike).

Sipas teorisë absolute, qëllimi i dënimit është hakmarrja, represioni ndaj autorit për veprën e kryer. Me këtë veprë, ai i shkakton shoqërisë një të keqe, kurse shoqëria ia kthen të keqen nëpërmjet caktimit të dënimit. Ky person e përjeton të keqen që i shkakton caktimi i dënimit gjatë vuajtjes së këtij dënimi. Prandaj qëllimi i dënimit është hakmarrja, shpagimi nga ana e shoqërisë, pikërisht vuajtja që i shkaktohet autorit të veprës. Teoritë shpaguese bazohen, nga ana tjetër, edhe në një parim në thelb utilitarist: dënimi aplikohet thjesht sepse fajtori e ka merituar. Këto teori nuk përpiqen të rindërtojnë çarjet sociale të krijuara nga akti kriminal. Ajo që është thelbësore në teorinë shpaguese është respektimi i proporcionalitetit i përqendruar mbi rëndësinë e raportit rrezik-dëm dhe mbi intensitetin e shkallës së fajit, qoftë ajo dashje apo pakujdesi.

Teoritë relative hedhin poshtë qasjen, sipas së cilës hakmarrja është i vetmi qëllim i dënimit dhe konsiderojnë se dënimi paraqet mjetin e mbrojtjes së shoqërisë nga kriminaliteti. Qëllimi i dënimit gjendet në dobishmërinë shoqërore, që do të thotë, në faktin se sa mund të shërbejë

dënimi si mjet efikas në luftën kundër kriminalitetit (edhe ky një funksion utilitar). Në këtë kuptim, qëllimi themelor i dënimit është parandalimi i kryerjes së veprave penale në të ardhmen. Autori nuk dënohet për atë që ka bërë, por që të mos gabojë më në të ardhmen. Në varësi të mënyrës se si realizohet ky qëllim, dallohen:

- 1) Teoria e prevencionit individual dhe special;
- 2) Teoria e prevencionit të përgjithshëm.

Teoritë e prevencionit individual dhe atij special konsiderojnë se qëllimi i dënimit është parandalimi i kryerjes së veprave të tjera nga ana e autorit. Ky qëllim arrihet me aplikimin e mjeteve të veçanta dhe të metodave ndikuese mbi autorin, të cilat janë të mjaftueshme që ai në të ardhmen të mos kryejë vepra penale¹⁴⁶.

Në varësi të metodës, përmes së cilës ushtrohet ndikimi, dallohen tri variante të kësaj teorie:

- 1) Teoria e frikësimit;
- 2) Teoria e përmirësimit;
- 3) Teoria e kujdestarisë.

Sipas teorisë së frikësimit, dënimi duhet të zbatohet në mënyrë të tillë që të shkaktohet frikë tek autori i veprës, në një masë të tillë, në mënyrë që ai të pengohet të kryejë vepra penale në të ardhmen. Teoria e përmirësimit nisët nga supozimet se autori i veprës penale është person, tek i cili mbizotërojnë tipare negative. Për këtë arsye, ndikohet me anë të dënimit që ato karakteristikë negative të shuhën dhe të zhvillohen karakteristikë pozitive. Në mënyrë që kjo të arrihet, dënimi duhet të jetë mjet për përmirësim, pra mjet që mund të ndërrohet, zëvendësohet, për t'iu përshtatur karakteristikave psikologjike të autorit të veprave penale.

Teoritë e prevencionit gjeneral konsiderojnë se qëllimi i dënimit është ndikimi në masa të gjera të qytetarëve në mënyrë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale. Me të vepruarit e tillë të dënimit paraprakisht parandalohen qytetarët, të cilët janë të prirur për kryerjen e veprave penale që të mos i kryejnë ato dhe në këtë mënyrë, t'i shmangen zbatimit të dënimit. Në varësi të mënyrës se si mund të arrihet ky qëllim, dallohen tri variante të kësaj teorie: 1) Teoria e frikësimit të përgjithshëm, 2) Teoria e tërheqjes së vërejtjes, 3) Teoria e frikësimit me ekzekutimin e dënimit.

Sipas teorisë së frikësimit të përgjithshëm me dënimin e përcaktuar (teoria e detyrimit psikologjik), i bëhet me dije secilit qytetar se do t'u

¹⁴⁶ Shih L. Eusebi: "La nuova retribuzione", në *Diritto penale in trasformazione* nën kujdesin e Marinucci e Dolcini, Milano, f. 93 e vijues, 97 e vijues, 106 e vijues, në të cilin trajtohet raporti midis teorisë shpagueuse, parandalimit të përgjithshëm dhe qëllimet politiko-kriminale.

ndodhë diçka e keqe në qoftë se ata kryejnë vepra penale. Kërcënimi me dënim ndikon si detyrim psikologjik në të gjithë delikuentët potencialë që të përmbahen nga shkelja e rregullave dhe të mos kryejnë vepra penale. Sipas teorisë së vërejtjes mbi dënimin e përcaktuar (teoria e detyrimit moral), u bëhet me dije qytetarëve se kryerja e veprave penale është amorale dhe e ndaluar dhe natyrisht, e dënueshme. Në këtë mënyrë, dënimi lufton karakteristikat amorale, të cilat ekzistojnë te disa qytetarë dhe në anën tjetër, ngre moralin e përgjithshëm të shoqërisë.

Teoria e frikësimit me ekzekutimin e dënimit konsideron se parandalimi i kriminalitetit arrihet me ekzekutimin e dënimit ndaj të gjykuarve. Ky ekzekutim duhet të jetë i tillë që të shkaktojë frikë në masë. Në mënyrë që kjo të arrihet, dënimet duhet të ekzekutohen hapur dhe të jenë të ashpra apo në mënyrë të tillë që për to të flitet në masë nga një person tek tjetri.

Sipas teorisë së kujdestarisë, autori i veprës është person që nuk ka rezistencë ndaj ndikimeve të jashtme, prandaj ai ka rezultuar të jetë i përshtatshëm për kryerjen e veprave penale.. me caktimin e dënimit ndaj tij, ai vihet nën përkujdesjen e organeve shtetërore, të cilat kanë për detyrë që ta aftësojnë për t'u sjellë në pajtim me rregullat e shoqërisë dhe për të respektuar normat e rendit juridik dhe të disiplinës shoqërore.

Teoritë e përziera (eklektike) kanë lindur si bashkim i elementeve të teorive absolute dhe atyre relative. Sipas kësaj qasjeje, qëllimi i dënimit nuk mund të realizohet vetëm me hakmarrje e as vetëm me parandalim. Dënimi duhet të ketë qëllim parandalimin (pra parandalimin e kryerjes së veprave në të ardhmen). Megjithatë dënimi zbatohet me rastin e kryerjes së ndonjë vepre penale konkrete dhe natyrisht, ndaj autorit të asaj vepre, ku në një këndvështrim të ngushtë, paraqet detyrimin dhe masën retributive (masën e kufizimit apo marrjen e të mirave juridike, lirinë dhe të drejtën), pra autori dënohet për veprimin e gabuar, por edhe që të mos gabojë më.

Duke interpretuar dispozitat e caktuara të ligjit penal të Republikës së Shqipërisë, rezulton se qëllimi i dënimit është që:

- të shprehet gjykimi shoqëror për veprën e kryer penale;
- të ndikohet mbi autorin, që në të ardhmen të mos kryejë vepra të tilla;
- të ndikohet mbi qytetarët e tjerë që të mos kryejnë vepra penale;
- të ndikohet në vetëdijen e qytetarëve mbi anën e dëmshme të veprave penale, si dhe mbi dënimin e drejtë të autorëve¹⁴⁷.

¹⁴⁷ E drejta penale e Republikës Popullore të Shqipërisë, pjesa e përgjithshme, grup autorësh, Tiranë, 1973, f. 2010.

Kjo do të thotë që ligjvënësi nisët nga ideja se qëllimi final i dënimit është mbrojtja e shoqërisë, konkretisht e të mirave dhe vlerave të tjera shoqërore, nga kriminaliteti dhe qëllimi i tij i drejtëpërdrejtë është përcaktuar si i dyfishtë:

- Preencionin special (i veçantë), si parandalimin e autorit për të kryer vepra penale dhe përmirësimin, edukimin e tij;
- Preencionin e përgjithshëm, si ndikim edukativ mbi qytetarët e tjerë që të mos kryejnë vepra penale dhe ndikimin në vetëdijen e tyre mbi anën e dëmshme të veprave penale dhe domosdoshmërinë e dënimit të autorëve të tyre¹⁴⁸.

Edhe ligje të tjera penale bashkëkohore e përcaktojnë në mënyrë të ngjashme qëllimin e dënimit.

3. Llojet më të përhapura të dënimeve penale

Sistemi i dënimeve është tërësia e dënimeve të përfshira në legjislacionin penal të një vendi, mënyra e përcaktimit të tyre, si dhe raportin e ndërsjellë. Për qëllim të luftimit më të suksesshëm të kriminalitetit, të gjitha legjislacionet parashikojnë shumëllojshmëri të dënimeve. Për këtë arsye është e domosdoshme të realizohet individualizimi i dënimit, që do të thotë, se ndaj secilit person që kryen vepra penale të caktohet ai dënim, i cili realizon në mënyrën më të mirë qëllimet e dënimit penal.

Në bazë të kësaj që u tha, ekzistenca e një numri të madh të dënimeve ka për pasojë:

- nevojën e një lufte më efikase dhe më cilësore kundër kriminalitetit;
- nevojën e përshtatjes së llojit dhe masës së dënimit me autorin përkatës të veprës, në mënyrë që të arrihet risocializimi i tij.

Duke qenë se legjislacionet penale parashikojnë shumë lloje të dënimeve, atëherë ato mund të ndahen në bazë të kriterëve të ndryshme:

- Në varësi të pavarësisë në caktimin e tyre, dënimet ndahen në dënime kryesore dhe në dënime plotësuese. Dënimet kryesore janë ato që mund të caktohen më vete, kurse dënimet plotësuese janë ato të cilat nuk mund të caktohen më vete, por vetëm bashkë me dënimet kryesore¹⁴⁹.
- Në varësi të kohëzgjatjes, dënimet ndahen në të gjata dhe në dënime të përcaktuara në kohë. Dënimet e gjata (të përjetshme) janë ato dënime të cilat caktohen për tërë jetën e të dënuarit. Dënimet e përcaktuara në

¹⁴⁸ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë, 1999.

¹⁴⁹ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë, 1999.

kohë janë ato dënime, të cilat caktohen nga gjykata për një kohë të caktuar¹⁵⁰.

- Në varësi nga të mirat që dënimet godasin, ato ndahen në: dënime kundër jetës, dënime kundër integritetit trupor, dënime kundër lirisë, dënime kundër pasurisë, dënime kundër të drejtave qytetare, etj¹⁵¹.
- Në varësi të procedurës legislative, dënimet mund të jenë alternative dhe kumulative. Atëherë kur dënimet janë të paraqitura si alternative, gjykata cakton vetëm njërin prej tyre. Në rastin e dënimeve të parashikuara si kumulative, gjykata cakton të gjitha dënimet e parashikuara në ligj kundër autorëve të veprave penale¹⁵².

4. Avantazhet dhe rreziqet e përdorimit të dënimeve alternative

Modeli i drejtësisë restauruese imponohet si një model gjithëpërfshirës me shumëllojshmëri aplikimesh. Nga ana tjetër, Wright, ngre disa problematika rreth aplikimit të drejtësisë restauruese që në thelb konsistojnë në ekzistencën e rrezikut që viktimat të ndjehet e detyruar, duke qenë në dijeni të avantazheve që autori i veprës penale mund të ketë; në rrezikun që të shkelen të drejtat e të pandehurit, i cili mund të ndjehet i detyruar të vetakuzohet për të përfituar nga avantazhet, edhe në prani të provave të vlefshme në shfajësim të tij; në mungesën e qartësisë së rezultateve, pasi mund të verifikohen kërkesa të ndryshme nga ana e viktimave karshi autorëve të veprave penale të ngjashme, pasi siç kemi thënë, objektivi kryesor i drejtësisë restauruese është t'i ofrojë hapësirën maksimale (të mundshme) kërkesave të palës së dëmtuar. Autori përfundon duke përkufizuar drejtësinë restauruese, jo shumë si një model alternativ që lind në kontrast me modelet e mëparshme, por si një proces evolutiv dhe i vazhdueshëm i kalimit nga objektiva shtypës në objektiva restaurues¹⁵³. Konsiderojmë se pjesërisht është kështu, pasi asnjë ndryshim nuk mund të ndodhë pa marrë parasysh se çka qenë përpara.

Duhet të theksojmë gjithashtu që nuk mund të mbrohet në asnjë rast teza se lindja e një modeli të ri të administrimit të drejtësisë, korrespondon me rënien totale të modelit të vjetër, por që modelet e ndryshme alternohen dhe rikthehen në raport me ndryshimet shoqërore dhe politike, siç është

¹⁵⁰ Salihu Ismet, "E drejta penale, Pjesa e përgjithshme", Prishtinë, 2003.

¹⁵¹ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë, 1999.

¹⁵² Salihu Ismet, "E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme", Prishtinë, 2003.

¹⁵³ McNeil, F. (2006). A desistance paradigm for offender management. In *Criminology & Criminal Justice*. Vol. 6(1): 39-62. Sage Publications Hoëard Journal, Vol. 39, No. 4, pp 382-397.

rasti i modelit shpagues, i gatshëm të rishfaqet sapo të lindë nevoja e forcimit “të përgjigjes ndëshkuese” dhe rivendosjes së garancive procedurale dhe modeli socio-rehabilitues që natyrisht nuk ka përënduar, sidomos nëse i referohemi sistemit të drejtësisë për të miturit, ku në çdo rast mund të integrohet me modelin e ri të drejtësisë restauruese.

Kushdo që propozon aplikimin e programeve të ndërmjetësimit në fushën e drejtësisë (dhe jo vetëm), propozon një lexim të dyfishtë të çështjes së ndërgjegjësimit apo të bërit përgjegjës: e para më tepër e lidhur me specifikën e funksionimit të ndërmjetësimit, e dyta në lidhje me formën e përfshirjes së palëve. Nëse, siç mendon De Leo, mendojmë për ndarjen tendencioze që ekziston midis përgjegjësisë së hekurt që gjejmë në botën e drejtësisë dhe përgjegjësisë së ndryshme e të hapur që mund të gjejmë në fushën e psikologjisë dhe në shumë sektorë të tjerë të shkencave humane, shumë larg nga bota e së drejtës, vërejmë se ndërmjetësimi punon për të vënë në lëvizje lidhje të reja ndërvepruese e dinamike, midis përgjegjësi relative me kontekstet e ndryshme sociale dhe atyre që vërehen në çështjet e drejtësisë. Por, De Leo, na ka mësuar mbi të gjitha se, përgjegjësia mund të kuptohet si një nga funksionet që janë baza e proceseve të diferencimit social. Për shembull, duke mos konsideruar përgjegjës disa subjekte (të miturit, të sëmuret mendore etj.), apo duke i konsideruar përgjegjës vetëm pjesërisht, mund të thotë se këtyre subjekteve u njohim më pak pushtet, më pak rëndësi shoqërore, më pak mundësi për të socializuar apo për të kuptuar, si dhe më pak aftësi dhe vetëvlerësim, për rrjedhojë më pak mundësi për të recuperuar ndaj një akti/veprimi negativ të kryer, qoftë materialisht, qoftë psikologjikisht.

Në proceset sociale, në fakt, përgjegjësia është drejtpërdrejt e proporcionuar me pushtetin e poseduar, me statusin social, me autoritetin që kemi mbi veten dhe mbi të tjerët. Pikërisht mbi bazën e këtyre konsideratave, në njëzet vitet e fundit studiuesit, politikanët, operatorët socialë dhe të së drejtës kanë punuar për të ndërtuar një model të drejtësisë për të miturit, i aftë që të shkojë - shikojë - tej dënimit, si sanksion impersonal dhe institucionalizues.

Kjo do të thotë se përgjegjësia është diçka që ndërtohet në raportet midis subjektit – veprimit – institucionit – shoqërisë, dhe jo vetëm një cilësi e brendshme e ndërgjegjes dhe e vullnetit, e thënë ndryshe, e aftësisë për të kuptuar dhe dëshiruar.

Përkrahësit e ndërmjetësimit marrin shkas pikërisht nga bindja se ajo çka përjeton dhe eksperiencia e të miturit, lidhja që ai ka me sjelljet e tij devijuese, njohja dhe këndvështrimi nga pikëpamja normative, sociale,

institucionale, janë pikat kyçe për një politikë “përgjegjshmërie” (politica della responsabilita).

Për sa i përket aspektit dhe përmbajtjes së çështjes së përgjegjësisë dhe të bërit përgjegjës, mund të afrotojmë problemin në këto terma. Kush propozon programe ndërmjetësimi në fushën e drejtësisë (dhe jo vetëm), propozon një këndvështrim të dyfishtë për sa i përket çështjes së përgjegjësisë: e para e lidhur më shumë me aspektin specifik të “funksionimit” të ndërmjetësit, e dyta “restorative justice”, në sensin e vërtetë të fjalës, që implikon kushtin paraprak të rolit aktiv të viktimave në procesin dhe impenjimin në një aktivitet riparues-pajtuës nga ana e autorit të veprës penale.

Nëse, siç sugjeron De Leo¹⁵⁴, mendojmë për ndarjen që zakonisht ekziston midis përgjegjësisë së fortë dhe të kushtëzuar që ekziston në fushën e drejtësisë, dhe përgjegjësisë së diferencuar e të hapur, të pakushtëzuar që gjejmë në fushën e psikologjisë dhe në shumë sektorë të tjerë të shkencave humane, larg botës të së drejtës, vërejmë se ndërmjetësimi punon për të vënë në lëvizje shumë lidhje dinamike dhe evolutive, midis përgjegjësive që lidhen me kontekstet e ndryshme shoqërore dhe atyre që përdoren nga praktikantët gjyqësorë. De Leo na ka mësuar, mbi të gjitha, se procesi i ndërgjegjësimit (i të bërit përgjegjës) mund të kuptohet si një nga funksionet që i paraprijnë proceseve shoqërore diferencuese. Për shembull, të mos ngarkosh me përgjegjësi disa subjekte (të miturit, të sëmurët mendorë etj.), apo t'i ngarkosh ata pjesërisht me përgjegjësi, nënkupton më pak pushtet tek këto kategori subjektësh, më pak vlerësim social ndaj tyre, më pak mundësi për të socializuar dhe për të kuptuar, si dhe më pak aftësi dhe vetëvlerësim, për rrjedhojë më pak mundësi për të rekuperuar karshi një veprimi negativ të kryer, qoftë e parë nga një këndvështrim material, qoftë nga një këndvështrim psikologjik.

Në fakt, në proceset sociale, përgjegjësia është drejtpërdrejt e proporcionuar me pushtetin e poseduar, me statusin social, me autoritetin mbi vete apo mbi të tjerët. Është pikërisht mbi valën e gjatë të këtyre konsideratave që në vitet e fundit, studiuesit, politikanët, operatorët socialë dhe ato të drejtësisë kanë punuar për të ndërtuar një model të drejtësisë për të miturit, të aftë për të tejkaluar konceptin e dënimit të ashpër, impersonal, institucionalizues, duke lënë në të njëjtën kohë pas krahëve konceptin e

¹⁵⁴ Merrington, S., Stanley, S. (2007) “Effectiveness: Who counts What?” in Gelsthorpe, L. and Morgan, R. (eds) Handbook of Probation. Cullompton: Willan Miller, E. & Rollnick, S. 2002, Motivational Interviewing: Preparing People for Change. 2nd edn. London: Guildford Press.

papërgjegjshmërisë paternaliste-asistencialë që ka karakterizuar politikat e viteve shtatëdhjetë.

Kjo do të thotë se përgjegjësia është diçka që ndërtohet në raportet midis subjektit-veprimit-institucionit-shoqërisë, dhe jo vetëm një cilësi e brendshme e ndërgjegjes dhe e vullnetit, e thënë ndryshe, e aftësisë për të kuptuar dhe dëshiruar (për të shprehur një vullnet).

Përkrahësit e ndërmjetësimit nisen pikërisht nga bindja se përjetimi dhe eksperiencia e të miturit, lidhja që ai ka me sjelljen devijuese, perceptimi i tij i kryer nga një këndvështrim normativ, social dhe institucional, janë të gjithë hapa që duhen ndërmarrë drejt një politike të të bërit përgjegjës.

Të zhvillosh ndërmjetësimin në fushën e drejtësisë për të miturit (dhe jo vetëm) do të thotë, mbi të gjitha, të tejkalohet vizioni i krimit si një akt i izoluar dhe abstrakt i kryer nga një subjekt “i vështirë” dhe të fillohet të lexohet si një segment i disa marrëdhënieve komplekse shoqërore. E përkthyer ndryshe, do të thotë t’i ofrohet më shumë vëmendje protagonistëve të ngjarjes kriminale: karshi viktimës, subjekt tradicionalisht i lënë në harresë nga jeta procesuale, i garantohet një pjesëmarrje dhe një rol më aktiv se ç’ndodh në procesin penal; karshi fajtorit lihet mënjandë, në çdo rast që gjyqtarët, operatorët socialë dhe ndërmjetësuesit do ta konsiderojnë të arsyeshme, koncepti i dënimit në këndvështrimin shpagues, siç na mëson dhe përgjegjësia, çdo herë që flitet për ndërmjetësimin, nuk ka të bëjë më (vetëm) me “të qenit përgjegjës” të diçkaje apo për diçka, por kuptohet si një rrugëtim që në përfundim të tij, do të çojë subjektet në konflikt të jenë “përgjegjës ndaj” (që të përgjigjen njëri karshi tjetrit).

Rrugëtimi nis me dëgjimin e vetes dhe të tjetrit, dëgjim që prodhon si rezultat njohjen me bashkëbiseduesin, pasi ndodh brenda një marrëdhënieje që ndërtohet në prani të të tretit; në fakt, ndërmjetësuesi nuk gjykon kurrë, nuk këshillon, nuk gjen dhe nuk jep zgjidhje, por ndërhyr në konflikt për t’i dhënë fjalën njërit apo tjetrit, për të lejuar në këtë mënyrë identifikimin e origjinës së situatës problematike. Në këtë mënyrë, përgjegjësia lind nga marrëdhënia. Nuk bëhet më fjalë për të gjetur format apo përmbajtjen e të qenit përgjegjës. Faktet objekt i veprës penale, apo dhe vetë konfliktet sociale të krijuara prej tyre, bëhen shkas për t’i dhënë hapësirë një rrugëtimi, i cili sheh përballë njëri- tjetrit dy subjekte që pyesin reciprokisht njëri-tjetrin, të përfshirë në një projekt relacional që ndërmjetësuesi nuk mund (nuk duhet) të përshkruajë paraprakisht 38. Diskutimi rreth ndërmjetësimit, hap horizonte të reja që kombinohen më së miri me kuadrin e krizës socio-institucionale të përshkruar më lart.

Është e rëndësishme që të mendohet rreth ndërmjetësimit jo si një mënyrë e aftë që të aktivizojë “shpresat mesianike të ndryshimit dhe të shlyerjes”, jo si një, apo më keq akoma, si zgjidhja e atyre problemeve, të cilëve drejtësia e zakonshme nuk ka ditur dhe nuk di t’i japë zgjidhje, por thjesht si mënyra më e hapur për t’u njohur dhe më e disponueshmja karshi mënyrave që çojnë drejt sanksionit penal, si një mjet i nevojshëm për të kaluar nga momenti destruktiv në atë kurativ, për të pranuar çrregullimin që paraqitet në shoqëritë e sotme.

Dënimet alternative, nga njëra anë, u japin mundësinë autorëve të veprave penale, të cilët kanë mundësi për riintegrim dhe rehabilitim në shoqëri të rifillojnë më shpejt jetën në komunitet, ndërsa, nga ana tjetër, kontrollojnë dhe ndëshkojnë autorët e veprave penale duke vepruar si mburojë për komunitetin. Sigurisht për të arritur rezultate të kënaqshme veprohet në bashkëpunim me shërbimet lokale sociale dhe të mirëqenies për të nxitur dhe rritur mundësitë e përfshirjes në shoqëri¹⁵⁵. Në mënyrë të përmbledhur avantazhet e dënimeve alternative mund të renditen si më poshtë:

- Dënimet alternative zvogëlojnë probabilitetin e rikthimit në rrethin e krimit.
- Dënimet alternative u kushtojnë më pak taksapaguesve.
- Dënimet alternative ofrojnë një mundësi për të zhdëmtuar dëmin dhe viktimën.
- Dënimet alternative zhdukin “Shkollën e krimit në burg”. Dënimet alternative shmangin marrjen e kulturës së burgut, në mënyrën e të jetuarit, të të shprehurit dhe zakonet e ndryshme që fitohen gjatë qëndrimit në burg.
- Dënimet alternative ndihmojnë në mbajtjen e lidhjeve familjare dhe sociale.
- Dënimet alternative i japin të dënuarit një mundësi për t’u riintegruar në shoqëri.
- Dënimet alternative eliminojnë stigmën e dënimit me burgim. Turpi i të qenit në burg është kaq real, sa dhe anëtarët e pafajshëm të familjes e vuajnë atë edhe më shumë se vetë i dënuari.

Komuniteti përfiton nga anëtarët e tij të rregullt dhe që kanë një plan të qartë për jetën. Ky plan përfshin pjesëmarrjen në jetën ekonomike, një punë të rregullt dhe i japin një kontribut konkret komunitetit në vend të krijimit të problemeve.

¹⁵⁵ Leskoviku, M. “Teoritë e kontrollit social të krimit, njohja dhe vlerësimi i tyre” Revista Shkencore-Juridike e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Nr.1, 2005.

Përsa i përket anës financiare, dënimet alternative kanë më pak shpenzime krahasuar me mbajtjen në institucion të të dënuarit.

BIBLIOGRAFIA:

1. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1977.
2. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1995.
3. Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë, 1999.
4. Kodit i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Botimi i publikimeve zyrtare, Tiranë, shtator, 2002.
5. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2002.
6. Elezi Ismet (1962): “Mbrotja juridike penale e jetës së njeriut në Republikën Popullore të Shqipërisë”, Tiranë.
7. Halili Ragip (2005): “Kriminologjia”, Prishtinë.
8. Halili Ragip (1987): “Kriminaliteti kundër martesës dhe familjes në KSA të Kosovës”, Prishtinë.
9. Halili Ragip (2007): “Kriminologjia”, Prishtinë, tetor, bot. V.
10. Hysi, V. (2005): Kriminologjia, Crystallina-KH, Tirana.
11. Pallazzo, F., Papa, M. (2000): “Lezioni di diritto penale comparato”, Giappichelli editors, Padova.
12. Leskoviku, M. (2005): “Teoritë e kontrollit social të krimit, njohja dhe vlerësimi i tyre”, Revista Shkencore-Juridike e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Nr.1.
13. Merrington, S., Stanley, S. (2007).
14. McNeil, F. (2006): A desistance paradigm for offender management. In *Criminology & Criminal Justice*. Vol. 6(1): 39-62.
15. Salihu Ismet (2003): “E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme”, Prishtinë.
16. E drejta penale e Republikës Popullore së Shqipërisë, pjesa e përgjithshme, grup autorësh, Tiranë, 1973, f. 2010.
17. Shih L. Eusebi: “La nuova retribuzione”.
18. Kambovski, V. (2006): *Criminal Law, General part*, Print ISM, Skopje.
19. G. Fiandaca, E. Musco (1995): “Diritto penale parte generale”, Bologna, f. 648.

DALLIMI NDËRMJET KALIMIT ME TITULL UNIVERSAL DHE ME TITULL TË VEÇANTË TË PASURISË TRASHËGIMORE

Greta Bardeli

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë

The difference between passing universal title and special titled inheritance

ABSTRACT

The difference between passing universal and the particular title inheritance, presents not only theoretical values but also practical values and depending on the type konkriti crossing, will also determine the amount of inheritance to be passed to heirs at the time of opening of heritage.

Hyrje

Në veprat e juristëve romakë, dispozitat e së drejtës trashëgimore, bënin pjesë në mënyrat e fitimit të pronësisë¹⁵⁶. Mënyrat trashëgimore-juridike të fitimit, në dallim nga mënyrat e tjera të fitimit të pronësisë, të cilat veprojnë *inter vivos*, karakterizoheshin nga mënyrat e fitimit *mortis causa*, apo edhe në rastin e vdekjes së pronarit të gjeratëhershëm: *hereditas nihil aliud est, quam succesoi in universum ius quod defunctus haberium*¹⁵⁷. Me fjalë të tjera, e drejta trashëgimore, është përmbledhje e dispozitave juridike, e cila rregullon të drejtën e trashëgimit universal apo singular të pasurisë (në rast të vdekjes të pronarit të saj)¹⁵⁸.

E drejta trashëgimore, deri në shfaqjen e së drejtës private, nuk ishte e zhvilluar, pasi fakti i vdekjes gjatë kohës klanoro-fisnor, s’kishte pasoja

¹⁵⁶ A.Mandro, “E drejta romake”, Tiranë, 2006, f. 415.

¹⁵⁷ Gai 2,97-3,87. D 50 ,17, 62.

¹⁵⁸ A. Kalia, “E drejta ndërkombëtare private”, Elbasan, f. 256.

pronëso-ro-juridike¹⁵⁹. Kushtet dhe veglat e prodhimit në kohën kuiritare gjendeshin në pronësi të gjensit, i cili nuk vdiste, ndërsa objektet e përdorimit personal varroseshin bashkë me personin që i kishte përdorur.

Kur kushtet dhe veglat e prodhimit kaluan në pronë private të pater familiasve të ndryshëm dhe kur ato hynin në marrëdhënie të shumta pronësore, u shfaq e drejta trashëgimore, si përmbledhje e dispozitave juridike, që duhej të rregullonin zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore të lidhura për së gjalli dhe se kujt do t'i takonte *familia pecuniaque* pas vdekjes së *pater familiasit*.

Në legjislacionin tonë civil trashëgimia njihet si formë e prejardhur e fitimit të pronësisë. Nëpërmjet saj realizohet kalimi i pasurisë së një personi të vdekur (trashëgimlënësit) tek personat e tjerë trashëgimtarë të tij, në bazë të ligjit ose në bazë të vullnetit të fundit të *de cuius*, të materializuar në testament.¹⁶⁰ Rëndësia e institutit të trashëgimisë, përcaktohet në radhë të parë nga rëndësia që ka vetë e drejta e pronësisë në shoqërinë e sotme¹⁶¹. Trashëgimia duke qenë një nga mënyrat kryesore të fitimit të pronësisë, tregon për rëndësinë e madhe që ajo ka në qarkullimin civil të pasurisë, midis personave në një shoqëri. Kjo rëndësi rezulton e qartë, sepse edhe kushtetuta në një dispozitë të veçantë, në nenin 41, paragrafi i dytë i saj, ka përcaktuar trashëgiminë si mënyrë klasike të fitimit të pronësisë. Kështu, neni 41, paragrafi i dytë i kushtetutës parashikon:

“Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil”.

Kushtetuta si ligj themelor i shtetit, parashikon vetëm një normë të përgjithshme me karakter deklarativ, pasi mënyra dhe kushtet ligjore se si fitohet pasuria me trashëgim, rregullohet nga Kodi Civil, por kushtetuta duke shpallur se prona mund të fitohet me trashëgim, tregon për rëndësinë e madhe që paraqet instituti i trashëgimisë si pjesë e së drejtës civile.

Rëndësia e trashëgimisë si institut i së drejtës civile, rezulton edhe nga fakti që ky institut i së drejtës, jo vetëm është parashikuar si i tillë në Kodin Civil, por ai është rregulluar në mënyrë të hollësishme, në mbi njëqind dispozita. Kjo tregon për rëndësinë e madhe që i ka kushtuar ligjvënësi këtij instituti të së drejtës. Jo vetëm aq, por ligjvënësi në Kodin Civil, duke parë rëndësinë që paraqet instituti i trashëgimisë në ditët tona,

¹⁵⁹ I. Puhan, “E drejta romake”, botim V, Prishtinë, 1980, f. 405.

¹⁶⁰ A. Nuni, L. Hasneziri, “E drejta civile III, Trashëgimia”, Tiranë, 2010, f. 7.

¹⁶¹ Po aty...

në kushtet e ekonomise se tregut dhe të qarkullimit të lirë të mallrave, si dhe të kapitalit, këtij instituti i ka kushtuar një pjesë të veçantë të tij, siç është pjesa III e Kodit Civil, duke e barazuar për nga rëndësia me institutin e pronësisë. Edhe teoria e së drejtës civile apo doktrina juridike, e trajton trashëgiminë si pjesë e veçantë e së drejtës civile, çka tregon që ky institut paraqet një rëndësi të madhe, jo vetëm për ligjvënësin, por edhe për doktrinën juridike.

Zhvillim

Për rregullimin me sukses të trashëgimisë universale apo singulare të pasurisë, kur pronari ndërronte jetë, duhej paraparë sa vijon:

1. Cilët persona mund të trashëgojnë, apo cilët persona mund të ishin trashëgimtarë të *de cuius*?
2. Çfarë e përbënte masën e trashëgimit të hereditas?
3. Cilët persona në përgjithësi ishin të zotë për pozitën e trashëgimtarit universal (heres) apo trashëgimtarit të disa sendeve (suksesor singular, legatari)?
- 4) Çfarë ishte *vocatio heredum*.

Marrëdhënia trashëgimore - juridike, realizohej kur trashëgimtari i thirrur me rregull, që ishte i aftë të pranonte trashëgim, deklaronte kur ishte e nevojshme se, e pranonte trashëgiminë. Kur ishte fjala për trashëgimin që e kishte lënë trashëgimlënësi i aftë dhe kur ishte fjala për sendet që mund të ishin objekt i trashëgimit, trashëgimtari fitonte të gjitha të drejtat që më parë i kishte *de cuius*¹⁶². E drejta e trashëgimtarit vepronte ndaj të gjithëve (*erga omnes*). Kjo e drejtë ndryshonte nga marrëdhëniet e tjera juridike me efekt *erga omnes*, vetën se krijohej *mortis causa*, apo rasti i vdekjes së trashëgimlënësit¹⁶³. Të gjithë të drejtat e trashëgimtarit mbroheshin me padi trashëgimore apo me *actiones hereditaria*¹⁶⁴.

¹⁶² D 50,17, 59.

Citimet janë marrë nga Bionbi "institucione del diritto romano", IV ed, Milano, 1972, 624

¹⁶³ Në disa raste të suksedimit singular nuk bëhej lidhja e marrëdhënies juridike me efekt *erga omnes*, por lidhja e marrëdhënieve që vepronin vetëm inter partes: midis trashëgimtarit universal dhe legatarit. Në rastet e tilla, suksedimi universal sipas vullnetit të trashëgimlënësit i imponohej detyrimi që trashëgimtarit singular t'i paguhej diçka, është fjala kur trashëgimtari universal ishte debitor dhe kur ai singular kreditor.

¹⁶⁴ Prej *actiones hereditariae* që shërbenin për mbrojtjen e së drejtës trashëgimore të trashëgimtarëve universalë, duhen dalluar paditë konkrete që shërbenin për mbrojtjen e të drejtave trashëgimore të trashëgimtarëve singularë dhe për realizimin e disa të drejtave nga masa e trashëgimit.

Trashëgimtarët e *de cuius*

Statusin për të qenë trashëgimtar nën kushtet e caktuara, mund ta fitonte çdo person fizik. Para se të braktisim të drejtën romake lidhur me trashëgiminë, vlen të theksohet se këtë status mund ta fitonin edhe skllëverit¹⁶⁵. Që të kishte këtë status, duhej që personi fizik në momentin e hapjes së trashëgimit (momenti i delegacionit apo momenti i vdekjes së *de cuius*), të ishte gjallë. I vetmi përjashtim nga ky rregull parashihej për fëmijët e lindur pas vdekjes së të atit apo për pasardhësit e *de cuiusit*, të lindur pas vdekjes së trashëgimlënësit.

Për ato vlente rregulli: *infans conceptum pro jam nato habetum, quotiens de como dis eius agitur*¹⁶⁶. Kur nuk mund të vërtetohej saktë se a ka qenë trashëgimtari me të vërtetë gjallë në momentin e vdekjes së *de cuius*, kur është fjala për komorientët a për personat që kishin humbur jetën njëkohësisht, aplikohet supozimi juridik se i ati, kishte rrojtur pas vdekjes së të birit të mitur, ndërsa biri madhor, kishte rrojtur pas vdekjes së të atit¹⁶⁷. Në rastet e tjera supozohej se komorientët kishin vdekur bashkë, prandaj nuk mund të konsideroheshin trashëgimtarë reciprokë.

Edhe personat juridikë mund të fitonin statusin e trashëgimtarit¹⁶⁸. Personat juridikë privat mund ta fitonin këtë status në bazë të privilegjit të veçantë, ndërsa shteti e kishte këtë të drejtë, sipas dispozitave të përgjithshme¹⁶⁹.

Masa e trashëgimit

Masa e trashëgimit apo hereditas, ishte një grumbull sendesh (universitas iuris), e përbërë nga të gjitha të drejtat pronësore të trashëgueshme, të cilat i kishte *de cuiusi* në momentin e vdekjes¹⁷⁰. Masa e trashëgimit përbëhej nga të gjitha autorizimet pronësore të trashëgimlënësit, si dhe nga të gjitha të drejtat reale mbi sendet e huaja, duke i përjashtuar te servitutet personale që shuheshin në momentin e

¹⁶⁵ Ulp. 22,5: servus heredes intituere posumus, nostros cum libertate, alienos sine libertate, communes cum libertate vel sine libertate.

¹⁶⁶ D 1, 5, 7:

¹⁶⁷ D 34, 5, 4:

shih në lidhje me komoriencën neni 321 i Kodit Civil.

¹⁶⁸ shih nenin 316 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

¹⁶⁹ Një gjë të tillë e parashikon edhe neni 366 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

¹⁷⁰ Shih N.Biçoku "E drejta e trashëgimisë në Republikën e Shqipërisë", Tiranë, 1997, f. 58.

vdekjes së trashëgimlënësit. Masa e trashëgimit përbëhet edhe nga aktivet obligatore, si dhe nga borxhet obligatore, duke përjashtuar borxhet intuitu personae, që shuheshin në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit (kontratat intuitu, detyrimet deliktore). Të drejtat reale dhe aktivet obligatore të trashëgueshme, përbënin aktivin e masës trashëgimore; borxhet e trashëgueshme obligatore, përbënin pasivin e saj. Diferenca midis aktivitet dhe vlerës së lartësisë së pasivit, përbën thjesht masën e trashëgimit. Të drejtat personale dhe familjare të trashëgimlënësit, nuk mund të ishin objekt i masës së trashëgimit.

Vocatio heredum

Pas vdekjes së trashëgimlënësit, masa e trashëgimit nuk i takonte asnjë personi me zotësi trashëgimore: u takonte vetëm atyre personave me zotësi trashëgimore, të cilët në mënyrë të rregullt ishin thirrur për të marrë masën e trashëgimit të *de cuius* të caktuar. Thirrja e trashëgimit i ishte lënë kryesisht vullnetit të *de cuiusit*, kurse kur *de cuius* nuk e kishte bërë këtë, si dhe kur i kalonte autorizimet, të cilat i kishte sipas ligjit, rregullohej në mënyrë ligjore.

Në rastin e parë bëhet fjalë për trashëgiminë testamentare, ndërsa në të dytin thirrje ligjore në trashëgim. Thirrja ligjore në trashëgim ndahej në trashëgim dispozitiv ligjor apo intestator dhe në trashëgim imperativ apo i domosdoshëm sipas ligjit. Të gjitha mënyrat e përmendura shërbënin për thirrjen e trashëgimtarëve universalë (hers). Kur është fjala për suksedimin singular, *de cuiusi* i emëronte me testament ose sipas së drejtës romake me kodicil ose shprehje joformale të dëshirës së fundit (fideikomis). Në qoftë se trashëgimtari testamentar është më titull partikular, ai ka të drejtën vetëm mbi pasurinë konkrete të përcaktuar në testament në favor të tij dhe nuk ka asnjë të drejtë mbi pjesën tjetër të pasurisë trashëgimore të testamentlënësit. Në qoftë se në momentin e çeljes së trashëgimisë¹⁷¹, pasuria konkrete, e cila është disponuar në favor të trashëgimtarit testamentar me titull partikular, për arsye të ndryshme, nuk është në pronësi të testatorit apo nuk ekziston fare, trashëgimtari partikular nuk mund të kërkojë send tjetër të pasurisë trashëgimore dhe të konsiderohet se testamenti për këtë pjesë nuk ekziston. Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendim unifikues nr.1, dt 24.3.2005, të cilët me vendimin e mësipërm unifikojnë praktikën gjyqësore në këtë mënyrë: “...Mbështetur në sa thamë më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se, vetëm trashëgimtarët universalë apo me titull

¹⁷¹ Shih nenin 318 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

universal kanë zotësi juridike për të përfitur edhe elemente pasurore, të cilat de cuius nuk i ka parashikuar shprehimisht në testamet. Vetëm ata mund të përfitojnë të drejta (sende) që janë fituar mbas hartimit të testamentit e që ekzistojnë në pasurinë e trashëgimlënesit në momentin e çeljes së trashëgimisë dhe nga ana tjetër kanë gjithashtu detyrimin të përmbushin intra vires hereditatis-në kufijtë e pasurisë trashëgimore, detyrime që rëndojnë mbi këtë pasuri.

Sa më sipër, të sjellë në konkluzionin logjik se vetëm në rastin e trashëgimisë universale, përfshihen edhe ato marrëdhënie juridike, ekzistenca e të cilave nuk njihej nga vetë testamentlënësi.

Në të kundërt trashëgimtari me titull të posaçëm (legatari), ka një të drejtë të kufizuar, që lidhet me sendet apo të drejta të përcaktuara shprehimisht në testament-ut singuli, e për rrjedhojë ndryshimet e pasurisë trashëgimore të konstatuara në momentin e çeljes së trashëgimisë, nuk reflektohen në titullin e tyre...¹⁷². Nisur nga qëndrimi unifikues i mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, rezulton se një person do të konsiderohet si legatar, jo vetëm kur ndodhemi para legut të parashikuar në nenin 384 të Kodit Civil, mbi bazën e të cilit testatori ngarkon një ose disa trashëgimtarë testamentarë, që t'u japin një ose disa trashëgimtarëve ligjorë dhe kur testatori nuk ka trashëgimtarë të tri radhëve të para, t'i japë çdo personi një përfitim pasuror nga trashëgimi, pa i bërë këto të fundit trashëgimtarë, por edhe në rastet kur vetë testatori ka disponuar në favor të një ose disa personave si trashëgim pasuri konkrete të caktuara dhe të individualizuara.

PËRFUNDIM:

Nga sa u sqarua më sipër, rezulton se legjislacioni ynë ka pranuar institutin e trashëgimisë, si mënyrë e fitimit të prejardhur të pronësisë, kuptimi i së cilës jepet në nenin 316 të Kodit Civil:

“Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur një ose më shumë personave (trashëgimtarëve), sipas rregullave të caktuara në këtë kod”.

Nga kuptimi që i jep kjo dispozitë trashëgimisë, rezulton se me anë të trashëgimisë, bëhet kalimi ose transferimi në mënyrë universale i të drejtave pronësore nga *de cuius*, te një ose disa persona në dy mënyra, sipas dispozitave ligjore jemi para rastit të trashëgimisë ligjore dhe sipas vullnetit, jemi para rastit të trashëgimisë testamentare. Përcaktimi i mësipërm tregon

¹⁷² Për më tepër në lidhje me këtë çështje shih: Vendim Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara së Gjykatës së Lartë, nr.1 dt.24.3.2005.

se tek trashëgimia, qoftë ajo ligjore apo testamentare, kalimi i pasurisë bëhet me titull universal dhe me titull të veçantë.

Dallimi ndërmjet kalimit me titull universal dhe partikular të pasurisë trashëgimore, paraqet jo vetëm vlera teorike, por edhe vlera praktike dhe në varësi nga lloji konkret i kalimit, do të përcaktohet edhe sasia e pasurisë trashëgimore, e cila do t'u kalojë trashëgimtarëve në kohën e çeljes së trashëgimisë.

Në qoftë se trashëgimtari ka fituar me titull partikular pasurinë trashëgimore, duke u përcaktuar se ai do të përfitojë vetëm një ose disa sende apo të drejta konkrete të pasurisë trashëgimore, ai ka të drejtë të kërkojë vetëm ato sende apo të drejta, në kohën e çeljes së trashëgimisë dhe jo sende apo të drejta të tjera që mund të ekzistojnë në pasurinë e trashëgimlënësit pas vdekjes së tij. Përkundrazi, në qoftë se trashëgimtari ka përfituar me titull universal pasurinë trashëgimore, ai ka të drejtë që në përputhje me pjesën e tij, të kërkojë çdo send të pasurisë trashëgimore, që ekziston në kohën e çeljes së trashëgimisë, pavarësisht që kjo pasuri të mos ketë ekzistuar në kohën e hartimit të testamentit dhe madje të mos jetë përmendur në testament.

BIBLIOGRAFI

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
3. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.
4. Francesco Galgano (1992): "E drejta private", Milano.
5. N. Biçoku (1997): "E drejta e trashëgimisë në Republikën e Shqipërisë", Tiranë.
6. Ivo Puhan (1980): "E drejta romake", Prishtinë.
7. Arta Mandro (2006): "E drejta romake", Tiranë.
8. Ardian Nuni, Luan Hasneziri (2010): "E drejta civile III (Trashëgimia)", Tiranë.
9. Ardian Kalia: "E drejta ndërkombëtare private", Elbasan.
10. Solozzi (1932): "Diritto ereditario romano", Napoli.
11. Mommsen, Krygen (1882): "Corpus iuris civile", Berlin.
12. Vendim Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara së Gjykatës së Lartë, nr.1 dt.24.3.2005.

**SHPENZIMET GJYQËSORE SI BARRIERË E AKSESIT
TË PALËVE NË GJYKATË (NË PROCESIT CIVILE), NË
PRIZMIN E PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR**

Romina Kali, Ildir Duhanxhi

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë

**Court costs as barriers of party access to the court (in civil
proceedings), through the prism of due process**

ABSTRACT

This paper comes as a result of numerous problems that are encountered every day in court and concerns of many people who feel unable to act and to use their rights recognized by the Constitution, as our fundamental law. In this paper, that treats court costs I think that occupies an important place, in our country today who, like many other countries of the world, is facing with economic problems that are directly reflected on problems them specifically in our case, in legal issues or problems they may have, and causing problems in restoring their rights alleged to be infringed. These costs represent a fundamental problem and affect a legal right of the parties, protected and sanctioned in the Constitution, thus violating the due process, so necessarily requires the drafting of legislation to correct a legal issue in proper legal form, designed by the rules and principles laid down by the Constitution and laws.

However, the definition and expression explicitly in the Code of Civil Procedure of entities that facilitate or excluded, and very important part of reducing or removal of tariffs on sensitive issues and essential for citizens. For that matter, below, will be treated legal costs by determining how much are they, how they have changed, what are intended, and how justified as creating a problem of access to court.

Key words: Court, costs, due process, barriers, access, rights.

1. Fillesat e kuptimit të shpenzimeve gjyqësore

Në kuadrin e procesit të rregullt ligjor, një çështje e rëndësishme është edhe ajo e rregullimit të shpenzimeve gjyqësore. Në fillesat e saj dhe në kohët më të hershme, kur gjykimi i çështjeve civile filloi të merrte formë më të konsoliduar, kjo në sajë edhe të kontributit të priftërinjve në Romë (të cilët kishin dhënë një kontribut të madh dhe puna e tyre ishte e një rëndësie të veçantë), pasi nuk kishte shpenzime në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, veçanërisht pagesat për avokatët. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për periudhën klasike në të drejtën Romake¹⁷³. Si karakteristikë e kësaj kohe (duke iu rikthyer përsëri rëndësisë së priftërinjve), ishin rregullimet fetare. Por, edhe pse kjo kohë konsiderohej si “*legio actio sacramentum*”, ajo kishte rregullat e veta, shpeshherë edhe shumë të rrepta, ashtu siç përgjithësisht ishin rregullat fetare (pavarësisht fushës që rregullonin), si për shembull, ashtu siç sot kërkohet një interes dhe një shkak i ligjshëm, në atë kohë procedurat duheshin filluar vetëm në bazë të një ankese ekzistuese dhe jo të supozuar dhe në mirëbesim dhe jo me keqdashësi. Kjo gjë funksiononte në mënyrë të tillë: palët të cilat kishin një mosmarrëveshje dhe donin të rivendosnin në vend secili të drejtat e tyre, duhej të dorëzonin çdonjëri nga ato diçka (*sacramentum*)¹⁷⁴ në tempull, që ishin “institucionet” më të rëndësishme fetare dhe mbasi vendimi merrej, atëherë pala fituese mund ta merrte mbrapsht atë që kishte dorëzuar, ndërsa pala tjetër jo (pra pala humbëse), procedurë kjo e përcaktuar në ligjin e 12 tabelave (450. p.e.s)¹⁷⁵ (gjë që të kujton edhe parimin e sotëm “*humbësi paguan*”). Në pjesën e parë të epokës klasike, si një lloj “mbrojtjeje” dhe zbrapsjeje të personave, të cilët mund të vepronin me keqbesim (*poena temere ligantium*), vendosej të bëhej edhe një pagesë e dyfishtë me qëllim që t’i vendosej një barrierë e caktuar që të mos lejohej të nxiste shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje, e cila nuk ekzistonte në të vërtetë, apo ishte kaluar dhe konsiderohej si diçka e gjykuar tashmë, pra që në atë kohë edhe pse jo e shprehur saktë, por e nënkuptuar, shpenzimet do të përbënin barrierën ndaluese të palëve, në këtë rast e dëshiruar, për arsye pozitive. Gjërat filluan të ndryshonin në kohën e Justinianit dhe të Perandorisë Bizantine, ku edhe sistemi pësoi një zhvillim të mëtejshëm, duke ndryshuar situata edhe në kontekstin e shpenzimeve. Tashmë avokatët filluan të paguheshin dhe gjithashtu ishte zhvilluar një sistem i caktuar i

¹⁷³ Werner Pfennigstorf - *Law and Contemporary Problems, (The European Experience with Attorney Fees Shifting)*, USA 1984, f. 40.

¹⁷⁴ Po aty, f. 41.

¹⁷⁵ *The twelve tables 451-450 B.C* – burim www.csun.edu.

taksave që nxitej nga një zhvillim burokratik gjithnjë e më i madh, ku edhe zyrtarët kërkonin pagesën e tyre për veprimet dhe punët që bënin. Pikërisht, me këtë realitet tjetër që po krijohet, filloi të zbatohet edhe parimi i rimbursimit nga ana e humbësit drejt palës fituese dhe në rast të keqbesimit, të një rimbursimi apo kompensimi të dyfishtë. Ky parim filloi të ndiqet në të gjitha çështjet, qofshin ato në mirë apo keqbesim. Ishte Perandori Zenon, i cili në vitin 486 p.e.s., që njoftoi për herë të parë dhe sanksionoi si parim se *“Humbja është e mjaftueshme si fakt se ai që humb, ai paguan shpenzimet e fituesit”*¹⁷⁶.

2. Kuptimi i shpenzimeve gjyqësore dhe parashikimet ligjore në fuqi.

Shpenzimet gjyqësore janë pjesë përbërëse e procesit gjyqësor dhe një kusht i domosdoshëm ligjor që nga ngritja e padisë dhe deri në vazhdimin e gjykimit të saj. Shpenzimet gjyqësore janë ato, që në mënyrë më të thjeshtë, mund t'i quajmë kosto të procesit gjyqësor. Kuptimi i shpenzimeve gjyqësore, nënkupton një parim shumë të rëndësishëm, atë të ekonomisë së çështjes në gjykim, i domosdoshëm për t'u zbatuar gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore, që duhet të kryhet në respektim të parimeve procedurale brenda një kohe sa më të shkurtër, por edhe me punë sa më të pakët dhe me harxhime sa më të vogla.¹⁷⁷ Në fakt, çështja e shpenzimeve gjyqësore në proceset e ndryshme civile, ku paraja është zakonisht objekt parësor, barra financiare e procesit gjyqësor mund të jetë konsiderata e vetme më e rëndësishme për të vendosur nëse vlen për të luftuar në gjykatë.¹⁷⁸

Por, edhe nëse një palë ka apo sheh, që mund të fitojë çështjen, edhe sikur në një shkallë më të lartë të jetë e garantuar kjo fitore, ...një palë nuk mund të jetë në gjendje apo e gatshme të mbajë koston e procesit gjyqësor... Në të vendosurit se si duhet të veprojnë saktësisht, sa duhet të investohet, çfarë risqesh duhet të marrin përsipër, nëse duhet ankimuar apo jo etj., palët duhet të marrin në konsideratë, cili do të pagujë në përfundim për gjithçka.¹⁷⁹

Në fakt, po të hedhim një vështrim mbi atë se çfarë ofrojnë trajtimet mbi këtë çështje, në vendet e kontinentit apo më gjerë, shihet qartë një

¹⁷⁶ Werner Pfennigstorff - *Law and Contemporary Problems, (The European Experience with Attorney Fees Shifting)*, vep. e cit., f. 47.

¹⁷⁷ Prof.dr. Faik Brestovci, “E Drejta Procedurale Civile I&II”, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, (ribotimi IV), Prishtinë, 2006, f. 37.

¹⁷⁸ Mathias Reimann, “Cost and Fee Allocation in Civil Procedure. A comparative study” vol 11, bot. SPRINGER, USA, 2012, f.4.

¹⁷⁹ Po aty.

trajtim kritik i raportit të shpenzimeve gjyqësore, në kuadër të procesit gjyqësor që në mënyrë të drejtpërdrejtë evidentohet e prek apo çënon mundësinë e palëve që të kenë akses në gjykatë, e lidhur kjo me respektimin e parimit të procesit të rregullt ligjor.

Kështu, në Angli, kostot financiare të gjykimit të një çështjeje, mund të jenë shumë të larta, madje më të larta se në ndonjë vend tjetër të së drejtës të shkruar (civil law).¹⁸⁰ Pak më ndryshe, prezantohet gjendja në SHBA, ku disa kosto gjyqësore, të cilat lidhen me fillimin e gjykimit, shpenzimet për avokatët etj., nuk i faturohen vetëm palës humbëse. Një panoramë me luhatje të vogla, pozitive apo negative, haset edhe në vendet e kontinentit, si: Franca, Italia, Gjermania, Greqia etj.¹⁸¹

Ndërsa tek ne, në fillimet e viteve '90,¹⁸² fillimisht nuk ka qenë e evidentuar një çështje e tillë apo nuk ka qenë shumë e ndjeshme. Më pas, me kalimin e kohës, një çështje e tillë po ndihet mjaftueshëm, përsa i përket rëndimit të zërit të shpenzimeve gjyqësore mbi vetë procesin gjyqësor dhe në fundmi palët ndërgjyqëse apo humbësin e saj. Këtu përfshihen: taksat gjyqësore (që këto dy vite kanë njohur rritje jo të paktë), taksa mbi objekte që kalojnë një vlerë të caktuar (për të cilat paguhet, paraprakisht, nga paditësi një vlerë në masën prej 3% të vlerës së objektit), shpenzimet për avokatët, ekspertët etj. Këto së fundmi kanë filluar të ndjehen në buxhetin e individëve, duke marrë në konsideratë nivelin e pagesave që ekziston tek ne, dhe që ndikon mbi mundësinë që palët t'i drejtohen gjykatës, edhe sikur mundësitë për të fituar të jenë premtuese.

Në shërbim "*të reduktimit*" të shpenzimeve apo të ekonomisë në gjykim, në kodin tonë të procedurës, ekzistojnë edhe disa instrumente procedurale, që gjykata rast pas rasti i vlerëson si të vlefshme në këtë drejtim. Kështu, është parashikuar mundësia e bashkimit të dy gjykimeve, të cilat janë në zhvillim e sipër midis palëve të njëjta: ajo e bashkimit të kërkimeve (neni 159 i KPC), apo edhe ngritja e një padie nga dhe ndaj dy apo më tepër personave (neni 161 i KPC); apo që gjatë gjykimit, sipas rastit, të paraqitet kundërpadi (neni 160 i KPC), që gjykohet nga e njëjta

¹⁸⁰ Kjo e ndikuar nga një sërë faktorësh që lidhen me lirinë e palëve në procedurat para dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor; humbësi paguan edhe shpenzimet gjyqësore të bëra nga gjyqfituesi; mënyra e pagesës së ndihmës ligjore etj. - Për më tepër mbi këtë çështje shih - Adrian A. Zuckerman, Sergio Chiarloni, Peter Gottwald, "Civil Justice in Crisis. Comparative Perspectives of Civil Procedure", Oxford University Press, N.Y. (USA), 1999, f. 14,15.

¹⁸¹ Për më tepër, shih po aty f. 21-29.

¹⁸² U referohemi viteve '90 e më pas, sepse deri në këtë periudhë shpenzimet gjyqësore përballoheshin kryesisht nga shteti dhe palët, nuk është se mund të mbanin një barrë të rëndë financiare duke iu drejtuar gjykatës për të dhënë drejtësi.

trupë gjyqësore, e cila gjykon padinë kryesore dhe mund të shmangë shpenzime të tjera nëse do paraqitet si padi më vete; ajo e mos humbjes së veprimeve që kryhen nga një gjykatë jo kompetente etj. Këto dhe disa instrumente të tjera, duhet që të jenë pjesë e punës së gjykatës gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe dhënies së drejtësisë, që t'i mundësojë secilës palë që të marrë drejtësi me një kosto sa më të ulët.

Në lidhje me shpenzimet gjyqësore ekzistojnë disa parashikime ligjore, të cilat do të trajtohen në vijim.

Konkretisht, në pjesën e 13 të kushtetutës tonë mbi "*Financat Publike*", në nenin 155 të saj përcaktohet se "*Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të pagesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Në këto raste ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese.*"

Edhe në nenin 118 të kushtetutës, i cili duket i lidhur ngusht me nenin 155, gjithmonë në këtë aspekt, e thekson në pikën 2 të tij, se "*Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.*"

Duke marrë parasysh, parimin e aftësisë paguese, i cili është i parashikuar në kushtetutat e vendeve të ndryshme, si në kushtetutën e Italisë, Belgjikës, Gjermanisë, Francës, mund të tregohemi "*favorizues*" ndaj këtyre neneve të mësipërme të kushtetutës tonë, duke menduar se ato, edhe pse nuk e shprehin saktë, e nënkuptojnë këtë qëllim. Ky parim kushtetutes ka një rëndësi të madhe, sipas të cilit sigurohet e drejta e çdo personi duke marrë parasysh gjendjen e tij, apo aftësinë e tij paguese. Pra, duke u nisur nga vetë emërtimi i këtij parimi, ai duket se kërkon të vendosë një sërë lehtësirash apo përjashtimesh, duke marrë në konsideratë gjendjen e secilit person përballë atyre tarifave që ai duhet të paguajë. Mbrojtja, që ky parim ofron, duket edhe më i rëndësishëm nga ai që çfarë mendohet. Më sipër theksojmë që mungesa e tij sjell pasoja, të cilat sjellin çënime të atyre të drejtave që kushtetuta i ka të sanksionuara dhe që mbrohen edhe nga marrëveshje apo Konventa Ndërkombëtare dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Kështu, paaftësia paguese e shpenzimeve gjyqësore, sjell një pengim për fillimin e atij procesi gjyqësor që dëshiron të iniciohet nga palët për të vendosur në vend një të drejtë të pretenduar. Pra, çënohet e drejta e një personi për të hapur një proces dhe për t'u mbrojtur. Neni 42 i Kushtetutës të RSH-së dhe Neni 6 i Konventës, përcaktohen si nenet me të rëndësishme dhe si bazë e një procedimi gjyqësor. Po kështu, në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "*Për Masa Ndaj Dhunës Në Marrëdhëniet*

Familjare” neni 14, pika 3, përcakton se për hartimin e kërkesë-padisë, përgatitjen e akteve dhe paraqitjen e tyre në gjykatë kërkuesi asistohet nga një avokat falas. Kërkuesi shkarkohet nga taksat e gjykatës. Me daljen e urdhrin të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje. Në rast të kundërt, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuetit. Kërkesë-padia regjistrohet në një regjistër të veçantë dhe protokollohet ditën e dorëzimit të saj. Në fakt, gjatë intervistimit të profesionistëve të drejtësisë, të cilët kanë trajtuar raste të dhunës në familje, për të cilat është proceduar pranë gjykatës, është konstatuar heqja e tarifës gjyqësore për këtë kategori, gjithmonë kur bëhet fjalë për procedurat në lidhje me aplikimin e UMM/UM. Problemi i vërtetë lind në momentin, që viktimat e dhunës u drejtohen organeve të drejtësisë në lidhje me procedurat civile-familjare, si p.sh., kur kërkojnë të zgjidhin martesën ndërkohë që mbulohen nga UM. Në të tilla raste, shpenzimet duhet t’i ngarkohen palës së paditur, por deri në momentin e përfundimit të procedurës, viktimës i duhet të paguajë për padinë, psikologun në rastin e caktimit të kujdestarisë së fëmijëve, etj. Rrjedhimisht, edhe nëse viktimat mbulohet përkohësisht nga UM, duke qenë se nuk disponon mjetet monetare për t’iu drejtuar gjykatës, lidhja e saj martesore me dhunuesin, mbetet e pazgjidhur.

Rregullimi ligjor i tarifave, nuk parashikohet vetëm në Kodin e Procedurës Civile, por gjen rregullim edhe në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për Sistemin e Taksave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Neni 11 i këtij ligji, përcakton se “ ... *quhen tarifa shërbimi jo vetëm tarifat e shërbimit të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore, por edhe tarifat për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë, Notarisë, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme...*”, këto të përcaktuara edhe në Udhëzimin Nr.13, datë 12.02.2009, udhëzim ky i përbashkët i dy Ministrive, asaj të Financave dhe të Drejtësisë, që shërbeu si plotësues i ligjit të lartpërmendur. Ajo që vërejmë janë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë disa viteve, që nga viti 2008, e me ndryshimin e fundit që u bë në nëntor të vitit 2013. Ajo që përbën një nga pikat më të rëndësishme, për hartimin e një legjislacioni fiskal, qëndron në studimin e gjendjes shoqërore-ekonomike të shoqërisë, ku këto politika do të zbatohen, duke i kushtuar këtu një rëndësi të veçantë, pagës minimale, të ardhurave për frymë etj. Ajo që duhet të merret parasysh është marrja e masave dhe përcaktimi i subjekteve në nevojë, subjekteve lehtësuese dhe përjashtuese dhe përveç përcaktimit teorik edhe zbatimit praktik dhe sa më rigoroz të tyre. Mosrespektimi i pikave të tilla të mësipërme, ka bërë që gjatë viteve, shpeshherë, niveli i këtyre shpenzimeve

ka sjellë si pasojë kufizimin e aksesit për personat me të ardhura të pamjaftueshme. Kështu, në ligjet nr. 8088, dt. 28.03.1996, "*Për statusin e të Verbërit*", nr. 7874, dt. 17.11.1994 "*Për statusin e Veteranit*", nr. 7889 dt. 14.12.1994 "*Për statusin e invalidit*", nr. 8626 dt. 22.06.2000 "*Për statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik*", përcaktohet se ato përjashtohen nga taksat dhe si rrjedhojë edhe nga këto tarifa gjyqësore, por problemi qëndron në shumë individë, të cilët nuk janë subjekte të këtyre ligjeve, por gjendja e tyre i bën ata të pamundur për t'iu drejtuar gjykatës dhe duke iu cënuar e drejta e tyre, sepse gjykata në bazë të neneve 154/a dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile, ia ka kthyer aktet, çka shoqërohet me cënueshmërinë e së drejtës së aksesit. Duke u bazuar në parimin e barazisë, këto tarifa janë të njëjta për të gjithë, por në fakt kjo situatë arrin në një gjendje diskriminuese, kur trajtohen në mënyrë të barabartë edhe personat që janë në pozita të pabarabarta.

Vlen të përmendet rasti i një gjyqtari të Rrethit Gjyqësor Pogradec, i cili ka pezulluar çështjen e tij dhe ia ka dërguar atë Gjykatës Kushtetuese, konkretisht gjykimin e çështjes civile me Nr.Regjistri Them. 126/01071-948, datë regjistrimi 02/12/2011, duke i kërkuar asaj kontrollin e kushtetueshmërisë së Nenit 11/2 të Ligjit Nr.10065, dt. 29/01/2009 "*Për disa ndryshime në Ligjin Nr.9975, dt. 28/07/2008, Për sistemin e taksave Kombëtare*", por që Gjykata Kushtetuese e rrëzoi si kërkesë, duke u shprehur se nuk ka probleme të tilla të pretenduara dhe se nuk cënohet e drejta e aksesit. (*shih Nr. 7, dt. 27.02.2013*).

Rregullimit të problematikës dhe barrierës që krijojnë shpenzimet gjyqësore për palët, i vjen në "*ndihmë*" Ligji 10039, datë 22.12.2008 "*Për ndihmën juridike*", i cili ofron dy lloje ndihmash, atë parësore dhe dytësore, por problem përbën efektiviteti i kësaj ndihme, përballë ekzistencës së një barriere shpenzimesh të tjera, që i bëjnë palët të zbrapsen. Vetë Gjykata Kushtetuese, ka dhënë një alternativë apo një lloj zgjidhjeje, duke u bazuar pikërisht tek kjo ndihmë, e cila të mos jetë vetëm një ndihmë juridike, por edhe ekonomike për ata që përfitojnë nga ndihma juridike, duke përcaktuar kështu edhe subjektet edhe duke zgjeruar dhe konsoliduar efektivitetin e kësaj ndihme dhe të këtij ligji, duke marrë si shembull konkretizues Francën dhe sistemin e saj të ndihmës juridike, ku shteti ndihmon individët përfitues, duke marrë pjesë në përballimin e shpenzimeve gjyqësore, sipas nivelit të të ardhurave personale.

Në vijim të asaj që u përmend më sipër, nga shteti shqiptar, është duke u diskutuar që nga 1 janari i vitit të ardhshëm, të gjithë personat që marrin ndihmë sociale apo janë viktima të trafikut e të dhunës, mund të hapin një proces gjyqësor për ankesat që kanë për çështje të caktuara dhe

shërbimi gjyqësor do t'iu ofrohet falas. Me këtë nismë ligjore, të miratuar me konsensus në Komisionin e Ligjeve, synohet të shmangen nga barra e rëndë e pagesave të gjithë njerëzit në nevojë, të cilët nuk i drejtohen gjykatës, pasi nuk kanë mundësi të paguajnë tarifat gjyqësore.

3. Koncepti i shpenzimeve në dy familjet e mëdha Common law dhe Civil Law. Problematikat.

3.1 Shpenzimet ne dy familjet e mëdha Civil Law - Common Law. Ndryshimet.

Çështja e shpenzimeve gjyqësore, është dhe vijon të debatohet akoma edhe sot, duke evidentuar nevojshmërinë e tyre, nivelin e tyre, dhe sa e cënojnë të drejtën për akses. Pra, duket se kjo çështje ka kontradiktë me parimin e aksesit në gjykatë. Një çështje në nivel ndërkombëtar, për një rast të tillë është çështja *Kreuz kundër Polonisë, aplikimi nr. 2.28249/95, gjykim i datës 19/06/2001*, ku pagesa e kërkuar për fillimin e gjykimit të çështjes, e pamundur për t'u realizuar nga pala, solli mosdëgjimin e saj nga gjykata, duke cënuar kështu të drejtën e aksesit të palës në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Një çështje tjetër, me po të njëjtin interes, është edhe *Cibicki kundër Polonisë, aplikimi nr. 20482/03, aktegjykimi i datës 3 mars 2009*.

Sistemet gjyqësore janë të ndryshme dhe ndryshueshmëria e tyre nuk qëndron vetëm në burimet e tyre dhe në mënyrat e tyre të krijimit të së drejtës, por edhe në shpenzimet gjyqësore. Kur bëhet krahasimi nga ana e studiuesve dhe juristëve, dilemën e shpenzimeve gjyqësore, e krahasojnë me dilemën shekspiriane “*ta paguash apo të mos e paguash?*”¹⁸³

Një pyetje tjetër shumë e rëndësishme, që me të drejtë lind, është rasti kur humbësi paguan, çfarë shpenzimesh i caktohen atij? Duke iu referuar kësaj, mund të realizohen kategori apo grupime të vendeve të ndryshme. Për këtë, këta studiues bëjnë një klasifikim të vendeve të ndryshme në disa sisteme, ku secili prezanton specifikat e veta. Saktësisht mund të flasim për tri lloje sistemesh:

a. Humbësi paguan (MAJOR SHIFTING).

Shembulli i një rregulli të tillë është sistemi civil law (ku bën pjesë edhe vendi ynë). Përfshihen ato që quhen familja gjermanike e sistemit kontinental, si: Austria, Republika Çeke, Germania, Holanda, Zvicra. Por, gjithashtu përfshin dhe pjesën tjetër të sistemit kontinental në Lindje, si: Poloni, Rusi, Serbi, Sloveni, Danimarkë, Finlandë, Norvegji dhe Suedi, po ashtu edhe Turqia. Por, vazhdon me Italinë me Spanjën, Belgjikën dhe

¹⁸³Mathias Reimann, “Cost and Fee Allocation in Civil Procedure. A comparative study”, *vep. e cit.*, f. 53.

mbase edhe Greqinë, dhe më tej me Brazilin, Hong-Kong, Makau, Venezuela Meksikane në çështjet civile. Edhe Unioni Evropian e ka huazuar shpesh këtë rregull.

b.Pagime të pjesshme (*PARTIAL SHIFTING*)

Pjesërisht shlyhet pala fituese. Paguhet vetëm shpenzimet bazike dhe jo shpenzimet e avokatit. (*PARTIAL SHIFTING*) Shtetet që bëjnë pjesë në këtë sistem, janë shtete të cilat e mbështesin rregullin e pagimit nga humbësi, por jo në masën e rregullit të parë dhe karakteristikë e tyre është se ky rregull dhe zbatueshmëria e tij varet nga çështja dhe zhvillimi i çështjes përkatëse, duke e lënë përcaktimin në duart e gjykatës. Brenda këtij grupi, i ndajmë në nëngrupe që kanë disa cilësi apo veçori të veçanta nga njëra-tjetra, megjithëse i përkasin të njëjtit rregull.

c. Vetëm një pjesë e shpenzimeve rimbursohen, një pjesë shumë e vogël e shpenzimeve të gjyqit, sepse shpenzimet e avokatit janë shumë të shtrenjta dhe pse fituesi i gjyqit ai nuk rimbursohet për shpenzimet e tij. Më shumë këtu flitet për pagimin e secilës palë për shpenzimet e veta, të paktën për avokatët, që janë shumë të shtrenjtë dhe paguan secila palë shpenzimet e veta. Këtu në këtë grup përfshihen Shtetet e Bashkuara të Amerikës. (*MINOR SHIFTING*)

Siç e shohim shumica e sistemeve përkrah parimin humbësi-paguan dhe ky parim reflekton kryesisht një ide bazë të drejtësisë në kuptimin substancial të kësaj të drejte. Kështu pra, duket se vetëm humbësi duhet të kompensojë fituesin. Por, duke qëndruar pikërisht te e drejta e aksesit në gjykatë dhe barrierës që ata krijojnë, ka shtete si për shembull, Meksika dhe Venezuela, që nuk i ngarkojnë me shpenzime gjyqësore, apo i mbajnë ato në nivele shumë të ulëta me qëllim që të sigurojnë dhe lehtësojnë qasjen në dyert e drejtësisë.

3.2 Problematikat e shpenzimet gjyqësore.

Këto problematika nuk është se ekzistojnë në të gjitha sistemet, por në një pjesë të madhe të tyre. Kjo për arsye se,

Së pari, sepse edhe përtej gjykatave me cilësi specifike, por edhe për ankimet më të thjeshta, gjykimet dhe shpenzimet, mund të shkojnë shumë më shumë sesa vlejnë dhe ndonëherë edhe ato mund të mos jenë aq eficientë në krahasim me atë ankim të bërë, apo për atë çështje aq të thjeshtë për të cilën mund të bëhet fjalë. Gjykata me procedura të thjeshtuara, pretendimet e vogla dhe ndoshta edhe të mesme, shpesh nuk mund të trajtohen në mënyrë të efektshme për shkak se në gjyq mund të kushtojë më shumë se sa vlera e tyre.

Së dyti, ka shpenzime aq të mëdha, të cilat palët detyrohen t'i paguajnë, aq sa t'i nxjerrin ato vetë nga xhepi i tyre, për të arritur zgjidhjen

e çështjes së caktur. (Kjo ndodh në shtete të tilla, si: Austria, Brazili, Zvicra, Republika Çeke, Itali, Japoni, Meksikë, Turqi, Afrika e Jugut).

Së treti, në gjyqe “të mesme” dhe të mëdha, kërkesat shumë shpesh janë aq të shtrenjta sa shumë pak mund t’i përballojnë, për t’i paguar nga xhepi i tyre edhe sikur te duan.

Së katërti, situata të papërballueshme financiarisht, pavarësisht interesave dhe mundësisë së palëve. Ky problem haset më së shumti në të gjitha shtetet common law (si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Australi, Kanada, Angli dhe Uells) dhe në sisteme mikse, si: Skocia, Izraeli dhe Afrika e Jugut. Ky shqetësim në fakt nuk është se haset shumë në shtetet e Civil law, sepse e thamë edhe më sipër që këto shtete shpeshherë hasen me shifra dhe me shpenzime që janë më të ulëta sesa keto në common law.¹⁸⁴ Ndonjëherë, fakti që i kalohen shpenzimet palës humbese, duket si një zgjidhje, por në fakt ajo nuk është një zgjidhje edhe aq efektive. Është e vërtetë që njëra palë çlirohet, ose të paktën çlirohet nga një pjesë e madhe e tyre, por sigurisht kjo shikohet vetëm në fund të procesit, duke dalë fitimtar, i cili sigurisht që në sisteme të caktuara, nuk është se do të rimburohet për të gjitha shpenzimet, pra varet se çfarë sistemi i takon.

Këto kosto, disproporcionale, janë pikërisht arsyeja e kufizimit të aksesit në gjykatë, pra janë barriera moslejuese. Sigurisht, kjo nuk është e vetmja arsye, por gjithsesi përbën një pengesë të madhe, sepse duke mos ekzistuar kjo pengesë, të paktën palët mund të realizonin të drejtën e tyre për t’iu drejtuar gjykatës, pavarësisht se cili do të jetë rezultati. Në bazë të kërkimeve, rasteve, problematikave dhe sipas një përmbledhjeje të caktuar, është menduar një zgjidhje ideale mbi:

1. Heqjen e kostove dhe lirive të pjesëmarrjes në gjykatë apo të aksesit në Gjykatë.
2. Mirëmbajtjen e Gjykatave nga qeveria, të paktën këtë dhe pjesën tjetër të kostove siç janë avokatët, kur kanë mundësinë t’i paguajnë vetë.
3. Diferencën dhe trajtimin e ndryshëm për çështjen në mirë apo keqbesim.¹⁸⁵

Në përfundim, mund të themi se trajtimi i një teme të tillë, qëndron në ekzistencën e sjelljes të një sërë problematikash në shoqëri, që çon deri në cënimin e ligjit dhe të të drejtave të njeriut. Në shumë raste, palët nuk kanë mundësi për të bërë pagesa të tilla, duke bërë që ato të zbrapsen dhe madje edhe të humbin besimin në drejtësi. Shpenzime të tilla shihen si një kusht i

¹⁸⁴ Mathias Reimann, “Cost and Fee Allocation in Civil Procedure. A comparative study” vol 11, vep. e cit., f. 70.

¹⁸⁵ Werner Pfennigstorf - *Law and Contemporary Problems, (The European Experience with Attorney Fees Shifting)*, vep. e cit., f. 83.

domosdoshëm dhe kjo tregon rëndësinë e tyre, e sipas një rrjedhoje logjike edhe faktin se sa vendimtare janë ato për fatin e një kërkesë-padie, që palët e dorëzojnë në gjykatë, për pranimin apo jo të saj.

Kodi i Procedurës Civile i RSH-së, ka të përcaktuar një nen, të cilin mund ta quajmë si “*neni përjashtues*”, por as ai vetë, nuk e ka të shprehur në mënyrë eksplicite se cilët janë subjektet që përjashtohen, por këtë gjë mund ta bëjmë vetëm duke u drejtuar tek subjektet, të cilat janë të përjashtuara nga taksat në përgjithësi, siç janë: të verbërit, veteranët, invalidët, ndërsa pjesa tjetër mbetet e njëjtë dhe e barabartë përpara një fakti të tillë. Por, logjikisht lind pytja: “*Po çfarë ndodh me personat, të cilët kanë gjendje shumë të vështirë ekonomike*”? Çfarë ndodh me ato persona, të cilët atë shumë që duhet të paguajnë për një padi, për një marrëdhënie kontraktore apo për për shkaktim dëmi me deri në 100 000 lekë, kur ndërkohë marrin asistencë për të jetuar gjithë muajin? Për njerëz që duan të mbrohen, sepse janë hequr padrejtësisht nga puna apo për viktima të dhunës? Megjithatë, çështja kryesore është ajo e aksesit në gjykatë, të cilës i jepet një rëndësi themelore dhe të gjitha shtetet qofshin këto pjesë e sistemit common law apo civil law, mundohen që të krijojnë hapësirat e duhura për një rritje të aksesit në gjykatë dhe jo të krijimit të barrierave për palët. Pra, situata është e tillë, që kërkon një ndryshim që duhet të fillojë:

Së pari, që nga baza, pra që nga hartimi i legjislacionit, duke respektuar parimet dhe jo duke i anashkaluar ato. Sigurisht duke marrë parasysh edhe rrethanat shoqërore dhe ekonomike;

Së dyti, me përcaktimin e subjekteve në nevojë dhe shprehjen e tyre edhe në Kodin e Procedures Civile, duke mos krijuar probleme me interpretimin dhe duke mos ia lënë në dorë gjykatësit për t’i përcaktuar ato sipas dëshirës, duke krijuar kështu edhe hapësira për diskriminim apo për shkelje;

Së treti, rregullimin e tarifave, duke përcaktuar çmime më të ulëta dhe me të përballueshme dhe përcaktimin e tyre si çmime fikse dhe jo me përqindje, e cila krijon shpeshherë probleme dhe cënon rivendosjen e të drejtës që mund ta konceptojmë “*si të kushtëzuar*”, sepse rregullimi dhe rivendosja e tyre, bëhet duke “*ia cunguar*” atë përfitim që pala duhet ta gëzojë me ligj. Arsyeja qëndron në faktin se për këto padi, pavarësisht objektit, nuk kanë pse të kenë një tarifë me %, e cila kushtëzohet nga dëmshpërblimi për shkaktim dëmi, duke u paguar në mënyrë të tillë, që sa më i lartë të jetë dëmshpërblimi, aq më e lartë do jetë tarifa, dëmshpërblim, të cilin sigurisht duhet ta gëzojë pala e dëmtuar.

BIBLIOGRAFIA:

Literaturë shqiptare:

1. Prof.dr. Faik Brestovci, "E Drejta Procedurale Civile I&II", Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, (ribotimi IV), Prishtinë, 2006.
2. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare/ Center for Legal Civic Initiatives, Tiranë, 2013.

Kushtetutë, kode dhe akte ligjore

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, bot "Alb Juris", Tiranë, 1998.
2. Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 8116, datë 29.03.1996, botuar në fletoren zyrtare nr. 9/1996, i ndryshuar.
3. Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për sistemin e taksave kombëtare në Republikën e Shqipërisë".
4. Ligji nr. 8088, datë 28.03.1996, "Për statusin e të verbërit".
5. Ligji nr. 7874, datë 17.11.1994, "Për statusin e veteranit".
6. Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit".
7. Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik".
8. Ligji nr. 10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike".
9. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.

Akte Ndërkombëtare

1. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KEDNJ) me protokolle. Miratuar me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, e ndryshuar.

Literaturë e huaj

1. Mathias Reimann, "Cost and Fee Allocation in Civil Procedure. A comparative study" vol 11, bot. SPRINGER, USA, 2012.
2. Werner Pfennigstorff - *Law and Contemporary Problems, (The European Experience with Attorney Fees Shifting)*, USA, 1984.
3. Adrian A. Zuckerman, Sergio Chiarloni, Peter Gottwald, "Civil Justice in Crisis. Comparative Perspectives of Civil Procedure", Oxford University Press, N.Y. (USA), 1999.

Jurisprudencë***Vendime të Gjykatës Kushtetuese***

- Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 7, dt. 27.02.2013.

Vendime të GJEDNJ-së

- Kreu kundër Polonisë, aplikimi nr. 2.28249/95, datë 19/06/2001.
- Cibicki kundër Polonisë, aplikimi nr. 20482/03, datë 3 mars 2009.

Burime nga interneti

- www.avokatonline.com
- www.avokatipopullit.com
- www.avokati.org.com
- www.csun.edu
- www.drejtesia.gov.al
- www.drejteshqiptare.com
- www.europa.eu
- www.ec.europa.eu
- www.gjykataelarte.gov.al/
- www.legaleconsulenza.it
- www.gjk.gov.al/
- www.legaleconsulenza.it
- www.respublica.com

**E DREJTA PËR MBROJTJEN E FAMILJES ME
SHËRBIME SOCIALE NË KONTEKSTIN
NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR**

Brilanda Lumanaj

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Departamenti Psikologji-Punë Sociale

**The right to protection of families with social services
in international and national context**

ABSTRACT

This article analysis the right to protection of families with social services. The purpose of this article is to concern the international and national documents toward the protection of families with social services. In this article, also, it is emphasized the right to protection of families based on the perspective of social welfare state. There are given the main international and national documents that include the protection of families with social services. The article concludes that in main international and national documents social services are provided as a right of protection of the family by the state in order to ensure social welfare.

Keywords: the right of protection, social services for families, social welfare state, international context, national context.

Hyrje

Shërbimet sociale për familjen janë pjesë e mbrojtjes sociale dhe janë të lidhura me funksionet e shtetit të mirëqenies sociale. Duke u nisur nga një perspektivë funksionale, familja dhe shteti përmbushin një funksion mbështetës për njerëzit në nevojë.

Familja perceptohet si një vend kryesor i ndërhyrjes së shtetit të mirëqenies me politika dhe shërbime, të cilat kërkojnë të luftojnë përjashtimin social.¹⁸⁶

Catherine Caruana dhe Myfanwy McDonald (2011), në studimin e tyre, përcollën mesazhin që shërbimet e mbrojtjes së familjes, luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e përfshirjes sociale, si dhe në promovimin e kushteve, të cilat i lejojnë fëmijët të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga jeta e përditshme.¹⁸⁷

Shërbimet sociale për familjen, konsiderohen si një dimension i rëndësishëm i të drejtave të familjes. Në këtë kontekst është e rëndësishme të analizohen dokumentet ndërkombëtare dhe kombëtare, lidhur me parashikimin e të drejtës për mbrojtje të familjeve me shërbime sociale.

1. E drejta e mbrojtjes sociale në perspektivën e shtetit të mirëqenies sociale

Branco, F. (2009), thekson se, angazhimi i shtetit të mirëqenies sociale në mbështetje të familjeve me nivel të ulët ekonomik, me probleme të ndryshme sociale dhe psikologjike, është një obligim për të garantuar të drejtën e familjes për mbrojtje sociale.¹⁸⁸

Mbrojtja sociale luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e mbështetjes dhe shpërndarjen e të ardhurave dhe shërbimeve, si dhe në promovimin e përfshirjes sociale në vendet anëmbanë botës.¹⁸⁹

Bazuar në Raportin e Komisionit Evropian të vitit 2008, sistemi publik i mbrojtjes sociale në Shqipëri, ofron mbulim të kufizuar të shërbimeve sociale, duke adresuar kategoritë e personave në nevojë: të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe jetimët. Sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri, është i projektuar të sigurojë mbrojtje ndaj risqeve sociale të njohura, të bazuara kryesisht në kontributet e bëra nga punëdhënësit dhe punëmarrësit. Situata sociale dhe demografike, e

¹⁸⁶ Hughes, N. (2010). Models and Approaches in Family-Focused Policy and Practice. *Social Policy & Society* 9:4, f.545.

¹⁸⁷ Caruana, C. & McDonald, M., (2011). Social inclusion in the family support sector. f.9.

¹⁸⁸ Branco, F., (2009). The future of the welfare state: paths of social policy innovation between constraints and opportunity, f. 9.

¹⁸⁹ European Union, (2013). Feasibility of Social Protection Schemes in Developing Countries. ISBN: 978-92-823-4121-6. Doi: 10.2861/11066. f.5. Aksesuar nga: http://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2009_2014/documents/deve/dv/study_social_protecti/study_social_protection.pdf

influencuar nga ndryshimet ekonomike, shkakton një nevojë në rritje për të futur skema të reja të mbrojtjes sociale për familjet dhe fëmijët. Financimi është një nga sfidat për një sistem të mbrojtjes sociale të përshtatshme dhe të vazhdueshme.¹⁹⁰

Feely & Gottlieb et al., (2000) dhe McCubbin (1993), shpjegojnë se, mbështetja e familjes nga komuniteti dhe shoqëria, mund t'i ofrojnë familjes një kuptim më të lartë të përkatësisë dhe kohezionit.¹⁹¹

Mbrojtja sociale dhe zbutja e varfërisë, edhe pse me ligj janë të përcaktuara si funksione “të përbashkëta”, në praktikë funksionojnë si funksione të pastra të deleguara, për të cilat qeveritë vendore nuk kanë liri veprimi dhe funksionojnë si agjenci të thjeshta shpërndarjeje shërbimi dhe që financohen, udhëhiqen dhe vendosen tërësisht nga qeveria qendrore.¹⁹²

Shteti i mirëqenies sociale, synon të mbrojë individët, grupet dhe familjet, të sigurojnë të ardhura dhe kushte për të jetuar një jetë me dinjitet njerëzor dhe me pjesëmarrje të plotë në shoqëri; të luftojë diskriminimin dhe pabarazinë; të nxisë kohezionin dhe përfshirjen sociale, si dhe të luftojë varfërinë dhe mangësitë ekstreme në shpërndarjen e pasurisë në shoqëri.¹⁹³

Kur ndërhyrjet shtetërore për mbrojtjen e familjes ndërmerren në mënyrë eksplicite, ato shtyhen zakonisht nga motivet e mëposhtme (Kaufmann, 2000: 426f):

- *Motivet institucionale*, për të ruajtur familjen si një institucion me të drejtat e saj, shpesh të lidhur me politikën konservatore dhe një model tradicional familjar.
- *Motivet demografike*, të cilat kanë rritur rëndësinë e kontekstit të ndryshimeve demografike, siç janë masat për rritjen e normës së lindjes ose zvogëlimin e abortit.
- *Motivet ekonomike*, së pari theksojnë rëndësinë e familjes për ndërtimin e kapitalit njerëzor dhe vlerësimin e benefiteve të saj për shoqërinë, së dyti theksojnë funksionalitetin ekonomik (forcimin e fuqisë punëtore nëpërmjet kujdesit për fëmijët).

¹⁹⁰ European Commission, (2008). Social Inclusion and Social Protection in Albania, f.7, 9. Aksesuar nga: http://pasos.org/wp-content/archive/albania_summary_en.pdf

¹⁹¹ Black, K. & Lobo, M., (2008). A Conceptual Review of Family Resilience Factors. Journal of Family Nursing. Volume 14 Number 1. February 2008, f.33-55.

¹⁹² UNICEF (2011). Reformimi i ndihmës ekonomike: Nga mbijetesa tek investimi në reduktimin e varfërisë. Raport. f.10, 83. Shtëpia botuese Pegi.

¹⁹³ Rengasamy, S., (May 2009). Evolution of Social Welfare/Work in UK, USA & India. Madurai Institute of Social Sciences, f.18-22.

- *Motivet socio-politike*, për të kompensuar kostot e drejtpërdrejta dhe përgjegjësitë familjare (p.sh., humbjet e të ardhurave).
 - *Motivet e barazisë gjinore*, synojnë heqjen e disavantazheve ekonomike dhe sociale sidomos për gratë, arritjen e barazisë gjinore në familje, si dhe detyrat e përcaktuara dhe stimuj të veçantë për baballarët.
 - *Motivi i mirëqenies së fëmijës*, i cili synon sigurimin e kushteve për plotësimin e nevojave të fëmijëve nga sektori publik.

2. E drejta e mbrojtjes sociale për familjen me anë të instrumenteve ndërkombëtare

Duhet theksuar se mbrojtja sociale konsiderohet si një obligim dhe prioritet për vendin tonë në rrugën drejt integritimit evropian. Shqipëria ka nënshkruar një pjesë të konsiderueshme të dokumenteve ndërkombëtare që garantojnë mbrojtjen sociale, ku përfshihen, gjithashtu, edhe të drejtat e individit dhe familjes për shërbime sociale dhe mbrojtjen nga shteti dhe shoqëria.

Dokumentet ndërkombëtare të mëposhtme parashikojnë të drejtën e mbrojtjes së familjes.

- *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948)*. Neni 16 (pika 3) i këtij dokumenti thekson që familja ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti. Në Nenin 22, gjithashtu, theksohet që gjithkush ka të drejtën e sigurimit shoqëror dhe realizimit të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore të domosdoshme për dinjitetin e vet dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe mundësitë e çdo shteti.¹⁹⁴
- *Karta Sociale Evropiane (1961)*. Neni 16, me synim sigurimin e kushteve të nevojshme për zhvillimin e plotë të familjes, si njësi themelore e shoqërisë, parashikon të drejtën e familjes për mbrojtje ekonomike, ligjore dhe sociale. Neni 30 i këtij dokumenti njeh të drejtën e mbrojtjes së familjes nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror.¹⁹⁵
- *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (1966)*. Neni 10 thekson se shtetet nënshkruese duhet t'i japin familjes një mbrojtje dhe ndihmë sa më të gjerë, e cila është

¹⁹⁴ Shih: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948), Neni 16 (pika 3).

¹⁹⁵ Shih: Karta Sociale Evropiane (1961), Neni 16, 30.

element i natyrshëm dhe themelor i shoqërisë, sidomos për formimin e saj dhe për aq kohë sa ajo ka përgjegjësinë për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve në ngarkim.¹⁹⁶

- *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966)*. Neni 23 njih të drejtën e mbrojtjes së familjes nga shoqëria dhe shteti, si njësi e natyrshme dhe themelore e shoqërisë.¹⁹⁷

3. E drejta e mbrojtjes sociale për familjen me anë të instrumenteve kombëtare

Konteksti në të cilin zhvillohen shërbimet sociale në Shqipëri bazohet në parimet e mbrojtjes sociale të garantuar me anë të instrumenteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Dokumentet kombëtare në fushën e shërbimeve sociale janë hartuar dhe përshtatur në bazë të direktivave të BE-së. Ato synojnë rritjen e cilësisë së jetës së individit, familjes dhe komunitetit, garantimin e të drejtave themelore të njeriut, ku një vend të rëndësishëm zë e drejta për shërbime dhe mbrojtje sociale.

Shteti shqiptar i mirëqenies sociale ndër vite ka pësuar shumë ndryshime në sistemin e mbrojtjes sociale përmes hartimit të politikave sociale, procesit të decentralizimit dhe de-institucionalizimit, përmirësimit të skemës së ndihmës ekonomike, hartimit të standardeve të shërbimeve shoqërore, etj. Dimensionin e përfshirjes sociale, gjithashtu, është një element kryesor i fuqizimit të familjes edhe në kontekstin kombëtar.

E drejta e mbrojtjes sociale të familjes parashikohet edhe në kuadrin ligjor kombëtar. Kjo e drejtë garantohet përmes një kuadri të gjerë ligjor dhe në nivel kombëtar të paraqitur më poshtë:

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998)*. Në Nenin 53, Kushtetuta garanton të drejtën e familjes për të gëzuar mbrojtje të veçantë nga shteti.¹⁹⁸
- *Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë*. Ligji Nr.9062, datë 08.05.2003, “Kodi i Familjes”, Neni 1 thekson që familja gëzon mbrojtjen e veçantë nga shteti. Neni 3 parashikon që shteti dhe shoqëria duhet t’u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes.¹⁹⁹

¹⁹⁶ Shih: Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (1966), Neni 10.

¹⁹⁷ Shih: Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966), Neni 23.

¹⁹⁸ Shih: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998), Neni 53.

¹⁹⁹ Shih: Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, Neni 1 dhe 3.

- *Ligji për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore*. Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005, për “Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore” (Nenin 1, pika 2), ka si qëllim kryesor të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësinë për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre. Parimet bazë mbi të cilat funksionon skema e ndihmës dhe e shërbimeve shoqërore janë: respektimi dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit, universaliteti, barazia e mundësive, e drejta për të përfituar, partneriteti, pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit, mosdiskriminimi dhe karakteri subvencionues.²⁰⁰
- *Ligji për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare*. Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006, për “Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” në Nenin 1 (pika 2), garanton mbrojtjen e anëtarëve të familjes me masa ligjore, të cilët janë viktimat të dhunës në familje.²⁰¹
- *Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje (2011-2015)*. Qëllimi i kësaj strategjie, në kuadër të politikave mbi dhunën kundrejt grave dhe dhunën në familje, është edhe promovimi i një mjedisi që mundëson reduktimin e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve në të gjitha aspektet e jetës shoqërore. Pritshmëria e përgjithshme për këtë prioritet strategjik, është përmirësimi i sistemit të përgjigjes ndaj dhunës kundrejt grave dhe dhunës në familje.²⁰²
- *Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale, (2007-2013)*, vë theksin në fushën e shërbimeve shoqërore, duke synuar reforma për ngritjen e shërbimeve në nivel komunitar, atje ku janë përfituesit dhe lindin nevojat e tyre, për të mbështetur dhe ndihmuar individin, familjen, grupin ose komunitetin që të vetëfunksionojnë, të jenë të pavarur dhe të përfshihen si të barabartë me anëtarët e tjerë të shoqërisë.²⁰³
- *Standardet për Shërbimet Shoqërore në Shqipëri (2005)*, është dokumenti që pasqyron parimet bazë të të gjitha llojeve të shërbimeve shoqërore për të gjitha grupet në nevojë. Në këtë dokument theksohet

²⁰⁰ Shih: Ligji Nr. 9355, të datës 10.03.2005, për “Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore”, Neni 1(pika 2).

²⁰¹ Shih: Ligji Nr.9669, të datës 18.12.2006, për “Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, Neni 1 (pika 2).

²⁰² Shih: Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje (2011-2015). Tiranë, Shqipëri, 2008. Botime Pegi.

²⁰³ Shih: Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale (2007-2013).

se familja konsiderohet si pjesa më e rëndësishme e sistemit të mbështetjes për personat në nevojë.²⁰⁴

PËRFUNDIME NGA SHQYRTIMI I LITERATURËS:

Familja dhe shërbimet ndaj saj, duhet të jenë objekt kryesor i hartimit dhe i vlerësimit të shërbimeve sociale, në të kundërt përjashtimi social, do të kufizonte perspektivën e ardhshme të funksionimit të saj. Funksionimi i familjes dhe mbështetja e saj me shërbime sociale, është një përgjegjësi e shtetit të mirëqenies sociale dhe arrihet në rastet kur familja konsiderohet si pjesë e rëndësishme e politikave sociale.

Në dokumentet kryesore ndërkombëtare dhe kombëtare, shërbimet sociale parashikohen si një e drejtë e mbrojtjes së familjes nga shteti me qëllim sigurimin e mirëqenies sociale. Nga shqyrtimi i literaturës rezulton se e drejta për mbrojtjen e familjes me shërbime sociale, zë një vend të rëndësishëm në dokumente kombëtare e ndërkombëtare. Rezulton se mbrojtja sociale për familjen dhe e drejta për shërbime sociale është e parashikuar në kuadrin ligjor kombëtar.

REFERENCA:

1. Black, K. & Lobo, M., (2008): A Conceptual Review of Family Resilience Factors. *Journal of Family Nursing*. Volume 14 Number 1. February 2008, 33-55.
2. Branco, F., (2009): The future of the welfare state: paths of social policy innovation between constraints and opportunity, f. 9.
3. Caruana, C. & McDonald, M., (2011): Social inclusion in the family support sector. f. 9.
4. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948): Aksesuar nga: <http://arkiva.mfa.gov.al/dokumenta/deklarata.pdf>
5. European Union, (2013). Feasibility of Social Protection Schemes in Developing Countries. ISBN: 978-92-823-4121-6. Doi: 10.2861/11066.
6. European Union Commission, (2010). Commission Opinion on Albania's application for membership of the European Union. Aksesuar nga: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/al_opinion_2010_en.pdf
7. European Commission, (2008): Social Inclusion and Social Protection in Albania, f. 7, 9.
8. Hughes, N. (2010): Models and Approaches in Family-Focused Policy and Practice. *Social Policy & Society* 9:4.
9. Karta Sociale Evropiane. Aksesuar nga: <http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/socialcharter/presentation/escrbooklet/Albanian.pdf>
10. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore. Aksesuar nga:

²⁰⁴ Shih: Standardet për Shërbimet Shoqërore në Shqipëri (2005).

- <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AIntCovEconomicSocialCulturalRights.pdf>
11. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998): Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008.
 12. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Aksesuar nga: <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/ACovenantCivilPoliticalRights.pdf>
 13. Ligji Nr.9062, datë 08.05.2003, “Kodi i Familjes”. Aksesuar nga: <http://keshillimeligjore.al/legjislacioni-shqiptar/kodet%20shqip/Kodi%20i%20familjes-2012.pdf>
 14. Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005, për “Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore”. Aksesuar nga: <http://www.partnersalbania.org/skedaret/1292856021-Ligji%209355.pdf>
 15. Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006, për “Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”. Aksesuar nga: <http://www.osce.org/sq/albania/30437?download=true>
 16. Rengasamy, S., (May 2009). Evolution of Social Welfare/Work in UK, USA & India. Madurai Institute of Social Sciences. f.18-22.
 17. Strategjia e Shërbimeve Shoqërore (2005-2010). Aksesuar nga:
 18. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje (2011-2015). Aksesuar nga: http://www.mod.gov.al/images/PDF/barazia_gjinore_strategji.pdf
 19. Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale, (2007-2013). Aksesuar nga: http://www.dsdc.gov.al/dsdc/pub/strategjia_e_mbrojtjes_sociale_163_1.pdf
 20. Standardet për Shërbimet Shoqërore në Shqipëri (2005). Aksesuar nga: http://www.sherbimeshoqerore.gov.al/materiale/Standardi_sherbimeve_shoqerore.pdf
 21. UNICEF (2011). Reformimi i ndihmës ekonomike: Nga mbijetesa tek investimi në reduktimin e varfërisë. Raport. f.10, 83. Shtëpia botuese Pegi.

NJE NDALESË NË STATUT
(NORMAT PENALE NË STATUTET E SHKODRËS)

Engjëll Likmeta, Katrin Treska

*Universiteti i Tiranës, departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë
Drejtoria e Hartimit dhe Analizës së Legjislacionit, Drejtoria e Përgjithshme
e Kodifikimit, Ministria e Drejtësisë*

A short insight in the Statute
(Criminal provisions in the Shkodra Statute)

ABSTRACT

The purpose of this paper is to treat the albanian written norms in the Middle Ages, by bringing to the attention *Shkodra Statutes*, as an important source of information about how social relations were protected in that period of time by criminal norms.

Through *Shkodra Statutes* was specifically protected life and health of persons, specifically defended the woman, as well as employees of the justice system of the time, which indicates the importance and the special place that had the development of the trial.

It is important to mention that in the Statutes of Shkodra, each statutory provision was carefully detailed. Statutes care not only for the punishment of a certain action, but explicitly define the manner in which each forbidden action had to be accomplished in order to be punished by the statute, and in special cases was specified the active and the passive subject.

Particular attention is paid in this paper to *Shkodra Statutes*, as a precious asset of our country, addressing briefly the offenses provided in this document.

Key words: Shkodra Statutes; Offense; Crimes against life; Murder; Injury.

1. Hyrje

Historia, sipas Aristotelit, është një regjistrim i asaj çfarë njerëzimi ka bërë dhe një shpjegim i asaj se pse vuan prej bëmave të veta. Ndërsa sipas profesor Dritan Egros, me të drejtë, njohja e historisë është një nga elementet formëzuese dhe ngjizëse së vetëdijes kombëtare dhe se shkrimi dhe mësimi i saj duhet konsideruar një element i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm, i cili i jep formë mënyrës të menduarit të një populli. Madje, njohja e saj dhe literatura historike janë elemente esenciale në krijimin e kulturës elitare të një shoqërie.²⁰⁵

Njohja e trashëgimisë sonë juridike në prag të mesjetës është e nevojshme. Pa njohjen e saj do të ishte shumë e vështirë të arrihej në përgjithësi me vlerë për karakteristikat e përgjithshme të së drejtës sonë mesjetare.²⁰⁶

Nxjerrja në pah e karakteristikave të përgjithshme dhe e veçantive të së drejtës sonë ndihmon për të vendosur të drejtën tonë në një kuadër më të gjerë ballkaniko-mesdhetar. Nga ana tjetër, vlerat e kësaj tradite, nuk mund të kuptohen dhe nuk mund të jenë reale pa dëshmuar vijueshmërinë e saj, rezultat i rrënjëve të thella në vetëdijen dhe në kulturën e një populli dhe në prirjet për drejtësi, prirje dhe aftësi që shqiptarëve nuk u kanë munguar asnjëherë.²⁰⁷

Në këtë kuadër mund të themi se, etnologjia dhe historia ligjore, nganjëherë na përballin me situata të papritura dhe mund të duket i çuditshëm fakti, se një tekst i hulumtuar gati një shekull më parë dhe rreth të cilit, për më tepër, në njëqind e ca vjet, nuk ishin shpenzuar më shumë se dhjetë fjalë, të mund të detyrojë një grup të tërë studiuesish dhe të kërkojë një vëllim më vete.²⁰⁸ “Bibliografia e statuteve” e vitit 1907, përmend për herë të parë ekzistencën e një statuti shkodran.²⁰⁹

Prof. dr. Aleks Luarasi, që në vitin 1981, mendohej të përcaktonte ekzistencën e statuteve shqiptare teksa thonte se “*Burimet e senatit të*

²⁰⁵ Ibid, f. 10-11.

²⁰⁶ Aleksandër Meksi, “*Arkitektura e kishave të Shqipërisë*”, Shtëpia botuese “UEGEN”, Tiranë, 2004, f. 10.

²⁰⁷ Ibid, f. 11.

²⁰⁸ Gherardo Ortalli, “Statutet midis Shkodrës dhe Venedikut”, Libri i Lucia Nadin “*Statutet e Shkodrës*”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti Wisdow, Tiranë, 2010, f. 10.

²⁰⁹ Ibid.

Venedikut na bëjnë me dije se statute kanë pasur Durrësi, Shkodra, Drishti, Ulqini dhe Tivari".²¹⁰

Burimi kryesor i së drejtës të qyteteve ishin statutet, që në kuadrin e një të drejtë të veçantë ishin akte normative, që rregullonin jetën e brendshme të qyteteve shqiptare në mesjetë. Krijimi i kushtetutave qytetare ka kaluar nëpërmjet një procesi gradual e të vazhdueshëm, në të cilin kanë ndikuar në radhë të parë e drejta bizantinel, që ka shërbyer si model në zgjidhjen e problemeve juridike, si dhe e drejta zakonore shqiptare.²¹¹

2. Pak histori

Statutet e Shkodrës, të krijuara në të njëjtën periudhë kur vihej në jetë "Costituto Senese", në fillimet e viteve 1300, përbëjnë treguesit e një karte bashkëkohore kushtetuese.²¹² Na lind detyrë të thellojmë studimet në to, me qëllim afirmimin në mënyrë të qartë dhe bindëse të rrënjët tona të hershme evropiane, ashtu sikurse dhe Paolo Foresti theksonte në sesionin shkencor ndërkombëtar "*Statutet e Shkodrës, vlerat dhe rëndësia historiko-juridike*".²¹³

Statutet e Shkodrës kanë vlerën e të qenit tekst më i vjetër ligjvënës i hartuar në territorin shqiptar që ka arritur në ditët tona.²¹⁴ Statutet përmbanin norma me karakter kushtetues, juridiko-penal, civil, tregtar, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e qytetarve ndaj komunës së tyre.²¹⁵

Statutet e Shkodrës njihen për vlerën e tyre si dokument i parë i shkruar mbi normën penale shqiptare.²¹⁶

Nga 279 nene, rreth 32% e tyre janë të natyrës penale, pra, gati 1/3 e të gjithë krerëve përcaktojnë të gjitha veprat penale përfshi këtu: veprat penale kundër pasurisë, jetës dhe shëndetit, veprat penale kundër moralit,

²¹⁰ Aleks Luarasi, Tezë doktorature, "*Shteti dhe e drejta shqiptare para dhe gjatë epokës së Skënderbeut*", Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Tiranë, 1981, f. 89.

²¹¹ Ibid, f. 87.

²¹² Lucia Nadin, "*Statutet e Shkodrës*", "Onufri", Botim i dytë, Universiteti "Wisdom", Tiranë, 2010, f. 400.

²¹³ Ambasador Paolo Foresti, "*Statutet e Shkodrës*", Libri i Lucia Nadin "*Statutet e Shkodrës*", "Onufri", Botim i dytë, Universiteti "Wisdom", Tiranë, 2010, f. 398-400.

²¹⁴ Gherardo Ortalli, "*Statutet midis Shkodrës dhe Venedikut*", Libri i Lucia Nadin "*Statutet e Shkodrës*", "Onufri", Botim i dytë, Universiteti "Wisdom", Tiranë, 2010, f. 12.

²¹⁵ Aleks Luarasi, Tezë doktorature, "*Shteti dhe e drejta shqiptare para dhe gjatë epokës së Skënderbeut*", Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Tiranë 1981, f. 90.

²¹⁶ Ismet Elezi "Normat penale në statutet e Shkodrës", Libri i Lucia Nadin "*Statutet e Shkodrës*", "Onufri", Botim i dytë, Universiteti "Wisdom", Tiranë, 2010, f. 410.

nderit dhe dinjitetit të personit, dëmtimet e pasurisë, veprat penale kundër drejtësisë, si dhe një numër i konsiderueshëm veprash penale të tjera.²¹⁷

Nga rreth 80 norma me karakter penal që ka i gjithë statuti, vetëm një pjesë fare e vogël e tyre rregullojnë institutet e pjesës së përgjithshme, si ai i mosnjohjes së normave statutores, precedenti gjyqësor, ashtu dhe ai dënimit.²¹⁸

3. Dënimet në statutet e Shkodrës

Të analizosh llojet e dënimeve që përdor një vend në një kohë të caktuar, është e rëndësishme për të kuptuar mënyrën që ka zgjedhur ky vend për të mbrojtur marrëdhëniet e rëndësishme shoqërore, duke parashikuar ndëshkime të personave që çenojnë këto marrëdhënie.

Statutet e Shkodrës njihnin këto lloj dënimësh: me gjobë, mbyllja në shtëpi dhe pagimi i taksës së gjakut, zhdëmtimi ose kthimi i gjësë së vjedhur, kthimi i pasurisë së fajtorit në pronë publike, dëbimi i përkohshëm ose i përhershëm, prerja e kokës, damkosja, si dhe shëtitja nëpër krahinë duke e rrahur me kamxhik. Ashtu sikurse dhe ligjet mesjetare të shumë qyteteve evropiane dhe statutet e Shkodrës karakterizoheshin në disa momente nga ekstremiteti në disa prej sanksioneve të tyre, si antihumanizmi, depersonalizimi.²¹⁹

Dënimet e mësipërme mund t'i kategorizojmë në izolime të autorëve (si mbylljen në shtëpi; dëbimin e përkohshëm ose të përhershëm), dënimet me natyrë ekonomike, që zënë vend të rëndësishëm (si gjobën, pagimin e taksës së gjakut, zhdëmtimin ose kthimin e gjësë së vjedhur, kthimin e pasurisë së fajtorit në pronë publike), si dhe dënime mjaft të ashpra ndaj autorit, si prerja e kokës dhe damkosja, apo shëtitja nëpër krahinë duke e rrahur me kamxhik, si formë poshtërimi ndaj autorit.

Këto dënime përveçse synojnë parandalimin e kryerjes së shkeljeve, ndëshkimin e autorit, mbi të gjitha synojnë dhe edukimin e komunitetit, duke u treguar të gjithëve se sjellje të tilla të ndaluara, sjellin pasoja për individët që i kryejnë ato.

4. Mbrojtja e jetës dhe shëndetit nga statutet

Ajo që të bie në sy tek statutet e Shkodrës është mënyra e detajuar e parashikimeve që bën secila dispozitë statutores. Një prej marrëdhënieve shoqërore që mbrohej me zë më të fortë në statutet e Shkodrës, ishte jeta

²¹⁷ Kristinka Jançe, Tezë doktorature, "Aspekte të zhvillimit të qyteteve në mesjetë dhe statutet e Shkodrës si monumente të vërteta të Shqipërisë mesjetare", Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranës, Departamenti i së Drejtës Publike, Tiranë, 2011, f. 162.

²¹⁸ Ibid.

²¹⁹ Ibid, f. 168.

dhe shëndeti, duke parashikuar ndëshkime për veprat, si: vrasja, akuzat për vrasje, plagosja dhe llojet e saj, goditja dhe llojet e saj, prerja e mjekrës si dhe rrahja dhe llojet e saj.

Statutet kujdesen jo vetëm për ndëshkimin e një veprimi të caktuar, por përcaktojnë në mënyrë të hollësishme sipas rastit anën objektive (mënyrën e kryerjes së veprimit të ndaluar prej statutit), apo në raste të veçanta duke specifikuar dhe subjektin pasiv dhe duke mbrojtur në mënyrë të posaçme subjekte të caktuara.

Më në detaje, le t'i shohim me radhë si më poshtë, bashkë me dënimet për secilën vepër:

4.1 Vrasja

Statutet e Shkodrës parashikojnë sanksionin me gjobë për krimin e vrasjes, vlera e së cilës duhej të ndahej midis dy subjekteve që ishin mbreti dhe i afërmi i viktimës. Në rast se fajtori nuk paguante shumën e caktuar prej 5 hyperprerë sklavonie, çështja i kalonte për gjykim mbretit, që nga ana e tij gjykonte vetëm një numër të caktuar çështjesh.²²⁰

Ndërsa në rastin kur ndaj një personi nuk kishte prova për të vërtetuar fajësinë e tij, normat e statuteve të Shkodrës parashikojnë të drejtën e këtij të fundit për t'u betuar së bashku me persona të tjerë për të dëshmuar pafajësinë e tij.²²¹ Normat e statutit parashikojnë dhe procedurën e duhur që duhej zbatuar në rastin e një akuze për vrasje.

4.2 Plagosjet

4.2.1 Plagosja e rënda²²²

Në rast se do të ndodheshim përpara krimit të plagosjes së rëndë, statutet parashikojnë dënimin prej 5 hyperperësh për çdo plagë të marrë, që ndahej në përpjesëtim të drejtë midis Kontit dhe të plagosurit. Lidhur me elementet e tjera të figurës së veprës penale të plagosjes, ashtu sikurse dhe për çdo figurë tjetër krimi, statuti mjaftohet vetëm në dhënien e dënimet me gjobë.

4.2.2 Plagosja gjatë lojës²²³

Normat statutores të komunës së Shkodrës parashikojnë moslindjen e përgjegjësisë penale në rast të dëmtimit pa dashje në kryerje e sipër të lojës. Në rast se në pikëpamje të anës subjektive plagosja mbarte qëllimin e posaçëm për të dëmtuar personin, statutet sanksionin lindjen e përgjegjësisë

²²⁰ Lucia Nadin, "Statutet e Shkodrës", "Onufri", Botim i dytë, Universiteti "Wisdom", Tiranë, 2010, f. 364, n. 224.

²²¹ Ibid, f. 364, n. 225.

²²² Ibid, f. 368, n. 243.

²²³ Ibid, f. 367, n. 241.

penale që varej gjithnjë nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore dhe objekti i cënuar.

4.2.3 Plagosja në qytet²²⁴

Statutet e Shkodrës në pikëpamje të anës objektive vlerësonin disa elementë të rëndësishëm sikurse ishin koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale. Në këtë aspekt, normat statutore bënin me dije se çdo person që kryente një plagosje natën apo në ndonjë shesh apo rrugë publike të qytetit, ndëshkohej me një gjobë prej 12 groshësh. Në këtë rast, norma statutore nuk përcakton në mënyrë të shprehur se në favor të kujt shkon detyrimi i fajtorit.

4.2.4 Mbi plagosja në detyrë²²⁵

Statuti parashikonte se në rast të dëmtimeve gjatë kryerjes së shërbimeve në favor të komunës, dhe në rast se i dëmtuari nuk ishte plagosur për fajin e tij, komuna ishte e detyruar të merrte përsipër mbulimin e shpenzimeve të tilla, si për mjekimin e të dëmtuarit dhe shpërblimin e këtij të fundit për ditët e humbura, ashtu dhe shpërblimin për mjekun. Norma statutore nuk parashikonte një masë vlerësimi për shpërblimin që duhej të jepej. Objekti i cënuar në këtë figurë penale ishte i posaçëm, personi që dëmtohej gjatë ushtrimit të detyrës.

4.2.5 Mbi plagosjet me shpatë, shigjetë, ose shufër hekuri²²⁶

Në një tjetër normë statutore, statutet e Shkodrës, parashikonin rëndësinë juridiko penale të mjeteve të kryerjes së veprës penale të plagosjes. Në pikëpamjen e anës objektive të figurës së veprës penale të plagosjes, statutet sanksiononin rëndësinë e mjeteve të tilla, si: shpata, shigjeta dhe çdo shufër hekuri, mjete këto që në çdo rast mund të ndihmonin në realizimin e veprës penale të plagosjes.

Norma në këtë rast parashikonte një dënim prej 50 hyperperësh të fajtorit dhe që shkonte në favor të mjekut dhe për kohën e humbur të të plagosurit, gjithnjë nëse çmohej se plagosja kishte paraqitur rrezik për jetën e të dëmtuarit. Po ashtu, ndaj fajtorit, lindte detyrimi për të shpërblyer në përpjesëtim të drejtë taksën e gjakut ndaj të dëmtuarit nga njëra anë, si dhe të komunës dhe kontit në anën tjetër.

4.2.6 Mbi plagosjet në kishë²²⁷

²²⁴ Ibid, f. 368, n.244.

²²⁵ Ibid, f. 368, n.245.

²²⁶ Ibid, f. 369, n. 246.

²²⁷ Ibid, f. 369, n. 247.

Në një tjetër dispozitë, statutet e Shkodrës, i kushtonin rëndësi një elementi të veçantë të anës objektive, sikurse ishte vendi i ndodhjes së veprës penale të plagosjes. Në këtë aspekt, statutet sanksiononin: *“Nëse një person plagos dikë në kishë duke i shkaktuar gjakderdhje, dënohej me një gjobë prej 10 hyperësh[...] dhe prej 5 hyperësh në rast të mos pasjes së gjakderdhjes”*.²²⁸

Një normim i tillë bëhej për të marrë në mbrojtje vendin e ushtrimit të besimit. Dhe se, në varësi të shkallës së objektit të cënuar ishte dhe sanksioni, që ishte dyfish në rast të cënimit të jetës dhe shëndetit të personit të plagosur.

Subjekti i kësaj figure veprë penale, ishte çdo person që kishte mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ishte i përgjegjshëm. Qëllimi i dënimit dhe në këtë rast ishte ndëshkimi financiar i fajtorit, ashtu sikurse në të gjitha normat e tjera të parashikuara në statut.

4.3 Dëmtime të tjera me dashje (goditjet dhe rrahjet)

Pjesë përbërëse e mbrojtjes së personit është dhe mbrojtja juridike penale e shëndetit të njeriut.²²⁹ Lidhur me dëmtimet të tjera me dashje, normat e statuteve të Shkodrës i kualifikonin në dy lloje kryesore, e konkretisht në rrahje dhe në goditje. Objekti i tyre i përbashkët ishte marrëdhënia statutore e vendosur për të mbrojtur shëndetin e subjekteve të posaçme, si më poshtë:

4.3.1 Goditjet

Mbi ata që qëllojnë kontin²³⁰

Në këtë figurë krimi merrej në mbrojtje një subjekt krejtësisht i veçantë, sikurse ishte konti, pozita shoqërore e të cilit ishte shumë e rëndësishme për kohën. Subjekti aktiv i këtij krimi ishte i përgjithshëm. Vepra penale kryhej me veprime aktive që mund të ishin nga më të ndryshmet. Fajtori ndëshkohej me një dënim prej 8 hyperperësh, që shkonin në interes të kontit dhe të komunës, në masën 50% për secilin.

▪ Kur goditen gjykatësit²³¹

Subjekti pasiv dhe në këtë figurë krimi ishte i posaçëm, gjykatësi. Norma statutore i kushtonte rëndësi vendit të kryerjes së veprës penale. Kështu, në rast se krimi ishte kryer gjatë procesit ligjor, fajtori ndëshkohej me humbjen e çështjes si dhe me një gjobë prej 30 hyperperësh.

²²⁸ Ibid.

²²⁹ Prof.dr. Ismet Elezi, “E drejta penale”, Pjesa e posaçme, Botimet “Erik”, Tiranë, 2009, f. 82.

²³⁰ Lucia Nadin, “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 365, n. 229.

²³¹ Ibid, n.230.

Ndërsa në rast të kryerjes së saj jo në sallën gjyqësore, fajtori detyrohej të paguante një gjobë prej 15 hyperperës në favor të kontit dhe të viktimës.

Ajo që vërejmë në analizën e fundit është fakti se normat statutore, bënëin përpjekje për mbrojtjen e saj, që në ditët tona konsiderohet si solemniteti dhe shenjtëria e seancës gjyqësore, duke mbrojtur posaçërisht procesin gjyqësor.

▪ **Kur goditet noteri ose sekretari**²³²

Po me qëllim mbrojtjen e seancës gjyqësore dhe me qëllim zhvillimin normal të saj, statutet merrnin në mbrojtje noterin dhe sekretarin, si dy subjekte të posaçme. Edhe në këtë rast, ashtu sikurse në veprën e mësipërme, rëndësi për efekt të cilësimit të veprës, merrte vendi i kryerjes së krimit.

Kështu, nëse krimi kishte ndodhur në seancë gjyqësore, kjo konsiderohej si rrethanë rënduese dhe parashikohej një ndëshkim dyfish më i madh në raport me krimin e ndodhur jashtë dverve të gjykatës. Fajtori detyrohej në rastin e fundit të paguante një gjobë prej 12 hyperperësh që shkonte në favor të kontit dhe viktimës. Ndërsa gjoba për krimin e ndodhur në seancë gjyqësore, ishte 25 hyperperë.

▪ **Kur goditet semenci dhe otagu**²³³²³⁴

Kjo dispozitë merr në mbrojtje një kategori të caktuar personash, sikurse ishin zyrtarët publikë. Fajtori ishte i detyruar t'i nënshtrohej ndëshkimit me një gjobë prej 9 hyperperësh në rast se vepra e goditjes ndodhte brenda seancës gjyqësore dhe 4 hyperperësh, nëse vepra penale ndodhte jashtë sallës së gjykimit.

▪ **Goditje me gurë**²³⁵

Normat statutore të komunës së Shkodrës merrnin në mbrojtje shëndetin e individit, dhe jo vetëm të atyre të veshur me funksione publike. Në këtë aspekt, mund të themi se fajtori ishte i detyruar të paguante një gjobë prej 2 hyperperësh, në rast se ndodheshim përpara një plagosje të lehtë, që shkonte në favor të të dëmtuarit dhe të kontit. Njëkohësisht, për fajtorin lindte detyrimi të paguante mjekun dhe ditët e humbura të të dëmtuarit.

²³² Ibid, n.231.

²³³ Ishin zyrtarë publikë në periudhën mesjetare.

²³⁴ Lucia Nadin, "Statutet e Shkodrës", "Onufri", Botim i dytë, Universiteti "Wisdom", Tiranë, 2010, f. 366, n. 232.

²³⁵ Ibid, f. 367, n. 240.

Në rast të plagosjes së rëndë, fajtori gjobitej me një gjobë prej 8 hyperperësh. Norma e statuteve të Shkodrës bënte dallimin midis plagosjes së lehtë dhe të rëndë nisur nga pasoja e ardhur.

Në përgjithësi, mjeti i kryerjes së veprës penale, paraqiste një rëndësi të madhe dhe ishte i posaçëm, guri apo bastuni. Megjithatë, në pikëpamje të anës objective, krimi i goditjes me gurë përfshinte çdo dëmtim të shkaktuar me gurë dhe me bastun, si dhe të gjitha llojet e goditjeve, si me pëllëmbë, grushta, etj. Krimi kryhej me veprime aktive. Subjekti ishte i përgjithshëm dhe për efekt të cilësimit juridik në pikëpamje të anës subjektive nuk kishin rëndësi motivet dhe qëllimet. Kryhej me dashje të drejtpërdrejtë.

4.3.2 Rrahjet

Në grupin e dytë të veprave penale kundër personit, konkretisht në dëmtimet e tjera, përfshihej edhe rrahja, e cila ndahej në disa lloje, sikurse ishin:

A) Në varësi të subjektit pasiv në:

- Rrahjen e nënpunësve;
- Rrahjen e të huajit;
- Rrahjen e denoncuesit.

B) Në varësi të vendit:

- Rrahjen në shtëpi.

C) Në varësi të mënyrës:

- Rrahjet dhe qethjet;
- Rrahjen me shkop;
- Shkuljen e mjekrës.

Në të gjitha këto norma statutore sigurohej paprekshmëria e shëndetit të personit. Në çdo rast të shkeljes së tyre, fajtori ndëshkohej me një gjobë që varionte nga 2 -50 hyperperësh²³⁶, që shkonte në favor të kontit dhe të dëmtuarit.

Këto figura veprash penale dalloheshin midis tyre kryesisht nga sanksioni që vendosej në varësi të shkallës së objektit të cënuar. Statutet merrnin në mbrojtje dhe individin që ndodhej në banesën e tij nga veprimi kriminal i rrahjes. Në këtë figurë krimi merrte rëndësi vendi i kryerjes së

²³⁶ Në rast se rrihej një nëpunës publik, gjoba ishte 7 hyperperë, 12 hyperperë në rastin e rrahjes dhe qethjes së dikujt, 4 dhe 8 hyperperë ishte gjoba për të huajt e rrahur jashtë dhe brenda qytetit, 4 hyperperë kur rrihej ose fyhej një prej palëve në proces, 2 hyperperë kur dikush rrihej me shkop, si dhe 50 hyperperë kur një njeriu i shkulej mjekra.

Për më tepër shih: Lucia Nadin, "Statutet e Shkodrës", "Onufri", Botim i dytë, Universiteti "Wisdom", Tiranë, 2010, f. 366-367, n. 233- 239.

veprës si një element i anës objektive. Në një rast të tillë, fajtori ndëshkohej dhe për cënim dhe dhunim të banesës me një gjobë prej 16 hyperperësh.

Në një tjetër normë të statuteve të Shkodrës, merrej në mbrojtje dëmtimi i pjesëve të fytyrës, sikurse ishte dhe shkulja e mjekrës, që në thelb ishte dhe një veprim poshtërues ndaj të dëmtuarit.²³⁷ Në një tjetër normë të statuteve merrte rëndësi mjeti i kryerjes së veprës penale, si një element i anës objektive që mund të ishte një shkop, dru, apo çdo send tjetër.²³⁸

5. Veprat penale kundër moralit

Veprat penale kundër moralit përfshinin vepra të tilla, si: përdhunimi i gruas, të qenurit grua e përdalë, si dhe kur një grua ankohej kundër klerikut. Veprat penale kundër moralit janë një dëshmi e mbrojtjes juridike penale të nderit të gruas²³⁹.

5.1 Kur një grua ankohej kundër një kleriku²⁴⁰

Statutet e Shkodrës mbronin nderin, dinjitetin, jetën dhe shëndetin e femrës në çdo rast. Statutet e Shkodrës parashikonin të drejtën e gruas edhe kur ajo pretendonte një cënim të të drejtave të saj ndaj një kleriku, që për hir të së vërtetës, në periudhën mesjetare, kur dhe normat vepronin, gëzonte dhe ishte një figurë qendrore, i veshur me shumë pushtet në çdo drejtim.

Për tej kësaj, gruaja gëzonte një mbrojtje të plotë ligjore kundrejt çdo veprimi kriminal të drejtuar ndaj saj, sikurse mund të ishte cënimi i nderit dhe i dinjitetit (përdhunimi), dëmtimi i saj (rrahja), apo prekja e pasurisë së saj. Si subjekti aktiv, si subjekti pasiv në këtë rast ishin të posaçëm.

Kleriku, përfaqësuesi i besimit fetar, ndëshkohej me një gjobë prej 50 hyperperësh Sklavonie në rast të kallzimit të bërë nga gruaja. Në çdo rast, nuk ishte e nevojshme që të provohej ekzistenca e veprës penale, por ligjbërësi mjaftohej me kallzimin e bërë nga gruaja për ta cilësuar një veprim kriminal, duke u nisur nga interesi i lartë i subjektit që mbronte.

Kleriku ndëshkohej me një gjobë që shkonte në favor të peshkopit në masën 50%, dhe nga 25% në interes të kontit dhe të së dëmtuarës.

²³⁷ Lucia Nadin, “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 367, n. 239.

²³⁸ Ibid, n. 238.

²³⁹ Kristinka Jançe, Tezë doktrature, “Aspekte të zhvillimit të qytetve në mesjetë dhe statutet e Shkodrës si monumente të vërteta të Shqipërisë mesjetare”, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranës, Departamenti i së Drejtës Publike, Tiranë, 2011, f. 179.

²⁴⁰ Lucia Nadin, “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 358, n. 200.

Statutet parashikonin së në rast se peshkopi hiqte dorë nga marrja e vlerës, kjo e fundit kalonte në favor të shtetit.²⁴¹

5.2 Mbi përdhunimin e grave²⁴²

Statutet e Shkodrës, ndalonin kryerjen e akteve të dhunës ndaj grave. Në veprën penale të përdhunimit të grave, objekt kryesor ishte mbrojtja e paprekshmërisë seksuale të gruas që kishte mbushur moshën 18 vjeç. Ruhej jeta dhe shëndeti i saj.

Dhuna në dy format e saj (fizike dhe psikike), ishte elementi kryesor përbërës i figurës së krimit të përdhunimit të grave. Subjekt i këtij krimi ishte i përgjithshëm, çdo burrë që ishte i përgjegjshëm. Vepra penale gjithnjë kryhej me dashje të drejtpërdrejtë.

Statuti parashikonte si ndëshkim për fajtorin bashkimin në martesë me të dëmtuarën, nëse ishin të dy të pamartuar. Në rast se të dy ishin të martuar, burri ndëshkohej me një gjobë prej 50 hyperperësh që shkonte në favor të viktimës dhe kontit, në masën 50% për secilin. Norma statutore në fjalë nuk rregullonte momentin kur vetëm njëri prej subjekteve (gruaja, apo burri) ishte i martuar, dhe tjetri beqar. Gjithsesi, mendoj se dënimi me gjobë do të zbatohej dhe në këtë rast.

Norma statutore mbi përdhunimin e grave dallon nga ajo kur një grua ankohej kundër një kleriku. Në këtë të fundit, nuk ishte e nevojshme paraqitja e provave bindëse, për të cilën ishte një domosdoshmëri në krimin e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura. Që të ndodheshim përpara kësaj dispozite, në çdo rast kërkohet që gruaja të ishte e ndershme, ndryshe nuk gëzonte mbrojtje sipas këtij parashikimi statutor, ndonëse norma statutore nuk jepte kuptimin e ndershmërisë.

5.3 Mbi shërbyesën e përdhunuar²⁴³

Në këtë figurë krimi, subjekti pasiv ishte i posaçëm, shërbyesja ndaj së cilës ushtrohej dhunë. Të tërheq vëmendjen fakti se, në rast se gjatë ushtrimit të dhunës, shërbyesës i çenohej jeta, normat statutore nuk parashikonin lindjen e përgjegjësisë penale të fajtorit në favor të viktimës, por vetëm në favor të pronarit a pronares së saj. Kjo pasi shërbyesit nuk gëzonin asnjë lloj të drejte dhe shiheshin si sende.

Statuti parashikonte lindjen e detyrimit të fajtorit kundrejt pronarit për të zëvendësuar viktimën me një tjetër shërbëtoare. Madje dhe fëmija që lindte nga viktima, ishte në pronësi të pronarit të nënës.

²⁴¹ Ibid, n. 200.

²⁴² Ibid, n. 201.

²⁴³ Ibid, n. 202.

6. Veprat penale kundër nderit dhe dinjitetit të personit

Veprat penale kundër nderit dhe dinjitetit të personit përfshinin fyerjen e tjetrit, vënien dorë mbi një femër ose hyrjen me dhunë në shtëpinë e saj, fyerjen e gjykatësit, statuteve, kontit, shpifjen, si dhe gjobat për qytetarët që ziheshin e grindeshin. Ndërkohë që fjala tradhtar ishte fyerja më e rëndë e parashikuar nga statutet e Shkodrës.²⁴⁴

7. KONKLUZIONE

Të gjitha këto dispozita, kultura e lartë e të shkruarit dhe klasifikimi i tyre, përforcojnë përfundimin se kemi të bëjmë me fillesat e një Kodi Penal. Statuti i Shkodrës na tregon se në atë qytet ishte hartuar, miratohej dhe zbatohet një legjislacion penal i një rendi të avancuar shoqëror, kjo për faktin se popullsia kishte arritur nivele dhe standarde të larta kulturore dhe ekonomike.²⁴⁵

Përmes statuteve mbrohej posaçërisht jeta, shëndeti i personit, mbrohej në mënyrë të posaçme gruaja, si dhe punonjësit e sistemit të drejtësisë të asaj kohe, gjë që tregon për vendin dhe rëndësinë e posaçme që kishte zhvillimi i gjykimit.

Përsa u takon “Statuteve të Shkodrës”, duhet thënë se zbulimi dhe botimi i tyre, paraqet rëndësi në shumë drejtime. Përmes statuteve zbulojmë se ç’formë kishte struktura ligjore e qyteteve të kohës.²⁴⁶

Teoricientëve të së drejtës shqiptare, u del si detyrë të thellojnë studimet në këtë ligj të vjetër plotësisht shqiptar, me qëllim afirmimin në mënyrë të qartë dhe bindëse të rrënjëve shqiptare të hershme evropiane.²⁴⁷

BIBLIOGRAFIA:

1. Aleks Luarasi (1981): Tezë doktorature, “Shteti dhe e drejta shqiptare para dhe gjatë epokës së Skënderbeut”, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Tiranë.
2. Ambasador Foresti, P. (2010): “Statutet e Shkodrës”, Libri i Lucia Nadin “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë.
3. Egro D. (2007): “Historia dhe Ideologjia”, Instituti i Historisë, Shtëpia botuese “Maluka”, Tiranë.
4. Elezi I. (2010): “Normat penale në statutet e Shkodrës”, Libri i Lucia Nadin “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë.

²⁴⁴ Kristinka Jançe, Tezë doktorature, “Aspekte të zhvillimit të qyteteve në mesjetë dhe statutet e Shkodrës si monumente të vërteta të Shqipërisë mesjetare”, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranës, departamenti i së Drejtës Publike, Tiranë, 2011, f. 180.

²⁴⁵ Ibid, f. 162.

²⁴⁶ Ibid, f. 194.

²⁴⁷ Ambasador Paolo Foresti, “Statutet e Shkodrës”, Libri i Lucia Nadin “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 398-400.

5. Elezi I. (2009): "*E drejta penale*" pjesa e posaçme, Botimet "Erik", Tiranë.
6. Kristinka Jançe (2011): Tezë doktore, "*Aspekte të zhvillimit të qytetve në mesjetë dhe statutet e Shkodrës si monumente të vërteta të Shqipërisë mesjetare*", Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranës, Departamenti i së Drejtës Publike, Tiranë.
7. Mexi A. (2004): "*Arkitektura e kishave të Shqipërisë*", Shtëpia botuese "UEGEN", Tiranë.
8. Nadin L. (2010): "*Statutet e Shkodrës*", "Onufri", Botim i dytë, Universiteti "Wisdom", Tiranë.
9. Ortalli G. (2010): "*Statutet midis Shkodrës dhe Venedikut*", Libri i Lucia Nadin "*Statutet e Shkodrës*", "Onufri", Botim i dytë, Universiteti "Wisdom", Tiranë.

REFORMA LIGJORE DHE RISITË NË PROCESIN E LICENCIMIT TË BIZNESIT

Jetmira Rragami

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë

Legal reform and innovation in the business licensing process

ABSTRACT

Over the past 24 years commercial law has been subject to significant legislative changes. Commercial law itself does not represent a strong resistance to the legal reform or changes, because this resistance is usually virtue of a respected past. Looking back in commercial law history we can find reflected distant origins of some institutions, but still we have to deal with a new right, because modern trade (commerce) is not satisfied with the processes that were considered sufficient in the past. It is always in a changing process in order to be appropriated to an evolving economy. The mobility that represents this field of law in some way can be considered as weakpoint, but at the same time convert it into an interesting subject to study .

In this context it is important to go throw Law no. 10081 “For licenses, authorizations and permits in the Republic of Albania”. National Licensing Center operates based on this law, forming in this way another convenience in business development in Albania.

1. E kaluara e procesit të licensimit në Shqipëri

Shteti shqiptar gjatë këtyre viteve, është përpjekur të hartojë dhe të krijojë një kuadër të plotë ligjor, i cili parashikon dhe rregullon mënyrat e licensimit të aktiviteteve private, duke synuar lehtësimin e tërësisë së rregullave juridike dhe arritjen drejt procedurave të thjeshtëzuara dhe të lehtësuara të përmbushjes së këtij procesi. Në vijim të këtyre ndryshimeve legjislative dhe të nismave në favor të biznesit, më 23 Shkurt 2009, u miratua ligji 10081 “*Për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”, ligj ky që solli një reformim të licensimit të bizneseve private.

Në këtë mënyrë u themelua Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), si një institucion publik qendror, me personalitet juridik, në varësi të ministrit që mbulon çështjet e tregtisë. Kjo reformë solli në mënyrë të ndjeshme përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri.

Subjekti privat për të përfituar licensën për ushtrimin e aktivitetit tregtar, duhet të plotësojë disa kushte, në mënyrë që të krijojë bindjen e plotë që është në gjendje të ushtrojë aktivitetin për të cilin ka aplikuar dhe i plotëson të gjitha kërkesat dhe kriteret ligjore. Kriteret mund të jenë jo vetëm të karakterit juridik, por edhe të karakterit teknik dhe ekonomik.

Për të krijuar një ide më të saktë të procedurës tradicionale të licencimit, marrim shembull konkret, kriteret dhe procedurat që duhej të plotësoheshin për hapjen e një institucioni arsimor privat të arsimit parauniversitar. Leja e funksionimit të këtij institucioni duhej të realizohej nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.²⁴⁸

Subjekti privat aplikues²⁴⁹, i cili duhet të ishte vetëm një person juridik, vendas apo i huaj, duhet të paraqiste pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, kërkesën për llojin e institucionit arsimor për të cilin kërkonte të pajisej me leje funksionimi (institucione arsimore private dhe institucione arsimore plotësuese private parauniversitare), të shoqëruara me dokumentet, të cilat duhet të ishin të nënshkruara nga subjekti aplikant. Kriteret konkrete, që duheshin të plotësoheshin nga personi juridik dhe që parashikoheshin në këtë udhëzim ishin:

a) Formulari i autodeklarimit, i cili është i përbërë nga dy pjesë:

- *Pjesa e parë*, përmbante/deklaratën e subjektit mbi gjeneralitetet e tij, etj.
- *Pjesa e dytë*, përmbante deklaratën e subjektit, se njeh dhe zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të fushës përkatëse, si dhe mban përgjegjësi të plotë që i gjithë informacioni në formularin e plotësuar është i vërtetë.

Ndër të tjera padiskutim çdo aplikim do të shoqërohej dhe me dokumentacionin teknik të nevojshëm.

Në rast se vëreheshin mangësi apo deklarime të rreme lidhur me kërkesat e këtij udhëzimi, subjekti njoftohej për ndërprerjen e procedurës të filluar për leje nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. (MASH).

Në këtë udhëzim parashikoheshin krahas kriterëve të posaçme që duhet të plotësoheshin për të fituar të drejtën e marrjes së lejes së funksionimit për hapjen e një institucioni arsimor parauniversitar, edhe e gjithë procedura që duhej ndjekur deri në marrjen përfundimtare të lejes së funksionimit, e cila jepej me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Kështu në udhëzim parashikohej ngritja e një komisioni të posaçëm, të përhershëm, i cili merrte në shqyrtim të gjitha dosjet e

²⁴⁸ Sot Ministria e Arsimit dhe e Sportit.

²⁴⁹ Udhëzimi nr. 26, dt. 07.09.2007 i MASH-it, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare”.

ardhura për aplikim dhe të depozituara në MASH. Komisioni përbëhej nga specialistë të fushës së arsimit parauniversitar, juristë, ekonomistë dhe inxhinierë. Dosjet paraprakisht shqyrtoheshin nga sekretariati teknik, i cili vepronte pranë këtij komisioni. Sekretariati kontrollonte dosjet në përputhje me kriteret, afatet dhe procedurat që kishin ndjekur deri në shqyrtimin e tyre nga komisioni, tek i cili kalonin të gjitha dosjet. Gjithashtu po në këtë fazë shqyrtimi (nga sekretariati teknik), u kërkohej edhe drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore të kontrollonin në vend gjendjen fizike të objekteve të ndërtuara, të cilat pas miratimit do të funksiononin si shkolla nëse do të pranohej që atyre t'u jepej leja e funksionimit në përputhje me standardet normative të përcaktuara për institucionet arsimore.

Me ardhjen e përgjigjes pozitive nga zyrat rajonale më pas dosja kalonte për shqyrtim të mëtejshëm në komision, pasi kalonte filtrin e parë të shqyrtimit nga sekretariati teknik.²⁵⁰ Në rastet kur objektet e inspektuara nuk plotësonin kërkesat dhe standardet e vendosura për realizimin e plotë të procesit mësimor, atëherë Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ndërpriste procedurat e filluara për leje, duke njoftuar subjektin përkatës.

Në komision shqyrtoheshin të gjitha kërkesat e depozituara me dosjet shoqëruese dhe në rast konstatimi qoftë edhe të një mangësie të dokumentacionit të përgjithshëm apo teknik, komisioni vendoste refuzimin e kërkesës, e cila i bëhej e ditur me anë të një shkrese të MASH-it edhe subjektit aplikues, lidhur me vendimin e marrë nga ky komision. Në rastin e pranimit të kërkesës, pas marrjes së vendimit nga komisioni, i sugjerohej Ministrin të Arsimit dhe të Shkencës për këtë pranim dhe nxjerrjen e urdhrin të miratimit të dhënies së lejes së funksionimit për hapjen e një institucioni privat parauniversitar apo institucioni privat plotësues parauniversitar. Me miratimin e urdhrin nga ministri, pas propozimit të dhënë nga komisioni me vendim, i bëhej me dije subjektit aplikues privat, për të drejtën e marrjes së kësaj leje dhe ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar, por duke parashikuar në urdhër edhe disa detyrime të tjera që duhet të plotësoheshin domosdoshmërisht nga subjekti (pagesa e tarifës së shërbimit, paraqitja e numrit të nxënësve dhe listës të mësuesve, të cilët do të fillonin dhe do të mbaronin vitin shkollor, planin mësimor, programet lëndore dhe strukturën që do të përdorte institucioni në fillim të çdo viti shkollor, certifikatën e regjistrimit në organin tatimor, listën e veprimtarive jashtëshkollore që janë parashikuar të zhvillohen gjatë vitit shkollor (për institucion arsimor privat parauniversitar etj.).

Gjithashtu në udhëzim parashikohej se, të gjitha materialet që mbaheshin nga shkollat private parauniversitare, si: regjistra, regjistër amze,

²⁵⁰ Udhëzimi nr. 26, dt. 07.09.2007 i MASH-it, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare".

indekse alfabetik, statistika të numrit të nxënësve dhe të mësuesve etj., duhej t'u viheshin në dispozicion organeve kontrolluese kompetente. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve, si dhe mosdhënia apo fshehja e këtyre informacioneve, ndaj organeve kontrolluese kompetente, të cilat do të verifikojnë apo kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtyre institucioneve arsimore përbënte kundravajtje administrative. Kundravajtësit, në çdo rast dënohen me gjobë, siç është parashikuar në ligj ose me heqje të lejes së dhënë. Pra, në udhëzim, parashikoheshin edhe raste marrje masash ndaj subjekteve private që nuk respektonin rregullat e parashikuara në këtë udhëzim dhe në urdhrin e dhënies së lejes së funksionimit. Kështu, në rast mos ushtrimi brenda një viti shkollor nga momenti i marrjes së licencës, të aktivitetit për të cilin ishte marrë leja, subjekti humbiste automatikisht të drejtën për të ushtruar këtë aktivitet. Për të rifilluar aktivitetin, ai duhet të paraqiste kërkesën me dokumentacionin shoqëruar, nga fillimi.

Të drejtën e pezullimit të përkohshëm, deri në 1 vit kalendarik të institucionit arsimor privat e kishte (por edhe e ka) Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, me kërkesë të vetë subjektit ose me propozim të Drejtorise së Inspeksionit, Drejtorive Arsimore Rajonale apo Zyrave Arsimore, në rast shkeljeje të kriterëve të përcaktuara në dokumentacionin përkatës ligjor e nënligjor.

Në këtë mënyrë rregulloheshin dhëniet e lejeve dhe të licencave edhe nga institucione të tjera, të cilat kishin të drejtën e pajisjes me licencë të subjekteve të ndryshme private. Pra, me akte ligjore e nënligjore, rregulloheshin kriteret, kushtet, afatet e procedurat e fitimit, ndryshimit dhe shuarjes të së drejtës për pajisje me leje apo licencë.

2. Qendra Kombëtare e Licencimit pjesë e projektit “One stop Shop”.

QKL është krijuar dhe funksionon sipas Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Qëllimi i këtij ligji²⁵¹ është reduktimi i barrierave administrative nëpërmjet një rregullimi në terësi dhe koherent i sistemit të licencave e lejeve, bazuar në disa parime kryesore, si dhe nëpërmjet ngritjes së Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe një regjistri të integruar elektronik për licencat dhe lejet. Miratimi dhe zbatimi i këtij ligji përbën një ndryshim rrënjësor, në thellësi dhe gjerësi të sistemit të sotëm burokratik të licensave e lejeve (siç u ilustrua dhe me lart).

Kjo qendër shfrytëzon mundësitë që ofron teknologjia e informacionit, duke krijuar një sistem elektronik, i cili automatizon procesin e licencimit. Gjithashtu sistemi mundëson ndjekjen e procedurës dhe të ecurisë së aplikimit. Në këtë mënyrë QKL-ja redukton zvarritjet administrative duke ulur kostot për bizneset në procesin e licencimit, duke zovogëluar mundësitë e informalitetit dhe përmirësuar ndjeshëm klimën e

²⁵¹ N.1 Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

biznesit. Shërbimi me një ndalesë ofron procedura të përshpejtuara, transparente dhe më të shpejta.

Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.²⁵²

Aktet ligjore ligjore përcaktojnë më tej se kush do të jenë fushat që do i nënshtrohen procesit të licencimit dhe të autorizimit me kategoritë dhe nënkategoritë përfshirësë:²⁵³

- fusha / siguria kombëtare, rendi publik dhe mbrojtja civile
- fusha / ushqimi dhe shëndeti
- fusha / mjedisi dhe burimet mjedisore bazë
- fusha / burime minerare, hidrokarbure dhe energjetike
- fusha / transporti
- fusha / industri dhe shërbime të tjera
- fusha / arsimit dhe shkenca
- fusha / kujdesi shoqëror dhe punësimi
- fusha / drejtësia dhe ligji

Që veprimtaria të licencohet apo të autorizohet duhet në radhë të parë të plotësohen këto dy rrethana:²⁵⁴

a) ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullt mund të çënojë jetën, shëndetin, të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, sigurinë e rendin publik, sigurinë kombëtare, konkurrencën e ndershme apo mirëfunksionimin e tregut, një të mirë publike, objektivat sociale dhe çdo interes tjetër publik të kësaj natyre;

b) garantimi i përshtatshëm i interesave të përcaktuar në pikën “a” të sipërpërmeduar, pavarësisht ekzistencës së rregullave, të standardeve e mekanizmave vlerësues, vëzhgues dhe ndëshkues të mëpasshëm, nuk mund të arrihet pa një proces vetëdeklarimi, shqyrtimi, inspektimi e vlerësimi të përmbushjes së disa kriterëve të paracaktuara, përpara fillimit të veprimtarisë apo të kryerjes së veprimit.

Ligji përcakton më tej parimet e përgjithshme për përcaktimin e veprimtarive që i nënshtrohen lejes për ushtrimin e aktivitetit²⁵⁵.

²⁵² N.5. Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

²⁵³ V.Nr.538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

²⁵⁴ N.6. Ligji Nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Përdorimi i një të mire publike, nëpërmjet një lejeje, bëhet vetëm nëse plotësohet, të paktën, njëra nga këto rrethana:

- a) kur nëpërmjet procesit të dhënies së lejes, synohet marrja e kundërvleftës më të mirë në interes publik;
- b) përdorimi i lirë i së mirës publike nga subjekte, që nuk zotërojnë njohuritë, teknologjitë apo garanci të tjera të nevojshme, shkakton ose mund të shkaktojë dëmtimin e saj ose një shfrytëzim të papërshtatshëm;
- c) kur e mira publike, për shkak të kufizimit të saj në sasi, shtrirje, hapësirë apo kohë, ose për shkak të rrethanave të tjera, të arsyeshme, nuk lejon, përveçse një numër të kufizuar përdoruesish apo përdorim të kufizuar, ose kur përdorimi i lirë i të mirës publike nga një numër i pakufizuar subjektësh apo pa kufizim në sasi dhe/ose shtrirje në hapësirë dhe/ose kohë shkakton ose mund të shkaktojë dëmtimin e saj apo një shfrytëzim të papërshtatshëm.

Analiza e kuadrit ligjor dhe në shembullin e licensimit të aktivitetit të shkollës së lartë parauniversitare dhe më tej në praktikën e licencave dhe lejeve tregon më së miri se sistemi ishte i mbingarkuar me licenca dhe leje, të cilat ishin përcaktuar me ligje të veçanta, duke mos marrë në konsideratë, në të shumtën e rasteve këto parime që identifikohen më së miri në ligjin nr. 10081, të datës 23.02.2009, “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”.

Bazuar në këto parime të përgjithshme ky ligj ka shërbyer për të orientuar në vazhdim të gjitha nismat pasuese ligjore dhe nënligjore në fushën e licencave dhe të lejeve. Përcaktimi i këtyre parimeve bazë krijon në këtë formë dhe një pengesë për nismat që mund të rëndonin këtë sistem duke e mbingarkuar dhe duke rrezikuar ta kthejnë në një pengesë serioze për nismën e lirë.

Ligji nr. 10081, të datës 23.02.2009, “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”, përcakton rolin dhe tiparet bazë të Regjistrat Kombëtar të Licencave dhe Lejeve. Regjistri në fakt përbën instrumentin kryesor të realizimit të kësaj reforme kaq të rëndësishme. Ai shërben për disa qëllime.²⁵⁶

• *Së pari*, me anë të regjistrat mundësohet aplikimi i kërkesave, shqyrtimi i tyre nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) dhe institucionet e tjera qendrore, madje shkon më tej deri në lëshimin apo revokimin e tyre. Aktet hyjnë në fuqi vetëm pas publikimit në regjistrin tregtar, ndaj ky regjistër duhet kuptuar si formë e komunikimit zyrtar, si një arshivë zyrtare, e cila shërben për të shpallur akte, të cilat hyjnë në fuqi vetëm nëpërmjet kësaj shpalljeje.

Regjistri nuk cënon pavarësinë e institucioneve të pavarura, pasi ai është konceptuar si një mjet ku çdo institucion ka pjesën e tij në të cilën boton projektet

²⁵⁵ N.7. Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”.

²⁵⁶ Kreu III N.14 Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”.

apo aktet që janë të detyrueshme të botohen në regjistër apo botime të tjera të dobishme. Regjistri elektronik siguron në këtë formë transparencë maksimale të procedurës së vendimmarrjes, si dhe krijon lehtësitë maksimale të kësaj procedure.

- *Së dyti*, ai mundëson dhe përdorimin e parimit të “miratimit në heshtje”.²⁵⁷ Regjistri i krijon mundësinë çdo subjekti të informohet mbi licencat dhe lejet e poseduara nga subjektët e tjera private, qofshin këto persona fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj.

Institucionet publike janë grupuar në dy grupe të mëdha. Institucionet qendrore që përfshijnë Këshillin e Ministrave, Ministrinë dhe institucionet në varësi të tyre dhe Institucionet e Pavarura, që përfshijnë ato, të cilat krijohen si të tilla me ligj (p.sh., Entet rregullatore) dhe njësitë e qeverisjes vendore²⁵⁸. Kjo ndarje është e rëndësishme, pasi reforma me parimet e saj, siç është trajtuar edhe në pjesët e tjera të ligjit, prek licencat dhe lejet e të dy grupeve, por ndryshimi në thellësi nëpërmjet thjeshtimit të dukshëm dhe trajtimit nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit, është herë për licencat dhe lejet e Institucioneve Qendrore, në të cilat është dhe pjesa dërrmuese e licencave dhe lejeve.

Licencat/lejet që trajtohen nga/ose nëpërmjet QKL-së, grupohen në 4 grupe, të cilat ndjekin karakteristikën bazë të të dhënave dhe të mënyrës që përdoret për të vlerësuar ligjshmërinë dhe/ ose meritën e marrjes së një licence / leje nga një subjekt.

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës, ka miratuar ndarjen e licencave, të autorizimeve dhe lejeve dhe / ose nënkategorive të tyre, që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKL-së:²⁵⁹

- *Në grupin e parë*, futen ato licenca / leje, të cilat vlerësimi i plotësimit të kushteve nga subjekti privat, do të bazohet vetëm në vetëdeklarimin e tij.
- *Në grupin e dytë*, hyjnë ato licenca/leje, për të cilat krahas vetëdeklarimit, përdoren edhe dokumente të lëshuara më parë nga subjekte të ndryshme sipas rastit e që dorëzohen së bashku me kërkesën për aplikim.
- *Në grupin e tretë*, hyjnë ato licenca/leje, që krahas karakteristikës që kanë sipas grupit të dytë, vlerësimi i shqyrtimit të ligjshmërisë dhe/ose meritës së subjektit, kërkon përdorimin e metodave të tjera, si: inspektim, testim, provim, garë apo çdo metodë tjetër.
- *Grupi i katërt*, është një grup i veçantë licencash/lejesh, të cilat për shkak të natyrës së veprimtarisë apo përdorimit të së mirës publike trajtohen me dy faza.

Grupi i parë dhe i dytë, trajtohet ekskluzivisht nga QKL, e cila në këtë rast shfaqet me të gjitha tiparet e një qendre unike me një ndalëse. Procedura për

²⁵⁷ N.22/5. Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

²⁵⁸ N.3. Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

²⁵⁹ N.16. Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

këto dy grupe është mjaft e thjeshtë, bazuar në forma e formate standarde të bërjes së kërkesës në dokumente të mirënjohura, për t'u paraqitur dhe në një shqyrtim të shpejtë nga QKL. Në rastin e grupit të parë, procedura zgjat maksimalisht dy ditë pune, ndërsa në grupin e dytë ajo zgjat maksimalisht 4 ditë.

Në fakt kjo është plotësisht realiste për shkak të thjeshtësisë dhe standardizimit të informacionit që shqyrtohet për çdo kërkesë. Për këtë arsye vlerësohet se nuk ka asnjë rrezik që këto kompetenca të përqendrohen në një qendër të vetme si QKL.

Shembulli që morëm më lart për licencimin e aktivitetit privat të arsimit parauniversitar, bën pjesë në grupin e tretë të sipërcituar. Grupi i tretë licencave/lejeve, shqyrtimi i të cilave bazohet në disa veprime specifike shtesë dhe ndjek procedurën e kombinuar.²⁶⁰ QKL kryen shqyrtimin paraprak për aq sa QKL bën edhe në rastin e grupit të dytë. Pas shqyrtimit nga QKL dhe në rast rregullsie të kërkesës, ajo i kalon një apo disa institucioneve të tjera qendrore që do të ruajnë kompetenca të caktuara në këtë proces sipas licencës/lejes përkatëse. Secili institucion kryen procedurat dhe përdor metodat përkatëse të shqyrtimit. Kur çdo institucion tjetër e miraton kërkesën, licenca/leje quhet e miratuar dhe botohet nga QKL, duke ia përcjellë kësaj të fundit miratimin e dhënë në formën elektronike dhe atë shkresore, ndryshe subjektit i refuzohet kërkesa me arsyetimin përkatës të dhënë nga institucioni qendror. Në raport me grupin e tretë sistemi procedural merr tiparet e vendimmarrjes kolegjiale e paralele.

Grupi i katërt, është një grup i vecantë licencash/lejesh, të cilat për shkak të natyrës së veprimtarisë apo përdorimit të së mirës publike, trajtohen me dy faza. Secila nga fazat është një licencim me vete dhe mund t'i përkasë secilit prej tri grupeve të shpjeguara më lart. Kjo ndarje me faza është nevojë praktike, pasi disa veprimtari, me qëllim që të verifikohen, a janë në përputhje me rregullat dhe standardet e detyrueshme, kërkojnë një fazë ku vetë veprimtaria duhet të fillojë të kryhet.

Ligji trajton edhe çështje të tjera të lidhura me këto licenca/leje si zevëndësimi, ndryshimi i të dhënave. Revokimi nga QKL (revokimi për arsye të tjera dhe nga institucione të tjera), mënyra e paraqitjes së kërkesave dhe njoftimeve, ankimi etj.

Ligji trajton gjithashtu organizimin dhe funksionet e Qendrës Kombëtare të Licencimit. Qendra Kombëtare e Licencimit është krijuar si një institucion publik qendror me personalitet juridik në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, e cila është edhe ministria që mbulon çështjet e tregtisë. Qendra Kombëtare e Licencimit në statusin e saj është thujse identike me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, veçanërisht lidhur me risitë që ajo solli.

²⁶⁰ N.20. Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

QKL u propozua të ketë funksion bazë në procesin e licencimit / lejimit përfshirë mirëmbajtjen e Regjistrit Kombëtar (në bashkëpunim me institucionet e tjera), por edhe disa role të tjera, si: informim, këshillim, kryerje studimesh etj.

QKL ofron shërbimin ndaj publikut të gjerë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, me sportele në selinë e saj, sportelet e shërbimit të krijuara për të shërbyer në territor, sportelet e shërbimit në njësitë e qeverisjes vendore apo në institucione e ente të tjera, publike apo private.

Njësitë e qeverisjes vendore, ku krijohen dhe funksionojnë shërbimet e sportelit, përcaktohen nga Qendra Kombëtare e Licencimit dhe janë të detyruara të krijojnë sportelet në përputhje me Ligjin nr.10081, të datës 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Në këto njësi të qeverisjes vendore, shërbimi i sportelit kryhet si funksion i deleguar, në përputhje me dispozitat e ligjit të mësipërm dhe në përputhje gjithashtu edhe me dispozitat e ligjit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

3. Funksionet e Qendrës Kombëtare të Licencimit

Funksionet e QKL-së janë të përcaktuara qartë në ligj dhe më konkretisht:²⁶¹

- Qendra Kombëtare e Licencimit, informon dhe këshillon aplikuesit dhe publikon procedurat e licencimit, autorizimit e lejimit.
- Ajo mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe të lejeve.
- Trajtimin e procedurave të licencimit, autorizimit, lejeve, ndryshimit dhe revokimit të tyre sipas ligjit në fjalë.
- QKL jep mendime për çdo nismë ligjore apo nënligjore në fushën e licencave, autorizimeve dhe lejeve.
- Sigurimin e aksesit të lirë të publikut, në përputhje me ligjin, veçanërisht nëpërmjet faqes së saj të internetit.
- Gjithashtu, ajo kryen studime, për cilësinë e mjedisit rregullator, mbështet me informacion, analiza e këshilla institucionet qendrore dhe të pavarura, për nismat e tyre normative dhe organizative në fushën e licencave, autorizimeve e lejeve dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Këshillin e Ministrave në politikat për përmirësimin e mjedisit rregullator.

Gjatë punës së saj funksionale QKL ndjek dhe realizon një procedurë të caktuar pune, duke përcaktuar rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë / autorizim / leje për të gjitha grupet.

Kërkesa²⁶² përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse. Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna: emërtimin e kategorisë/nënkategorisë; llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike e të përdorimit të saj; të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën; vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së

²⁶¹ N.38. Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

²⁶² N.34 Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

veprimet apo përdorimit të së mirës; të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë; deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit / autorizimit / lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet); deklaratën për vertetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe / ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/ autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato; adresën për komunikim listën e dokumenteve shoqëruese që duhen paraqitur:

- QKL -ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera të paparashikuara në formular. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.
- QKL-ja merr në shqyrtim kërkesat për grupin e parë, sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe merr vendim në një afat prej 2 ditësh pune nga data e paraqitjes së kërkesës.
- QKL-ja shqyrton²⁶³ kërkesat për grupin e dytë, sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe merr vendim në një afat prej 4 ditësh pune nga data e paraqitjes së kërkesës. QKL-ja shqyrton edhe paraqitjen e të gjitha dokumenteve provuese.

Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e tretë, është në mënyrë më të alternuar dhe nuk ka tipare të mirëfillta të “one stop shop”.

Më konkretisht:

1. QKL-ja merr në shqyrtim paraprak²⁶⁴, kërkesat për grupin e tretë, sipas radhës së paraqitjes së tyre.
2. QKL-ja vlerëson vetëm përmbushjen e kriterëve në kompetencë të saj, e bazuar në vetëdeklarimin e kërkuarit dhe/apo dokumentet provuese, sipas të njëjtave procedurave dhe afateve, sipas rastit, të përcaktuara për grupin e parë ose të dytë.²⁶⁵

Nëse QKL-ja konstaton njerën nga shkaqet e refuzimit ajo vendos refuzimin përfundimtar të kërkesës.

Në rast të kundërt, QKL-ja, publikon në regjistër vendimin paraprak të kalimit në fazën e dytë të shqyrtimit dhe njofton, në mënyrë elektronike, institutionet e tjera, që shqyrtojnë përmbushjen e një apo të disa kriterëve të licencimit/autorizimit / lejimit, në kompetencë të tyre.

Institutionet e tjera brenda afatit të caktuar, shqyrtojnë përmbushjen e kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencën e tyre duke kryer vlerësimin, inspektimin, duke organizuar testimin apo garën, intervistën apo dëgjimin, ose duke zbatuar metodën tjetër përkatëse dhe shprehin miratimin apo refuzimin e tyre për përmbushjen ose mospërmbushjen e kriterëve përkatëse.

²⁶³ N.18 Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

²⁶⁴ N.19/1 Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

²⁶⁵ N.19/4,5 Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Refuzimi parashikon edhe shkaqet e tij. Refuzimi apo miratimi publikohet menjëherë nga vetë institucioni në regjistër.

Nese publikimi i miratimit apo i refuzimit nga njëri nga institucionet është paraprakisht, i domosdoshëm për shqyrtimin e të njëjtit kriter apo të një kriteri tjetër licencimi/autorizimi/lejimi nga një institution tjetër, afati i caktuar për këtë të fundit, fillon nga publikimi në regjistër i miratimit apo i refuzimit të institucionit të parë.

E gjitha kjo procedurë brenda një afati të caktuar (i cili fillon të llogaritet nga data e publikimit të vendimit të QKL-së).

Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara, apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i institucionit tjetër. QKL-ja merr një vendim përfundimtar, jo më vonë se 2 ditë nga kalimi i afatit të fundit dhe me të gjatë për kërkesën e paraqitur. Në qoftë se edhe një nga institucionet e tjera, ka vendosur refuzimin dhe shkaqet e tij, QKL-ja vendos refuzimin e kërkesës, në rast të kundërt QKL-ja vendos, përkatësisht miratimin.

Licencat, autorizimet dhe lejet, që trajtohen sipas këtij ligji nga / apo nëpërmjet QKL-së dhe për të cilat, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të licencimit/autorizimit/ lejes bëhet për një pjesë të kriterëve që përpara fillimit të veprimtarisë, ndërsa vlerësimi i përmbushjes së pjesës tjetër të kriterëve bëhet vetëm pas një periudhe të caktuar të ushtrimit të veprimtarisë, trajtohen si më poshtë:

- a) procedura kalon në këto dy hapa: licence/autorizim/leje e përkohshme dhe licence/autorizim/leje përfundimtare;
- b) licenca / autorizimi / leja e përkohshme, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, është me afat të përcaktuar, sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe titullari duhet të paraqesë kërkesën për pajisjen me licencën / autorizimin /lejen përfundimtare, përpara përfundimit të afatit të asaj të përkohshme. Licencat, autorizimet dhe lejet, që trajtohen sipas këtij ligji, nga apo nëpërmjet QKL-së dhe për të cilat, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, vlerësimi i përmbushjes së kushteve të licencimit / autorizimit / lejimit bëhet me dy hapa dhe në hapin e dytë shqyrtohet vetëm kërkesa e subjektit që ka kaluar me sukses hapin e parë, trajtohen si më poshtë: procedura kalon në këto dy hapa: miratimi i kalimit me sukses të hapit të parë dhe licencimi/autorizimi/lejimi përfundimtar; pas njoftimit nga QKL-ja të vendimit të miratimit për kalimin me sukses të hapit të parë, kërkuuesi duhet të paraqesë dokumentet shoqëruese për hapin e dytë brenda afatit përkatës. Trajtimi i secilit prej hapave të parashikuar në shkronjen "a", përkatësisht, të pikave 1 e 2 të këtij neni, u nënshtrohet, sipas rastit, procedurave të këtij ligji për grupin e parë, të dytë apo të tretë. Këshilli i Ministrave përcakton grupin, sipas të cilit trajtohet secili hap.

Vendimi i miratimit apo i refuzimit të kërkesës bëhet sipas formularit tip e njoftohet sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji. Vendimi i refuzimit përmban të gjitha shkaqet e refuzimit, ndërsa vendimi për miratim përmban edhe të dhënat e llogarisë bankare përkatëse, si dhe vlerën e taksës / tarifës që duhet paguar nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi. Vendimi i refuzimit, 266 përmban edhe vendimin, sipas formularit tip të institucionit tjetër që ka vendosur refuzimin. Riparaqitja e kërkesës pas refuzimit trajtohet si kërkesë e re. Në çastin kur QKL-ja, brenda afatit të përcaktuar, sipas këtij kreu, nga paraqitja e kërkesës, nuk publikon vendimin e refuzimit apo të miratimit, atëherë kërkesa quhet automatikisht e miratuar në heshtje dhe sistemi elektronik gjeneron menjëherë vendimin e miratimit. Vendimi i miratimit në heshtje publikohet automatikisht nga sistemi elektronik në regjistër.

Licenca, autorizimi apo leja hyn në fuqi menjëherë, me publikimin e titullit përkatës në regjistër, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit, që e miraton atë, lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare. Në rastet kur për përfitimin e titullit nuk është e zbatueshme një tarifë apo taksë, titulli publikohet në regjistër menjëherë dhe automatikisht, së bashku me njoftimin e vendimit të miratimit, sipas pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji, apo menjëherë me gjenerimin e miratimit të heshtur, sipas pikës 5 të nenit 22 të këtij ligji dhe mund të tërhiqet në çdo sportel shërbimi të QKL-së apo të printohet drejtpërdrejt nga regjistri.

Kërkesat dhe paraqitja e dokumentit të pagesës së tarifës/taksës në QKL mund të kryhen nëpërmjet:

- a) paraqitjes drejtpërdrejt në çdo sportel shërbimi të QKL-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së kërkuarit;
- b) dërgimit me postë me lajmërim-marrje në selinë qendrore të QKL-së;
- c) dërgimit me mjete elektronike, në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik.

Dokumentet shoqëruese paraqiten në origjinal, në kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin apo në kopje të shoqëruara me origjinalin, që njësohen me origjinalin nga nëpunësi i sportelit, lehtësi tjetër kjo që ul koston e dokumentacionit. Çdo kërkesë dhe çdo vendim i QKL-së apo i një institucioni tjetër, që lidhet me licencimin/autorizimin/lejimin, sipas këtij kreu, publikohet në regjistër brenda ditës së nesërme të punës nga paraqitja e kërkesës apo marrja e vendimit ose e bërjes me dije.

²⁶⁶ N.20/10 Ligji Nr. 10081, të datës 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

PËRFUNDIME:

Në mbyllje të kësaj analize të shkurtër të ligjit për licencimet, mund të bëjmë një përmbledhje të shkurtër të karakteristikave dhe risive kryesore, që solli krijimi i QKL-së dhe lehtësitë që i krijoi biznesit.

Programi “one stop shop”, aplikohet tërësisht për licencimin e biznesit privat, vendas dhe të huaj kryesisht në dy grupet e para të liçensimit, pasi për grupin e tretë licencimi karakterizohet nga bashkëpunimi me institucionet qendrore.

Regjistrimi elektronik i biznesit. Instrumenti kryesor që bënte të mundur realizimin e reformës, ishte regjistri elektronik. Me anë të tij mundësohet bërja e kërkesave, shqyrtimi i tyre, sipas rastit nga QKL-ja, apo nga Institucionet Qendrore dhe kështu deri te lëshimi apo revokimi i tyre. Ai sjell një risi dhe në mënyrën e informimit që ofron për të tretët dhe jo vetëm për bizneset e interesuara.

Plotësimi i kërkesave të tregut evropian. E kemi cituar dhe më lart se, hartimi i një legjislacioni bashkëkohor, është kusht dhe për situatën gjeopolitike ku është Shqipëria. Ky ligj dhe QKL-ja, përkon më së miri me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për licencimin e biznesit. Ai i bën të dhënat e aksesueshme, jo vetëm për përdoruesit shqiptar, por dhe për investitorët e huaj.

Reduktimin e kostos për bizneset. Procesi i licencimit i lëshimit të lejeve apo autorizimeve, u kthye kështu në një proces administrativ me më me pak ndalesa. Ky proces reduktoi jo vetëm kostot financiare të biznesit, por dhe kostot në shpenzimin e kohës pas procedurave të njëpasnjëshme ligjore dhe administrative. Me hyrjen në zbatim të ligjit të ri u modifikuan dhe u shkurtuan afatet e pranimit të kërkesave dhe të shqyrtimit të tyre si nga QKL-ja, kjo kur flitet për licencat e grupit të parë dhe të dytë, ashtu edhe nga institucionet qendrore, të cilat duhet të shqyrtojnë përmbushjen e kriterëve të licencimit/ autorizimit/lejimit, nga vlerësimi i bërë brenda kompetencave të tyre.

Miratimi në heshtje. Më lart doli në pah sistemi i miratimit të licencës/autorizimit /lejes në heshtje. Në rast se QKL-ja brenda afatit të përcaktuar në ligj, nga data e paraqitjes së kërkesës nuk publikon vendimin e refuzimit apo të miratimit, atëherë kërkesa quhet automatikisht e miratuar në heshtje dhe sistemi elektronik gjeneronte vendimin e miratimit. Ky parim vlente dhe në rastin kur institucionet qendrore me të cilat bashkëpunonte QKL-ja, nuk përgjigjeshin brenda afatit të caktuar, apo nuk kishin regjistruar shtyrjen e afateve, do të vihej në zbatim parimi i miratimit

në heshtje. Ky parim është një shembull konkret i shmangies së burokracive administrative dhe lehtësive të krijuara.

Në përfundim, padiskutim mund të themi se, krijimi i QKL-së, solli një ndryshim të padiskutueshëm në zhvillimin e biznesit, ndryshim i cili reflekton më së miri praktikat evropiane. Integrimi ligjor e bën më të thjeshtë rrugën e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

BIBLIOGRAFIA:

1. Ligji nr. 9741. datë 21. 05. 2007, “*Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar”.
2. Ligji nr. 10081, datë 23. 02. 2039, “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”.
3. Vendim Nr. 535, datë 26. 05. 2009 i Këshillit të Ministrave, “*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”, i ndryshuar.
4. Udhëzimi nr. 26. datë 07.09.2007 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes të funksionimit për institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore plotësusuese private parauniversitare*”.
5. Udhëzimi nr. 11. datë 28.02.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “*Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës*”.

KEQTRAJTIMI I FËMIJËS DHE PASOJAT E TIJ

Fatbardha Osmanaga

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Psikologji-Punë Sociale,
departamenti i Mësuesisë*

Child maltreatment and its consequences

ABSTRACT

In this paper it is treated child maltreatment topic. There are explained the main types of child maltreatment, as child physical abuse, child sexual abuse, child neglect and child psychological abuse. There are treated the DSM 5 definitions. It is treated, too, the Albanian legislation about protection of child rights. There are explained the consequences of child maltreatment. There are given the main aspects of prevention of child maltreatment.

Key words: child physical abuse, child sexual abuse, child neglect, child psychological abuse.

Pjesa teorike

Keqtrajtimi i fëmijës përfshin të gjitha tipat e abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës nën moshën 18 vjeç nga ana e prindit, kujdestarit apo një personi tjetër në rolin e kujdestarisë (p.sh., klerikët, trajneri, mësuesi). Ekzistojnë katër tipa të zakonshëm të abuzimit : a)abuzimi fizik, b)abuzimi seksual, c)abuzimi emocional, d)neglizhimi.²⁶⁷

Vlerësimet në botë tregojnë se afro 40 milionë fëmijë janë aktualisht viktimat të keqtrajtimit, ku neglizhimi është forma më e përhapur e raportuar (Encyclopedia on Early Childhood Development (2012)).²⁶⁸

²⁶⁷Centers for Disease Control and Prevention(2013), *Child Maltreatment Prevention*, Atlanta, USA

²⁶⁸Encyclopedia on Early Childhood Development (2012), Maltreatment (Child) Synthesis

Keqtrajtimi i fëmijës (CM) përbën një problem domethënës të shëndetit publik në SHBA. Sipas agjencive të Shërbimit të Mbrojtjes së Fëmijës, më shumë se 676.000 fëmijë, ishin viktime të keqtrajtit në vitin 2011 dhe po në të njëtin vit, 1,545 fëmijë, humbën jetën nga ushtrimi i dhunës fizike ndaj tyre.²⁶⁹

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, afro 20% e femrave dhe 5-10% e meshkujve, raportojnë të jenë abuzuar seksualisht, kur kanë qenë fëmijë, ndërsa 23% e individëve raportojnë të jenë abuzuar fizikisht, kur kanë qenë fëmijë (WHO (2014) Fact sheet N°150).²⁷⁰

Abuzimi fizik dhe neglizhimi i fëmijës janë të lidhura me disavantazh shoqëror në familjet e fëmijëve. Njerëzit që abuzojnë me fëmijët, duke përfshirë prindërit, janë individë me probleme, një pjesë e të cilëve kanë vuajtur abuzim apo neglizhim në fëmijërinë e tyre. Adoleshentët djem, të cilët abuzojnë seksualisht fëmijët, kanë më probabilitet që të kenë pësuar ose të kenë qenë dëshmitarë të dhunës fizike dhe që të kenë përjetuar abuzim apo ftohje emocionale gjatë kujdesit të tyre. Abuzimi emocional, abuzimi fizik dhe neglizhimi, janë hasur shpesh në familje, në të cilat një ose të dy prindërit vuajnë nga sëmundje mendore, kanë një çrregullim personaliteti, apo çrregullim të abuzimit me drogë/alkool. Dhuna ndërmjet prindërve përbën, gjithashtu, një faktor reziku.²⁷¹

DSM5 i quan “*probleme të keqtrajtit dhe neglizhimit të fëmijës*”. Këtu përfshihen: a)abuzimi fizik i fëmijës, b)abuzimi seksual i fëmijës, c)neglizhimi i fëmijës, d)abuzimi psikologjik i fëmijës.

Abuzimi fizik i fëmijës

Abuzimi fizik i fëmijës është dëmtimi fizik i shkaktuar ndaj fëmijës me qëllim mizor dhe/ose të keq. Abuzimi fizik mund të jetë rezultat i qëllimit me grushta, i rrahjes, i shkelmimit, i kafshimit, i djegies, i tundjes, apo i ndonjë forme tjetër të dëmtimit fizik të fëmijës.²⁷²

Sipas DSM 5, “*Abuzimi fizik i fëmijës është një dëmtim fizik i fëmijës, i cili nuk ndodh rastësisht dhe radhitet nga mavijosje të vogla deri në frakturë të rënda apo deri në vdekje, që ndodhin si rezultat i qëllimit me grushta, i rrahjes, i shkelmimit, i kafshimit, i tundjes, i rrëzimit, i qëllimit*

²⁶⁹ <http://www.cdc.gov/Features/HealthyChildren/>

²⁷⁰ <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs150/en/index.html>

²⁷¹ Skuse D., Bruce H., Dowdney L., Mrazek D. (2011): Child Psychology and Psychiatry, John Wiley & Sons, Ltd., Publication, USA, f.114-115.

²⁷² <http://www.medterms.com/script/main/art.asp?articlekey=8360>

*me thikë, i zënies së frymës, i goditjes (p.sh., me dorë, me shkop, me rrip apo me ndonjë objekt tjetër), i djegies apo si rezultat i çdo metode tjetër të shkaktuar nga një prind, nga një kujdestar apo nga një tjetër individ që ka përgjegjësi për fëmijën. Një dëmtim i tillë konsiderohet abuzim, pavarësisht nga fakti nëse personi kujdestar kishte apo jo ndërmend që ta lëndonte fëmijën”.*²⁷³

Abuzimi seksual i fëmijës

Nuk ekziston një përkufizim universal i abuzimit seksual të fëmijës. Megjithatë, karakteristika thelbësore e tij, lidhet me pozicionin dominues të të rriturit, i cili ia lejon vetes që ta detyrojë një fëmijë në veprimtari seksuale.²⁷⁴

Sipas DSM 5, “Abuzimi seksual i fëmijës përbën çdo akt seksual, i cili përfshin fëmijën që synon t’i japë kënaqësi seksuale një prindi, një kujdestari, apo një individ tjetër që ka përgjegjësi për fëmijën. Abuzimi seksual përfshin veprimtari të tilla, si: përkëdheljen e gjenitaleve të fëmijës, penetrimin, incestin, përdhunimin, sodominë dhe ekspozimin e pahijshëm. Abuzimi seksual përfshin, gjithashtu, shfrytëzimin pa kontakt të fëmijës nga prindi apo nga kujdestari, p.sh., duke e detyruar, duke e mashtruar, duke e joshur, duke e kërcënuar apo duke i ushtruar presion fëmijës që të marrë pjesë në akte të kënaqësisë seksuale për të tjerët, pa kontakt fizik të drejtpërdrejtë ndërmjet fëmijës dhe abuzuesit”.²⁷⁵

Pjesa më e madhe e abuzuesve e njohin fëmijën me të cilin abuzojnë. Ata mund të jenë miq të familjes, komshi apo kujdestarë fëmijësh. Afro 1/3 e abuzuesve kanë lidhje me fëmijën. Pjesa më e madhe e abuzuesve janë meshkuj.²⁷⁶

Problemi duhet identifikuar, duhet ndaluar abuzimi dhe fëmija duhet të marrë ndihmë profesionale. Dëmi emocional dhe psikologjik afatgjatë i abuzimit seksual, mund të jetë shkatërrues për fëmijën.²⁷⁷

²⁷³American Psychiatric Association (2013) Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders Fifth Edition, Arlington, USA, f. 717.

²⁷⁴<http://www.apa.org/pubs/info/brochures/sex-abuse.aspx>

²⁷⁵American Psychiatric Association (2013) Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders Fifth Edition, Arlington, USA, f. 718.

²⁷⁶<http://www.nlm.nih.gov/medlineplus/childsexualabuse.html>

²⁷⁷American Academy of Child and Adolescent Psychiatry (2011) Facts for Families, Child Sexual Abuse, Washington

Neglizhimi i fëmijës

Neglizhim ndaj fëmijës, përkufizohet çdo akt skandaloz, i konfirmuar apo i dyshuar, apo pakujdesi nga ana e një prindi të fëmijës apo nga ana e kujdestarit që e privon fëmijën nga nevojat themelore të moshës dhe mund të rezultojë, ose ka potencial të arsyeshëm për të rezultuar në dëmtim fizik ose psikologjik të fëmijës. Neglizhimi i fëmijës përfshin braktisjen, mungesën e mbikëqyrjes së duhur, pamundësinë për të plotësuar nevojat e domosdoshme emocionale ose psikologjike, pamundësinë për të siguruar edukimin e duhur, kujdesin mjekësor, ushqyerjen, strehimin dhe/ose veshjen.²⁷⁸

Abuzimi psikologjik i fëmijës

Abuzimi psikologjik i fëmijës, është një model i veprimeve të qëllimshme verbale apo pjellore, si dhe mungesa e veprimeve që i përcjell fëmijës mesazhin se fëmija është i pavlefshëm, i keq, jo i dashur, i rrezikuar, apo që vlen vetëm për të përmbushur nevojat e dikujt tjetër. Shembuj të abuzimit psikologjik janë: mosdhënia e mbështetjes emocionale, izolimi apo terrorizimi i fëmijës.²⁷⁹

Sipas DSM 5, “Abuzimi psikologjik i fëmijës është akt verbal ose simbolik, i cili nuk ndodh rastësisht, nga ana e prindit të fëmijës ose kujdestarit, që rezulton ose ka potencial të arsyeshëm për të rezultuar në dëmtim domethënës psikologjik të fëmijës. Shembuj të abuzimit psikologjik të një fëmije përfshijnë sharjen, diskreditimin, apo poshtërimin e fëmijës; kërcënimin e fëmijës; dëmtimin/braktisjen apo të treguarit që ofenduesi i supozuar do të dëmtojë/do të braktisë njerëz ose objekte për të cilat kujdeset fëmija; kufizimin e fëmijës (si, duke i lidhur së bashku krahët apo këmbët e fëmijës ose duke e lidhur fëmijën për mobilje apo tek një objekt tjetër, ose kufizimin e fëmijës në një zonë të vogël të mbyllur (p.sh., në depo); viktimizimin e jashtëzakonshëm të fëmijës; detyrimin e fëmijës për t’i shkaktuar dhimbje vetes së tij dhe ndëshkimin e tepruar të fëmijës (p.sh.,

²⁷⁸ American Psychiatric Association (2013): Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders Fifth Edition, Arlington, USA, f. 718.

²⁷⁹ <http://www.healthyplace.com/abuse/child-psychological-abuse/what-is-psychological-abuse-of-a-child/>

*në frekuencë apo kohëzgjatje tejet të lartë, bile edhe nëse jo në nivelin e abuzimit fizik) përmes mjeteve fizike ose jofizike”.*²⁸⁰

Legjislacioni shqiptar

Aspekte të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës janë trajtuar dhe janë sanksionuar edhe në legjislacionin shqiptar. Më poshtë janë listuar disa prej tyre.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 54, pika 3 thekson “*Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal*”.

Strategjia Kombëtare për Fëmijët

Në vitin 2001 u miratua **Strategjia Kombëtare për Fëmijët**. Në këtë strategji iu kushtua vëmendje e veçantë shëndetit të fëmijës, duke filluar nga periudha e shtatzënësisë, organizimit të shërbimeve shëndetësore për fëmijët, sigurimit të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, për fëmijët jetimë dhe për fëmijët me probleme sociale. Iu kushtua vëmendje e veçantë edhe mbrojtjes së fëmijëve, veçanërisht, mbrojtjes të fëmijëve nga vetëvrasja, arsimimit të fëmijëve, ku u vu theksi tek arsimimi gjithëpërfshirës dhe në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006, Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Në Nenin 3 jepen përkufizimet e termave “Dhunë”, “Dhunë në familje”, “Viktimë”, “Dhunues/e”, “Urdhër mbrojtjeje”, “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje”. Sqarohen, gjithashtu, masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje (Neni 10), si dhe procedurat ligjore në lidhje me lëshimin e urdhrit të mbrojtjes (Neni 11-14, 16-20).

²⁸⁰ American Psychiatric Association (2013) Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders Fifth Edition, Arlington, USA, f. 719.

Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013

Në gusht të vitit 2007, u miratua **Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013**, në të cilën shërbimeve sociale iu dha rëndësi e madhe. Theksi u vu tek decentralizimi, tek transferimi i shërbimeve rezidenciale tek njësitë lokale të administrimit, tek rritja e diversitetit të shërbimeve komunitare, tek mbulimi i të gjitha grupeve sociale me shërbimet bazë në të gjitha rrethet e vendit, tek deinstitutionalizimi, tek konsolidimi i shtëpive model “*shtëpi-familje*” për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, tek përhapja e këtyre shërbimeve për grupet e tjera sociale (të rinjtë, personat e moshuar), tek implementimi i standardeve të shërbimit dhe tek përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për fëmijët, për personat me aftësi të kufizuara dhe për personat e moshuar.

Ligji mbi Shëndetin Publik (Nr.10 138, dt. 11.5.2009)

Në në maj të vitit 2009, u miratua **Ligji i Shëndetit Publik** (Nr.10 138, dt. 11.5.2009). Në këtë ligj jepet, mes të tjerash, përkufizimi i shëndetit publik, përcaktohen parimet e shëndetit publik, veprimtaritë dhe shërbimet bazë të shëndetit publik, ku bën pjesë edhe shëndeti mendor. Jepet, gjithashtu, edhe koncepti i strukturave rajonale të shëndetit publik, përgjegjësitë, funksionet dhe shërbimet e tyre. Një vend të rëndësishëm zë edhe edukimi shëndetësor dhe promovimi i shëndetit, objekti, parimet dhe paketa e promovimit të shëndetit.

Ligji Nr.10 347, datë 4.11.2010 Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

Neni 5 thekson se mbrojtja e të drejtave bëhet duke garantuar ndërmjet të tjerash, “*Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinioneve të shprehura apo të bindjeve të prindërve/përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij*” (Pika 3).

Neni 21 thekson se fëmija mbrohet nga çdo formë e a)dhunës fizike dhe psikologjike, b) ndëshkimit trupor dhe trajtimit poshtërues e denigrues, c) diskriminimit, përjashtimit dhe fyerjes, ç)keqtrajtimit dhe braktisjes, d)mospërfilljes dhe neglizhimit, dh)shfrytëzimit dhe abuzimit, e)dhunës seksuale.

Pasojat e keqtrajtimit të fëmijës

Abuzimi dhe neglizhimi mund të ndikojë shëndetin e individit dhe shëndetin e tij mendor në disa mënyra të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta. Efektet negative në zhvillimin fizik, mund të rezultojnë nga

trauma fizike (p.sh., goditje të kokës apo trupit, apo tundje të dhunshme) dhe nga neglizhimi (p.sh., ushqim jo i përshtatshëm, mungesë e stimulimit të duhur lëvizor apo refuzim i trajtimeve mjekësore).²⁸¹

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, pasojat e keqtrajtimit të fëmijës, përfshijnë shëndet fizik dhe mendor të dëmtuar gjatë gjithë jetës dhe pasojat sociale e profesionale, mund të ngadalësojnë zhvillimin ekonomik e social të vendit (WHO (2014) Fact sheet N°150).

Në përgjithësi, fëmijët e abuzuar dhe të neglizhuar, mund të provojnë një larmi dëmtimesh, duke përfshirë vështirësi intelektuale apo akademike, marrëdhënie të reduktuara me moshatarët dhe probleme me atashimin me personat kujdestarë. Studimet të cilat kanë shqyrtuar abuzimin fizik të fëmijës, kanë zbuluar lidhje me paaftësinë për të kontrolluar gjendjen shpirtërore (p.sh., depresion, Johnson et al., 2002), dëmtim konjitiv (p.sh., vonesa të gjuhës, Eigsti & Cicchetti, 2004) dhe sjellje eksternalizuese (p.sh., kundërshtim në rritje dhe agresion, Trickett & Kuczynski, 1986). Fëmijët e abuzuar fizikisht, mund të shfaqin frikë ndaj të rriturve dhe mund të bëjnë rezistencë ndaj ribashkimit me prindërit (p.sh., pas shkollës, NCCAN, 2003c).²⁸²

Kërkimet tregojnë se ekziston një lidhje ndërmjet keqtrajtimit të fëmijës dhe një sërë problemesh, duke përfshirë: abuzimin me substanca, dhunën nga ana e partnerit, shtatzënë në adoleshencë, ankthin, depresionin, vetëvrasjen, diabetin, sëmundjet ishemike të zemrës, sëmundjet seksualisht të trashëgueshme, pirjen e duhanti dhe obezitetin (Fellitti et al., 1998; Mercy & Saul, 2009; Repetti, Taylor, & Seeman, 2002).²⁸³

Abuzimi fizik shoqërohet me sjellje agresive dhe me vetëvlerësim të ulët. Neglizhimi emocional shkakton rezultate të ulëta shkollore dhe vështirësi në marrëdhëniet me moshatarët, si dhe sjellje kundërshtuese. Abuzimi seksual shoqërohet, veçanërisht me depresion të mëvonshëm, me abuzim me substancë dhe vetëdëmtim, me fenomene posttraumatike dhe me sjellje seksuale jo të përshtatshme. Sjellja antisociale shoqërohet në mënyrë domethënëse me keqtrajtimin e mëparshëm të fëmijës.²⁸⁴

²⁸¹ <https://www.childwelfare.gov/can/impact/longterm/health.cfm>

²⁸² Ammerman R.T., Hersen M., Thoma J.C. (2006) Comprehensive Handbook of Personality and Psychopathology, Volume 3, Child Psychopathology, John Wiley & Sons, Inc., Hoboken, New Jersey, f.369.

²⁸³ Zimmerman F., Mercy J.A. (2010) A Better Start- Child Maltreatment Prevention as a Public Health Priority, The Doris Duke Charitable Foundation & Centers for Disease Control and Prevention.

²⁸⁴ Skuse D., Bruce H., Dowdney L., Mrazek D. (2011) Child Psychology and Psychiatry, John Wiley & Sons, Ltd., Publication, USA, f.117.

Keqtrajtimi gjatë foshnjërisë ose gjatë fëmijërisë së hershme, mund të bëjë që zona të rëndësishme të trurit të formohen në mënyrë jo të duhur, duke shkaktuar probleme fizike, mendore dhe emocionale, të tilla si: çrregullime gjumi, çrregullim paniku dhe çrregullim të mungesës së vëmendjes/hiperaktiviteti (DHHS 2001).²⁸⁵

Parandalimi

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit,

- Është i mundur parandalimi i keqtrajtimit të fëmijës dhe ai kërkon një qasje multisektoriale.
- Programet efikase të parandalimit bazohen tek prindërit dhe u mësojnë atyre aftësi pozitive të prindërimit.
- Kujdesi i vazhdueshëm i fëmijëve dhe i familjeve mund të reduktojë rrezikun e keqtrajtimit të përsëritur dhe mund të minimizojë pasojat e tij (WHO (2014) Fact sheet N° 150).²⁸⁶

Ndërhyrjet për parandalimin e keqtrajtimit të fëmijës, zakonisht, klasifikohen në tri nivele: a) parandalimin parësor (shërbimet universale me fokus gjithë popullsinë), b) parandalimin dytësor (shërbimet me target familjet me faktor rreziku, të identifikuar si familje që kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme), c) parandalimin terciar (tretësor) (shërbime të specializuara të ofruara, sapo është zbuluar keqtrajtimi i fëmijës dhe që synojnë parandalimin e riviktimizimit).²⁸⁷

BIBLIOGRAFIA:

1. American Psychiatric Association (2013): Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders Fifth Edition, Arlington, USA.
2. American Academy of Child and Adolescent Psychiatry (2011): Facts for Families, Child Sexual Abuse, Washington.
3. Ammerman R.T., Hersen M., Thoma J.C. (2006): Comprehensive Handbook of Personality and Psychopathology, Volume 3, Child Psychopathology, John Wiley & Sons, Inc., Hoboken, New Jersey, f. 369.
4. Child Welfare Information Gateway (January 2013), Bulletin for Professionals.
5. Encyclopedia on Early Childhood Development (2012), Maltreatment (Child) Synthesis.
6. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
7. Ligji Nr.10 347, datë 4.11.2010, Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

²⁸⁵ <http://www.athealth.com/Consumer/issues/FAQAbuse.html>

²⁸⁶ <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs150/en/index.html>

²⁸⁷ WHO Europe (2007) "Preventing child maltreatment in Europe: a public health approach – Policy briefing, WHO Regional Office for Europe, Denmark, f. 7.

8. Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006, Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare.
9. Ligji mbi shëndetin publik (Nr.10 138, dt. 11.5.2009).
10. Skuse D., Bruce H., Dowdney L., Mrazek D. (2011): Child Psychology and Psychiatry, John Wiley & Sons, Ltd., Publication, USA.
11. Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale 2007-2013 (Tiranë, 2007).
12. Strategjia Kombëtare për Fëmijët (Tiranë, 2001).
13. Zimmerman F., Mercy J.A. (2010): A Better Start- Child Maltreatment Prevention as a Public Health Priority, The Doris Duke Charitable Foundation & Centers for Disease Control and Prevention
14. WHO Europe (2007): "Preventing child maltreatment in Europe: a public health approach – Policy briefing, WHO Regional Office for Europe, Denmark.
15. WHO (2014) Fact sheet N°150
16. <http://www.apa.org/pubs/info/brochures/sex-abuse.aspx>
17. <http://www.athealth.com/Consumer/issues/FAQAbuse.html>
18. http://www.who.int/topics/mental_health/en/
19. <http://www.cdc.gov/Features/HealthyChildren/>
20. <https://www.childwelfare.gov/can/impact/longterm/health.cfm>
21. <http://www.healthyplace.com/abuse/child-psychological-abuse/what-is-psychological-abuse-of-a-child/>
22. <http://www.medterms.com/script/main/art.asp?articlekey=8360>
23. <http://www.nlm.nih.gov/medlineplus/childsexualabuse.html>
24. <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs150/en/index.html>

**“PAGA IME”, BANKA KOMBËTARE TREGTARE DHE
KONKURRENCA NË SISTEMIN BANKAR
NË SHQIPËRI**

Ardita Boriçi, Albiona Hoxha

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Administrim-Biznesit,
Banka Kombëtare Tregtare, Shqipëri*

**"My salary", National Commercial Bank and the competition in the
banking system in Albania**

ABSTRACT

The study examines methods of assessing the effectiveness of the package “My salary” in the banking market of Albania. One of the priorities of the National Commercial Bank (NCB) is the service to individuals and NCB has focused its work on providing a full range of products to meet their needs.

Faced with banking market liberalization and the possibility of public sector employees choosing their preferred bank, National Commercial Bank offers the package “My salary”. This has also been done by other banks, but with marked changes compared to what NCB offers.

“My salary” package is the most competitive package in the market and includes the most used banking products for individuals, with preferential conditions. This package has some advantages and benefits not only for the management of the salary but also for the benefit of other banking products with preferential commissions.

Hyrje

Termi “bankë” e ka zanafillën e vet që në shekullin XII (në veri të Italisë, në Lombardi), ku shkruheshin dhe jepeshin disa fletë, të cilat

shërbenin si dëshmi për huatë e dhëna (borxhet) huamarrësve, ose më saktë për huatë në formë biznesi, ndërmjet tregtarëve dhe blerësve, ku këto fletë luanin rolin e obligacioneve.

Dy produktet më të rëndësishme të paketës “Paga ime”, janë: e-banking dhe karta e kreditit. Michael Karlin (kryetar dhe shef operacioni i bankës së parë virtuale në botë), është i mendimit se, nuk është e nevojshme që të kemi software, për të ruajtur të dhënat në kompjuterin tonë, pasi tani me e-banking, të gjitha transaksionet ndodhin në server bankar mbi infrastrukturën e internetit.

Karta e kreditit është një metodë e shitjes së mallrave dhe e shërbimeve pa pasur nevojë që shitësi të ketë lekë fizikisht. Një kartë krediti është e vetmja mënyrë automatike për t’i ofruar kredit një klienti. Sot, çdo kartë krediti, mban një numër identifikues, i cili përdoret në transaksionet e blerjes. Numri i transaksioneve bankare me kartat po rritet gjithnjë e më shumë, gjithashtu edhe siguria që ofrojnë bankat. Megjithatë rreziku ekziston ende.

Etapat e zhvillimit të sistemit bankar në Shqipëri nisën që në vitin 1924 e deri në ditët sotme, ku rolin kryesor e luajnë bankat e nivelit të dytë, të cilat janë marrë në studim. Këto banka janë: Banka Kombëtare Tregate, Raiffeisen Bank, Tirana Bank, Intesa SanPaolo Bank, Procredit dhe Credins Bank, ku për secilën është bërë prezantimi i paketës “Paga ime”, si dhe përshkrimi i produkteve të saj me të gjitha karakteristikat përkatëse. Gjithashtu me interes paraqitet edhe analiza krahasuese e kësaj pakete mes bankave të marra në studim, si dhe për secilën, avantazhet dhe disavantazhet e veta.

Bankat dhe zanafilla e tyre

Për origjinën e termit “bankë”, historianët kanë shprehur mendime të ndryshme. Mendimi, ose opinioni i parë për prejardhjen e fjalës bankë, shprehur nga studiuesi Rajmond P. Kent,²⁸⁸ është se ajo rrjedh nga fjala italisht “banco”. Këtë ai e lidh me faktin se hebrejtë, të cilët merreshin me shkëmbimin e monedhave, jetonin në Lombardi, që njihej si vendi prej nga e ka origjinën praktika e shkëmbimit të monedhave nga tregtarët hebrej. Në këtë rajon verior të Italisë, ata blinin, shitnin dhe shkëmbenin ar e argjend me peshë. Këtë biznes ata e zhvillonin mbi një tavolinë, në qiell të hapur drejtpërsëdrejt në sheshin e tregut. Në italisht kjo tavolinë quhet

²⁸⁸ Orhan Zarshati, *Historiku i Bankës Kombëtare Tregtare*, f. 12.

“banco”, siç quhet dhe sot. Sipas studiuesit Rajmond P. Kent, me kalimin e kohës, fjala “banco” evoluoi në fjalën “banka”.

Studiuesi R. W Jones,²⁸⁹ sqaron se, fjala “banka” rrjedh, sepse këto obligacione u njohën me emrin “banchi”.

Dy nga inovacionet më të reja dhe më të rëndësishme për klientët (që ia vlen të përmendim), janë *shërbimi e-banking* dhe *karta e kreditit*, si dy komponente më thelbësore të paketës “*Paga ime*”.

Internet banking forma më e re e kryerjes së transaksioneve online

E-banking është një nga shërbimet në distancë, e ofruar nëpërmjet kanaleve elektronike të shpërndarjes dhe të komunikimit, të produkteve dhe të shërbimeve tradicionale më të reja bankare. Megjithatë, sipas (Daniel, 1999),²⁹⁰ duhet theksuar se *internet banking*, të paktën në fazën aktuale, nuk tenton të zëvendësojë kanalet tradicionale të shpërndarjes së produkteve bankare. Ai qëndron bashkë me një tërësi kanalesh, që shkojnë nga ato tradicionale (si sportelet e filialeve) tek ato automatike (si ATM , Pos), në kuadrin e plotësimit dhe të përfundimit të raportit klient – bankë, për të realizuar të ashtuquajturën strategji shumëkanalëshe.

Sipas Michael Karlin²⁹¹ (kryetar dhe shef operacioni i bankës së parë virtuale në botë), nuk është e nevojshme, që të kemi software, për të ruajtur të dhënat në kompjuterin tonë, pasi tani me e-banking të gjitha transaksionet ndodhin në server bankare mbi infrastrukturën e internetit. Gjithashtu, sipas Karlin, klientët do të jenë në gjendje për të kryer shërbimet bankare kudo që atyre iu pëlqen, por mjafton që të kenë kompjuter dhe një modem, s’ka rëndësi se ku ata ndodhen (p.sh., në shtëpi, në zyrë, apo në një vend jashtë vendit). Por, e rëndësishme është se mund të përdoren shërbimet bankare 24 orë në ditë, 7 ditë në javë dhe 365 ditë në vit, pa pasur nevojën e plotësimit të një deklaratë bankare.

Etapat e zhvillimit të veprimtarisë bankare në Shqipëri, nga shpallja e Pavarësisë deri në ditët tona

Në historikun e bankës përfshihet veprimtaria bankare dhe e sistemit monetar, si dhe kreditit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë (1925 -

²⁸⁹ Orhan Zarshati, *Historiku i Bankës Kombëtare Tregtare*, f. 12.

²⁹⁰ Daniel , E. (1999): “Provision of electronic banking in the UK and the Republic of Ireland”.

²⁹¹ International Journal of Bank Marketing., Vol. 17, No.2, pp 72-82.

1944), kalimit në Bankën e Shtetit (1944 - 1992) për të arritur së fundmi në vitin 1992, kur u bë konstituimi i Bankës së Shqipërisë, si Bankë qendrore e shtetit shqiptar. Pas këtij akti sinjifikativ, ndodhi kompozimi i rrjetit të bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, ku përfshihet dhe Banka Kombëtare Tregtare, që u krijua me 1 janar 1993.

Për hërë të parë, në vitin 1993, shqiptarët patën një institucion të Bankës Qendrore. Ky institucion qendror bankar, u krijua si rezultat i marrëveshjes së Qeverisë të Ismail Qemalit me Karol Pitner dhe Oskar Pollak, përfaqësues të Wiener Bank Verein dhe me Pietro Fenoglio e Guido Ansbacher, përfaqësues të Banca Commerciale Italiana (Banka Tregtare Italiane), të cilët vepronin në emër të grupit bankar austro-hungarez dhe të grupit bankar italian, që kishin ardhur për bisedime. Në vitin 1925, banka e rifilloi veprimtarinë me emrin Banka Kombëtare e Shqipërisë, me qendër administrative në Durrës, por me komitetin administrativ në Romë. Ringritja e bankës u arrit me marrëveshjen e nënshkruar nga Mufid Libohova, në emër të qeverisë shqiptare dhe nga Mario Alberti, në emër të grupit financiar italian.

Sot në Shqipëri në sistemin bankar operojnë rreth 17 banka të nivelit të dytë, por në studim janë marrë gjashtë prej tyre, si bankat më konkurruese në treg dhe ato janë: Banka Kombëtare Tregtare, Raiffeisen Bank, Credins Bank, ProCredit Bank, Tirana Bank, Intesa SanPaolo Bank.

Hipoteza, objektivat, të dhënat

Hipoteza: Vlerësimi në treg i produkteve të paketës “Paga ime” mes BKT-së dhe bankave të tjera që operojnë në Shqipëri.

Objektivat:

- Të paraqesë elementet përkatëse të paketës “Paga ime” në treg.
- Të paraqesë shpërndarjen në treg të këtij produkti.
- Të provojë se matja e efektivitetit të paketës “Paga ime” ndikon në performancën e saj në treg, përballë konkurrentëve.
- Të japë rekomandime për përmirësimin e efikasitetit të paketës në treg.

Të dhënat e studimit janë të rëndësishme dhe bazohen në të dhëna parësore dhe dytësore. Të dhënat parësore janë marrë në mënyrë individuale nga kontaktet personale që kemi pasur me punonjës të bankave të marra në shqyrtim, ndërsa ato dytësore, bazohen tek literatura në fushën bankare.

Paketa “Paga ime” dhe karakteristikat e produkteve të saj

Paketa “Paga ime” është një paketë që ofrohet nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, por secila me avantazhet dhe disavantazhet e veta.

Sipas shkrimtares së njohur angleze Jane Austen ²⁹²: “*Një pagë e mirë është receta më e mirë për lumtuninë që kam dëgjuar ndonjëherë*”.

Ndërsa Robert Orben²⁹³ (shkrimtar i famshëm amerikan i komedive), citonte se “*Çdo ditë ngrihem dhe shikoj listën e “Forbes” për njerëzit më të pasur në Amerikë. Nëse nuk jam atje, shkoj në punë*”.

Paga është sasia e të hollave, dhënë si kompensim i punës së bërë, që zakonisht paguhet për muaj. Përndryshe paga merret edhe si të ardhurat mujore të nëpunësve dhe të punësuarve të tjerë, që për bazë nuk i kanë orët e punës, por paguhen sipas marrëveshjes në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit. Me dt. 07.04.2010, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë një VKM, i cili i dha të drejtën punonjësve buxhetorë dhe punonjësve të kompanive shtetërore, që të zgjedhin vetë bankën ku do të marrin pagën. BKT në kuadër të marrëdhënies për kalimin e pagave të punonjësve të institucionit, ishte e gatshme t’u ofronte klientëve të saj një paketë kushtesh preferenciale për shërbimet bankare.

Paketa “Paga ime” përmban:

1. Llogarinë pa komisionin e mirëmbajtjes
2. Karten e kreditit dhe kartën e debitit
3. Overdraft
4. Pagesën periodike dhe debitimet direkte
5. E-banking
6. Super kredi
7. Kredinë për shtëpi

²⁹² <http://www.shqiperia.com/lajme/lajm/nr/14758/100-shprehje-filozofike-per-parate-nga-politikane-filozofe-aktore-e-milionere>

²⁹³ <http://www.shqiperia.com/lajme/lajm/nr/14758/100-shprehje-filozofike-per-parate-nga-politikane-filozofe-aktore-e-milionere>

Analiza krahasuese e paketës “Paga ime” mes BKT-së dhe konkurrentëve të saj dhe analiza SWOT me fuqitë, dobësitë dhe të përbashkëtat.

BKT - FUQITE		INTESA SAN PAOLO- DOBESITE	
-Mirembajtje llogarie	pa komision	-Mirembajtje llogarie	150 ALL
-Interes mbi gjendjen e llogarise	0.1%	-Balance minimale	1000All
-Balance minimale	0	-Overdraft	22.2%
-Overdraft	16.74%(shteteror) 18.74%(privat)	-Kredi per shtepi	T-Bill+ 2%
-Kredi per shtepi	Bono Thesari + 1.5%	-Kredi kons pa kolateral	s'ka
-Super Kredi	17.1%-19.19%	-Internet Banking	1 € ne muaj
	1-4 vjet maturim		5 € per trans.
-Internet Banking	Pa komision	-Debitim Automatik	1 € cdo fature
-Debitim Direkt	Pa komision	-Komision mosdebitim direkte	2 €
-Pagese periodike	Pa komision	-Rinovim automatik depozite	50ALL
-Rinovim automatik depozite	Pa komision		

TE PERBASHKETA

Hapje Llogarie - **pa komision**

Transaksionet POS brenda vendit - **pa komision**

Transaksionet POS jashte vendit - **pa komision**

BKT - FUQITE

-Mirembajtje e llogarise	pa komision
-Interes mbi gjendjen e llogarise	0.1%
-Overdraft	16.74% (sht.)
-Kredi per shtepi	9.23%
-Transaksionet POS jashte vendit	pa komision
-Internet Banking	pa komision

Raiffeisen- DOBESITE

-Komision Pakte	125 ALL
-Overdraft	18.33%
-Kredi per shtepi	9.73%
-Transaksione POS jashte vendit	1.5%
-Internet Banking	500ALL Regjistrim
	300 ALL mujor

TE PERBASHKETA

Hapje e llogarise- **pa komision**

Mbyllje llogarise - **pa komision**

Ov + CC = **3 paga**

Transaksione ne POS brenda vendit - **pa komision**

Debitim direkt - **pa komision**

Pagese periodike - **pa komisione**

Raiffeisen- FUQITE

-Karte Krediti	pa komision
-Kredi pa kolateral	deri 1.000.000./ 7 vjet
	17.83%

BKT - DOBESITE

-Karte Krediti	pa komision viti 1
	1500 te tjeret
-Super Loan	deri 500.000/ 4vjet
	17.1-19.19%

BKT - FUQITE		CREDINS-DOBESITE	
-Mbyllje llogarie	pa komision	-Mbyllje llogarie	15 €
-Balance Minimale	0	-Balance Minimale	1000 ALL
-Interes mbi gjendjen e llogarise	0.1%	-Overdraft	18%
-Overdraft	16.42% shteteror	-Karte Krediti	1200 komision antarsimi 2.880ALL komision vjetor
-Karte Krediti	pa komision viti 1 1500 vitet e tjera	-Kredi per shtepi	Bono Thesari + 2.9%
-Kredi per shtepi	Bono Th + 1.5%	-Kredi pa kolateral	s'ka
-Super kredi	1-5 vjet maturim 17.1-19.19%	-Internet Banking	135 € regjistrim 3€ mirembajtje (mujore) 0.3 € per transakcion
-Internet Banking	pa komision	-Transaksionet POS jashte vendit	2%
-Transaksionet POS jashte vendit	pa komision	-Terheqje ne ATM	deri ne 3 terheqje ne muaj pastaj 30 ALL transakcioni
-Terheqje ne ATM	pa limit	-Debitim Direkt	s'ka
-Debitim Direkt	pa komision		

TE PERBASHKETA	
Hapje e llogarise dhe mirembajtje- Pa komision	
Overdraft + CC - 3 paga	
Transaksione ne POS brenda vendit - pa komision	

CREDINS- FUQITE	BKT - DOBESITE
------------------------	-----------------------

BKT - FUQITE

-Mirembajtje llogarie	pa komision
-Interes mbi gjendjen e llogarise	0.1%
-Overdraft	16.74% (shteteror) 18.74% (privat)
-Karte Krediti	pa komision vitit pare 1500 te tjeret
-Kredi per shtepi	Bono thesari+ 1.5%
-Super Loan	17.1-19.19% 1-5vjet
-Transaksione POS jashte vendit	pa komision
-I-banking	pa komision
-Pagesa fature	pa komision

ProCredit- DOBESITE

-Mirembajtje llogarie	100ALL
-Overdraft	19-20%
-Karte Krediti	2000ALL
-Kredi per shtepi	T.Bill+ 3-5%
-Kredi pa kolateral	20-22% deri 3 vjet
-Transaksione POS jashte vendit	0.5%
-I-banking	2500ALL regjistrim 250 ALL per 3 muaj (kosto mirembajtje)
-Pagesa Utilitare	100ALL cdo veprim

TE PERBASHKETA

Hapje Llogarie- **pa komision**

Overdraft + CC = **3 paga**

Transaksion ne POS brenda vendit - **pa komision**

BKT - FUQITE

-Mirembajte llogarise	pa komision
-Interes mbi gjendjen e llogarise	0.1%
-Karte Krediti	pa komision viti 1 1500 vitet e tjere
-Kredi per shtepi	Bono Thesari + 1.5%
-Super Kredi	17.1-19.19% 1-4 vjet
-Transaksione POS jashte vendit	pa komision
-Internet Banking	pa komision

TIRANA BANK - DOBESITE

-Mirembajte e llogarise	90ALL
-Karte Krediti	1500 komision vjetor
-Kredi per shtepi	Bono Thesari+ 3%
-Kredi Kons. pa kolateral s'ka	
-Transaksione POS jashte vendit	1% (min 200ALL)
-Internet Banking	800 ALL Regjistrim 3-5 € muaj mirembajtje

TE PERBASHKETA

Hapje e llogarise - **pa komision**

Mbyllje e llogarise - **pa komision**

Overdraft + CC = **3 paga**

Transaksione ne POS brenda vendit - **pa komision**

Debitim Direkt - **pa komision**

KONKLUSIONE:

- ✓ Bkt-ja ofron paketën “Paga ime ” me një larmi produktesh.
- ✓ Bkt-ja nuk mban komisione për hapjen dhe mbylljen e llogarisë.
- ✓ Shtimin në 0.1% të interesit mbi gjendjen e llogarisë.
- ✓ Nuk kërkon balancë minimale për llogarinë.
- ✓ Overdraft me normë interesi më të ulët se e gjithë konkurrenca.
- ✓ Ofrimin e produktit të kartës së kreditit pa komision për vitin e parë, pastaj me 1500 lekë për vitet e tjera.
- ✓ Kartat e kreditit kanë shërbimin Prima Këste, që nuk ofrohet nga konkurrentët e saj.
- ✓ Kartat e debitit janë dy llojesh: Visa Electron dhe Maestro.
- ✓ Ofrimin e shërbimit online Internet Banking pa komision, për regjistrimin, mirëmbajtjen dhe kryerjen e transaksioneve.
- ✓ Ofrimin e kryerjeve të transaksioneve në POS, brenda dhe jashtë vendit pa komisione.
- ✓ Ofrimin e produkteve të tjera të paketës, si debitimin direkt, pagesën utilitare dhe ato periodike pa komisione.
- ✓ Së fundmi kredinë për shtëpinë e ka me normën më të ulët të interesit B.TH+ 1.5%.

REKOMANDIME:

- ✓ Duhet të bëjë më tepër fushata për paketën “Paga ime”.
- ✓ Duhet të ofrojë kartën e kreditit me një komision vjetor më të ulët, se aktualisht e mban 1500 lekë.
- ✓ Duhet të ofrojë superkredinë me kushte më favorizuese në normën e interesit, afatin e kredise dhe shumën maksimale që mund të jepet.
- ✓ Duhet të shtojë ndonjë produkt të ri që t’i paraprijë konkurrentëve p.sh., depozita me normë preferenciale për pagamarrësit

REFERENCA:

Orhan zarshati, Historiku i Bankës Kombëtare Tregtare, Tiranë, 2011.

<http://www.pattichiari.it/home/saperne-di-piu/risorse/tutti-gli-argomenti/speciale-migranti/shqip/qytetaret/qytetaret13.dot>

<http://www.lirenti.com/content/247-4-gjerat-qe-duhet-te-dini-mbi-Kartat-e-Kreditit>

Daniel , E (1999). "Provision of electronic banking in the UK and the Republic of Ireland".

International Journal of Bank Marketing., Vol. 17, No.2 pp 72-82.

<http://www.shqiperia.com/lajme/lajm/nr/14758/100-shprehje-filozofike-per-parate-nga-politikane-filozofe-aktore-e-milionere>

http://inventors.about.com/od/cstartinventions/a/credit_cards.htm

<http://inventors.about.com/gi/o.htm?zi=1/XJ&zTi=1&sdn=inventors&cdn=money&tm=116&f=00&tt=2&bt=8&bts=8&zu=http%3A//money.hoestuffeorks.com/credit-card2.htm>

<http://www.monitor.al/kartat-bankat-rrisin-sigurine-ndaj-vigjilences-se-mashtruesve-2/>

[http:// www.bankofalbania.org/](http://www.bankofalbania.org/)

[http:// www.bkt.com.al/bktMain.aspx](http://www.bkt.com.al/bktMain.aspx)

[http:// www.raiffeisen.al/](http://www.raiffeisen.al/)

[http:// www .procreditbank.com.al/](http://www.procreditbank.com.al/)

[http:// www.tiranabank.al/](http://www.tiranabank.al/)

[http:// www.bankacredins.com/](http://www.bankacredins.com/)

[http:// www.intesasanpaolobank.al/](http://www.intesasanpaolobank.al/)

EKSPOZIMI EKONOMIK NDAJ KURSEVE TË KËMBIMIT DHE MBROJTJA NDAJ TIJ

Kleida Tufi (Heta), Sonila Kruja

*Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi“, departamenti i Financë- Kontabilitetit,
BKT- dega Koplík*

Economic exchange rate exposure and its hedging

ABSTRACT

Exchange rate risk is one of the most concerning risks that multinationals, institutional investors, domestic firms and even individuals face. Recently the variability of these exchange rates has increased, thus hedging this risk is important.

Firms operating in Albania find it necessary hedging exchange rate risk, which has a big effect at their income. This risk affects not only firms engaged in international transactions, but also firms operating only domestically. Firms in Albania face exchange rate risk to a large extent because of the relationships that Albania has with neighbor countries and further.

Hedging this risk in Albania is difficult because, a developing country like ours, currency derivative market does not exist. The nonfunctioning of the Tirana Stock Exchange, the lack of forward contract from the commercial banks, and lack of financial knowledge among business representatives, are some of the main obstacles for hedging this risk.

This study focuses in measuring to what extent Albanian business faces exchange rate risk and ways they use to hedge it. We have considered a case study from a firm operating in the fasson industry. After analyzing the data from the financial statements we will see the types of exchange rate risk this firm faces and the way it hedges. One of the main findings is that the firm does not face economic and translation exchange rate risk and it does not hedge financially. On the other hand it faces transaction exchange rate risk and it tries to hedge operationally.

Keywords: Risk, Exchange Rate, Economic Exposure, Protection

I. Hyrje

Risku i kursit të këmbimit është një nga risqet më shqetësuese të kompanive që kryejnë aktivitetet ndërkombëtar. Në ditët e sotme në mjedisin ekonomik, ku kompanitë ndërkombëtare dhe të tregtisë ndërkombëtare, kanë zgjeruar si kurrë më parë aktivitetin e tyre, ky risk kërcënon të ardhurat e firmës dhe vlerat e saj. Institucionet financiare kanë krijuar instrumente të ndryshme mbrojtëse për riskun e kursit të këmbimit, dhe firmat kanë alternativa të ndryshme për të mbrojtur sipas llojit të ekspozimit që ato përballen. Por edhe vetë firmat duhet të ndjekin disa strategji, për të mbrojtur këtë risk. Mundësitë për monedhat që tregtohen në tregjet e aksioneve janë të mëdha, por çfarë ndodh me monedha të vogla për të cilat nuk ka zgjidhje, nuk kanë opsione, kontrata të ardhshme? Në këtë studim do të shqyrtojmë disa lloje të ekspozimit të kursit të këmbimit dhe teknikat mbrojtëse. Gjithashtu do të paraqesim mbrojtjen e monedhave të vogla dhe do të ilustrojmë deri në çfarë mase firmat në Shqipëri janë të ekspozuara dhe çfarë bëjnë këto firma për të mbrojtur këtë risk.

Në Shkodër biznesi fason është shumë i zhvilluar, por megjithë ekspozimin e madh ndaj riskut të kursit të këmbimit, bizneset fason e pranojnë këtë risk. Cila është arsyeja? Leku është një monedhë e vogël dhe nuk tregtohet në bursë, bursa e Tiranës nuk funksionon, bankat e nivelit të dytë nuk e ofrojnë kontratën e mbrojtjes për firmat, të cilat janë të ekspozuara ndaj këtij risku. Edhe pse ky risk mund të ndikojë shumë në vlerën e firmës, biznesi fason inkurajohet nga paketa fiskale të ndryshme për nxitje të prodhimit si nxitës i punësimit në vendin tonë. Qëllimi i këtij punimi është të studiojë ekspozimin e bizneseve fason ndaj riskut të kursit të këmbimit dhe mbrojtjen ndaj tij.

Objektivat e punimit janë të evidentojë riskun e kurseve të këmbimit dhe rëndësinë e menaxhimit të tij, të evidentojë nëpërmjet analizës së regresionit nëse biznesi fason i marrë në konsideratë është i ekspozuar ndaj normave të këmbimit, si dhe interpretimi i rezultateve dhe nxjerrja e disa konkluzioneve në lidhje me këtë çështje.

Hipoteza e hedhur, e cila do të vërtetohet nëpërmjet analizës së regresionit, është nëse biznesi fason përballlet me ekspozimin ekonomik ndaj kurseve të këmbimit. Pra, a ndryshon vlera e firmës si rezultat i ndryshimit të kurseve të këmbimit.

Për të realizuar këtë studim jemi bazuar në kërkime parësore dhe dytësore. Burimi parësor në këtë punim shkencor, janë të dhënat e marra në drejtorinë e Doganës Shkodër, në lidhje me hyrjet dhe daljet e eksporteve dhe importeve në qytetin e Shkodrës, si dhe analizimin e të dhënave financiare në biznesin fason më të rëndësishëm në qytetin e Shkodrës, siç

është Calzaturificio Adelchi Sh.p.k. Për të vërtetuar hipotezën e punimit, kemi analizuar shitjet në periudha 3 mujore për 4 vitet e fundit për këtë biznes fason. Ndërsa, në lidhje me të dhënat dytësore, i kemi referuar librave dhe botimeve të ndryshme shqiptare dhe të huaja.

II. Shqyrtimi i literaturës

Studimi i investimeve ka treguar që jo të gjitha investimet sigurojnë kthim. Në varësi nga investimi dhe risku që përcjell këtë investim, varet edhe kthimi apo vëllimi i kthimit të investimit. Investitorët gjithnjë e kanë parasysh këtë lidhje, dhe jo të gjithë investitorët janë “investitorë riskant”. Nuk mund të themi që risku është negativ apo i keq. Për këtë duhet të kuptohet risku dhe si ndikon ai në investime dhe në kthimin e tyre, çdo investitor duhet të ndërmarrë masa që të parandalojnë dhe të trajtojnë në forma të ndryshme paraqitjen e riskut.

Njëra nga sfidat më themelore është menaxhimi i riskut në ndërmarrje. Në vendin tonë për shkak të panjohurive rreth riskut, si në aspektin negativ dhe atë pozitiv, shumë ndërmarrje hezitojnë që të kryejnë shumë investime fitimprurëse, njëkohësisht anashkalohen komponentët apo treguesit e riskut. Vlerësimi i riskut është përcaktimi i vlerës sasiore ose cilësore të riskut në lidhje me një situatë konkrete dhe një kërcënim të njohur i quajtur risk. Vlerësimi i riskut bëhet duke llogaritur vlerën sasiore të dy komponentëve të riskut, që janë madhësia e humbjeve të mundshme, dhe probabiliteti se humbja do të ndodhë. Vlerësimi i riskut konsiston në një vlerësim objektiv të riskut, në të cilën supozimet dhe pasiguritë janë konsideruar në mënyrë të qartë dhe të paraqitur.

Një pjesë e vështirësisë së menaxhimit të riskut është matja e dy sasive në të cilat ka të bëjë vlerësimi i riskut, humbja e mundshme dhe probabiliteti i ndodhjes. Mundësinë e gabimit në matjen e këtyre dy koncepteve është i madh. Një risk me një humbje të madhe të mundshme dhe një probabilitet të ulët që të ndodhë shpesh kjo humbje, është trajtuar ndryshe nga një risk me një humbje të ulët të mundshme dhe me mundësi të lartë që të ndodhë. Në teori, të dyja kanë prioritet gati të barabartë në trajtimin e parë, por në praktikë kjo mund të jetë shumë e vështirë për t'u menaxhuar kur të përballemi me mungesën e burimeve, veçanërisht kohës. Risku nuk është i keq, pasiguria përfshin edhe riskun dhe oportunitetin, pra mund të rezultojë në fitim apo humbje. Menaxhimi i riskut i mundëson drejtorëve që të zgjedhin problemet e pasigurive, risqeve dhe oportuniteteve përkatëse në mënyrë efektive. Ai rrit mundësitë për të shtuar vlerë. Çështja e menaxhimit të riskut është që të mos e eliminosh atë.

Kjo do ta eliminonte mundësinë e fitimit (Pra duhet të kesh parasysh humbjen e mundshme dhe probabilitetin e ndodhjes).

Risku fokusohet në dy dimensione: (1) Probabiliteti - risku ka të bëjë me ngjarje të pasigurt dmth., me gjasë, dhe (2) Impakti - risku lidhet me objektivat, dmth, mund të pengojë arritjen e objektivave duke krijuar konsekuenca. Risku ndahet në tri kategori kryesore (1) Risku financiar, (2) Risku operacional, (3) Risku strategjik.

Risku financiar ka një efekt direkt në humbjet financiare të organizatës. Kurse risku jofinanciar ka një efekt më të vonshëm, por sidoqoftë në terma afatgjatë ato ndikojnë në fitimin e organizatës p.sh., reputacioni i keq, dobësitë e kontrollit të brendshëm, menaxhimi i dobët i burimeve njerëzore etj., nuk janë rreziqe financiare, por në afatgjatë ato do të ndikojnë në fitimin e organizatës. Risku financiar, ku dhe fokusohet punimi ynë, përbëhet nga (a) risku kreditor, (b) risku i likuiditetit, (c) risku i normës së interesit, (d) risku i normës së këmbimit.

Risku i kursit të këmbimit mund të përkufizohet gjerësisht si risku që performanca e kompanisë do të ndikohet nga lëvizjet e kursit të këmbimit, Madura (2008)²⁹⁴. Në veçanti, ajo është përcaktuar si humbje e mundshme e drejtpërdrejtë (si rezultat i ekspozimit pambrojtur) ose humbje indirekte në flukset monetare të firmës, aktivet dhe detyrimet, fitimin neto, dhe në kthimin e aksioneve të gjitha nga lëvizjet e kursit të këmbimit (Papaioannou, 2006)²⁹⁵.

Menaxherët financiarë duhet të kuptojnë dhe të përcaktojnë llojin e ekspozimit të këmbimit që firma po përballet, strategjinë e mbrojtjes që do të përdoret dhe instrumentet në dispozicion të mbrojtjes. Sipas Adler dhe Dumas (1984)²⁹⁶, ekspozimi ndaj rrezikut të monedhës është që të identifikohet me matësa statistikore, të cilët përmbledhin mundësinë që forca aktuale e brendshme blerëse e një valute të huaj në një datë të caktuar në të ardhmen, do të ndryshojë nga vlera e saj e parashikuar fillimisht. Në këtë mënyrë, menaxherët duhet të dinë se si ta masin atë.

Shapiro (1996)²⁹⁷, Eun & Resnick (2004)²⁹⁸, Madura (2008)²⁹⁹, identifikojnë tri lloje kryesore të ekspozimit të kursit të këmbimit:

²⁹⁴ Madura, J., (2008). *International financial management*, 9th ed. (pp. 280-306). Mason, OH: Thomson South-Western.

²⁹⁵ Papaioannou, M. (2006). Exchange rate risk measurement and management: Issues and approaches for firms. *South-Eastern Europe Journal of Economics* 2, pp 129-146.

²⁹⁶ Adler, M., Dumas, B. (1984). Exposure to currency risk: definition and measurement. *Financial Management, Summer*, pp 41-50.

²⁹⁷ Shapiro, A. C. (1996). *Multinational Financial Management*, 5th ed. Hoboken, New Jersey: Wiley.

Ekspozimi ekonomik: Ky lloj ekspozimi mat ndryshimin në vlerën prezente të rrjedhjeve operative të ardhshme të parave të një firme që rezulton nga ndryshimet në normën e këmbimit. Ndryshimi në vlerën prezente varet nga efekti i ndryshimit të normës së këmbimit tek vëllimet e ardhshme të shitjeve, çmimet, apo kostot e ardhshme.

Ekspozimi në transaksion përcaktohet si ndjeshmëri e flukseve kontraktuale të firmës në para të vlerës së monedhës vendase ndaj valutës së huaj, që mund të jetë pjesë e ndryshimeve të papritura të kursit të këmbimit.

Ekspozimi në përkthim i referohet potencialit që pasqyrat financiare të konsoliduara të filialeve të MNE-ve, mund të ndikohen nga ndryshimet në kurset e këmbimit. Ky ekspozim quhet ndryshe edhe si ekspozim në kontabiletet. Në rastin e një MNE-je, aksionerët e firmave janë të interesuar të vlerësojnë pasqyrat financiare të konsoliduara të MNE-së, në mënyrë që të dinë të shesin apo të mbajnë aksionet e tyre.

Kur firmat janë të prekura nga ekspozimi i kursit të këmbimit, ato duhet të përcaktojnë se çfarë lloj ekspozimi është. Ato duhet ta vlerësojnë atë dhe pastaj të vendosin nëse duan apo jo ta izolojnë (ekspozimin) dhe të mbrohen ndaj tij. Ekspozimi ekonomik mund të matet duke përdorur (1) analizën e ndjeshmërisë dhe (2) duke përdorur një analizë të regresionit (Madura, 2008). Metoda e parë konsiston duke konsideruar veçmas, si shitjet dhe shpenzimet, janë të prekura nga skenarë të ndryshëm në kursin e këmbimit. I dyti konsiston në drejtimin e një analize regresioni të flukseve historike të parave, me të dhënat e kursit të këmbimit.

Për të parë ekspozimin në transaksion, firma ka nevojë (1) të bëjë parashikimin e fluksit të saj monetar neto në çdo monedhë dhe (2) të masë ndikimin e mundshëm të ekspozimit të monedhës. Vlera në rrezik (Value at risk) është një metodë e njohur për të vlerësuar ekspozimin e transaksionit.

Sipas Khazeh dhe Salimian³⁰⁰ (2012), metoda Value at risk (VAR), është teknika më e përdorur për vlerësimin e ekspozimit të transaksionit. Metodologjia VAR, mund të vlerësojë humbjen maksimale të ngjarë në vlerën e flukseve neto të MNC të mjeteve monetare, të shprehura në një ose më shumë monedha të huaja për një periudhë të caktuar kohore. Periudhat

²⁹⁸ Eun, Resnick.(2004). International financial management, 4th ed., (pp. 282-348). New York, NY: The McGraw-Hill Companies.

²⁹⁹ Madura, J., (2008). International financial management, 9th ed. (pp. 280-306). Mason, OH: Thomson South-Western.

³⁰⁰ Khazeh, K., Winder, R. C., Salimian, F. (2012). Value at Risk and Transaction Exposure: Lexicographic Permutation of a Six-Currency Portfolio. *The Journal of Current Research in Global Business*, Vol. 15, No. 24; Fall: 20-31.

kohore të dëshiruara mund të ndryshojnë nga nj periudhe fare e shkurtër si 1 ditë për aq kohë si 1 jave, 1 muaj ose edhe më gjatë. Vlerësimet e humbjes maksimale pastaj mund të përdoret për të vlerësuar nëse mbrojtja është e dëshirueshme.

Holton³⁰¹ (2003), thotë se llogaritja VAR varet nga 3 parametra: (a) periudhës së mbajtjes, p.sh., gjatësia e kohës për të cilën pozicioni valutor është planifikuar të mbahet. Periudha tipike e mbajtjes është 1 ditë. (b) niveli i besimit në të cilën vlerësimi është planifikuar të bëhet. Nivelet e zakonshme të besimit janë 99% apo 95%, dhe (c) njësia e monedhës që do të përdoret për emërtimin e VAR.

Kjo metodë ka disa kufizime. Sipas Maduras (2008), metoda VAR, supozon se shpërndarja e lëvizjeve të kursit të këmbimit është normale. Nëse shpërndarja nuk është normale, maksimalja e humbjes së pritur i nënshtrohet gabimit. Metoda VAR gjithashtu supozon se devijimi standard i lëvizjeve të kursit të këmbimit është i qëndrueshëm me kalimin e kohës. Nëse lëvizjet e kursit të këmbimit janë më pak të paqëndrueshme në të kaluarën se në të ardhmen e parashikuar, humbjet maksimale të pritshme që rrjedhin nga metoda VAR do të nënvlerësohen.

Hagelin dhe Pramborg³⁰² (2004), sugjerojnë se ka ulje të rrezikut nga mbrojtjet e ekspozimit të transaksionit, si dhe nga mbrojtjet e ekspozimit të përkthimit. Një shpjegim i mundshëm për këtë të fundit është se ekspozimi në përkthim i përafron vlerën e ekspozuar flukseve të ardhshme të parasë nga operacionet në filialet e huaja (dmth, ekspozimit ekonomik). Nëse është kështu, nëpërmjet mbrojtjes së ekspozimit të përkthimit, ekspozimi ekonomik është zvogëluar.

Eun, Resnick (2004), thonë se për të mbrojtur ekspozimin ekonomik, firmat mund të përdorin strategji të ndryshme të tilla, si: zgjedhjen e mundësisë së prodhimit të produktit me kosto të ulët. Firma mund të zgjedhë për të zhvilluar aktivitetin e saj të prodhimit në një vend të huaj, ku kostot janë të ulëta për shkak të monedhës së nënvlerësuar apo faktorëve të nënvlerësuar të prodhimit. Firmat gjithashtu mund të përpiqen për të ruajtur politikën fleksibile ndihmuese, diversifikimin e tregut, diferencimin e produktit, ose mbrojtjen financiare duke përdorur opsione të monedhës apo kontrata të së ardhmes forward (të cilat ofrohen nga bankat e nivelit të dytë) dhe futures (kontrata të standardizuara që ofrohen në bursa).

³⁰¹ Holton, G. A. (2003). *Value-at-Risk: Theory and Practice*. San Diego, California: Academic Press.

³⁰² Hagelin, N. Pramborg, B. (2004). Hedging foreign exchange exposure: risk reduction from transaction and translation hedging. *Journal of International Financial Management and Accounting* 15:1.

Forma të tjera mbrojtjeje janë nëpërmjet tregut të parasë, kontratave të këmbimit swap, strategjive lead dhe lag.

III. Analiza e rastit studimor të marrë në shqyrtim

Me anë të këtij rasti studimor jemi përpjekur për të shpjeguar ekspozimin e kursit të këmbimit për një kompani në Shkodër, e cila operon në sektorin e fasonëve. Firma është përzgjedhur rastësisht nga 24 biznese që operojnë në qytetin tonë të kësaj industrie. Calzaturificio Adelchi Sh.p.k është themeluar më 15/12/1997. Biznesi merret me prodhimin dhe përpunimin e këpucëve dhe pjesëve të saj, prodhimin e objekteve prej lëkure dhe të ngjashme me lekurë, duke përdorur lëndën e parë nga jashtë shtetit, nga klienti dhe shitjen e produktit të përfunduar jashtë dhe në një fazë të dytë duke blerë direkt lëndën e parë dhe shitjen direkt të produktit të përfunduar, si në tregun e brendshëm ashtu dhe atë të jashtëm.

Sipas të dhënave të tri viteve të fundit të doganës Shkodër, biznesi që kryen më shumë importe dhe eksporte në Shkodër, është kompania Calzaturificio Adelchi Sh.p.k. Si rrjedhojë e këtyre import-eksporteve menduam të studionim këtë kompani, pasi ato kompani që kanë më tepër aktivitet, janë më të ekspozuara.

Ekspozimi ekonomik, mat ndryshimin në vlerën prezente të rrjedhjeve operative të ardhshme të parave të një firme, e cila rezulton nga ndryshimet në normën e këmbimit tek vëllimet e ardhshme të shitjeve, çmimet apo kostot e ardhshme.

Analiza është mbështetur në të dhëna të bilancit dhe të pasqyrave financiare të kompanisë. Në tabelën e mëposhtme (tab.1) janë dhënë shitjet e kësaj firme fasonë gjatë periudhave trimujore për 4 vitet e fundit (2010, 2011, 2012, 2013). Gjithashtu në tabelë janë të dhëna edhe kurset e këmbimit me të cilat janë konvertuar këto shitje. Konvertimi i shitjeve nga euro në lek bëhet në momentin e realizimit të shitjeve. Gjithashtu kam paraqitur në tabelë edhe kursin mesatar të këmbimit të Bankës Qendrore për periudha trimujore.

Tabela 1

Periudha	Shitje Euro ³⁰³	Shitjetekonv.Lek	K.këmbi mitmesata r i përdorur ³⁰⁴	K. mesatar i BQ 3-mujor ³⁰⁵	Ndryshimi në % i normës së këmbimit	Ndryshimi në % i shitjeve (në lek)
1/1/10 - 31/3/10	240,884.76	33,379,797.44	138.6	138.5		
1/4/10-30/6/10	261,324.90	36,154,910.48	138.4	137.7	-0.58%	0.08
1/7/10-30/9/10	167,839.90	22,934,776.71	136.6	136.5	-0.87%	-0.37
1/10/10-31/12/10	272,570.75	37,616,687.40	138.0	138.7	1.61%	0.64
1/1/11 - 31/3/11	515,506.72	71,846,835.86	139.4	139.5	0.58%	0.91
1/4/11-30/6/11	170,854.54	24,254,809.17	142.0	141.6	1.51%	-0.66
1/7/11-30/9/11	355,676.00	49,968,424.24	140.5	140.1	-1.06%	1.06
1/10/11-31/12/11	566,755.33	79,627,752.24	140.5	138.9	-0.86%	0.59
1/1/12- 31/3/12	2,324,086.00	323,452,724.60	139.2	139.2	0.22%	3.06
1/4/12-30/6/12	597,816.63	83,484,264.61	139.6	139.3	0.07%	-0.74
1/7/12-30/9/12	1,772,811.50	244,378,521.07	137.8	137.9	-1.01%	1.93
1/10/12-31/12/12	898,690.79	125,768,340.25	139.9	139.7	1.31%	-0.49
1/1/13 - 31/3/13	2,588,381.57	358,272,471.82	138.4	139.7	0.00%	1.85
1/4/13-30/6/13	678,724.45	95,127,273.26	140.2	140.7	0.72%	-0.73
1/7/13-30/9/13	4,524,320.59	634,768,166.85	140.3	140.3	-0.28%	5.67
1/10/13-31/12/13	2,861,200.69	402,465,699.20	140.7	140.4	0.07%	-0.37

³⁰³ Informacion nga firma³⁰⁴ Informacion nga firma³⁰⁵ <http://bankofalbania.gov.al>

Tani do të zhvillojmë një analizë regresioni për të parë nëse kjo firmë ka apo jo ekspozim ekonomik si rezultat i riskut nga normat e këmbimit.

$$y = \alpha + \beta x$$

Në qoftë se koeficienti përpara variablit të pavarur është statistikisht i rëndësishëm, atëherë firma haset me ekspozim ekonomik.

$$H_0: \beta = 0 \text{ dhe } H_a: \beta \neq 0$$

Variabli i pavarur është ndryshimi në përqindje i normave të këmbimit


Variabli i varur është ndryshimi në përqindje i shitjeve në euro, të konvertuara në lekë sipas firmës me kursin e ditës kur shitja realizohet. I hedhim të dhënat në programin statistikor të përdorur dhe lidhja që ekziston ndërmjet këtyre dy variablave është si më poshtë:

$$y = 0.8803 - 53.68x$$

$$R^2 = 0.076$$

Tani vazhdojmë me testimin e koeficientit të pavarur për rëndësinë e tij. Duhet të krahasojmë statistikën t me vlerën kritike të marrë nga tabela e shpërndarjes t, në mënyrë që të përcaktojmë nëse koeficienti ndryshon në mënyrë sinjifikative nga vlera në hipotezën e shtruar. Rezultatet do të interpretohen me shpërndarjen e Fisherit dhe të Studentit. Gjithashtu do të përdorim dhe tabelën ANOVA dhe tabelën e koeficientëve për qëllime statistikore. Niveli i besueshmërisë që do të përdorim është 95% ($P > 0.05$).

Grafiku 1



Grafiku i mësipërm jep lidhjen mes ndryshimit në përqindje të normës së këmbimit dhe ndryshimit të shitjeve në monedhen lek.

Nga rezultatet e analizës së regresionit, statistika t për koeficientin e variablit të pavarur është -1.0341 e cila është më e vogël se vlera kritike 2.1448 ($\alpha = 0.05$ e dy anshme dhe shkallët e lirisë 14). Pra vlera kritike ndodhet brenda intervalit. Gjithashtu vlera $P = 0.3199279 > 0.05$. Në këtë mënyrë nuk mund ta hedhim poshtë H_0 me nivel besueshmërie 95%. Prandaj koeficienti nuk është statistikisht i ndryshëm nga zero. Nga kjo, mund të themi që firma nuk has ekspozim ekonomik. Pra vlera e saj, nuk ndryshon si pasojë e ndikimit të kursit të këmbimit.

<i>Regression Statistics</i>	
Multiple R	0.275701592
R Square	0.076011368
Adjusted R Square	0.004935319
Standard Error	1.750690388
Observations	15

ANOVA					
	<i>df</i>	<i>SS</i>	<i>MS</i>	<i>F</i>	<i>Significance F</i>
Regression	1	3.27773598	3.277735976	1.069437167	0.319928
Residual	13	39.8439188	3.064916834		
Total	14	43.1216548			

	<i>Coefficients</i>	<i>Standard Error</i>	<i>t Stat</i>	<i>P-value</i>	<i>Lower 95%</i>	<i>Upper 95%</i>
Intercepti	0.880279217	0.45468886	1.936003469	0.074915848	-0.10202	1.862575
Ndr. % i k. tekembimit	53.67995073	51.908021	1.034135952	0.3199279	-165.82	58.46051

IV. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:

Firmat e angazhuara në bizneset ndërkombëtare apo jo përballen me rrezikun e kursit të këmbimit. Kjo është humbja e mundshme në vlerën e firmës, ose humbje në flukset monetare të marra ose humbje në përkthim. Llojet e ekspozimeve ndaj kursit të këmbimit, me të cilat përballen firmat janë: ekspozimi ekonomik, ekspozimi në transaksion dhe ekspozimi në përkthim.

Teknika kryesore për të matur ekspozimin ekonomik është një analizë e regresionit midis ndryshimit në përqindje të flukseve të mjeteve monetare ose të ardhurat, apo shitjes dhe ndryshimit në përqindje të kursit të këmbimit. Ndërsa, për vlerësimin e ekspozimit në transaksion është

VAR. Ekspozimi në transaksion mund të mbrohet nga kontratat financiare, si farward dhe opsione të kontratave, si dhe nga teknika të tilla operative si zgjedhjen e monedhës faturës, strategji të lead / lag .

Monedha që firmat shqiptare janë më të ekspozuara ndaj riksut të normës së këmbimit është euro. Kjo është për shkak se shumica e bizneseve që firmat shqiptare merren vijnë nga Eurozonë.

Firmat përballen me ekspozimin në transaksion. Ata përdorin teknika operacionale për të mbrojtur këtë ekspozim të rrezikut, por ata nuk mund të përdorin instrumente financiare. Arsyeja e parë është për shkak të mungesës së njohurive financiare dhe arsyeja e dytë është se monedha jonë lek, është një që nuk përdoret gjerësisht, ndaj dhe nuk egzistojnë kontrata të së ardhmes apo kontrata të ardhshme që të mund të përdoren për lekun.

Bankat tregtare në Shqipëri duhet të fillojë duke ofruar kontratat e ardhshme të këmbimit (forwards), në mënyrë që firmat mund të mbrojnë ekspozimin e tyre të transaksionit duke përdorur instrumentet financiare.

Firma Calzaturificio Adelchi Sh.p.k. nuk përdorin ndonjë kontratë të veçantë për t'u mbrojtur nga kursi i këmbimit, por zakonisht në bankat ku ato operojnë i vlerësojnë me kurse preferenciale. Risku më i madh i kompanisë është pasiguria nëse llogaritë e arkëtueshme do të arrijnë të shlyhen totalisht.

Firma të tilla që operojnë në sektorin e fashionit, kryesisht nuk pritet të kenë ekspozim ekonomik, pasi të gjitha firmat e këtij sektori operojnë njëjloj dhe do të ndikohen njëjloj nga kurset e këmbimit. Përveç këtij fakti, këto firma operojnë në bazë të kontratave afatmesme dhe afatgjata, ndaj i kanë të kontraktuara sasi të prodhimit dhe të shitjes paraprakisht. Megjithatë, këto firma hasen me ekspozimin e transaksioneve, pasi fitimi i tyre do të ndikohet nga luhatshmëria e monedhave. Këto firma nuk hasen as me ekspozimin në përkthim, pasi nuk kanë filiale në vendet e huaja. Ato operojnë vetëm në vendin tonë.

BIBLIOGRAFIA:

1. Adler, M., Dumas, B. (1984): Exposure to currency risk: definition and measurement. *Financial Management, Summer*, pp 41-50.
Allayannis, G., Ihrig, J., and Weston, J. (2001): Exchange-Rate Hedging: Financial vs. Operational Strategies. *American Economic Review Papers and Proceedings*, 91 (2), pp. 391-395.
2. Campbell, J.Y., De Medeiros, K.S., Viceira, L. M. (2010): Global currency hedging. *The Journal of Finance, Vol. LXV, no. 1*, pp. 87-121.
3. Dufey, G., Giddy, I. H. (2003): Management of corporate foreign exchange risk. Chapter 6 in Choi, Frederick D.S., (3rd eds), *International finance and accounting handbook*, Hoboken, NJ: John Wiley & Sons.

4. Eun, Resnick (2004): International financial management, 4th ed., (pp. 282-348). New York, NY: The McGraw-Hill Companies.
5. Hagelin, N. Pramborg, B. (2004): Hedging foreign exchange exposure: risk reduction from transaction and translation hedging. *Journal of International Financial Management and Accounting* 15:1.
6. Heta-Tufi K., Mulleti B., (2013): "The exposure of Albanian firms to the exchange rate risk and its hedging", *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, Vol.2, No 9, October, pp. 745-751
7. Holton, G. A. (2003): *Value-at-Risk: Theory and Practice*. San Diego, California: Academic Press.
8. Khazeh, K., Winder, R. C., Salimian, F. (2012): Value at Risk and Transaction Exposure: Lexicographic Permutation of a Six-Currency Portfolio. *The Journal of Current Research in Global Business*, Vol. 15, No. 24; Fall: 20-31.
9. Madura, J., (2008): International financial management, 9th ed. (pp. 280-306). Mason, OH: Thomson South-Western.
10. Papaioannou, M. (2006): Exchange rate risk measurement and management: Issues and approaches for firms. *South-Eastern Europe Journal of Economics* 2, pp 129-146.
11. Shapiro, A. C. (1996): *Multinational Financial Management*, 5th ed. Hoboken, New Jersey: Wiley.
12. Vernon, Raymond (1966): "International Investment and International Trade in the Product Cycle", *Quarterly Journal of Economics*. Cambridge. pp. 191

<http://bankofalbania.gov.al>

<http://dogana.gov.al>

<http://money.cnn.com/magazines/fortune/fortune>

<http://tatime.gov.al>

MARRËDHËNIET E FMN-SË ME SHQIPËRINË GJATË VITEVE 1997- 2000 DHE REKOMANDIMET PËR STABILIZIMIN E EKONOMISË

Azis Jata

Drejtor i Institutit të Ekspertëve Fiskalë

**The relations between Albania and IMF during 1997- 2000 and
recommendations for the stabilization of the economy**

ABSTRACT

The aim of this paper is to highlight the relations of Albanian state, with the International Monetary Fund (IMF), one of the most important institutions in the world during the difficult period that our country faced immediately after the collapse of pyramid schemes in (1997 -2000). This institution supported Albania with financial assistance in the form of loans, but also provided trainings and made recommendations in the financial sphere with aim to overcome the crises of 1997. IMF approved a three-year loan for Albania under the Enhanced Structural Adjustment Facility (ESAF) to help Albania stabilize the economy. So this paper try to highlights strategies of Albanian government and IMF in a post conflict emergency assistance policy, successfully initiated to stabilize the economy, rebuild institutional and administrative capacity, and restart the structural reforms. So due to this collaboration inflation fell faster than projected, economic growth resumed, and confidence in the currency was increased significantly.

Synim i këtij punimi është pasqyrimi i marrëdhënieve të shtetit shqiptar me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), njërit prej institucioneve më të rëndësishme në botë (në periudhën e vështirë që kaloi vendi ynë, menjëherë mbas rënies së skemave piramidale 1997-2000). Ky është një institucion që mbështet me ndihmë financiare në formë huaje, por gjithashtu ofron trajnime dhe jep rekomandime për vendet anëtare, pra monitoron ecurinë ekonomike dhe financiare të vendeve anëtare të kësaj

organizate (188 shtete aktualisht),³⁰⁶ përfshi Shqipërinë, e cila futet në kategorinë e vendeve në zhvillim dhe nënseksionin e Evropës Juglindore.

Në shkurt të vitit 1997, e pavarura me qendër në Londër “The Economist Intelligence Unit”, e cila merret me parashikime dhe këshillime përmes hulumtimeve dhe analizave të tilla, si: raportet e vendeve mujore, parashikimet ekonomike vjetore për secilin vend etj., në analizën e muajit shkurt shkruan se “*Rënia e piramidave do të rezultonte në një përkeqësim të ndjeshëm në performancën e ekonomisë në vitin 1997*”. Bëhet një kthim mbrapa në kushtet e hershme të vitit 1990, kur Shqipëria ishte e varur nga ndihma ushqimore dhe ka pasur një tentativë eksodi masiv në Perëndim. Megjithatë, kishte një shans për një ulje të butë për ekonominë, nëse ndihma shumëlaterale do të mbështeste financiarisht. FMN-ja kishte bërë deklarata mbështetëse dhe në bazë të përvojës së viteve të fundit, ndihma e jashtme do të ishte e konsiderueshme.³⁰⁷

Tek databaza e tyre që quhet “World Economic Outlook Database”,³⁰⁸ e cila është mbase databaza me voluminoze e FMN-ë, gjenden të dhëna për një sërë parametrash makroekonomike, financiarë dhe marrëdhëniet që ky insitucion ka zhvilluar me shtete të ndryshme dhe rrjedhimisht me Shqipërinë. Qeveria e re që mori pushtetin në mesin e vitit 1997, miratoi një strategji me dy faza.

Faza e parë, u mbështet në politikën e asistencës emergjente nën mbikëqyrjen e FMN - së pas konfliktit, nisi me sukses stabilizimin makroekonomik, rindërtimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative dhe rifillimin e reformave strukturore. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 1997, inflacioni ra më shpejt se sa parashikohej, rritja ekonomike vazhdoi dhe besimi në monedhën vendase u rrit ndjeshëm.

Faza e dytë, është një program gjithëpërfshirës afatmesëm makroekonomik dhe strukturor, i mbështetur nga programi i FMN-së i quajtur ESAF.³⁰⁹ Ky program parashikonte kredi koncensionare (5 deri 10 vjet) afatmesme për bilancin e rregullimit të pagesave në vendet më të varfra.

Qeveria shqiptare në kuadër të marrëveshjes ESAF, duhet të mbështetej mbi:

³⁰⁶ Shiko <https://www.imf.org/external/about.htm>

³⁰⁷ *Njësia inteligjente Ekonomisti*, Raporti për Shqipërinë, Tremujori 1, shkurt, 1997, f. 9.

³⁰⁸ Shiko <http://www.imf.org/external/ns/cs.aspx?id=28>

³⁰⁹ “FMN miraton kredinë ESAF 3 vjeçare për Shqipërinë” “Fondi Monetar Ndërkombëtar”, Komunikatë për shtyp No 98/18, 13, maj, 1998, burimi online. <http://www.imf.org/external/np/sec/pr/1998/pr9818.htm>

1. Rivendosjen e stabilitetit makroekonomik deri në vitin 1998.
2. Rivendosjen e ligjit dhe të rendit.
3. Mbylljen e skemave piramidale, të cilat shkaktuan krizën (që do të shkonte në fazën përfundimtare). Administratorët e huaj, të cilët janë emëruar në vitin 1997 të kthehen mbi administratorët lokalë, shitja e disa prej aseteve të mbetura dhe shpërndarja e të ardhurave për investitorët.
4. Vazhdimin e reformave që nevojiteshin për të mbështetur rimëkëmbjen.
5. Ristrukturimi i Bankave. Banka Tregtare Agrare është vënë në likuidim, Banka Kombëtare Tregtare (BKT) është përgatitur për privatizim dhe një blerës i huaj strategjik ishte zgjedhur dhe Banka e Kursimeve. Është e nevojshme që të mbahet në një kontratë të qeverisjes, e cila i jep të drejtën e vetos në vendimet kyçe operative të këshilltarëve të huaj.
6. Megjithatë, nevojat e zhvillimit të Shqipërisë mbeten thelbësore: për frymë PKB është vetëm rreth US \$ 800, deri rrjeti i sigurisë sociale është shtrirë hollë; infrastruktura themelore mungon ose në riparim të dobët; sistemi financiar është i pazhvilluar; baza tatimore duhet të zgjerohet më tej; si dhe kapacitetet institucionale duhet të forcohen.³¹⁰

Fondi Monetar Ndërkombëtar miratoi këtë kredi 3 vjeçare për Shqipërinë në shumën 47.000.000 \$ amerikanë për të mbështetur programin ekonomik të qeverisë 1998-2001. Kredia e parë vjetore, e barabartë me rreth 16.000.000 \$ amerikanë, u vu në dispozicion në dy këste të barabarta gjastëmujore menjëherë në maj të vitit 1998, por e gjithë shuma do të tërriqej nga qeveria shqiptare përgjatë 3 viteve.³¹¹

Gjatë vitit FMN në kuadër të marrëveshjes që kishte nënshkruar me Shqipërinë, ishte shumë aktive dhe e rregullt në raporte, duke shtruar rekomandime dhe objektiva, se Shqipëria duhet të përmbushte në mënyrë që ekonomia të dilte sa më shpejt nga kriza. Në raportin e 7 nëntorit të vitit 1997, ata konsiderojnë se qëllimi kryesor makroekonomik i qeverisë, për 1997-1998, duhet të ishte zhvlerësimi i shpejtë dhe rifillimi i rritjes ekonomike. Objektivat kryesore makroekonomike të programit ishin: (1) **të kufizohet rënia e prodhimit të brendshëm bruto (PBB) real nga 8 për qind në vitin 1997 të arrijë rritje reale prej rreth 12 për qind në 1998;** (2) **të arrihet mbajtja e normës vjetore të inflacionit nga rangu 51-54 për qind**

³¹⁰ Programi ESAF për Shqipërinë, dokumenti bazë i politikës për 1999-2001 përgatitur nga autoritetet shqiptare në bashkëpunim me stafin e FMN-së dhe Bankën Botërore, 28 maj 1999, faqe 1-20.

³¹¹ Komunikatë për shtyp e FMN-së, *vepër e përmendur*, No 98/18.

në vitin 1997, të kalojë në 15 - 20 për qind në vitin 1998; dhe (3) të mbahet rezerva ndërkombëtare bruto mbi ekuivalentin e 3.5 muajve importe gjatë vitit 1998.³¹² Banka e Shqipërisë do të mbështesë përpjekjet për zvogëlimin e inflacionit, duke mbajtur në mënyrë të përshtatshme një qëndrim monetar të shtrënguar.

Shqipëria është promovuar si një ekonomi vitrinë nga FMN-ja dhe ka gëzuar mbështetje të konsiderueshme politike nga SHBA. Nuk është kjo arsyeja e vetme të besohet, se ndihma do të vinte për të zbutur dëmet, pra efektet e rënies së firmave piramidale në ekonomi. BE-ja do të vendoste gjithashtu nën presion shtetet anëtare të prekshme nga pasojat nga kriza, veçanërisht Italinë dhe Greqinë, për të ofruar ndihmë financiare për Shqipërinë. Prapambetja relative e ekonomisë shqiptare mund të ndihmojë gjithashtu për të kufizuar dëmet. Fakti se më shumë se 50% e GDP-së ishte ende e gjeneruar nga bujqësia, pra është sektor irëndësishëm në këtë drejtim. Por edhe nëse qeveria vërtet rimerr tokën bujqësore nga ata që kanë falimentuar dhe si rezultat kanë shitur pronën e tyre për të investuar në skemat piramidale, ka një shans që të prekte sektorin e bujqësisë, e cila ka qenë motorri i rritjes ekonomike në vitet e fundit.³¹³

Sipas z. Fatos Nano në rolin e Guvernatorit të Fondit për Shqipërinë, në fjalimin e mbajtur në 3 tetor 1997 në Konferencën e FMN-së në Hong Kong “*Prioritetet e qeverisë së re duhet të jetë përfundimi i restaurimit të rendit publik e cili filloi me ardhjen e forcave shumëkombëshe që marrin pjesë në Operacionin Alba dhe tani është duke u ushtruar nga forcat e sigurimit të vendit, ndërsa në të njëjtën kohë duhet të vazhdojë perspektiva e institucioneve demokratike të cilat në themelet janë jetike për stabilitetin e ekonomisë sonë në zhvillim të tregut*”³¹⁴. Në rolin e përfaqësuesit të qeverisë shqiptare të kohës, ai deklaronte se në sferën makro-ekonomike, prioritetet e qeverisë do të ishte arritja e stabilizimit dhe fillimi i procesit të uljes së inflacionit, i cili arriti 28 për qind në gjysmën e parë të vitit 1997. Kjo do të arrihej nëpërmjet kombinimit të politikave të shëndosha makro-ekonomike dhe reformat më të gjera strukturore. Në mbështetje të këtyre qëllimeve, u përgatit një program që përfshinte masa të

³¹² “FMN miraton ndihmën urgjente pas konfliktit për Shqipërinë”, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Komunikatë për shtyp, 7 Nëntor 1997, Nr 97-51, burimi online <http://www.imf.org/external/np/sec/pr/1997/pr9751.htm>

³¹³ *Njësia inteligjente Ekonomisti*, Raporti për Shqipërinë, vepër e përmendur, f. 9.

³¹⁴ *Deklarata nga z. Fatos Nano*, Guvernatori i Fondit për Shqipërinë në Diskutimit e Përbashkëta Vjetore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Takimi vjetor i 1997-ës, Hong Kong, Kinë, komunikatë për shtyp nr 27, 23-25 shtator 1997, f. 1-5, burimi online <http://www.imf.org/external/am/speeches/pdf/pr27ale.pdf>.

menjëhershme për të frenuar deficitin fiskal të vendit, për të vendosur asetet e mbetura të skemave piramidale nën kontrollin administrativ para një likuidimi të rregullt, si dhe vazhdimi me reformat thelbësore strukturore, duke përfshirë zhvillimin e një sistemi të mirërregulluar bankar të sektorit privat.³¹⁵

Të dhënat statistikore për ecurinë e ekonomisë shqiptare gjatë viteve 1997-1999, nuk mungojnë në shtypin shqiptar, por jo gjithmonë këto shkrime për parametrat makroekonomike janë adekuate, madje disa herë këto raporte cungohen apo dhe keqinterpretohen nga shtypi (si p.sh., në rastet kur një parametri të caktuar i jepet më shumë rëndësi sesa duhet dhe një parametër tjetër kryesor injorohet fare). Për më tepër, këto të dhëna statistikore që hasen në shtyp, zakonisht i përkasin një periudhe të shkurtër kohore, disa muaj ose dy- tre vite, mungesa e të dhënave për vitet e mëparshme e bën të pamundur perceptimin e ecurisë së ekonomisë shqiptare për një periudhë afatgjatë. Arsyeja pse kam zgjedhur të citoj vetëm raporte dhe letra zyrtare dhe jo shtypin shqiptar në lidhje me marrëdhëniet e FMN-së me Shqipërinë gjatë këtyre viteve të vështira, është se këto shkrime janë të rralla dhe jo objektive. Shtypi është i varfër dhe i ndikuar nga ngjarjet e kohës dhe i orientuar politikisht. Ato pak shkrime janë bazuar mbi fakte joreale, por thjesht supozime.

Gjatë pranverës së vitit 1999, më shumë se 450.000 refugjatë shqiptarë të Kosovës u zhvendosën në Shqipëri. Shumë prej tyre të detyruar me dhunë nga forcat serbe në Kosovë. Pavarësisht varfërisë akute të Shqipërisë, shumë shqiptarë hapën shtëpitë e tyre për t'u siguruar strehim refugjatëve hyrës dhe qeveria nuk kurseu asnjë përpjekje, duke organizuar ndihma humanitare dhe duke vënë të gjithë vendin në dispozicion të NATO-s. Si rezultat, në sytë e popullit mbarë shqiptar, Shqipëria siguroi pozitën e saj si atdhe shpirtëror të të gjithë shqiptarëve, dhe pritet të luajë një rol të shquar në aspiratat e ardhshme pan-shqiptare.³¹⁶ Duke mbajtur një politikë të dyerve të hapura, Shqipëria do të kërkonte ndihmë Ndërkombëtare, për të përballuar krizën, të cilën shumë shpejt do ta kishte, nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara, agjenci të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, rreth 200 organizata joqeveritare ndërkombëtare dhe mijëra

³¹⁵ *Po aty*, Komunikatë për shtyp nr 27

<http://www.imf.org/external/am/speeches/pdf/pr27ale.pdf>

³¹⁶ Grupi i krizave Ndërkombëtare, *Shqipëria: shteti i kombit*, Raporti European No 87, I mars 2000, burimi online

<http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/albania/087-albania-state-of-the-nation.aspx>

trupa të NATO-s, ndihmuan në situatën e krijuar. UNCHR vecanërisht punoi afër me qeverinë shqiptare për të mbrojtur refugjatët.³¹⁷

Edhe këshillat e FMN-së në kuadër të marrëveshjes së përbashkët, do të kishin një rol vendimtar, si mund të menaxhohej kriza dhe mos ndikonte mbi ekonominë. Në raportin e përbashkët të muajit maj të vitit 1999, midis qeverisë shqiptare dhe FMN-së, theksohen një sërë objektivash që Shqipëria duhet të arrinte sigurisht me asistencën e FMN-së, kështu vihet në dukje progresi i kërcënuar nga fluksi masiv i refugjatëve nga kriza në Kosovë, të cilat kanë imponuar presione të konsiderueshme në ekonominë shqiptare. Ndërkohë që qeveria mbetet fuqimisht e përkushtuar për të zhvilluar reforma objektive.³¹⁸ Ky raport arrin në përfundimin se, Shqipëria ka ende rrugë të gjatë përpara se të krijojë një ekonomi të shëndoshë të tregut dhe të trajtojë varfërinë e përhapur. Edhe pas rritjes së shpejtë në vitet e para të tranzicionit (1992-1996) standardi mesatar i jetesës në Shqipëri mbetet një nga më të ulëtit në Evropë. Për të mbështetur programin e saj, qeveria shtron mundësinë e një marrëveshje tjetër dyvjeçare nën monitorimin e FMN-së. Duke zgjeruar rregullimin strukturor (ESAF), një kredi të rregullimit strukturor (SAC) dhe rregullime të tjera, si dhe të kreditimit të investimeve nga Banka Botërore, mbështetje të mëtejshme financiare dhe teknike nga Kreditorët bilaterale, multilaterale dhe donatorët. Qeveria gjithashtu në këtë raport thekson se kërkon grante buxhetore nga Bashkimi Evropian dhe nga donatorët e tjerë dypalësh për të ndihmuar në barrën e refugjatëve.³¹⁹

Nga ana e shpenzimeve, kursimeve në shpenzimet korrente, të lidhura me krizën humanitare të shkaktuara nga lufta e Kosovës, ekspertët e FMN-ë, rekomandonin që qeveria duhet të mbajë objektivat e programit fiskal dhe monetar të vendosura më parë për vitin 1999, për të ruajtur një normë të fuqishme të rritjes, drejtorët theksuan rolin kritik dhe që mbështetja financiare duhet të vazhdojë në përmbushjen e shpenzimeve të krizës në Kosovë. Drejtorët gjithashtu theksuan se vigjilenca e madhe ishte e nevojshme për të siguruar që këto shqetësime të krijuara nga kriza e Kosovës nuk e dobësojnë qeverisjen. Qeveria duhet të vazhdojë të zbatojë programin e saj antikorrupsion dhe reformat e nevojshme në gjyqësor, doganat dhe administratën publike. Episodi i skemave piramidale duhet të

³¹⁷ UNHCR raport Global, *Shqipëria në një shkrim*, 1999, f. 322 burimi online <http://www.unhcr.org/3e2d4d50d.pdf>

³¹⁸ Programi ESAF për Shqipërinë, dokumenti bazë i politikës për 1999-2001 përgatitur nga autoritetet shqiptare në bashkëpunim me stafin e FMN-së dhe Bankën Botërore, 28 maj 1999, faqe 1-20.

³¹⁹ Programi ESAF për Shqipërinë, *po aty*, faqe 1-20.

përfundojë sa më shpejt dhe të jetë sa më transparent. Së fundi, ata theksuan se është e rëndësishme që autoritetet të respektojnë standardet më të larta të transparencës në kontabilizimin e shpenzimeve dhe të financimit të lidhura me krizën e Kosovës.³²⁰

Shqipëria ka përfituar nga FMN, që prej vitit 1997, mbështetje në shumën prej 64 milionë dollarë për reformimin e sektorit bankar dhe të administratës publike, veçanërisht për administrimin financiar, si dhe për fuqizimin e stabilitetit makroekonomik,³²¹ në mënyrë për të rritur shpenzimet në infrastrukturë, shëndetësi, arsim, si dhe në rrjetin e sigurisë sociale në afatin e mesëm. Ndërsa arritja e konsolidimit të mëtejshëm fiskal, një rritje në raportin e taksave ndaj PBB-së do të jetë e nevojshme. Gjithashtu duhet seriozisht të punohet në: politikat e shkëmbimit monetar, sektorin e jashtëm, politikat sektoriale dhe strukturore; reformat në sektorin bankar, sigurinë, rendin publik dhe forcimin e gjyqësorit; punësimin, bujqësinë dhe tregun e tokës; infrastrukturën, privatizimin, shëndetësinë, arsimin dhe deri përmirësimin statistikor; kërkesat për financim të jashtëm, menaxhimin e borxhit të jashtëm, kërkesat e asistencës teknike, etj.

Shqipëria kishte shumë dallime me fqinjët e saj. Problemet e qeverisjes mbetën një pengesë serioze në zhvillimin dhe daljen e Shqipërisë nga tranzicioni i stërzgjatur. Shqipëria vendosej në mënyrë të barabartë, apo në lagjen hije të Republikës së Kirgistanit, Azerbajxhanit dhe Gjeorgjisë. Nuk është e habitshme, që një nga barrierat kryesore, apo parandaluese ndaj investimeve të huaja në përgjithësi, ka qenë paefektshmëria dhe administrata arbitrare në dogana dhe departamentet e taksave, të cilat janë identifikuar kohët e fundit nga një studim. Kombinimi i normave mesatare të taksave në kontekstin rajonal, mbledhja e të ardhurave të ulëta nga taksat dhe ryshfetet e larta etj., sigurisht që përbëjnë një njollë të madhe në zhvillimin ekonomisë.³²²

Në datën 9 qershor të vitit 2000, Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), përfundoi rishikimin e dytë të marrëveshjes së dytë vjetore për uljen e varfërisë dhe rritjen ekonomike (PRGF 1) për

³²⁰ Bordi ekzekutiv i FMN-së aprovon rritjen dhe programin e dytë vjetor ESAF; realizon 30 milion \$ kës kredie, lajm shkurt Nr. 99/27, 14 qershor 1999, burimi online, <https://www.imf.org/external/np/sec/nb/1999/nb9927.htm>

³²¹ Agjencia Austriake për zhvillim, Referati për Shqipërinë, *Shqipëri plani 2007-2009*, botuar nga Ministria Federale për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare, Vjenë Austri, f. 18.

³²² Jan-Peter Olters (përfaqësues i përhershëm i FMN-së), *Ekonomia informale e Shqipërisë: një pengesë në zhvillimin ekonomik?*, Kumtesë mbajtur në Konferencën e 5-të të Bankës së Shqipërisë, 2005, f. 11

Shqipërinë. Si rezultat, Shqipëria do përfitonte rreth 3 milionë \$ US nga FMN. Marrëveshja tre vjeçare PRGF, e cila u miratua në maj të vitit 1998, arrinte një shumë rreth 59.900.000 \$ US, nga të cilat Shqipëria kishte tërhequr rreth 41.000.000 \$ US deri në qershor 2000. Stanley Fischer, zëvendëskryeministri i parë, drejtor menaxhues dhe një nga anëtarët e Bordit Drejtues të shqyrtimit, bërën deklaratën e mëposhtme: "*Autoritetet shqiptare kanë qenë të suksesshme në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, me PBB në rritje me rreth 7 për qind, inflacioni në afër zeros, dhe rezervat e jashtme në një nivel të rehatshëm. Këto rezultate të favorshme pasqyrojnë në masë të madhe ndjekjen e patundur të politikave autoritative të shëndosha makroekonomike. Pavarësisht krizës në Kosovë në fillim të vitit 1999, reformat strukturore kanë vazhduar, dhe progres veçanërisht i dukshëm kohët e fundit është arritur në privatizim.*"³²³ Autoritetet ishin të angazhuara të vazhdonin një strategji gjithëpërfshirëse për reduktimin e varfërisë nëpërmjet një procesi të hapur konsultativ, siç dëshmohet nga kjo marrëveshje. Pra gatishmëria për të bashkëpunuar me FMN nga qeveria shqiptare ishte e madhe, duket se të dyja përfitojnë.

Shqipëria në vitet 2000 kishte shumë probleme të ndryshme, të cilat duhet t'i zgjidhte, por pavarësisht nga kjo, optimizmi për të hedhur çdo gjë mbraza dhe për të gjetur forcën për vazhduar përpara, ishte i madh. Raportet e FMN-së përsërisin njëra-tjetrën pothuajse me të njëjtat rekomandime dhe terminologji në evidentimin e progresit, por dhe ndihmës reale që FMN-ja jep për të tejkaluar vështirësitë ekonomike, uljen e varfërisë dhe stabilizimin e ekonomisë. Në këtë periudhë mund të themi që marrëdhëniet FMN-Shqipëri ishin në kulmin e lulëzimit të tyre.

³²³ FMN Përfundon rishikimin e PRGF me Shqipërinë miraton kështu 3 milionë \$ US të kredisë, Lajm shkurt Nr. 00/43, 9 qershor 2000, burimi online <http://www.imf.org/external/np/sec/nb/2000/nb0043.htm>

RASTE TË BEGATIMIT PA SHKAK

Romina Damini

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i së Drejtës Civile

Cases of unjust enrichment

ABSTRACT

Unjust enrichment is a special source of the contract law creation. It means a legal relationship of obligations created when one of the parties wealth passes to the other contract party, without legal basis and with no justified due.

The subject, who is enriched without legal basis is considered enriched and is in the debtor position, while the subject whose property is reduced, is called depleted and is in the creditor's legal position.

Institute of unjust enrichment came to light for the first time from the operation of the Roman magistrates, who created *condictio* to stop unjust enrichment, which relies on keeping the property without cause and sought the return of what has been taken without right, as "condictio in debit".

This paper aims to determine cases of unjust enrichment, in order to bring innovation in the Albanian doctrine of the contract law.

Keywords: unjust enrichment, indirect enrichment, unconstrained payout, cases.

1. Pagimi i padetyruar

Detyrimi për të paguar një shumë të hollash ekziston në rast se midis palëve ekzistojnë marrëdhënie të tilla prej të cilave burojnë edhe detyrimet. Pagimi nënkupton ekzistencën e një detyrimi, ndaj në rast se dikush merr një pasuri ose një shumë të hollash për një detyrim që nuk ekziston, ai është i begatuar pa shkak në dëm të tjetrit, çka e detyron të kthejë atë që ka marrë. Pagimi i padetyruar është një nga rastet e kalimit të pajustificuar të pasurisë dhe ka qenë figurë e quasi kontratës që në periudhën mesjetare dhe sot shfaqet më së shumti në vendet e Civil Law. Që nga e drejta romake, kur nuk ekzistonte një mjet i përgjithshëm që të rregullonte kalimet e pajustificuara të pasurisë, ishte parashikuar një mjet

specifik për të vendosur detyrimin e kthimit të asaj që ishte paguar pa shkak.³²⁴ Edhe në Common Law, një nga paditë e njohura në fushën e restitucionit ishte padia *money had and received*, e cila synonte kërkimin e kthimit të shumave të parave të marra në mënyrë të padetyruar.³²⁵ Ngatërrimi dhe pandashmëria që është bërë shpeshherë midis gjerimit të punëve të tjetrit dhe begatimit pa shkak, ka bërë që, edhe padimi i padetyruar të mos shihet lehtë jo i ndarë nga begatimi pa shkak, sidomos në Itali, ku doktrinari Moscati, është shfaqur kundër një ndërtimi unik të padisë së begatimit pa shkak dhe padisë së pagimit të padetyruar, i cili konsiderohet një mjet më elegant përse kohë synon parimisht kthimin e asaj që është dorëzuar apo kryer në mënyrë të padetyruar, pa marrë parasysh begatimin efektiv.³²⁶

Pagimi i padetyruar mund të rezultojë i tillë për arsye kryesore, por rasti më i shpeshtë është ai i zbatimit të një kontrate me një ves që në origjinën e saj, ose me një ves të ndodhur më vonë³²⁷. Në radhë të parë u referohemi rasteve të zbatimit të një kontrate absolutisht të pavlefshme. Probleme të ngjashme shtrohen në rastet e anulimit dhe zgjidhjes së një kontrate, raste në të cilat lind problemi i përcaktimit të mjeteve të përdorshme për të marrë kthimin e sendeve në natyrë, ose në mënyrë alternative të vlerës së tyre, nëse do të zbatohet kontrata. Në të drejtën romake, që vazhdon të zbatohet edhe në Gjermani, në raste të tilla përdorej *condictio*, kurse në vendet e Common Law, zbatohet *law of restitution*, i cili ngjason shumë me *condiction*, por me dallimin se Civil Law nuk çon parimisht në kthimin e sendit në natyrë, por në vlerën e tij. Megjithatë, kishte disa kufizime përse i takon gabimit, pasi jo çdo gabim linte vend për pagimin e padetyruar, p.sh., kontinentalët i referoheshin një gabimi përcaktues, të cilin ata e quanin bazik.³²⁸

1.1 Pagimi i padetyruar sipas Kodit Civil Shqiptar

Në Shqipëri, literatura e cilëson pagimin e padetyruar si rast të begatimit pa shkak.³²⁹ Çdo pagesë prezumon ekzistencën e një detyrimi dhe marrja e diçkaje, për të cilën nuk ekziston detyrim, cilësohet si detyrim

³²⁴ Levi, Giulio "Il pagamento dell' indebito", Giuffrè, Milano, 1989, faqe 11.

³²⁵ Hirschberg, Eliyahu "The impact of inflation and devaluation on private legal obligations, legal aspects of contemporary monetary problems.", Izrael, 1976, faqe 48.

³²⁶ Moscati, Enrico "Il pagamento dell' indebito", Giuffrè, Milano, 1973, faqe 9.

³²⁷ Grosskopf, Ofer "Protection of Competition Rules Via the Law of Restitution", TEX. L. REV, 1981 (2001), faqe 79.

³²⁸ Virgo, Graham "The principles of the law of restitution", Oxford University Press, Londër, 1999, faqe 672.

³²⁹ Nuni, Ardian. Vokshi, Asim. Mustafaj, Ilir "E drejta e detyrimeve", Tiranë, 2008, faqe 187.

pa shkak. Sakaq, pranohet që jemi para rastit të pagimit të padetyruar, kur personi vepron në gabim. Dijenia apo mosdijenia e personit që përfiton pagesën lidhet me qenien e tij në mirëbesim apo në keqbesim. Neni 653 i Kodit Civil parashikon: *“Cilido që ka bërë një pagim të padetyruar, ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj që ka paguar, si dhe të gëzojë frytet dhe kamatat nga dita e pagimit, nëse personi që ka marrë pagesën është në keqbesim, dhe nga dita e kërkesës për kthim, kur personi është në mirëbesim.”*

Ndërkaq, personit që ka paguar detyrimin e një tjetri duke besuar se ishte debitor, në bazë të një lajthitjeje të kryer pa faj, mund t’i kthehet ajo që ka paguar, me kusht që kreditori të mos jetë privuar në mirëbesim prej titullit dhe garancive të kredisë.³³⁰

1.1.1 Kushtet për pagimin e padetyruar

Pagimi mund të jetë i padetyruar vetëm nëse nuk ekziston detyrimi për t’u përmbushur. Sistemet Common Law e Civil Law ndahen sipas faktit nëse pagimi i padetyruar presupozon vetëm inekzistencën e detyrimit apo edhe kritere të tjera, si p.sh., gabimin e atij që kryen pagimin e detyrimit. Në përputhje me traditën e së drejtës romake, Common Law, Gjermania³³¹ e Franca mbështesin idenë e mësipërme, kurse Franca mbështet idenë se mjafton vetëm prova e inekzistencës së detyrimit. Sipas jurisprudencës gjermane, paditësi nuk është i detyruar të vërtetojë se ka paguar nën ndikimin e gabimit, por i padituri duhet të tregojë karakterin vullnetar të pagimit, ose çdo faktor tjetër që e justifikon mbajtjen, me qëllim mosdetyrimin për kthimin e asaj që ka marrë. Në Common Law, sipas juristëve anglezë, për pagimin e padetyruar nuk është e mjaftueshme prova e inekzistencës së detyrimit, por kërkohet edhe prova e gabimit të personit që kryen pagimin e detyrimit. Italia, ku prania e lirisë për të paguar vlen në çdo rast për të përjashtuar kthimin³³², duhet të jetë sistemi i vetëm në të cilin nuk kërkohet prova e gabimit.

Një tjetër kufizim kishte të bënte me mohimin e detyrimit për kthim, nëse gabimi kishte rrjedhur nga neglizhenca e atij që kishte kryer pagimin. Sipas këtij kufizimi, nëse dikush kryente një pagim gabimisht në rrethana të tilla, që një person me ndërgjegje mesatare do të kishte mundur të mund të vihej në dijeni të gabimit, e kështu të mos e paguante pagesën,

³³⁰ Neni 654, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

³³¹ Kodi Civil i Gjermanisë (BGB) në nenin 814 parashikon: *“Nëse kush ka paguar e ka ditur që nuk ishte i detyruar për pagimin, përjashtohet nga kthimi.”*

³³² Levi, Giulio *“Il pagamento dell’ indebitato”*, Giuffrè, Milano, 1989, faqe 48.

kjo e fundit nuk do t'i kthehej. Ky rregull u refuzua nga çështja “*Kelly v. Solari*”.³³³

Kufizimi i tretë kishte të bënte me përjashtimin për t'u paguar, nëse pagimi i padetyruar kishte ndodhur në bazën e një gabimi të sjellë nga një person i tretë.

2. Përmbushja e detyrimit që rrjedh nga një veprim juridik i pavlefshëm

Në të gjitha sistemet ligjore ekziston kategoria e kontratave të pavlefshme, veçanërisht në Angli e SHBA, ku koncepti i një kontrate të tillë përdoret për të treguar më së shumti marrëveshjet pa ndonjë nga elementet kryesore duke mos prodhuar kështu efektin e tyre. Kontrata mund të jetë e pavlefshme në rast se bie në kundërshtim me normat ligjore të sistemit.³³⁴

Për të lindur detyrimi në rastin e veprimit juridik të pavlefshëm nuk ka rëndësi nëse veprimi është absolutisht i pavlefshëm (nul), apo deklarohet më vonë si i tillë nga gjykata, pra, është veprim relativisht i pavlefshëm.³³⁵ Përderisa veprimi juridik është absolutisht i pavlefshëm, prej tij nuk lindin detyrime, ndaj çdo gjë që palët i kanë dhënë njëra-tjetrës duhet të kthehet. Për shembull, në rastin e shitjes së shtëpisë që është bërë pa akt noterial, mbajtja e çmimit të paguar nga blerësi prej shitësit të shtëpisë, përbën begatim pa shkak të tij si pronar në dëm të personit që donte të blinte shtëpinë.³³⁶

Nëse zbatohet një kontratë nul, vepron parimi i kthimit, pra, lind përgjegjësia për begatim pa shkak. Në sistemin ligjor anglez i është kushtuar një rëndësi e madhe marrëveshjes së palëve, duke parashikuar se,

³³³ Në “*Kelly v. Solari*”, (1841) 9 M&W 54, bëhej fjalë për një person, i cili pasi kishte lidhur një policë për jetën, kishte paguar para se të vdiste, të gjitha kështu, me përjashtim të kështit të fundit. Në bazë të kontratës, përfituesit e kontratës nuk kishin të drejta, por njëri prej tyre iu drejtua shoqërisë, duke e marrë pagesën. Nëpunësi, i cili ishte kujdesur për pagesat nuk kishte bërë kontroll të plotë, si pasojë nuk e kishte vënë re se kështi i fundit nuk ishte paguar. Shoqëria e sigurimit, pasi e zbuloi gabimin, e paditi përfituesin e policës për të marrë shumën e paguar pa të drejtë, gjë që u miratua nga gjykata, duke hedhur poshtë argumentin se neglizhenca e atij që paguan detyrimin (shoqëria e sigurimit në këtë rast) do të mohonte mjetin për kthim. Për më tepër shih: <http://swarb.co.uk/kelly-v-solari-cexc-1841/>.

³³⁴ Kontrata në kundërshtim me normat ligjore është p.sh., kontrata e lidhur në mashtrim të ligjit apo kontrata e paligjshme. Në Common Law, konsiderohen të pavlefshme pjesa më e madhe e kontratave, të cilat janë lidhur nga të miturit.

³³⁵ Tutulani-Semini, Mariana “E drejta e detyrimeve dhe e kontratave”, Real Stamp, Tiranë, 2006, faqe 312.

³³⁶ Po aty.

edhe pse marrëveshja ishte nul, por ishte vënë në zbatim, ai që kishte kryer një veprim ose kishte dhënë diçka, ishte i detyruar për shpërblim.

Në vendet e **Common Law**, ekzekutimi i një kontrate nul, nuk sjell kalimin e pronësisë së sendit. Në këtë mënyrë, nuk mund të ngrihet një padi pronësore, duke lënë si mundësi të vetme veprimin *in personam* me quasi kontratat, funksioni i të cilave ishte kërkimi i asaj që është dhënë në zbatim të një kontrate të pavlefshme. Quasi kontratat u lënë vend restitucionit vetëm në rast se ka pasur një transferim të pronësisë.³³⁷

Në **Civil Law**, sistemi gjerman është ai i cili ka shumë të përafërta me atë angloamerikan. Dorëzimi i një sendi në bazë të një kontrate absolutisht të pavlefshme, çon te kalimi i pronësisë së sendit për fituesin, me pasojë që për kthimin e asaj që është dhënë pa shkak nuk është e mundur të veprohet me rivendikim. Dallimi që qëndron në të dy sistemet është që në Gjermani ekziston parimisht kthimi i sendit në natyrë ose vlera e tij, nëse kthimi i sendit në natyrë është i pamundur.

Në **Francë**³³⁸, deri në shekullin e njëzetë, padia e pavlefshmërisë mund të ngrihej vetëm pas ekzekutimit të kontratës, për kthimin e asaj që është dhënë pa shkak. Padia franceze për pavlefshmërinë del në pah jo si një kontratë e vërtetë pavlefshmërie, por luan në rastet kur zbatohet një marrëveshje nul, të njëjtin funksion që luan në Gjermani neni 812 i Kodit Civil dhe në Common Law, kërkimi i asaj që është dhënë pa shkak. Këto mjete bazohen në një shkak të njëjtë: **prova e pavlefshmërisë së kontratës, si edhe kthimi i asaj që është dhënë në zbatim të një kontrate absolutisht të pavlefshme.**

Sipas **Kodit Civil Shqiptar**³³⁹, veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm, nuk shkakton pasojat juridike që palët synojnë, ndërsa veprimi juridik relativisht i pavlefshëm, i humbet pasojat me fuqi prapavepruese, kur deklarohet i tillë nga gjykata.

Në lidhje me pasojat e pavlefshmërisë ndaj personave të tretë pranohet se, kur një veprim juridik është i pavlefshëm apo deklarohet i tillë, edhe veprimi juridik i mbështetur në veprimin e parë juridik, do të konsiderohet i pavlefshëm. Në bazë të parimit “*askush nuk mund t’i kalojë*

³³⁷ Nëse nuk ka pasur kalim të pronësisë nuk jemi përballë restitucionit, sepse përse kohë që askush nuk mund të kërkojë kthimin e sendit që nuk ka dalë kurrë nga pasuria e tij. Në këto raste nuk duhet vepruar gjyqësisht për të kërkuar deklarimin e kontratës si absolutisht të pavlefshme.

³³⁸ Në Francë, ai që jep send në ekzekutim të një kontrate të pavlefshme, ka të drejtë të paguhet në zbatim të parimeve të gjerimit të punëve të tjetrit. Për më tepër shih Ghestin, Jacques “Le contrat”, Paris, 1980, faqe 563.

³³⁹ Për më tepër shih nenet 106-111 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

një tjetri një të drejtë që nuk e ka as vet në momentin e dhënë” nuk mund t’i kalohet një tjetri një e drejtë e fituar në bazë të një veprimi të pavlefshëm, me përjashtim të rastit kur veprimi i parë është i pavlefshëm për shkak fiktiviteti ose simulimi, ku të tretët me mirëbesim, i ruajnë të drejtat e tyre.

3. Begatimi i detyruar

Begatimi i detyruar i referohet rastit të begatimit kur një subjekt nuk ka asnjë qëllim për t’u begatuar, e për më tepër për të kthyer fitimet e marra. Begatimi i detyruar karakterizohet nga statusi pasiv i të begatuarit, i cili nuk ka pasur qëllim begatimin, por ka nxjerrë përfitime nga sjellja e tij. Problemi nuk qëndron nëse begatimi ka ndodhur në kuadër të përmbushjes së një kontrate, por në faktin se mungon një marrëveshje mes palëve e nuk ka një qëllim për gjerim të punëve. Shembull tipik është përmirësimi i sendit nga ana e poseduesit me birësim përpara se t’ia kthejë sendin pronarit. Përmirësimi i sendit të tjetrit i plotëson kushtet për ngritjen e padisë së begatimit, rast ku detyrimi për kthim është i dukshëm. Por, në të vërtetë janë disa problematika në një situatë të tillë. Ne po ndalemi në dy prej tyre, të cilat i mendojmë si kryesore:

Së pari, kërkohet t’i sigurohet mbrojtje atij që ka bërë përmirësime në sendin, që e konsideron gabimisht si të tijin.

Së dyti, kërkesa për mbrojtje e një personi ndaj vendosjes së detyrimeve kundër vullnetit të tij.

Birks, në librin e tij,³⁴⁰ shprehet ndër të tjera se, nëse dikush kundër vullnetit të tij të shprehur, do të kryente një veprim apo shërbim në favor të tij, p.sh., nëse i pastron xhamat e makinës, edhe pse ky veprim shfaq një dobi të dukshme nuk është e lehtë vendosja e detyrimit për kthim, ndaj është shumë e vështirë vendosja e ekuilibrit midis problematikave të mësipërme.

Sipas Kodit tonë Civil, poseduesi me mirëbesim ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve të nevojshme,³⁴¹ që kanë bërë për sendin dhe shpenzimet e dobishme, në masën që këto i kanë shtuar vleftën, në qoftë se kjo vazhdon të jetë në kohën e kthimit të sendit. Ai ka të drejtë të

³⁴⁰ Birks, Peter “Unjust enrichment”, Clarendon Law Series, faqe 103.

³⁴¹ Shpenzimet e nevojshme ose të domosdoshme janë ato shpenzime, të cilat bëhen për të ruajtur ose mirëmbajtur sendin, si edhe ato shpenzime që bëhen për të bërë të mundur gëzimin e sendit, sipas destinacionit të tij ekonomik. Për më tepër shih: Nuni, Ardian, Hasneziri, Luan: “E Drejta Civile II (Pronësia)”, Tiranë, 2010, faqe 167.

zbresë nga të ardhurat e sendit këto shpenzime, si edhe të mbajë sendin, gjersa t'i paguhen shpenzimet e nevojshme të dobishme.³⁴²

3.1 Përmirësimet e sendit

Sistemi anglez është sistemi në të cilin ndjehet më tepër kërkesa e mbrojtjes kundër begatimeve të detyruara. Parimi i përgjithshëm i së drejtës angleze është se, kush ka kryer një shërbim, ka përmirësuar sendin e tjetrit, mund të paraqesë si detyrim për kthim vetëm nëse sendi apo shërbimi bëhet i pranueshëm më vonë. Siç e kemi përmendur gjatë trajtimit të punimit, institutet e begatimit pa shkak dhe ai i pagimit të padetyruar trajtohen si një i vetëm nga e drejta angleze, e jo vetëm, në përputhje me *law of restitution*, në dallim nga e drejta kontinentale, e cila i trajton veçmas, me karakteristikat përkatëse. Kjo e bën vendosjen e detyrimit për kthim praktikisht të pamundur, pasi parimi bazë i së drejtës angleze është se, kush ka kryer një shërbim ose ka dorëzuar një send jo të kërkuar, por/ose që mund të pranohet më pas, nuk mund të ngrejë pretendime për kthim. Kërkesës për mbrojtje të një personi ndaj vendosjes së detyrimeve kundër vullnetit të tij i jepet një rëndësi e veçantë, duke u bazuar në një argument të Pollock³⁴³ gjatë një gjykimi. Nëse nuk ka një kërkesë të tillë është e pamundur të ngrihet pretendim për kthim. Në bazë të rregullimit tradicional, poseduesi në mirëbesim jo vetëm që nuk ka të drejtë të rimburshej, por ai mund të ketë detyrimin për të shpërblyer dëmet.

Ky rregull i përgjithshëm është kundërshtuar fillimisht nga gjyqtari Story në çështjen *Bright v Boyd*³⁴⁴, në të cilën bëhej fjalë për një poseduesi në mirëbesim të një sendi të paluejtshëm, i cili kishte bërë përmirësime mbi sendin, të cilat jo vetëm ishin të një vlere të madhe, por edhe të përhershme. Mirëpo, kontrata nuk ishte e vlefshme, ndaj sendi duhej kthyer. Personi që kishte bërë përmirësimet veproi gjyqësisht për të kërkuar rimbursimin e tij, gjë e cila u pranua nga gjyqtari. Ky vendim pati një rol të rëndësishëm në SHBA, duke vendosur kështu parimin se, poseduesit në mirëbesim të sendeve të paluajtshme, mund të veprojnë gjyqësisht për të kërkuar rimbursim, në çdo rast që kanë kryer përmirësime mbi sendin. Nga ana tjetër, në rast të sendeve të luajtshme, nuk jepet asnjë parashikim i tillë.

³⁴² Nenet 299-301 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Për më tepër shih: <http://www.punesimi.info/legjislacioni/Kodi%20Civil.pdf>

³⁴³ Pollock ishte një ndër gjyqtarët më të spikatur në Angli, i cili gjatë një gjykimi, për të sqaruar konceptin e begatimit të detyruar theksoi se nëse dikush i pastron këpucët dikujt, ky i fundit nuk mund të bëjë asgjë tjetër veçse t'i veshë, për të treguar kështu pamundësinë për kthim.

³⁴⁴ *Bright v. Boyd*, shih: <http://chestofbooks.com/business/law/Quasi-Contracts/Sec-187-I-Improvement-Of-Real-Property.html#.U3KccXbuFc0#ixzz31da5mfZg>

Ndryshe nga SHBA, në Angli sa u takon sendeve të luajtshme, kushdo që ka bërë përmirësime në mirëbesim të sendi i luajtshëm i dikujt tjetër, ka të drejtë të rimburohet, edhe nëse shërbimi nuk është kërkuar paraprakisht apo nuk është pranuar më vonë.³⁴⁵ Megjithatë, pavarësisht këtyre dallimeve, në vendet e Common Law, janë bërë të qarta rregullat që zbatohen në fushën e përmirësimeve të bëra në sendin e dikujt tjetër. *Improver-i*, ka të drejtë të rimburohet, vetëm nëse ka vepruar në mirëbesim, ose shërbimi i tij ka qenë në ndonjë mënyrë i kërkuar ose i pranuar. Edhe nëse personi që ka përmirësuar sendin e tjetrit, ka qenë në keqbesim³⁴⁶, ai sërish ka të drejtë të paguhet për shërbimet e kryera, por detyrimi për kthim do të vendoset vetëm nëse shërbimi i kryer nuk njihet më pas.

4. Begatimi indirekt

Begatimi indirekt është begatimi, i cili shkaktohet si pasojë e vetëveprimeve të personit, i cili ka pësuar humbje. Si shembull të begatimit indirekt mund të sjellim rastin kur poseduesit të një toke, i cili ngarkon një sipërmarrës të kryejë një ndërtim mbi atë tokë. Në rast se, poseduesi rezulton në keqbesim, problemi është se ndaj kujt do të ngrihet padia për ndërtimin e shpenzimet e bëra, ndaj poseduesit apo do të mund të ngrihet ndaj pronarit të ligjshëm. Parimi i përgjithshëm është që sipërmarrësi nuk lejohet të ngrijë padinë e begatimit, sepse do të kishte thyerje të parimit të përgjithshëm se nuk mund të begatohesh pa shkak në dëm të një tjetri. Sistemi ligjor francez duket të jetë i vetmi që pranon mundësinë e padisë së begatimit në raste të tilla, madje kur shpalli parimin e ndalimit të begatimit në dëm të dikujt tjetër, kishte si pikë referimi begatimin indirekt. Kjo ka ndodhur me vendimin e vitit 1892, të Gjykatës së Kasacionit³⁴⁷, mirëpo u desh një periudhë 20 vjeçare që nga dhënia e këtij vendimi për t'u vendosur parimi i subsidiaritetit të *padisë së begatimit*. Në bazë të këtij parimi, padia e begatimit mund të ngrihet vetëm në rastin kur nuk mund të ngrihet padi tjetër. Ky parim reflekton edhe efektet e veta edhe për mundësitë e begatimit në rastet e begatimit *ex alieno contractu*.³⁴⁸

³⁴⁵ Greenwood v Izett (1972).

³⁴⁶ Sipas disa autorëve, edhe në rastet e keqbesimit duhet të vendoset detyrimi për kthim, me kusht që shpenzimet e kryera të plotësojnë kushtet e një *incontrovertible benefit*, që do të thotë se në rastet kur përmirësohet sendi i dikujt tjetër, duhet të vendoset në çdo rast detyrimi për kthim edhe në rast të pranimit të heshtur apo mirëbesimit.

³⁴⁷ Cour de cassation [Cass.] Qershor 15, 1892, S. Jur. I, 281, 283.

³⁴⁸ Birks, Peter "At the Expense of the Claimant: Direct and Indirect Enrichment in English Law", Oksford, 2002, faqe 4.

Në Gjermani, pas daljes së kodit, u ndryshua jurisprudenca e mëparshme³⁴⁹ dhe u mohua në mënyrë kategorike ngritja e padisë në rastet e begatimit *ex alieno contractu*, megjithatë nga ky rregull i përgjithshëm ka disa përjashtime. Përjashtimi më i rëndësishëm i referohet fitimeve me titull falas.³⁵⁰ Parimi, në bazë të të cilit begatimi indirekt (*ex alieno contractu*) nuk i lë vend padisë për kthim, po rishihet nga jurisprudenca gjermane. Edhe në vendet e Common Law bëhet parashikim i ngjashëm me të drejtën gjermane, duke përjashtuar çdo mundësi padie direkte për begatimin indirekt. Ky parashikim mund të justifikohet në mënyra në ndryshme. Në bazë të sistemit kontraktor anglez, kontratat mund të kenë efekt vetëm mes palëve kontraktuese. Kur quasi kontratat konsideroheshin me karakter implicit, përjashtojë mundësia për kthim, kur nuk ishte në prani të një kalimi direkt të pasurisë midis palëve.

Në ditët e sotme po diskutohet gjithmonë e më shumë se cila mund të jetë zgjidhja për kthim në rastin kur mungon premtimi i shprehur i pronarit të sendit për të kompensuar personin, i cili ka ka bërë punimet. Sipas Dawson³⁵¹, mundet parimisht të pranohet vendosja e një detyrimi për kthim edhe në rastet e mungesës së premtimit të shprehur, me kushtin që të mos përktëhet në vendosjen e përgjegjësisë nga begatimi kundër vullnetit të pronarit të sendit. Në të gjitha rastet, sipas tij nuk shtrohen probleme të veçanta në vendosjen e mundësisë së një padie direkte.³⁵² Megjithatë, raste të tilla mbeten ende të rralla.

PËRFUNDIME:

Pagimi i padetyruar është një nga rastet e kalimit të pajustificuar të pasurisë. Pagimi i padetyruar është një nga rastet e kalimit të pajustificuar të pasurisë dhe ka qenë figurë e quasi kontratës që në periudhën mesjetare, dhe sot shfaqet më së shumti në vendet e Civil Law.

Tjetër rast i begatimit pa shkak është begatimi indirekt, që është begatimi, i cili shkaktohet si pasojë e vetëveprimeve të personit, i cili ka pësuar humbje.

Vlen të theksohet se shumë çështje pushohen nga gjykata e jo rrallëherë gjykatat shqiptare nuk i mirëpërcaktojnë elementet e begatimit pa shkak. Duke u rritur edhe numri i çështjeve në gjykatat e vendit, do të pasurohej edhe më tepër doktrina në lidhje me këtë institut.

³⁴⁹ Sipas jurisprudencës së para Kodit, mund të veprohej gjyqësisht në rastet e begatimit indirekt.

³⁵⁰ Ky përjashtim sanksionohet nga vet Kodi Civil Gjerman, neni 822.

³⁵¹ Dawson ishte një nga ekspertët më të mëdhenj të restitucionit e teorive mbi të.

³⁵² Dawson, Jack "Indirect Enrichment", Tübingen, 1969, faqe 789-818.

Legjislatori shqiptar duhet të rishohë dispozitat e Kodit Civil, të cilat janë, në gjykimin tim, të kufizuara. Ky institut ka një klasifikim të gjerë, parashikuar nga legjislacionet e huaja, gjë që nuk parashikohet në dispozitat e kodit tonë. Kjo do të bënte të mundur trajtimin e këtij instituti nga institucionet gjyqësore ndarazi, bazuar në karakteristikat e veçanta e jo si një dispozitë fikse në të gjitha rastet.

Jurisprudenca e doktrina shqiptare i interpretojnë në mënyrë rigorozë kushtet për ngritjen e padisë së begatimit pa shkak, duke e përjashtuar ngritjen e kësaj padie në çdo rast kur i dëmtuari mund të ngrijë padi të tjera. Bazuar në karakteristikat e këtij instituti të trajtuara në këtë punim, do të ishte e udhës të dilnim jashtë kornizave të ngurta e të trajtohen në mënyrë të detajuar figurat tipike të begatimit pa shkak.

BIBLIOGRAFIA:

1. Birks, Peter (2002): "At the Expense of the Claimant: Direct and Indirect Enrichment in English Law", Oksford.
 2. Birks, Peter: "Unjust enrichment", Clarendon Law Series.
 3. Cour de cassation [Cass.] Qershor 15, 1892, S. Jur. I, 281, 283.
 4. Awson, Jack (1969): "Indirect Enrichment", Tübingen.
 5. Ghestin, Jacques (1980): "Le contrat", Paris.
 6. Greenwood v Izett (1972).
 7. Grosskopf, Ofer (1981) (2001): "Protection of Competition Rules Via the Law of Restitution", TEX. L. REV.,
 8. Hirschberg, Eliyahu (1976): "The impact of inflation and devaluation on private legal obligations, legal aspects of contemporary monetary problems", Izrael.
 9. Kelly v. Solari" (1841) 9 M&W 54.
 10. Kodi Civil Francez (1804).
 11. Kodi Civil Gjerman (BGB, 1900).
 12. Levi, Giulio (1989): "Il pagamento dell' indebito", Giuffrè, Milano.
 13. Moscati, Enrico (1973): "Il pagamento dell' indebito", Giuffrè, Milano.
 14. Nuni, Ardian, Vokshi, Asim & Mustafaj, Ilir (2008): "E drejta e detyrimeve", Tiranë.
 15. Nuni, Ardian (2009): "E drejta Civile (pjesa e përgjithshme)", Tiranë.
 16. Tutulani-Semini, Mariana (2006): "E drejta e detyrimeve dhe e kontratave, Real Stamp, Tiranë.
 17. Virgo, Graham (1999): "The principles of the law of restitution", Oxford University Press, Londër.
- <http://swarb.co.uk/kelly-v-solari-cexc-1841/>
<http://www.punesimi.info/legjislacioni/Kodi%20Civil.pdf>
<http://chestofbooks.com/business/law/Quasi-Contracts/Sec-187-I-Improvement-Of-Real-Property.html#.U3KccXbuFc0#ixzz31da5mfZg>

RËNDËSIA STRATEGJIKE E PRODHIMIT TË PRODUKTEVE TË REJA PËR EKONOMINË KOSOVARE

Veli Lecaj

Universiteti Publik "Ukshin Hoti" Prizren, Fakulteti Ekonomik

The strategic importance of the production of new products for the Kosovo economy

ABSTRACT

Kosovo shall have a stabile future with a stable economic development. Contemporary dynamic development requires the implementation of technical-technologic innovations, which affects the minimisation of the need for labour power, providing more qualitative and cheaper production. Change of the way of life acquaints need for more qualitative new products, more natural and more complex eco-products and services... due to the fact that the business climate is becoming more and more turbulent, competitor and unsafe. So ,whatever Kosovo's company manufacture has to be something that customers really want to buy. They have to design right marketing strategy and to be really focused on being connected to the customer.

Key words: economic development, production strategy, new product, product policy, customer, competition etc.

Studime të ndryshme teorike dhe praktike tregojnë që menaxhimi i mirëfilltë i prodhimit për një kohë të gjatë, ka pasur rëndësinë e orientimit fundamental, pra prodhimi nuk duhet të shihet si një proces i thjeshtë i transformimit të materialeve në produkte, por si një mënyrë efikase dhe efektive, i parë si qendër e të gjithë operacioneve të kompanive industriale,

në mënyrë që prodhimi të luajë role të ndryshme dhe po aq të rëndësishme (John Johansen & Harry Boer, 2008)³⁵³.

Ndërsa kohët e fundit mund të jetë me karakter dytësor, nëse për bazë nuk merren orientimet e marketingut. Kjo tregon se politika biznesore e kompanisë prodhuese apo shërbyese, patjetër duhet të ketë si objektivi themelor plotësimin e kërkesave të tregut dhe atë përmes orientimit strategjik të prodhimit.

Nuk duhet lënë pa përmendur fakti se, në shumë kompani të vendeve të tjera, përdoren sistemet prodhuese (JIT-it), (TQM), etj., por për kushtet ekonomike të Kosovës, përdorimi i tyre është i pamundur, sepse procesi prodhues kosovar është joadekuat dhe me kapacitete tejet të vogla, madje pa ndonjë orientim të qartë strategjik.

Një koncept i tillë deri tani është studiuar si i izoluar nga ai prodhimit, ndërsa tani, ai duhet shikuar si koncept integruar me konceptin e prodhimit. Por mënyra e realizimit të këtij koncepti të integruar nuk është aspak e lehtë, në qoftë se nuk kemi përmirësime dhe përshtatje të vazhdueshme të koncepteve të prodhimit dhe të marketingut, si elemente kyç për konkurrencën e suksesshme në ambientin e sotëm të paqëndrueshëm dhe mjaft dinamik të biznesit. Kërkesat e konsumatorëve në kohët e sotme, ndryshojnë me ritme shumë të shpejta dhe të shpeshta, ku për plotësimin e të cilave kërkohen produkte të reja, si dhe përveç mënyrës së re të prodhimit, nevojiten edhe njohuritë e reja për prodhimin³⁵⁴.

Pra, kërkohen investime të tilla, të cilat me teknologjinë e re dhe me një staf më të kualifikuar, bëjnë të mundur arritjen e rezultateve më të kënaqshme, përmes reduktimit të kohës, duke aplikuar sistemin JIT (Just in time) dhe TQM (Totaly Quality Management), si një mënyrë bashkëkohore e manaxhimit të procesit prodhues, furnizues dhe të marketingut, si një proces i vetëm dhe i integruar.

Robert Lane, kryeshef ekzekutiv i kompanisë 171-vjeçare, thotë se suksesi i tij aktual është rezultati i strategjisë të prodhimit. Sipas tij, kjo strategji ka gjashtë komponentët kryesorë (Robert, L. 2008)³⁵⁵:

1. Krijimin e lidhjeve të forta me tregun ("Çfarëdo që ju prodhoni duhet të jetë diçka që konsumatorët vërtetë duan të blejnë")

³⁵³Yang Cheng, John Johansen, Harry Boer, "NEW STRATEGIC ROLES OF MANUFACTURING: BEYOND FIT, FOCUS AND TRADE-OFF", Center for Industrial Production, Aalborg University Fibigerstraede 16, DK-9200 Aalborg, Denmark, 2008.

³⁵⁴ Philip Kotler & John A. Caslione, "Chaotics, The Business of Managing and Marketing in The Age of Turbulence", AMACON, New York, 2009, page 35.

³⁵⁵ William J. Holstein, *Six Keys to a Winning Manufacturing Strategy*- How John Deere bucked industrial trends to become an international growth star, Strategy&business, is published by Strategy&inc, maj 28, 2008.

2. Disiplinën rigoroze financiare.
3. Qasjen e balancuar në investim.
4. Shumëfishimin e “Tregjeve në shtëpi”, plus strategjinë e eksportit.
5. Feksibilitetin e punës.
6. Qëllimin e uljes të prodhimit për të zvogëluar sasinë e burimeve të përdorura. Prodhimin e shumë produkteve të ndryshme.

Në mbarë botën sot kërkohet, që në të gjitha ndërmarrjet moderne, të aplikohen rregulla strikte në lidhje me mbrojtjen e ambientit, kooperimin me konsumatorët, prodhimin e produkteve cilësore, në një farë mënyre, paraqitjen e orientimeve afatgjata të ndërmarrjeve, plotësimin e standardeve që kërkohen për produktet e reja në treg, për një konkurrencë sa më të suksesshme. (Elmazi, Liljana, 2010).³⁵⁶

Implementimi i strategjisë prodhuese në Kosovë, mundëson që prodhimi të jetë më tepër konkurrent, më i frytshëm dhe me rendimente më cilësore, drejt përmbushjes së dëshirave dhe të kërkesave të konsumatorëve, duke ndikuar në të njëjtën kohë në rritjen e mirëqenies të ndërmarrjes dhe shoqërisë në tërësi.

I kujt është roli kryesor në realizimin e kësaj strategjie?

Pa dyshim, roli kryesor, i takon *menaxherit të prodhimit* me qasje të re, që të inkorporojë dhe të materializojë njohuritë e tij në sistemet më të mira prodhuese, përballë të gjitha sfidave dhe provokimeve të ekonomisë së tregut. Interdisiplinariteti profesional dhe bashkëpunimi midis tyre, është çelësi i suksesit, si në prodhim ashtu edhe në proceset e mëtejme biznesore, përfshirë marketingun, si dhe shërbimet para e pas shitjes.

Është për t'u vlerësuar fakti se, kohët e fundit, shumë kompani kosovare mendojnë dhe synojnë që, përcjellja e inovacioneve dhe implementimi i teknologjive të reja në prodhim, do të bëjnë të mundur, që të përmbushen detyrat e prodhimit dhe premtimet ndaj konsumatorëve.

Nëse analizohet situata ekonomike e Kosovës, me një treg të hapur tërësisht, duhet patjetër të ndërrohet kahu zhvillimor, drejt orientimit prodhues, përmes hartimit të një politike të mirëfilltë ekonomike, e cila do të forconte idenë e zhvillimit të bizneseve prodhuese kosovare. Problematika e orientimeve strategjike në ndërmarrjet prodhuese për zhvillimin e produkteve të reja, nisur nga praktikët e deritanishme, nuk është përpunuar në tërësi, bile mund të themi se është bërë fare pak në këtë drejtim. Në Kosovë ekzistojnë pak institucione shkencore dhe shtetërore (OEK, MZHE, MTI, IPAK, ASHA, Instituti “RIINVEST”, Instituti

³⁵⁶ Elmazi (Billa), Liljana, 2010, *Strategjia Marketing*, Tiranë, f.137-138.

Ekonomik, jo shumë aktiv, Instituti i Menaxhimit të Ndërmarrësisë dhe Marketingut, Instituti Financiar i Kosovës e tjera), të cilat kanë bërë hulumtime të rëndësishme të disa segmenteve të strategjisë zhvillimore të bizneseve kosovare, por jo të mjaftueshme dhe gjithëpërfshirëse. Është më rëndësi të theksohet në këtë rast se, për ekonominë e Kosovës është thelbësore, zhvillimi dhe aplikimi i strategjive prodhuese, përmes inkorporimit të shërbimit të marketingut drejt krijimit, zhvillimit dhe plasimit të produkteve të reja, si në tregun kosovar dhe me gjerë.

Meqenëse sot jemi duke jetuar në një ambient ekonomik gjithnjë e më konkurrues, mjaft turbullues dhe dinamik, risia e produktit për ndërmarrjen, është mjete kryesor i fitimit dhe i ruajtjes së pjesës së tregut (Kotler, Keller, 2011)³⁵⁷.

Pra, pa produkte të reja, ndërmarrja, nuk ka mundësi që të ketë një perspektive të qartë afariste, por edhe ekonomia kosovare, nuk mund të ketë zhvillim perspektiv dhe të qëndrueshëm ekonomik.

Hulumtimet e deritanishme tregojnë se qasja ndaj produkteve të reja, teorikisht pranohet, ndërsa në praktikë nuk ndërmerren veprimet, duke theksuar se në Kosovë, ka vend për shumë produkte të reja, sepse në këtë periudhë të tranzicionit, ndërmarrjet e vjetra, nuk janë në fuksionim. NVM nuk kanë ndërtuar kapacitete prodhuese, prandaj çdo gjë sigurohet nga importi më përjashtim të një numri të vogël të produkteve, të cilat janë prodhim i bizneseve kosovare.

Është interesant fakti që pjesa dërrmuese e tyre theksojnë se, Kosova nuk ka politikë të mirëfilltë dhe të qëndrueshme ekonomike dhe zhvillimore, sipas së cilës do të hartoheshin politikat e produkteve në ndërmarrjet kosovare. Ndër të tjera, vihet në dukje se, prodhuesit janë të diskriminuar në Kosovë, sepse ka tatime të larta edhe në lëndën e parë, e cila na nevojitet për prodhim, kjo tregon se ne nuk mund të jemi konkurrent me produktet nga jashtë.

Pra, perfeksionimi teknologjik, politika inovative dhe e prodhimit në të gjitha variantet, duhet të jenë bazamenti i politikës zhvillimore të ndërmarrjes për prodhimin e produkteve të kualitetit të mirë, por: “A ka mjaft resurse për ndërtimin e programit të suksesshëm në biznesin kosovar për produkt të ri „?”

A keni mjaft resurse për ndërtimin e programit të suksesshëm për produkt të ri?

³⁵⁷ Kotler, Philip & Keller, Kevin Lane, 2011. *Marketing Management*. 14th ed. New Jersey, USA: Pearson Education, p.343.

Programi për produkt të ri	Përqindje	Kumulativi
a. <i>Po</i>	33.9%	33.9%
b. <i>Jo</i>	51.8%	85.7%
c. <i>Nuk e kemi analizuar</i>	14.3%	100.0%
<i>Totali</i>	100.0%	

Burimi: Autori VL

Planifikimi i produktit të ri është një proces shumë i rëndësishëm në çdo afarizëm që përdoret për identifikimin dhe zhvillimin e produkteve apo shërbimeve të reja (McDonald, Malcolm, 2008)³⁵⁸. Ajo i ndihmon ndërmarrjet për zgjedhjen e ideve dhe të programeve për produkte, të cilat do të jenë interesante për të investuar në to. Dihet se produkti ri sjell ndryshime shumë pozitive dhe mundësi për zgjerimin e tregut, për plotësimin sa më të mirë të nevojave të konsumatorëve, sjell rezultate më të mira afariste dhe krijimin e një stabiliteti më të qëndrueshëm në treg për kompaninë.

Në lidhje me këtë rreth një e treta e bizneseve kosovare kanë si orientim resurse dhe kapacitete, të cilat shërbejnë për krijimin e programit të suksesshëm për produktet e reja, rreth gjysma e tyre kanë deklaruar se nuk kanë resurse për programe të tilla, ndërsa rreth 14 % prej tyre nuk kanë menduar në lidhje me zgjerimin e asortimentit prodhues përmes produkteve të reja. *Kjo rezulton se mbi dy të tretat prej tyre, nuk planifikojnë mbi programin e prodhimit të produkteve të reja, që në një farë mënyre i bëjnë jokonkurrues në treg, duke hapur mundësinë për konkurrëntët për t'u zgjeruar dhe përfituar tregje dhe konsumatorë të rinj.* Pra, ndërmarrjet mund t'i qasen planifikimit të produktit nga një numër dimensionesh dhe këndvështrimesh të ndryshme, duke thënë se një nga bizneset kryesore të departamenteve të hulumtimit të tregut, janë idetë e reja të produktit, hulumtimet dhe programet. Për më tepër në këto procese duhet të përfshihen specialisët e marketingut, R & D eksperts, ekspertët e prodhimit dhe profesionalistët financiarë për vendimmarrjen në zhvillimin e sistemit të ri të planifikimit të produktit për ndërmarrjen, duke mos lejuar bërjen e shpenzimeve të panevojshme.

Çka duhet përmirësuar në pozitën e ndërmarrjeve në Kosovë?

³⁵⁸ McDonald, Malcolm, 2008. *On Marketing Planning – Understanding Marketing Plans and Strategies*. Cornwall, UK: MPG Books.

Në asnjë vend të botës nuk ndodh, që shteti të arkëtojë tatimin përpara se të fillojë prodhimi, sepse kjo nuk është një gjë normale për ekonominë e tij. Kosova ka nevojë për produkte të reja dhe pavarësisht nga mungesa e theksuar e tyre, prodhimet në vend janë cilësore.

Duke analizuar të gjitha të dhënat mbi strategjitë zhvillimore dhe politikën e produktit në ndërmarrjet prodhuese kosovare, nevojitet orientimi dhe zhvillimi i domosdoshëm i ndërmarrësisë prodhuese kosovare në baza shkencore dhe kombinimi i tyre pragmatik interdisiplinar në mes të menaxhimit të procesit prodhues, shërbimit të marketingut dhe analizës ekonomike. Për përmirësimet e mëtejshme në këtë drejtim po theksojmë: politikën fiskale më të favorshme, kualitetin dhe ngritjen e vazhdueshme të kualitetit të produkteve, si dhe çmime më të arsyshme për produktet, mbështetjen teknike dhe financiare, seriozitetin në treg, përmirësimin e qasjes ndaj konsumatorëve, zhvillimin dhe ndërmarrësinë më efektive, aplikimin e teknikës së re, subvencionimin e bizneseve prodhuese, uljen e tatimit dhe organizimin e trajnimeve për biznesin dhe stafin e tyre, përmirësimin e kushteve të punës për punëtorë, si diçka fundamentale, promovimin e produkteve kosovare etj.³⁵⁹ Si koment shumë interesant është komenti i një menaxheri nga industria e letrës dhe e printimit, i cili tha: *“...të gjithë ne e dimë se çdo produkt i ri në veçanti në Kosovë, mund të kontribuojë rreth një të tretën e rezultatit financiar të kompanisë. Në Kosovë, ekziston mungesa e perspektivës afatgjatë të politikave ekonomike në ekonominë e Kosovës, sa që shumica e bizneseve kosovare bëjnë një planifikim afatshkurtër për vlerësimin e aktiviteteve për zhvillimin e produktit të ri dhe nga ana tjetër analizën e suksesit të produktit të ri”*.

Realiteti në Kosove tregon se, biznesi kosovar, nuk ka përvojë të gjatë në bërjen dhe zhvillimin e analizave të rezultateve hulumtuese, si dhe të hartimit të politikave dhe të strategjive prodhuese, si parakushte për zhvillimin dhe mbështetjen e aktiviteteve ekonomike në ekonominë e tregut, prandaj në të ardhmen kërkohet lidhshmëria reciproke në mes të R&D, burimeve njerëzore, menaxhimit e procesit të prodhimit, marketingut dhe shërbimit të pas shitjes.

Nga kjo rezulton se, ndërmarrja që të hartojë një politikë të mirëfilltë zhvillimore dhe prodhuese, në një formë apo formë tjetër, duhet të sigurojë përgjigje në pyetjet në vijim:

1. Cili është misioni dhe vizioni i ndërmarrjes?

³⁵⁹ Lecaj, V, “Roli i promocionit në nxitjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës”, Prishtinë, 2008, f. 79.

2. Cilat janë produktet, grupet e synuara dhe tregu i synuar i ndërmarrjes?
3. Cilët janë konkurrentët, ku gjenden dhe sa kohë janë në treg ?
4. Cilët janë faktorët që ndikojnë në prodhimin e produktit të ri në kompani?
5. Cila është situata ekonomike në vend dhe me gjerë?

Sa i përket strategjisë zhvillimore, sektori shoqëror është pothuajse i pa shpresë dhe drejt privatizimit përfundimtar, ndërsa sektori privat i prodhimit në Kosovë, nuk ka përvojën dhe traditën e duhur, për të marrë përsipër barrën kryesore, të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Prandaj shtrohet pyetja se, çfarë mund të bëhet më tepër në kushtet e sotme kosovare, ku nuk kemi politikë të qëndrueshme dhe të mirëfilltë ekonomike, strategji afatgjatë zhvillimore, zhvillim të mirëfilltë biznesi, nuk kemi implementim të integruar të marketingut në pjesën dërrmuese të ndërmarrjeve kosovare, e veçanërisht nuk kemi një zinxhir funksional ndërsistemor ekonomik, ndërsa biznesi kosovar patjetër duhet ta tejkalojë këtë situatë specifike dhe aspak të volitshme.

Përgjigjja në çështjet e lartpërmendura qëndron në atë se ka mjaft hapësirë për krijimin e politikës së qëndrueshme ekonomike, për hartimin e strategjisë afatgjatë zhvillimore, përmes reformës ekonomike dhe të filozofisë biznese në vend, përmes reformës shkollore apo së paku përmes shkollimit të kuadrave deficitare jashtë vendit, ç'ka do të mundësonte se produktet kosovare mund të zhvillohen në pajtim, si me politikën e produktit, ashtu edhe me instrumentet e tjera të marketingut miks dhe të jenë konkurrense, si në tregun e brendshëm dhe më gjerë.

Meqenëse në Kosovë, struktura e bizneseve, përbëhet diku mbi 97 % nga ndërmarrje mikro dhe të vogla, argumentimi i zgjidhjes së kësaj sfide është tejet i vështirë. Këto ndërmarrje janë celulat fillestare të biznesit.

Siç theksuam edhe më lart, krahas evoluimit të shoqërisë, evoluohen edhe nevojat e saj e bashkë me të ndryshon stili i jetës, si brenda ashtu edhe jashtë ndërmarrjes,³⁶⁰ çështje kjo që kërkon produkte më cilësore.

Kështu, kompanitë përballen me sfida, të cilat nuk janë aspak të lehta për t'u kapërcyer, falë edhe kushteve kritike ekonomike, në cilën ndodhet vendi, si në prodhim ashtu edhe në treg, gjithashtu e bëjnë edhe më të vështirë për t'iu përgjigjur pyetjeve adekuate të poshtëshënuara, drejt rrugëtimit të suksesshëm biznesor.

Cilat janë produktet tona dhe në cilën fazë ciklike gjenden ato?

³⁶⁰ Drummond G. et al, *Strategic marketing, Planning and Control*, 3rd ed. Burlington MA, USA, 2008, f. 256-257.

1. A ka nevojë dhe a ka kapacitete prodhuese për zhvillimin e produkteve të reja dhe a duhet të braktisen produktet tjera nga programi prodhues?
2. Pse konsideroni se produkti në fjalë do të jetë i suksesshëm në treg?
3. Si e konsideroni praninë e produkteve të jashtme në tregun kosovar?
4. A ka lëndë të parë për prodhimin e produkteve tuaja dhe cilat janë strategjitë prodhuese?
5. Ndërmarrja juaj a ka shërbime pas shitjes?
6. Cilat janë tregjet tuaja (kombëtar apo ndërkombëtar)?
7. A keni bërë analizën e tregut, cilat janë elementet e hulumtimit dhe të analizës së tregut?
8. A ka përkrahje të ndërmarrjeve nga institucionet shtetërore kosovare?

Nëse kompania është në gjendje të japë përgjigje në shumicën prej këtyre pyetjeve, tregon se ndërmarrjet prodhuese, janë në hap e sipër për jetësimin e reformës në filozofinë biznesore, por për rrethanat e tanishme kosovare një gjë e tillë shkencërisht dhe praktikisht është e pamundur të aplikohet, për shkak të mosfunksionimit të sistemit të tërësishëm ekonomik të Kosovës. Ndërtimi i sistemit të tillë ekonomik në Kosovë, së pari kërkon reformimin e sistemit të tanishëm, si dhe ndërtimin e një sistemi të ri prodhues më të përsosur, me qëllim prodhimin e produkteve të reja, në përputhje me konceptin e marketingut dhe mbështetur nga strategjia e eksportit, ku ndërmarrjet kosovare gjatë funksionimit, tani për tani ballafaqohen me këto probleme:

1. Vështirësitë e largimit nga filozofia e tejkaluar e orientimit tradicional ndaj prodhimit.
2. Kërkesa e biznesit kosovar për mbrojtjen nga konkurrenca përmes masave administrative me mbyllje të kufirit, është në kundërshtim me liberalizimin e tregut.
3. Në ndërmarrjet prodhuese kosovare nuk ka strukturë organizative të funksioneve, nuk ka proces të mirëfilltë komunikimi në mes të shërbimeve të ndryshme.
4. Në të shumtën e rasteve një person kryen shumë punë, si të marketingut, madje edhe ato financiare dhe administrative.
5. Konkurrenca jolojale dhe zhvillimi i madh i ekonomisë së përhimtë.
6. Ndryshimi i legjislacionit që taksat dhe obligimet e tjera ligjore të mos paguhen para se të ndodhë procesi i prodhimit, por të prolongohet pas prodhimit të produkteve, madje me rastin e shitjes së tyre.
7. Prodhimi dhe dalja e atyre pak produkteve të reja, bëhet pa analiza e hulumtime paraprake të tregut, bëhet në bazë të vendimeve adhoc.

Pra, zhvillimi i strukturës organizative të kompanisë, i formës së komunikimit në mes të punëtorëve dhe të departamenteve, si dhe komunikimi me konsumatorin, paraqesin rrugën e vetme drejt pranimi të koncepteve moderne të menaxhimit dhe të marketingut (Jakupi, Ali, 2000).³⁶¹

Duke i analizuar të gjitha këto ndërveprime, pronarët e kompanive dhe menaxherët e marketingut nëpër shumë kompani botërore janë të vetëdijshëm se patjetër duhet të ekzistojnë politika të qarta, të sakta dhe perfekte të produktit në interakcion edhe me instrumentet e tjera të miksmarketingut, me qëllim të orientimit ndaj klientëve të sotëm bashkëkohor, të cilët janë shumë heterogjenë, shumë të vetëdijshëm, shumë të zhvilluar dhe shumë të aftë, si në aspektin social, informativ dhe teknikoteknologjik. Pra rezulton se përvetësimi i kësaj klientele të shekullit 21, nuk mund të rregullohet me orientimet e vjetra të marketingut dhe me strategji të vjetra biznesore.

Prandaj, vlen të theksohet se klientët e sotëm po zgjedhin produkte dhe kompani që plotësojnë nevojat më të thella për kreativitet, komunitet dhe idealizëm. Për këtë qëllim, kompanitë duhet të hartojnë strategji të drejta me synim zhvillimin afatgjatë të firmave në treg, që është një punë e vështirë dhe komplekse dhe në të njëjtën kohë të krijojnë, produkte, shërbime dhe kultura korporatash, të cilat frymëzojnë, përfshijnë dhe pasqyrojnë vlerat e klientëve të tyre. (Ph. Kotler, 2012). Si përfundim mund të themi se, me krjimin e politikave zhvillimore të prodhimit, së bashku me strategjinë zhvillimore të produkteve të reja, krijohet mundësia e ofrimit dhe e përvetësimit të klientelës krijuese, e cila ndër të tjera mbështet konsumimin e produkteve ekologjike me qëllim ruajtjen e mjedisit, si pasuri e veçantë kombëtare.

REKOMANDIME:

- Menaxherët e marketingut duhet të gjejnë teknikat më të lehta të mundshme për të zbatuar në praktikë strategjinë e hartuar për prodhimin e produkteve të reja për të arritur qëllimet e organizatës, duke zhvilluar luftën më të madhe me konkurrencen jo përmes çmimeve, por ngritjes së kualitetit të produktit dhe të respektimit të ekomjedisit nga njëra anë, si dhe klientelës tepër të aftë dhe të vetëdijshme nga ana tjetër.

³⁶¹ Jakupi, Ali, 2000. *Bazat e Marketingut*. Prishtinë, Kosovë: Universiteti i Prishtinës, f. 139.

- Punësimin nëpër ndërmarrjet kosovare i profesionistëve të rinj, kreativë dhe ambiciozë nga sfera e marketingut dhe e teknologjisë së prodhimit, të shkolluar në mbarë botën, me qëllim krijimin e një ambienti të ri dhe konkurrent të punës, konform kohës në të cilën zhvillohet biznesi.
- Formulimin, aprovimin dhe implementimin e politikave dhe të strategjive për eliminimin e pengesave, si dhe për ndërtimin e kapaciteteve efektive prodhuese në ekonominë e hapur.
- Promovimin e lehtësirave doganore dhe tatimore, nëpërmes formave të ndryshme për investitorët potencialë vendorë dhe nga diaspora, apo edhe të tjerë.
- Hartimin e strategjive të drejta të kompanive, me synim zhvillimin afatgjatë të firmave në treg (që është një punë e vështirë dhe komplekse), si dhe në të njëjtën kohë, të krijojnë produkte, shërbime dhe kultura korporatash, të cilat frymëzojnë, përfshijnë dhe pasqyrojnë vlerat e klientëve të tyre.

LITERATURA:

1. Yang Cheng, John Johansen, Harry Boer (2008): *New strategic roles of manufacturing: beyond fit, focus and trade-off*, Center for Industrial Production, Aalborg University Fibigerstraede 16, DK-9200 Aalborg, Denmark.
2. Philip Kotler & John A. Caslione (2009): "Chaotics, The Business of Managing and Marketing in The Age of Turbulence", AMACON, New York.
3. William J. Holstein (2008): *Six Keys to a Winning Manufacturing Strategy- How John Deere bucked industrial trends to become an international growth star*, Strategy & business, is published by Strategy & inc.
4. Elmazi (Billa), Liljana (2010): *Strategjia Marketing*, Tiranë.
5. Kotler, Philip & Keller, Kevin Lane (2011): *Marketing Management*. 14th ed. New Jersey, USA: Pearson Education.
6. McDonald, Malcolm (2008): *On Marketing Planning – Understanding Marketing Plans and Strategies*. Cornwall, UK: MPG Books.
7. Lecaj, V. (2008): "Roli i promovimit në nxitjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës", Prishtinë.
8. Drummond, G., (2008): et al, *Strategic marketing, Planning and Control*, 3rd ed. Burlington MA, USA.
9. Jakupi, Ali (2000): *Bazat e Marketingut*. Prishtinë, Kosovë, Universiteti i Prishtinës.
10. Ritson Neil (2008): "*Strategic management*", Neil Ritson & Ventus Publishing Aps, London, UK.
11. Viardot, Eric (2004): *Successful Marketing Strategy for High-Tech Firms*. 3rd ed. Norwood MA, USA: Artech House.

NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME. ROLI I TYRE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

Labeat Mustafa,

Universiteti "Haxhi Zeka", Fakulteti i Biznesit, Pejë

Small and medium enterprises and their role in the economic development of Kosovo

ABSTRACT

The paper treats the development of SMEs during 2000-2014 and their role in the economic growth of the Republic of Kosova. Factors that influence successful managing of Small and Medium Businesses, the role and importance of SMEs in the total number of employees, number of businesses during the period 2000-2014 as well as other environmental analysis for the successful development of SMEs.

Based on information from the Registry Agency of New Businesses in Kosova - ARBK, are given the percentages from year to year about the employees in these sectors.

Examines the role and importance of strategic management in order to adapt to the external and internal environment and emphasize the importance of applying the SWOT analysis to increase results, effectiveness and efficiency of SMEs.

Keywords: SMEs, external environment, internal environment, managing, strategic management, SWOT analysis.

I. Zhvillimi ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Klasifikimi i madhësisë së biznesit ndryshon në varësi të vendeve. Kriteret që merren për bazë lidhur me përcaktimin e madhësisë së ndërmarrjeve janë të shumta dhe të kombinuara. Ndër kriteret më të

njohura që merren për bazë janë: tregu lokal, kapitali, të ardhurat, profiti, shitja dhe numri i punëtorëve.

Në Republikën e Kosovës, sipas Administratës Tatimore – ATK, kriteret kryesore për përcaktimin e madhësisë së ndërmarrjes janë: qarkullimi vjetor, pagesat e tatimit dhe numri i punëtorëve. Këto kriterë aplikohen në mënyrë selektive të kategoritë e formuluar:


- Ndërmarrje të mëdha konsiderohen bizneset që kanë qarkullimin vjetor mbi 2 milionë €, pagesat e tatimit mbi 100 mijë €, numrin e punëtorëve mbi 250.

- Ndërmarrje të mesme konsiderohen bizneset që kanë qarkullim vjetor mbi 500.000 deri në 2 milionë € dhe pagesat e tatimit mbi 20 000 € dhe që punësojnë 50 deri 249 punëtorë.

- Ndërmarrje të vogla konsiderohen bizneset që kanë qarkullimin vjetor deri në 500.000 €, të cilat i punësojnë prej 10 deri në 49 punonjës.

- Mikrondërmarrje quhet ai biznes që punëson deri në 9 punonjës (http://www.sme-ks.org/repository/docs/2008_03-L-031_al.pdf).

Regjistrimi i bizneseve në Kosovë - Deri në fund të vitit 2000 numri i regjistrimit të bizneseve kishte arritur në 29.564, ndërsa deri me 23 mars 2003, kur përfundon regjistrimi i përkohshëm dhe fillon regjistrimi i përhershëm, numri i bizneseve ishte rritur në 56514, ndërsa me 31/12/2003, ky numër shënoi një rritje simbolike 56572. Kjo rritje ndodhi pas përfundimit të një procesi dhe fillimit të një procesi të ri e të përhershëm të regjistrimit.



Grafiku: Trendët e regjistrimit të bizneseve prej vitit 2000 – 2008 (Burimi-ARBK)


Mbështetur në të dhënat e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve/MTI dhe nga Agjencia për mbështetje të NVM, që nga viti 2000 deri me 31.08.2010, janë regjistruar 101.598 biznese, ndërsa janë shuar 9.813. Këtij trendi i duhet shtuar edhe veprimi i administratës tatimore të Kosovës, e cila në bazë të ligjit 03/L-222 neni 12.6 dhe udhëzimit administrativ

07/2009 neni 8 ka deaktivizuar 37.480 biznese, që nënkupton se në vitin 2010 në Kosovë vepronin 54.305 biznese aktive.

Nga totali i numrit të ndërmarrjeve në Kosovë 98.37% e përbëjnë mikro ndërmarrjet, 1.35% janë ndërmarrje të vogla, 0.22% janë ndërmarrje të madhësisë së mesme dhe vetëm 0.06% janë ndërmarrje të mëdha.


Deri me datën 31.08.2010 sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve numri i të punësuarve në ndërmarrje të vogla dhe të mesme ishte 214.157, shprehur në përqindje 79.37 %, ndërsa 20.63% e të punësuarve u takojnë ndërmarrjeve të mëdha.

Në ndërmarrje të mëdha me mbi 250 punëtorë, ku janë të regjistruara edhe ndërmarrjet shoqërore dhe publike KEK, PTK etj., janë punësuar 53.658 punëtorë apo 21.66 % e të punësuarve në bizneset e regjistruara.



Grafikoni. Pjesëmarrja e NVM në punësim Burimi-ARBK

Nga ky grafikon shihet se sektori i NVM-ve në Kosovë, ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe në formimin e vendeve të reja të punës, meqë afër 194.124 apo 78.44% e gjithë të punësuarve në ndërmarrje i absorbon ky sektor në numrin total të punësuarve në Kosovë. Sektori privat punëson 247.782, ndërsa sektori publik punëson 75.000, që gjithsej ishin të punësuar 322.782, sipas kësaj shohim se sektori i NVM-ve merr pjesë në punësim



Grafikoni Shpërndarja e bizneseve dhe punëtorëve nëpër sektorë (Burimi-ARBK)

me mbi 60%. Kjo përqindje është e përafërt me mesataren e vendeve të BE-së.

Kontributi i NVM-ve në krijimin e BPV-së, buxhetit të shtetit etj., në bazë të disa parallogarive konsiderohet se arrihte 40 -55%.

Kontributi i sektorit të NVM-ve në Kosovë edhe nga aspekti i zhvillimit të sektorëve ekonomikë është i rëndësishëm, pasi që NVM-të janë biznese, të cilat aktivizojnë edhe sektorët më të marginalizuar, gjithashtu NVM-të shquhen me një shtrirje të gjerë sektoriale, si dhe me plotësimin e diversitetit të nevojave të shoqërisë, mirëpo për shkak të specifikave që përmbajnë, nuk arrijnë të kthehen në një industri me shtrirje të gjerë apo me bazë të lartë profiti.

Në vendet me hyrje të ulëta të BPV-së mes 100-500\$/kokë banori, NVM-të, kontribuojnë me mbi 60% në krijimin e BPV dhe 70% të totalit të punësuarve, ndërsa në vendet me hyrje mesatare të BPV-së, NVM-të, kontribuojnë rreth 70% në krijimin e BPV dhe 95% në totalin e të punësuarve (Grajçevci N. 2010). Nga viti 2000 e deri në vitin 2014, janë hapur gjithsej 130 mijë biznese të reja.

Në Kosovë regjistrohen vazhdimisht biznese të reja, por gjithashtu edhe një pjesë e tyre shuhet. Sipas informatave nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në kuadër të MTI-së, vetëm gjatë vitit 2014 prej datës 1 janar – 13 maj, janë regjistruar 4122 biznese të reja.

Nga data 1 janar 2012 deri më 13 maj 2013, janë regjistruar 4210 biznese.

Prej datës 1 janar 2000 deri më 13 maj 2014, janë të regjistruara 130.708 biznese. Po gjatë kësaj kohe, janë shuar 14.299 biznese.

Në Bashkimin Evropian NVM-të përbëjnë përafërsisht 99% të të gjitha ndërmarrjeve dhe punësojnë mbi 65 milionë punëtorë, në Britaninë e Madhe, statistikat tregojnë se nga 4.5 mil. Biznese, 99.3% janë biznese të vogla me më pak se 50 punëtorë dhe 0.6%, biznese të mesme që punësonin nga 50-250 punëtorë, etj. (Small and Medium Sized Enterprise Statistics for the UK 2006, published 2007).

II. Faktorët që ndikojnë në menaxhimin e suksesshëm të biznesit të vogël dhe të mesëm

Teorikisht dhe praktikisht pranohet se ekzistojnë një tërësi faktorësh, që ndikojnë në krijimin dhe menaxhimin e suksesshëm të bizneseve të vogla dhe të mesme. Disa prej tyre janë: mjedisi makroekonomik; mjedisi politik dhe ligjor-rregullimi qeveritar; mjedisi shoqëror; aftësitë ndërmarrëse; niveli i teknologjisë; struktura e organizatës; personeli i organizatës etj.

Rritja ekonomike e qëndrueshme përmirëson stabilitetin politik dhe social, ndërsa në kushtet e periudhës së tranzicionit garanton suksesin e reformave. Kjo arrihet kur në vend krijohet një mjedis i sigurt dhe i qëndrueshëm për sektorin privat. Në një mjedis ku mungojnë transparenca dhe konkurrenca e ndershme sektori privat mund të shndërrohet në një pengesë të eficiencës. Kryerja e reformave, përparimi i shpejtë i tyre në vendet në tranzicion, është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e qeverisë. Qëllimi i tyre final do të jetë krijimi i një sektori privat energjik, i cili funksionon, shkëmben mallra dhe shërbime, si dhe investon lirshëm në një mjedis të sigurt ekonomik, politik dhe ligjor.

Suksesi i bizneseve të vogla varet nga përkushtimi, talenti krijues dhe motivimi i pronarit. Këtu bëjnë pjesë: përkrahja dhe korrektësia ndaj ndryshimeve, aftësia për t'u përshtatur ose për të krijuar vetë ndryshime, aftësia për të tërhequr e për të mbajtur punëtorë të aftë, vizioni lidhur me hollësitë operative, njohuritë mbi tregun, domethënë njohuritë mbi klientët dhe nevojat e tyre.

Çdo funksion biznesi, çdo institucion biznesi, çdo person i angazhuar në kryerjen e këtyre funksioneve për vete ose për një institucion biznesi, duhet të plotësojë kërkesat dhe nevojat e njeriut. Këto biznese janë efikase dhe mbijetojnë deri në atë masë që plotësojnë në mënyrë efektive dhe ekonomike kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve.

Nevoja e njohjes së tregut dhe e konsumatorëve, është e domosdoshme. Objektiv i biznesit, është sigurimi i mallrave të duhura, në vendin e duhur, në kohën dhe me çmimin e duhur, atëherë procesi i menaxhimit është i domosdoshëm (planifiko, organizo, udhëheq dhe kontrollo). Kontrollit duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë, ku përfshihen kontrolli financiar, si dhe mbajtja e evidencave të sakta. Menaxhimi i suksesshëm i bizneseve kërkon:

- Studimin më të kujdesshëm të tregut;
- Planifikimin e menduar mirë të veprimtarive afariste;
- Organizimin dhe udhëheqjen profesionale;
- Kontrollin e kujdesshëm të investimeve, mallrave, personelit, pajisjeve dhe ndërtesave, për të siguruar shfrytëzimin maksimal gjatë prodhimit;
- Të dhëna të mjaftueshme për shpenzimet;
- Zgjedhjen e mallrave të menduar mirë;
- Vendime strategjike, duke iu referuar me zgjuarsi tregut, duke pasur parasysh edhe burimet dhe transportin e mallrave;
- Politika të drejta e të pandryshuara të objektivave të përgjithshme, por elastike dhe të përshtatshme për të përballuar të papriturat e biznesit;

- Marrëdhënie të mira pune me furnitorët;
- Kredi të garantuara juridikisht;
- Zgjedhjen e klientelës dhe të përqendrimit në treg;
- Personelin e zgjedhur mirë e të aftë;
- Programin e planifikuar mirë për nxitjen e shitjeve.

Të gjitha këto elemente përfaqësojnë një tërësi të përgjithshme të rregullave operative moderne që duhet të jenë të pranishme, për të krijuar një ekuilibër të përshtatshëm në biznes.

Për të menaxhuar në mënyrë efektive, faktorët personalë kanë rëndësi të veçantë. Aftësia për të drejtuar, udhëhequr, madje për të frymëzuar të tjerët, është cilësi njerëzore, ashtu siç është dhe aftësia për të marrë dhe për t'u dhënë përgjegjësi të tjerëve. Aftësia për të fituar dhe për të ruajtur besimin në sigurimin e ndihmës financiare, dhënien e kredive, përbën një veçori të rëndësishme jetike për biznesin, duhet pasur parasysh se biznesi është projektim i personalitetit të drejtuesit. Në përgjithësi, individët e kanë ose nuk e kanë zotësinë që kërkohet dhe duke e pasur atë zotësi, ata bëjnë një punë të mirë e me dëshirë ose dështojnë kur nuk e kanë atë. Këto çështje nuk mund të mbitheksohen, sepse suksesi i biznesit është një filozofi, një pikëpamje, një alternativë që duhet të përshkrojë tërësisht mendimin e ndërmarrësit në rast se ai do që ta ketë në dorë ndërmarrjen (Buble, M., Cingula, M., Dujaniq, M., Dulciq, Z., Bozhac, M. G., Galetic, L., Lubic, F., Pfeifer, S., Tipuric, D., 2008).

III. Analiza e mjedisit për zhvillimin e suksesshëm strategjik të NVM-ve

Procesi i menaxhmentit strategjik fillon me analizën e mjedisit-rrethinës, e cila përfshin monitorimin, evaluimin dhe përhapjen e informatave nga mjedisi ekstern dhe intern në ndërmarrje.

Mjedisi ekstern e përbëjnë variablet, të cilat janë jashtë ndërmarrjes dhe zakonisht janë jashtë ndikimit të menaxhmentit të lartë. Këto variabla formojnë kontekstin në të cilin ekziston ndërmarrja, kurse mund të jenë forca dhe trende të përgjithshme në mjedisin e tërësishëm social ose faktorë specifikë, të cilët veprojnë në mjedisin specifik të detyrave të organizatës.

Mjedisi i përgjithshëm ose social paraqet atë pjesë të **mjedisit ekstern**, i cili është larg nga ndërmarrja, shpesh quhet mjedis i largët - *remote environment*, kështu që ndërmarrja vështirë mund të ndikojë në të.

Mjedisi i përgjithshëm ose social është prezantuar nëpërmjet pesë dimensioneve kryesore ose tipareve të mjedisit, të cilat janë: 1.

natyrore - ekologjike, 2. shkencore - teknologjike, 3. ekonomike, 4. politiko-juridike dhe 5. mjedisi sociokulturor.

1. *Mjedisi natyror-ekologjik*, përfshin resurset materiale dhe demografike, duke filluar nga lënda e parë e deri te njerëzit si resurs kryesor i çdo ndërmarrjeje, i cili me cilësinë dhe shumësinë e vet në mënyrë indirekte, ndikon në ekzistencën dhe zhvillimin e ndërmarrjes, si dhe në organizimin e saj të brendshëm.

2. *Mjedisi shkencor-teknologjik*, bën nivelin përkatës të arritjeve shkencore dhe teknologjike. Njohja e këtij dimensionit dhe e aspekteve përcjellëse të saj është paramendim për investim në veprimtarinë hulumtuese-zhvillimore, si dhe për marrjen e vendimeve strategjike për përparimin e teknologjive ekzistuese dhe për përvetësimin e teknologjive të reja në ndërmarrje.

3. *Mjedisi ekonomik*, është kornizë bazike për veprimin e ndërmarrjes. Nëpër këtë dimension në mënyrë indirekte thyhen të gjitha aspektet e ndikimit në ndërmarrje, duke filluar nga strategjia e përcaktuar globale e zgjedhur, pastaj forma e pronësisë, ligjit të kërkesës dhe të ofertës, të politikës së punësimit, e deri te masat e politikës monetare-kreditore.

4. *Mjedisi politik-juridik*, rregullon marrëdhëniet politike-ekonomike brenda sistemit përkatës politik në kuadër të të cilit vepron ndërmarrja. Kornizat institucionale, të cilat janë dhënë me distribuimin e fuqisë politike dhe me normat juridike, determinojnë kornizat e përgjithshme ligjore për themelimin, funksionimin dhe ndërprerjen e punës së ndërmarrjeve.

5. *Mjedisi socio-kulturor*, përmban shumë veçori dhe ndikime të shtresave shoqërore, si dhe mënyra individuale dhe grupore të sjelljeve në ndërmarrje. Këtë dimension, që mbështetet në sistemet përkatëse të vlerave, e përbëjnë normat dhe rregullat e sjelljes, si dhe vlerat dhe veçoritë demografike të shoqërisë në të cilën vepron ndërmarrja.

Mjedisi intern i ndërmarrjes, përbëhet nga variablat që janë brenda saj, si dhe mund të ndikojë menaxhmenti në to. Këto variabla formojnë kontekstin në të cilin zhvillohet puna e ndërmarrjes dhe përfshijnë strukturën organizative, kulturën dhe resurset, të cilat ndërmarrja mund t'i shfrytëzojë për të arritur përparësi konkurruese.

Menaxherët duhet të kuptojnë qëllimin e analizës së mjedisit, të hulumtojnë nivelet e ndryshueshme të mjedisit ekzistues organizativ dhe të kuptojnë synimet për zbatimin e analizës me qëllim që të jenë më të suksesshëm në kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Mjedisi intern është ai mjedisi i ndërmarrjes, i cili tërësisht është nën ndikimin e ndërmarrjes. Kohëve të fundit, epiqendra e interesit bartet nga mjedisi intern në atë ekstern. Kjo ka shkaktuar shfaqjen e konceptit

të menaxhmentit strategjik. Secila ndërmarrje dallohet me veçoritë e saja interne. Nga ky aspekt mund të flitet edhe për *forcat dhe dobësitë* si veçori të mjedisit intern, përkatësisht të ndërmarrjes. Dobësitë interne dhe kanosjet eksterne, mund të pengojnë, si ndërmarrjen në tërësi, po ashtu edhe disa pjesë të saj në arritjen e rezultateve të dëshiruara të afarizmit dhe të qëllimeve strategjike.

Mund të ndodhë që këto forca, për shkak të ndryshimit të kushteve, mund të bëhen pengesë për ndërmarrjen.

Forcat e ndërmarrjes, të cilat quhen edhe forca strategjike, janë aftësi pozitive që ndërmarrjes i mundësojnë të realizojë qëllimet e saj, të orientuara drejt arritjeve të përparësive strategjike. Forca kyçe të ndërmarrjes mund të paraqiten mbi:

- vizionin e qartë strategjik
- arsimimin, profesionalizmin dhe aftësimin e kuadrit
- strukturën organizative adekuate
- njohjen e tregut
- pajisjet tekniko-teknologjike
- investimin e vazhdueshëm në veprimtarinë hulumtuese – zhvillimore
- cilësinë, çmimet dhe njohjen e prodhimit dhe të shërbimeve
- pozitën e fuqishme konkurruese
- disponimim me mjete financiare
- përpunimin e sistemit të shpërblimeve
- përpunimin e kulturës organizative

Dobësitë e ndërmarrjes, të cilat quhen edhe dobësi strategjike, në përmbajtje, janë paaftësi të brendshme të ndërmarrjes, të cilat pengojnë realizimin e qëllimeve të ndërmarrjes, në praktikë paraqiten për shkaqe të:

- mosekzistimit të filozofisë përkatëse afariste dhe të vizionit strategjik
- mungesës së kuadrit profesionist, përkatësisht të ekipeve jopërkatëse kuadrovice
- mospërshtatjes së strukturës organizative me kërkesat e ndërmarrjes
- pajisjes jopërkatëse teknologjike të ndërmarrjes
- asortimentit joadekuat të prodhimit ose të diapazonit të shërbimeve
- pozitës së papëlqyeshme konkurruese
- mungesës së mjeteve financiare
- mos ndërtimit të kulturës organizative.

Forcat dhe dobësitë janë karakteristika kyçe të mjedisit intern të ndërmarrjes, të cilat së bashku me mundësitë dhe rreziqet nga mjedisi ekstern, përbëjnë bazën për analizën e gjithanshme të mjedisit. (Buble, M., Cingula, M., Dujaniq, M., Dulciq, Z., Bozhac, M. G., Galetic L., Lubic, F., Pfeifer, S., Tipuric, D., 2008).

Mjedisi intern është mjedisi i drejtpërdrejtë punues i ndërmarrjes në të cilin ndodhin të gjitha proceset dhe ngjarjet kyçe, të rëndësishme për ekzistimin dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Ndikimi i mjedisit në ndërmarrje

Është e rëndësishme të theksohet se mjedisi ndikon në ndërmarrje, por dhe ndërmarrja ndikon në të. Për ndërmarrjen, mjedisi konsiderohet si një mori faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët mund të ndikojnë në rrugën e saj drejt realizimit të qëllimeve. Menaxhmenti duhet që në mënyrë konstante të grumbullojë dhe shqyrtojë të dhëna, të cilat kanë të bëjnë me faktorët e mjedisit, kështu që bërja e analizave të mjedisit sigurisht do të jetë shumë e rëndësishme për menaxherët.

Qëllimi themelor i analizës së mjedisit është që t'i shërbejë menaxherit për reagim me kohë.

Për vlerësimin e mjedisit zhvillohet analiza SWOT (Strengths – Weaknesses - Opportunities - Thrats). Deri sa fuqitë (Strengths) dhe dobësitë (Weaknesses) lidhen me ndërmarrjen, përkatësisht me mjedisin intern, rastet e volitshme (Opportunities) dhe rreziqet-kërcënimet (thrats), kanë të bëjnë me mjedisin ekstern të ndërmarrjes. Një ndër detyrat kryesore të analizës së mjedisit është të identifikojë rastet e volitshme dhe kanosjet në mjedisin ekstern, kurse forcat dhe dobësitë në mjedisin intern. Për ta kryer këtë detyrë në mënyrë të suksesshme, analiza e mjedisit duhet që:

1. të zbulojë faktorët dhe presionin e tyre që i ndihmojnë ndërmarrjes për realizimin e qëllimeve (rasteve të volitshme) të saj;
2. të përcaktojë aftësitë pozitive të brendshme të ndërmarrjes, forcat si dhe paaftësitë e brendshme, të cilat e pengojnë realizimin e qëllimeve të ndërmarrjes;
3. nëpërmjet analizës SWOT duhet të lidhen rastet (mundësitë) dhe rreziqet me fuqitë dhe dobësitë në mënyrë që ndërmarrja të pozicionohet në mjedis;
4. të sigurojë bazën për formulimin e strategjisë me të cilën ndërmarrja do t'iu shmanget kanosjeve, duke shfrytëzuar forcat edhe duke eliminuar dobësitë e veta.


Që menaxhmenti ta bëjë analizën e suksesshme të mjedisit, është e domosdoshme që në ndërmarrje të ndërtohet një sistem informativ i tillë, i cili në mënyrë sistematike do të sigurojë informatat e nevojshme për gjendjen në mjedis. (Buble, M., Cingula, M., Dujaniq, M., Dulciq, Z., Bozhac, M. Gonan, Galetic, L., Lubic, F., Pfeifer, S., Tipuric, D., 2008).

Për të parë se sa i jepet rëndësi dhe sa aplikohet SWOT analiza në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, kemi bërë një pyetësor të cilin e kemi plotësuar në disa ndërmarrje të vogla dhe të mesme në Kosovë.

Rezultatet e anketave:

Pyetësori është plotësuar nga menaxherët e niveleve të ndryshme. Rreth 100 anketa të vlefshme dhe të plotësuara na kanë ndihmuar në nxjerrjen e përfundimeve dhe dhënien e disa rekomandimeve për menaxherët e NVM-ve në Kosovë.

Të pyetur se sa e vlerësojnë rolin e SWOT analizës për arritjen e rezultateve në menaxhimin e suksesshëm të firmës, 60 % janë përgjigjur se e vlerësojnë lart, 30 % janë përgjigjur se e vlerësojnë mesatarisht, 8 % kanë thënë se e vlerësojnë pak dhe 2 % kanë menduar se bën edhe pa të.




Burimi nga autori i punimit

Vihet re se nga shumica e menaxherëve i jepet rëndësi e madhe rolit të SWOT analizës, rëndësi mesatare dhe më pak kryesisht i jepej nga menaxherët në disa firma më të vogla.

Në pyetjen se sa zbatohet SWOT analiza në ndërmarrjet ku ata punojnë kemi këto rezultate, 57% deklarojnë se po zbatohet, 32 % deri diku, 8 % pak dhe 3 % nuk e aplikojnë fare. Shumica e firmave të vogla ishin ato që e përdorin deri diku, më pak apo nuk e aplikojnë fare SWOT analizën.


Nga kjo mund të vërehet se ndërmarrjet e vogla më shumë kanë nevojë për



Burimi nga autori i punimit

zhvillim të formës së menaxhimit, aftësim të kuadrove menaxhuese, me qëllim që të jenë më të suksesshëm, efikas dhe eficientë në kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Në pyetjen se sa janë të kënaqur me rezultatet e SWOT analizës, 50 të anketuarve të cilët thanë se zbatojnë SWOT analizën në ndërmarrjet e tyre ne morëm këto rezultate: 73% plotësisht të kënaqur, 25 % të kënaqur dhe 2% më pak të kënaqur.



Në bazë të kësaj analize vërehet se kënaqësia rreth rezultateve gjatë zbatimit të SWOT analizës ndryshon. Unë mendoj se kjo varet nga strategjia, lloji i strategjisë që kanë përdorur, si është zbatuar, sa kanë qenë të aftë t'ia përshtatin strategjinë e tyre mjedisit ku veprojnë, pra janë faktorë të shumtë, të cilët i kemi cekur më lart që ndikojnë në arritjen sukseseve apo të rezultateve të cekura më lart.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Sektori i NVM-ve në Kosovë ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe në formimin e vendeve të reja të punës, sepse 78.44% e gjithë të punësuarve në ndërmarrje i absorbon ky sektor.

Kontributi i sektorit të NVM-ve në Kosovë është i rëndësishëm edhe për zhvillimin të sektorëve ekonomikë, pasi që NVM-të janë biznese, të cilat aktivizojnë edhe sektorë të marginalizuar.

Që të arrihen rezultate më të mira duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë mjedisit, si atij intern po ashtu dhe atij ekstern.

Viteve të fundit, mbartja e interesit nga mjedisi intern në atë ekstern ka shkaktuar shfaqjen e konceptit të menaxhmentit strategjik.

Forcat dhe dobësitë e ndërmarrjes janë veçori dalluese të mjedisit intern të ndërmarrjes, të cilat, së bashku me mundësitë dhe kanosjet (rreziqet) nga mjedisi ekstern përbëjnë bazën për analizën e gjithanshme të mjedisit.

Nga qeveritë kërkohet krijimi i kushteve sa më të favorshme në ato fusha të biznesit ku investon sektori privat.

Duhet t'i jepet prioritet zhvillimit të sistemit bankar në përputhje me kërkesat e ekonomisë së tregut; hartimit të strategjisë së politikave të nxitjes së investimeve të huaja të drejtpërdrejta; reduktimit të pengesave burokratike; rritjes së efijencës së punës së administratës shtetërore për iniciativat e sektorit privat; monitorimit të ligjit mbi konkurrencën; luftimit të ryshfeteve dhe korrupsionit; rritjes së efikasitetit të sistemit të drejtësisë etj.

LITERATURA:

1. Prof. dr. Isak Mustafa (2013): *Menaxhimi i biznesit dhe i punësimit në ekonominë bashkëkohore*, IFK, Prishtinë.
2. Prof. dr. Isak Mustafa (1993): *Drejtori në udhëheqjen e biznesit*, "Eureka", Prishtinë.
3. Prof. dr. Isak Mustafa (1997): *Ndërmarrja në biznesin bashkëkohor*, "Eureka", Prishtinë.
4. Qimiao Fan, Alberto Criscuolo, and Iva Ilieva-Hame, *Punim për Bankën Botërore*.
5. Small and Medium Sized Enterprise Statistics for the UK, 2006, published 22 August 2007
6. Prof. Assoc. Sotirag Dhamo, Universiteti Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Prof. Assoc. Stefan Qirici, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, *Konferenca II Ndërkombëtare Biznesi dhe Punësimi*, IFK, 2003, Prishtinë.
7. Libri: *Konferenca IX Ndërkombëtare Biznesi dhe Punësimi*, IFK, Prishtinë, 2010.
8. Menaxhmenti Strategjik – Marin Buble, Marijan Cingula, Marcelo Dujaniq, Zelimir Dulciq, Marli Gonan Bozhac, Lovorka Galetic, Franjo Lubic, Sanja Pfeifer, Darko Tipuric - KOLEGJI UNIVERSITAR VICTORY, Prishtinë, 2008.
9. Të dhëna nga Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve të reja, MTI, Prishtinë 2008, 2010, 2014.
- http://www.sme-ks.org/repository/docs/2008_03-L-031_al.pdf

**PËRDORIMI I MEDIAS SOCIALE NË INDUSTRIJË E
TURIZMIT NË SHQIPËRI. RAST STUDIMI I
AGJENCIVE TURISTIKE NË TIRANË**

Irma Shyle

Universiteti Politeknik i Tiranës

**The use of social media in the tourism industry in Albania - Case study
of tourist agencies in Tirana**

ABSTRACT

Tourism is recognized as one of the largest industries in the world in which information technology is used. One of the most useful tools of this industry has been the Internet, which is certainly a great opportunity for practicing and expansion of tourism enterprises.

Use of information technologies in the Albanian tourist enterprises, compared with other European countries, remain at low levels. A significant proportion of small and medium tourism do not understand the importance of investing in technology and its use in marketing function to increase clientele. Market's demand, dictates business that it is necessary to use modern information technology, in order to survive and be competitive in the market.

The arrival of new technologies such as social media have made it possible to change the way consumers seek information on their buying decisions

Social media are becoming important tools in marketing management for companies of tourist destinations, having a major impact on tourism markets.

Social Media such as: Facebook, Twitter, MySpace are increasing at very rapid number of users, as well as their role in terms of interaction with customers.

This paper aims to examine the extent and importance of social media use by tourist agencies in Tirana.

Key words: *social media, tourism, marketing, client,*

1. Hyrje

Rrjetet sociale nuk janë një fenomen i ri i komunitetit njerëzor. Mjetet sociale të komunikimit perfaqësojnë një revolucion përse i përket mundësisë së publicitetit për ndërmarrjet. Nëpërmjet mekanizmave të network-ëve socialë nuk kanë ndryshuar vetëm instrumentet, por edhe vetë komunikimi. Mediat sociale nuk janë të orientuara vetëm në zhvillimin e platformave të promocionit dhe të komunikimit, por edhe në implementimin e shërbimeve për të krijuar mundësi të reja biznesi dhe karriere. Grupet profesionale të pranishme në një rrjet, shpesh janë të mbyllura dhe të orientuara në mënyrë specifike ndaj targeteve specifike në mënyrë që të realizojnë kështu objektiva të përcaktuara dhe të vendosura nga drejtimi i ndërmarrjes që përfiton nga këto platforma. Mjetet sociale të komunikimit perfaqësojnë një revolucion përse i përket mundësisë së publicitetit për ndërmarrjet. Nëpërmjet mekanizmave të network-ëve socialë nuk kanë ndryshuar vetëm instrumentet, por edhe vetë komunikimi³⁶². Publiciteti tradicional nuk funksionon më dhe si pasojë e faktit se konsumatorët kanë ndryshuar modelet (zakonet) e tyre të blerjes. Ndërmarrjet kanë përsëri të njëjtin problem, atë të rritjes të objektivave të shitjes duke kërkuar të përfshijnë blerësit³⁶³. Këtij ndryshimi në metodologjinë e shitjes dhe të komunikimit të ndërmarrjeve, ashtu siç ishte konceptuar tradicionalisht, i shtohet revolucioni i nisur nga mjetet sociale të komunikimit. Ndërmarrjet e kuptuan se nevojitet përfshirja e klientëve të vet në bërjen e diçkaje derisa ata të jenë përsëri aktivë në blerje. Asgjë s' është më e mirë se një instrument i tillë si rrjeti social për të arritur këtë objektiv³⁶⁴. Komunikimi nëpërmjet rrjeteve sociale është një fenomen që bazohet në pjesëmarrjen aktive të personave të përfshirë në të.

2. Marketingu dhe media sociale

Marketingu në përgjithësi ka të bëjë me rritjen e ndërgjegjësimit, edukimin, informimin dhe bindjen e klientëve. Armstrong & Kotler,³⁶⁵ argumentojnë se reklamave tradicionale iu mungon aftësia për të

³⁶² Powers, M. J. (1997). *How to program a Virtual Community*. Emeryville, Calif.: Ziff-Davis Press.

³⁶³ Buhalis, D. and M.C. Licata. (2002). The Future of eTourism Intermediaries. *Tourism Management*, 23, 207-220.

³⁶⁴ Lin H. F. (2008). "Determinants of successful virtual communities: Contributions from system characteristics and social factors", *Information & Management*, Vol. 45, pp. 522-527.

³⁶⁵ Armstrong A. and Kotler. P. (2012). "Marketing: An Introduction", Prentice Hall; 11 edition, pp.450-478

personalizuar komunikimin, por thjesht ato mbështeten kryesisht në një mënyrë komunikimi me audiencën. Reklamata dixhitale nuk duhet të jenë si këto edhe për shkak të natyrës p.sh., mediat sociale dhe komunikimi janë të njëanshme.

Media sociale është bërë një mënyrë shumë e përhapur për bërjen e marketingut nga bizneset. Me një pengesë të ulët në hyrje dhe përdorimin e tyre, si dhe aplikacione të shumta për të shfrytëzuar, media sociale ofron mundësi të pashembullt për kompanitë, të cilat duan të arrijnë konsumatorët dhe të krijojnë njohjen e markës së tyre në treg³⁶⁶. Megjithatë, duke përdorur këto platforma dhe potencialin e plotë të tyre, nuk është gjithmonë e lehtë dhe mbart një grup rreziqesh. Marketingu në median sociale, është një mënyrë e shkëlqyer për bizneset në mënyrë që të zgjerojnë ekspozimin e tyre për publikun me një kosto shumë më të ulët se ajo e marketingut tradicional. Krijimi i një profili në platforma të përdorura gjerësisht të tilla, si: Facebook dhe Twitter, mund të ndihmojnë në synimin e klientëve të rinj dhe që e bëjnë markën më të njohur³⁶⁷. Përveç kësaj, komunikimi i dyanshëm që bëhet i mundur nga media sociale, mund të përmirësojë shërbimin e klientëve dhe t'iu mundësojë bizneseve informacion në lidhje me klientët e tyre. Ndërkohë që media sociale mund të jetë një mjet i fuqishëm marketingu, nuk është krejtësisht pa rreziqe. Fansat janë të lirë që të postojnë komentet e tyre në këto platforma dhe kjo gjë e ekspozon biznesin ndaj publicitetit negativ. Hakerat paraqesin një tjetër kërcënim për bizneset në mediat sociale p.sh., një hacker mund të ndërmarrë sulme mbi faqen e një kompanie ose të shpërndajë informacion të rremë në lidhje me kompaninë.

3. Roli i faqeve sociale në nxitjen e turizmit

Mediat sociale, janë duke u shndërruar në instrumente të rëndësishme marketingu për organizatat e menaxhimit të destinacioneve turistike, duke pasur një ndikim të madh në tregjet e turizmit.

Roli që media sociale është duke luajtur në aspekte të ndryshme të jetës po bëhet gjithnjë e më i madh çdo ditë, veçanërisht në sferat si ndërveprimi social dhe aspektet kulturore dhe arsimore të jetës sonë. Përdorues të ndryshëm kanë role ekskluzive në këto komunitete.

³⁶⁶ Heinonen, K. (2011). Consumer activity in social media: Managerial approaches to consumers' social media behavior. *Journal of Consumer Behaviour*, 10(6), 356-364. doi:10.1002/cb.376

³⁶⁷ Kim, W. G., Lee, C., & Hiemstra, S. J. (2004). Effects of an online virtual community on customer loyalty and travel product purchases. *Tourism Management*, 25(3), 343-355

Moderatorët udhëheqin diskutime, komentuesit profesionalë japin mendime dhe pjesëmarrësit e përgjithshëm kontribuojnë në diskutime. Platformat si tripadvisor.com dhe WAYN.com ofrojnë shtrirje globale me furnizuesit e saj dhe rrisin rëndësinë e shpërndarjes dhe promovimit të shërbimeve turistike³⁶⁸. Ata kanë futur aplikime të reja për të shtuar vlerën përmes menaxhimit të informacionit dhe funksionalitetin e pasur interaktiv, duke filluar nga kërkimi i informacioneve dhe këshillave të udhëtimit, duke bërë transaksionet e udhëtimit, nxitjen e marrëdhënieve me njerëzit larg apo gjetjen e shokëve të udhëtimit³⁶⁹. Lehtësia e përdorimit, fleksibiliteti dhe interaktiviteti i ofruar nga këto faqe sociale, e bëjnë më të lehtë për klientët marrjen e informacioneve, të cilat në fund të fundit gjenerojnë shitje. Këto faqe të internetit interaktiv, që kanë statusin e komuniteteve sociale, inkurajjnë konsumatorët për të bashkëvepruar me komunitetin, duke forcuar perspektivat e klientit. Kjo do të rezultojë tek konsumatorët që vizitojnë komunitetin më shpesh për të marrë informacionin e dëshiruar³⁷⁰. Me këshillat apo njohuritë që ata marrin nga komuniteti, ndërtojnë perceptimin e destinacionit dhe përdoren për të marrë vendime nga konsumatorët³⁷¹.

4. Metodologjia

Ky punim është trajtuar nga këndvështrimi i ofertës duke hartuar kështu pyetësorët për agjencitë turistike. Numri i agjencive turistike të kontaktuara është 15 dhe të gjitha janë në qytetin e Tiranës.

Pyetësorët janë hartuar në atë mënyrë që të sigurohet informacion mbi rolin e mediave sociale në procesin e planifikimit të udhëtimit dhe perceptimin e përmbajtjes së paraqitur në faqet e mediave sociale nga audienca e tyre. Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët do të ndihmojnë gjithashtu për të identifikuar potencialet e mediave sociale në promovimin e agjencive turistike dhe të destinacioneve në përgjithësi. Pyetësi është i përbërë nga 10 pyetje, të cilat marrin informacion të përgjithshëm mbi

³⁶⁸ Bray, J., Schetzina, C., & Steinbrink, S. (2006). *Six travel tech trends for 2006*: PhoCus Wright.

³⁶⁹ Grace-Farfaglia, P., Dekkers, A., Sundararajan, B., Peters, L. and Park, S.-H. (2006). Multinational web uses and gratifications: Measuring the social impact of online community participation across national boundaries. *Electronic Commerce Research* 6(1): 75–101.

³⁷⁰ Poon, A. (1993). *Tourism, technology and competitive strategies*. Wallingford: CAB International.


³⁷¹ Wang, Y., Yu, Q., & Fesenmaier, D. R. (2002). Defining the virtual tourist community: implications for tourism marketing. *Tourism Management*, 23(4), 407–417

agjencitë turistike, metodat e promovimit të tyre, aplikimin ose jo të medias sociale në promovim etj.

Pyetësorët në lidhje me agjencitë turistike për këtë punim janë administruar personalisht. Personat të cilët mund të jepnin informacionin e nevojshëm ishin menaxherët e agjencive dhe pronarët e tyre.


5. Analiza e të dhënave të marra nga agjencitë turistike

Kjo pjesë do të shqyrtojë rezultatet e nxjerra nga pyetësori i drejtuar agjencive turistike dhe konsumatorëve. Për sa i përket kohës së krijimit dhe operimit në treg, mund të themi se agjencitë turistike të krijuara në më pak se 5 vjet, zënë 25% të agjencive të marra në studim, 5 deri në 10 vjet më parë në masën 38% dhe me më shumë se 10 vjet 37%. Pra, mund të themi se mosha mesatare e ndërmarrjeve turistike është afërsisht 10 vjet që tregon një përfshirje të mirë në treg.



Grafiku 1. Koha e operimit në biznes


Përsa i përket të ardhurave të bizneseve turistike, mund të themi që përqindjen më të madhe e zë kategoria me të ardhura 20001€-50000€ në masën 38%, kategoria e dytë është ajo me të ardhura 10001€-20000€ në masën 24%, më pas ato me mbi 50000€ me 18%. Më poshtë renditen ato me të ardhura 5001€-10000€ në masën 16% dhe me më pak se 5000€ vetëm 4% e agjencive turistike të këtij rajoni. Mund të themi që një vlerë mesatare të ardhurash për këtë lloj biznesi do ishte 35000€.



Grafiku 2. Të ardhurat vjetore të agjencive turistike


Për sa i përket faqeve promocionale më të përdorura mund të themi që përqindjen më të lartë e zë kartvizita/broshura & faqe në rrjete sociale me një përqindje përdorimi prej 21%, më pas renditen kartvizita/broshura & website & faqe në rrjete sociale me një masë prej 17%, e kështu me radhë. Masën më të vogël të përdorimit e kanë kombinimi kartvizita & broshura & reklama televizive me 1%.

Siç shihet nga grafiku 3, vëmë re se shumica e këtyre bizneseve pra 58%, harxhojnë më pak se 100€ për promovimin e biznesit të tyre; 31% e tyre harxhojnë 101€-300€ dhe mbi 300€ vetëm 11%. Shumica e kompanive nuk shpenzojnë buxhet për reklama televizive apo reklama në revista të ndryshme, por përgjithësisht për broshura dhe kartvizita, të cilat nuk janë aq të kushtueshme sa të sipërpërmendurat.



Grafiku 3. Shpenzimet për promovimin e agjencive


Për pyetjen: “A i përdorni rrjetet sociale për promovimin e biznesit tuaj?”, rezultoi se 96% e agjencive të intervistuar u përgjigjen me **po** dhe vetëm 4% nuk i përdorin rrjetet sociale, sepse mendojnë se nuk janë efektive (grafiku 4). Pra, mund të themi se shumica e këtyre bizneseve besojnë se, mediat sociale janë të dobishme për promovim.



Grafiku 4. A i përdorni rrjetet sociale për promovimin e agjencisë?


Faqet që kompanitë kanë profilet e tyre kryesisht (grafiku 5) janë: 72% e të intervistuarve kanë thënë se biznesi i tyre ka profil në Facebook, si rrjeti social më i përdorur nga konsumatorët.

Më pas renditen ato që kanë webpage të kompanisë së tyre me 10%, ku kryesisht janë ato kompani, të cilat kanë të ardhura të mëdha nga biznesi i tyre dhe kanë më shumë se 10 vjet që operojnë në treg




Grafiku 5. Në cilin rrjet social ka profil agjencia juaj?

Faqet e krijuara në platformat e rrjeteve sociale administrohen nga pronarët e ndërmarrjeve në 38% të rasteve, në 23% të rasteve i administrojnë menaxherët dhe në vlerën 11% persona të autorizuar. Gjithashtu ka edhe kombinime të tjera në vlerat 18% dhe 10%. (Grafiku 6)




Grafiku 6. Kush i menaxhon këto rrjete sociale?

Administratorët e faqeve të këtyre rrjeteve sociale shpërndajnë kryesisht informacion në lidhje me foto/video, ofertat dhe çmimet në lidhje me shërbimet që ofron kompania në masën 56%; 34% shpërndajnë foto/video dhe çmime në faqet e tyre sociale, 7% shpërndajnë foto/video, ndërsa 3% komentojnë ose thjesht publikojnë oferta ose çmime (grafiku 7).




Grafiku 7. Çfarë shpërndani në rrjete sociale?

Facebook si platforma më e përdorur nga biznesi për promovim ka një frekuencë përdorimi më të lartë, siç vihet re edhe nga paraqitja në grafik, rreth mbi 10 orë për 46% të të intervistuarve, 30% i kushtojnë kohën 6-10 orë dhe 23% e tyre 1-5 orë në një javë. Ndërsa 1% e të intervistuarve nuk janë përdorues të kësaj platformë. Instagrami është një rrjet, i cili siç duket ka një përdorim mjaft të vogël, afërsisht 4% e tyre e përdorin me një frekuencë 1-5 orë. Pjesa tjetër është jopërdoruese. Youtube përdoret afërsisht 1-5 orë në javë nga 17% e të intervistuarve dhe 6-10 orë nga 3% e tyre. Të tjera rrjete kanë një përdorim të madh dhe konkretisht 9% e të intervistuarve i përdorin 1-5 orë, 7% e tyre 6-10 orë dhe 2% mbi 10 orë (grafiku 8).



Grafiku 8. Frekuenca e përdorimit të rrjeteve sociale

Në grafikun 9 paraqitet një krahasim i efektivitetit të medias sociale në raport me mjetet e tjera promovuese. Krahasimi është i bazuar në intuitën e përdoruesve të mjeteve promovuese.



Grafiku 9. Si i vlerësoni mënyrat e marketingut krahasuar me median sociale?

Rezultatet e gjetura tregojnë se broshurat dhe kartvizitat janë më efektive se mediat sociale në 52% të rasteve; 36% e të intervistuarve mendojnë se efektiviteti është i njëjtë, 10% mendojnë se broshurat dhe kartvizitat janë më pak efektive se mediat sociale dhe 2% nuk i aplikojnë broshurat dhe kartvizitat si mjete promovuese për promovimin e bizneseve të tyre.

Për reklamat televizive të intervistuarit thanë se në 20% të rasteve është më efektiv se mediat sociale; 22% mendojnë se ka efektivitet të njëjtë me mediat sociale; 37% mendojnë se reklamat televizive janë më pak efektive se mediat sociale dhe 21% nuk i aplikojnë reklamat televizive për t'u promovuar.

Efektiviteti i revistave dhe gazetave është më i madh në 7% të rasteve; 11% mendojnë se kanë efektivitet të njëjtë; 58% thonë që revistat dhe gazetat janë më pak efektive në promovim në raport me median sociale dhe 24% nuk i aplikojnë revistat dhe gazetat për të promovuar agjencitë e tyre.

KONKLUZIONE:

Ky studim kishte për qëllim të shqyrtonte mundësinë e promovimit të industrisë së turizmit me anë të medias sociale, si dhe të kryhej një matje për përdorimin aktual të kësaj metode promovimi dhe duke pasur parasysh përfshirjen sa më të madhe të përdoruesve të medias sociale.

Në bazë të literaturës së përdorur shohim që media sociale sjell një sërë avantazhesh promovuese dhe kjo për faktin se media sociale mundëson kombinimin e një sërë elementesh të tillë, si: tekst, video, audio dhe foto. Ky kombinim sjell një avantazh të madh në komunikimin e integruar në marketing. Gjithashtu literatura sugjeron se media sociale është një trend i ri dhe me rritje të shpejtë dhe për pasojë ajo duhet menaxhuar mirë.

Ndër të tjera media sociale ka edhe disavantazhe përse i përket sigurisë së markave që promovohen, kërkon përkushtim dhe kërkon një menaxhim të mirë të komenteve negative.

Rezultatet praktike dolën në përfundimin se përse i përket ofertës turistike, promovohet nëpërmjet këtij kanali komunikimi por, ky mjet komunikimi përdoret si mjet tradicional, gjë që do të thotë se ndërmarrjet që kanë zgjedhur këtë metodë komunikimi nuk qëndrojnë aktive dhe rrallë herë përditësojnë të dhënat e tyre.

Kryesisht pak janë mjetet promociionale që përdorin ndërmarrjet dhe kryesisht janë broshurat dhe kartvizitat. Kjo interpretohet si një mungesë interesi apo si mungesë burimesh.

Media sociale konsiderohet si e rëndësishme në arritjet e objektivave promociionale dhe rëndësia e këtij mjeti komunikimi është më e madhe kryesisht në rritjen e ndërgjegjësimit për ndërmarrjen turistike apo

destinacionin në tërësi. Një vlerësim i mirë i jepet medias sociale edhe përse i përket efektivitetit promovues të saj në raport me mediat e tjera.

Si përfundim, përse i përket përdorimit të këtij kanali komunikimi për të promovuar ofertën turistike, mund të themi se ekziston interesi dhe besimi nga ana e agjencive, por mungon përfshirja dhe përkushtimi.

Mjete të mediave sociale të tilla, si: Facebook, Youtube & Webpage, kanë fituar popullaritet dhe tendencat janë duke treguar se konsumatorët më të shkolluar dhe të rinj, kanë filluar të përgjigjen edhe për këto mjete, gjithashtu këto rezultate takohen sërish.

REKOMANDIME:

Pasqyrimi i të dhënave të këtij studimi na orienton për të rekomanduar disa pika të mëposhtme.

Rekomandohet përdorimi i rrjeteve sociale për të përmirësuar dhe forcuar lidhjet me tregun e bizneseve. Në mesin e faktorëve që përdoren për marketing, përdorimi i medias sociale është një mënyrë shumë efektive si kanal komunikimi. Shpërndarja e sa më shumë informacioneve të dobishme për audiencën dhe qëndrimi në kontakt virtual me to. Për kompanitë e vogla dhe me pak burime komunikimi rekomandohet ky mjet promovimi, i cili është shumë efektiv dhe ekonomik në këto raste. Gjithashtu rekomandohen të menaxhohen mirë komentet negative në mënyrë që arma më e fortë e rrjeteve sociale, viraliteti, të mos kthehet kundër kompanive.

**RAST STUDIMI: KRAHASIMI I VLERËSIMEVE PËR
MËSIMDHËNIE E MËSIMXËNIE TË STUDENTËVE
TË DEGËS FINANCË DHE INFORMATIKË TË
UNIVERSITETIT TË SHKODRËS „LUIGJ GURAKUQI“**

Sadije Bushati

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomik

Case study: comparison of evaluations for teaching and learning by students of Finance and Computing Branches of Shkodra’s University.

ABSTRACT

Quality assurance is today one of the most important problems of Higher Education. The simulation applied in recent years has contributed to the reduction of quality and this will impact directly or indirectly in the coming years, the progress of the country. If disabled people will take key positions in government of the country or even the region, for many years will see negative consequences.

This should frighten us, so we should not allow to reach there ... but firmly and continuously seek quality growth.

The following study serves this purpose. It presents the results of a questionnaire developed by students from the Faculty of Economics, Finance and the Faculty of Natural Sciences, Department of Informatics, University of Shkodra. Analysis of the results is done with SPSS and EXEL programs.

Hyrje

Kërkesat për rritjen e cilësisë në arsimin e lartë po theksohen gjithnjë e më shumë. Bashkimi Evropian, me anën e programeve të ndryshme, po përpiqet të përfshijë të gjitha shtetet anëtare (si dhe ato që tentojnë të hyjnë në BE), për dhënien e një rëndësie të veçantë këtij problemi. Në raportin që u mbajt më 28.01.2014 në Parlamentin Evropian, për progresin e arritur në sigurimin e cilësisë të arsimit të lartë, u treguan

arritjet, por edhe mangësitë dhe detyrat për përmirësimin e vazhdueshëm të tij, sipas strategjisë së ndërtuar për këtë qëllim për vitet 2013-2020.

Në këtë raport del qartë se duhet krijuar kultura e brendshme në institucion për sigurimin e cilësisë dhe për t'ia arritur këtij qëllimi, duhen të organizohen aktivitete të shumta, ku të përfshihen të gjithë akademikët, punonjësit e administratës, studentët, etj. Në bazë të sigurimit të cilësisë qëndron mësimdhënia dhe mësimnxënia, por natyrisht këto lidhen me programet mësimore, sesa i shërbejnë ato komunitetit e punësimit; lidhen me trajnimin e burimeve njerëzore; me shkëmbimin e eksperiencave ndërkombëtare etj. Rëndësi e veçantë i atribuohet edhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, pra kualifikimit të vazhdueshëm. Për këtë të fundit jepen disa plane për veprime bashkëpunimi. Po kështu, BE-ja me anën e ERASMUS +, kërkon të arrijë bashkëpunimin, bashkëveprimin, nxitjen e reformave në arsim etj.

Në vendin tonë, mbas nënshkrimit të Procesit të Bolonjës nga qeveria, u arrit vendimi për hapjen e universiteteve për të gjithë maturantët, të cilët diplomoheshin, gjë që shtoi vlerën e kërkuar të raportit student/popullsi. Por kjo nuk u shoqërua me kërkesën e cilësisë për diplomat universitare. Diploma *bachelor*, u konsiderua si një nivel i ri, për të filluar punësimin e atyre që nuk mund të vazhdojnë studimet më lart, dhe kështu do të mund të arriheshin dy objektiva: përgatitjen për të hyrë në BE (nënshkrimi i procesit të Bolonjës) dhe shtyrjen për 3 vjet të punësimit të asaj pjese me formimin më të ulët, e cila kërkonte punën e munguar. Procesi i Bolonjës u jep mundësi studentëve për të vazhduar studimet në shumë vite, duke mbartur provimet vit pas viti dhe kjo si rrjedhojë, solli interesimin dhe dëshirën e prindërve, që fëmijët e tyre me mesatare 5-6, jo vetëm të ndjekin studimet në arsimin e lartë, por edhe ta përfundonin sa më shpejt. Hapja e universiteteve private (disa nga të cilët jepnin provimet e lëndës, pa u paraqitur fare në provim), që një ndër shkaktarët e rënies së nivelit kudo në arsimin e lartë.

Shteti që në vitin 2007, bëri disa hapa gati formalë për rritjen e cilësisë. Agjencia e Akreditimit përktheu dokumentet e dala nga BE-ja për problemin e sigurimit të cilësisë, u shpërndanë në të gjitha IAL-të dhe u kërkuar që të merren masa për të vënë në jetë kërkesat dhe standardet e vendosura nga BE. Në disa institucione (ku u krye edhe akreditimi), u ngritën komisionet e sigurimit të cilësisë dhe funksionuan në disa fakultete, të cilat nuk vijuan më pas, asnjë ushtrim kontrolli, nga njësitë drejtuese më të larta, në rang universiteti apo në rang ministrie. Kjo gjendje e krijuar në arsim, u bë shkaku kryesor për rënien e nivelit mësimor në shkollat e larta dhe bëri të mundur shfaqjen e mangësive të njohura sot nga të gjithë.

Fakulteti Ekonomik i USH-së, është një nga njësitë e pakta që ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të mbajtur të gjallë problemin e sigurimit të cilësisë. Pyetëtorët me studentët, janë mbajtur vazhdimisht, herë për të gjithë pedagogët, herë për një pjesë të tyre, herë për pedagogët e jashtëm. Duke i konsideruar pyetëtorët, një mjet mjaft të rëndësishëm për komunikimin me studentët, për marrjen e opinionit të tyre për disa probleme (për të cilët si fakultet ka vend për përmirësim), i është dhënë rëndësi këtyre pyetësorëve, analiza e të cilëve është bërë e njohur në rang departamenti ose fakulteti.

Përveç pyetësorëve, Fakulteti Ekonomik, në bazë të projektit “EUREQA- Fuqizimi i Universiteteve për të përmbushur përgjegjësitë e tyre për Sigurimin e Cilësisë”, ka kryer dhe do të kryejë disa aktivitete që kanë si qëllim zhvillimin e sistemeve të brendshme të sigurimit të cilësisë. Në këtë projekt marrin pjesë disa universitete nga: Shqipëria, Kosova, Bosnje-Hercegovina dhe më shumë nga BE (Finlanda, Austria, Danimarka, Irlanda, Portugalia, Holanda, Sllovenia).

Në vazhdimësi të veprimtarive që kryhen në Fakultetin Ekonomik, është edhe ky punim, ku do të analizohen pyetësorët e zhvilluar në degën e Financë-Kontabilitetit të Fakultetit Ekonomik dhe në degën Informatikë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, viti i parë dhe i dytë për të dy fakultetet. Me anën e metodave statistikore dhe programet SPSS dhe EXEL, është kryer analiza e përgjigjeve, pastaj bëhet ballafaqimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve të studentëve të pyetur.

Analiza është ndarë në katër pjesë: A) Gjeneralitetet e respondentëve; B) Analiza e mësimdhënies dhe krahasimet përkatëse; C) Analiza e mësimnxënies dhe krahasimet përkatëse; D) Përfundimet dhe sugjerimet. Janë shpërndarë nga 50 pyetësorë, respondentë janë 42 nga financë-kontabiliteti dhe 32 nga informatika.

a) Gjeneralitetet e respondentëve:

Gjeneralitetet e studentëve, gjinia dhe viti, të mjaftueshme për këtë studim, paraqiten në tabelat 1.

	FIN	INFOR	GJITH
FEMRA	32	13	45
MESHKUJ	10	19	29
GJITHSEJ	42	32	74

	FIN	INFOR	GJITH
VITI I	21	20	45
VITI II	21	12	29
GJITHSEJ	42	32	74

b) Analiza e mësimdhënies

Pyetjes: “Cili është mendimi i juaj për korrektësinë e pedagogëve në sallën e mësimit”, respondentët u përgjigjen sipas grafikëve në figurën 1

financa dhe fig. 2 informatika:




Fig.1 (Fin.)




Fig.2 (Inf.)

Është e lehtë të kontrollohet se mbi 71% janë rezultat “mirë” dhe “shumë mirë” te financa , ndërsa 44% te informatika; edhe grafiku tregon se Moda (vlera që shfaqet më shumë) është 4 te financa, e cila i korrespondon rezultatit “mirë”, ndërsa te informatika Moda është 3 (“mjaftueshëm”).

Pyetjes: “Cili është mendimi i juaj për kompetencën e pedagogëve në shpjegimin e lëndës”, respondentët patën rezultatet mirë dhe shumë mirë: Financa 67% , informatika 53% (Shih tabelën 2).

Tab.2

	Kompetenca	
	Financa	Informatika
Shumë dobët	1	2
Dobët	1	2
Mjaftueshëm	12	11
Mirë	23	13
Shumë mirë	5	4
Total	42	32

Pyetjes: “Cili është mendimi i juaj për të rejat që sjellin pedagogët në fushën e vet”, rezultatet mirë e shumë mirë janë në favor të informatikës, konkretisht 21% me 47%, megjithate po të shikohen rezultatet dobët dhe shumë dobët, te financa janë 29% te informatika mbi 34%.

Pyetjes: “*Cili është mendimi i juaj për formulimin e testeve*”, respondentët iu përgjigjën në mënyrë të pakënaqur, gati 70% e tyre të marrë së bashku (78% të Financa dhe 56% të Informatika), gjë që tregon se stafi akademik duhet t’i kushtojë vëmendje kësaj vërejtje dhe të reflektojë në të ardhmen.

Pyetjes: “*Cili është mendimi i juaj për komunikimin e studentëve me pedagogët*”, studentët e informatikës kanë rezultate mirë dhe shumë mirë në masën 59%, kurse ata të financës vetëm 42%. Ky rezultat i ulët në financë ka ardhur si pasojë se, në vitin e parë, ka një numër të konsiderueshëm studentësh që paraqesin ankesa për një pedagog të caktuar. Ky fakt do të pasqyrohet te vërejtjet dhe komentet e studentëve në pyetjen korresponduese.

Pyetjes: “*Cili është mendimi i juaj për gatishmërinë e pedagogëve për sqarime e konsultime jashtë klase*”, ka më tepër interes të tregojmë se te financa dobët dhe shumë dobët përgjigjen 59%, ndërsa të informatika afër 44%, gjë që tregon se edhe në këtë rast, stafi nuk tregon gatishmërinë e duhur si tutor (të cilën e për detyrë). Megjithatë, unë si pedagoge e një lënde në finance (viti I dhe informatikë viti II), pohoj se edhe pse gjatë gjithë kohës, e kam të shpallur orarin e konsultimeve, një numër shumë i vogël studentësh e shfrytëzon atë.

Pyetjes: “*Sa realizohet në përqindje programi mësimor*”, përgjigjet po t’i shohim në veçanti ose të marra së bashku si një popullim, japin vlerën e ulët, 25% , se mësimi realizohet në masën që do të duhej, 90-100% (figurat 3 dhe 4).



Fig.3



Fig.4

Pyetjes: “*Sa korrekt janë pedagogët në lidhje me vlerësimin tuaj*”, si një ndër pyetjet më bashkëkohore për universitetet shqiptare në përgjithësi, respondentët japin këto përfundime: Financa gati 75% janë të pakënaqur,

me probleme; vetëm rezultati “disi” ka 52% të respondentëve. Te informatika, pakënaqësia paraqitet në masën mbi 46%, por nga komentet e studentëve, del se ata si duket, kënaqen nga “mundësitë” që u ofrohen.

Pyetjes: “*Si e vlerësoni ju nivelin e plotësimit të nevojave tuaja me materiale të domosdoshme për mësim (tekste, leksione, materiale të tjera)*”, përgjigjet ishin për informatikën 63% me rezultate mirë dhe shumë mirë, ndërsa për financën, këto ishin në masën 57%; natyrisht kërkesat për më mirë janë të ligjshme.

C) Analiza e mësimnxënies

Sikurse është thënë më sipër, në pyetësor janë dhënë edhe një grup pyetjesh për mësimnxënien, dmth, sa është i angazhuar vetë studenti për t’u përgatitur profesionalisht nga fakulteti dhe dega që ka zgjedhur. Duhet të tregojmë se pyetësorët u janë dhënë studentëve në orët e leksionit, gjë që përgjithësisht tregon se ata janë nga studentët më të mirë apo më të interesuar të kursit.

Për pyetjen: “*Ju personalisht, sa kohë shpenzoni në ditë për mësimet*”, ka qenë mendimi ynë të kërkojmë sa kohë në një ditë studenti okupohet për mësimet, duke futur orët e mësimit në universitet dhe orët e përgatitjes, sepse duke qenë orari në universitet shumë i ndryshëm, në një ditë 2 orë dhe në një tjetër 8 orë, do të detyrohet ta shpërndajë edhe të mësuarin në përshtatje me këtë. Por, nga përgjigjet del se disa kanë treguar vetëm kohën e përgatitjes, kjo është arsyeja që te rezultatet e tyre ka edhe




Fig.5 (Financa)




Fig.6 (Informatika)

vlera “0”(figurat 5 dhe 6):

Pyetjes: “*Sa përqind është pjesëmarrja e juaj në leksione*” edhe për këtë pyetje ka rezultate të larta, sepse pjesëmarrësit në pyetësorë janë frekuentues leksionesh.

Pyetjes: “Sa e shfrytëzoni ju mundësinë e marrjes së pikëve gjatë vitit”, te financa përgjigjen mirë dhe shumë gati 90% e respondentëve, kurse te informatika janë më indiferentë, sepse ky rezultat është gati 60% .

Pyetjes: “*Ju personalisht keni kërkuar apo jeni konsultuar me pedagogët për ndonjë lëndë*”, përgjigjet janë: te financa 40% mirë e shumë mirë, te informatika, 34%, gjë që tregon se ata nuk janë vetë të interesuar.

Pyetjes: “*Seminaret zhvillohen sipas leksionit apo me literaturë plotësuese*”, rezultatet janë 75% e respondentëve sipas leksionit, pra ka pak lëndë që japin edhe literaturë plotësuese.

Pyetjes: “*Cilat janë rezultatet e tuaja të deritanishme*”, përgjigjet te financa, afër 5% janë dobët e shumë dobët, kurse te informatika, 34%.

Pyetjes: “*Sa kohë harxhoni ju personalisht në ditë për kafe e argëtim*”, del se mesatarja në të dy degët është e njëjtë, 1,67 orë; bile edhe të paktën dy orë shpenzojnë 50% te financa dhe 56% te informatika ose mbi 2 orë janë 26% te financa dhe 28% te informatika.




Fig.7 (Financa)




Fig.8 (Informatika)

Pyetjes: “*Sa lekë harxhoni ju personalisht në muaj për kafe e argëtim*”, del se ka studentë, të cilët nuk shpenzojnë dhe humbin kohën nëpër lokale, sepse nisen menjëherë në shtëpitë në komunat përreth. Ajo që të bën më shumë përshtypje në këto përgjigje është edhe sasia e madhe e shpenzimeve për kafe dhe argëtimin e disa studentëve, e cila arrin deri në shifrat 15000 lekë (të reja).




Fig.9 (Financa)




Fig.10 (Informatika)

Mesataret e llogaritura janë 3821 lekë për financën dhe 3406 për informatikën, që duken vlera të afërta, por për të qenë më të saktë në këtë përgjigje, ne zbatuam edhe hipotezën mbi barazimin e dy mesatareve, me hipotezë alternative që studentët e financës harxhojnë më shumë.

Duke pasur parasysh se zgjedhjet janë të mëdha (mbi 30), mund të përdorim kriterin Z' , me shpërndarje afërsisht normale, veçse duhet "rregulluar" devijimi standard $\sigma_{\sqrt{1-\bar{x}_2}}$, mbasi popullimet janë të fundme dhe raporti i vëllimeve zgjedhje/popullim është më i madh se 5%. Kështu, si rezultat i llogaritjeve, merret vlera e kriterit 0,49, e cila lejon të pranohet barazimi i mesatareve për çdo nivel rëndësie, deri në 30%.

Interesante këtu është se koeficientet e variacionit janë të mëdha, përkatësisht për financën 85% , kurse për informatikën 126%, që justifikon luhatjet e mëdha të shpenzimeve.

Pyetjes: "*Si e vlerësoni seriozitetin dhe angazhimin e grupit tuaj mësimor*", përgjigjet janë për financën afër 60% mirë dhe shumë mirë, kurse për informatikën afër 44%.

Për pyetjet: "*A mund të shënoni komentin tuaj personal për çdo problem të veçantë që keni hasur për ndonjë pedagog*" dhe "*Çfarë mendoni se duhet përmirësuar për të rritur cilësinë e formimit tuaj profesional*", studentët kanë shënuar një sërë mendimesh, ku shprehen edhe vlerësime në shkallë të lartë, por me qëllim që të përmirësojmë cilësinë, po shënojmë disa nga vërejtjet dhe sugjerimet e hasura më shumë:

A) VËREJTJE

1. Jo vlerësim objektiv i studentëve, me diferencime.
2. Ka mungesa në mësim: ka lëndë ku jepet më pak se gjysma e temave, deri vetëm 3 herë gjatë semestrit.
3. Ka raste të komunikimit jo të mirë me studentët dhe studenti ka frikë të shprehë mendimet e veta.
4. Ka lëndë që në tezë të provimit vendosen pyetje që nuk janë në literaturë dhe që nuk zhvillohen në leksion.
5. Ka raste që nuk pranohen ballafaqime për vlerësimin, vetëm shpallje të rezultateve.
6. Ka pedagogë që lexojnë në projektor, pa bërë shpjegime.
7. Infrastruktura lë për të dëshiruar në ekonomik; labororet në informatikë.

B) SUGJERIME

1. Studentët për degën e Informatikës duhet të zgjidhen me mesatare më të lartë. Ka shumë studentë të paformuar dhe me nivel të ulët matematiko-shkencor.

2. Studentët duhet të angazhohen më shumë për mësimnxënien. Ata kalojnë shumë kohë në kafë e argëtim.
3. Pedagogët duhet të zhvillojnë konsultime për çdo lëndë. Duhet të ketë pedagogë të aftë dhe të ndershëm, si dhe të ketë kontrolle për punën e pedagogëve.
4. Praktikë më shumë dhe lëndë më praktike.
5. Të ketë në programin mësimor të Informatikës më pak fizikë dhe matematikë.
6. Të jepet edhe literaturë ndihmëse në seminare dhe të ngarkohen më shumë studentët me detyra kursi.
7. Të ketë shkëmbime dhe eksperiencia midis profesorëve të universiteteve të tjera shqiptare e të huaja.

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME:

Në degët Financë-Kontabilitet dhe Informatikë ka shumë studentë të kënaqur nga performanca e stafit akademik përkatës dhe ka raste që respondentët falënderojnë pedagogë të veçantë. Për rritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe kënaqësisë së studentëve, kemi vendosur më sipër disa nga vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Më poshtë po e plotësojmë edhe me disa konstatime e mendime tonat:

1. Në departamentin e Informatikës nuk ka grup pune për rritjen e cilësisë dhe studentët nuk e njohin si problem, prandaj të shtrihet në të gjithë fakultetet e departamentet, ngritja dhe funksionimi i grupeve të kontrollit të cilësisë.
2. Fakulteti Ekonomik ka zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme pyetësorë me studentët lidhur me pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm ose pjesërisht. Ka grup të përcaktuar pune dhe merr pjesë në projekte ndërkombëtare me këtë objekt, rritjen e cilësisë.
3. Masivizimi i universiteteve nuk duhet të ulte cilësinë e formimit dhe të diplomimit të studentëve, por të merreshin masa për kontroll të vazhdueshëm për cilësinë e tyre.
4. Edhe vetë studentët kërkojnë që MAS të bëjë shpërndarjen e studentëve në degët që mund të japin më shumë dhe jo të plotësojë degë si Informatika me mesatare 5-6.
5. Shteti të investojë për infrastrukturën e nevojshme për universitetet publike dhe të mos lejojë që kjo të bëhet pengesë për vazhdimësinë dhe cilësinë e këtij universiteti apo fakulteti.
6. Dega e Financës preferohet dhe ndiqet edhe nga studentë shumë të mirë dhe me rezultate shumë të larta, kërkues dhe që ngrejné probleme për

- t'u zgjidhur; kurse në degën e Informatikës, përkundrazi, vitet e fundit studentët për t'u lavdëruar janë shumë të rrallë.
7. Ka probleme me stafin akademik (raste të rralla), prandaj mendojmë se duhet të ushtrohen kontrole nga organet drejtuese për plotësimin e ngarkesës mësimore në auditore, për cilësinë dhe vlerësimin e studentëve; të shpallet dhe të ndiqet orari i tutorit.
 8. Të rikthehet veprimtaria në departamente; të aprovohen tekstet dhe të azhurnohet puna shkencore e stafit.
 9. Studenti nuk duhet të detyrohet nga pedagogu të blejë librin.
 10. Të futet provimi i shtetit për të gjithë të diplomuarit.

LITERATURA:

1. S. Bushati, A.Troshani (2013): "Sigurimi i brendshëm i cilësisë, faktor i rëndësishëm për të arritur rezultate të kënaqshme", Buletini Shkencor (seria e shkencave ekonomiko-juridike, nr. 7), i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".
2. "Standarde dhe udhëzime për sigurimin e cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë", Shoqata "ENQA", Helsinki, 2005, përkthyer në shqip nga APAAL, 2007.
3. "Udhëzime mbi ngritjen e sistemit të brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri", APAAL, tetor, 2012.
4. "Manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë", APAAL, tetor, 2012.
5. "Eksperiencia e fituar në sigurimin e cilësisë në Universitetin e Grazit-Austri, 7-11 prill 2014", prof. dr.Arjeta Troshani.
6. "Ekzaminimi i kulturës së cilësisë", Andree Sursock; Oliver Vettori, EUREQA, EUA, 2014.
7. "Working together to take quality forward", EUA, Case studies, 2014.

**LUFTA NDAJ KORRUPSIONIT
SI FAKTOR I RËNDËSISHËM I RRRITJES
SË CILËSISË NË ARSIM**

Arjeta Fregjaj, Bledar Plori, Arjeta Anamali

*Asistent Avokate; Inspektor Taksash, Komuna Rrethina;
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi“, Fakulteti Ekonomik*

**Fighting corruption as an important factor in increasing
education quality**

ABSTRACT

Education is a fundamental human right and a major driver of personal and social development. The right to be educated means that the functioning of institutions and academic system should be qualitatively valid and accessible to all.

The most discussed topic recently in Albania is corruption in education, this highly controversial topic in public opinion polls, or visual media programs and writing sections of that. According to the survey conducted by Transparency International in 2012, Albania ranks 113-th out of 176 countries surveyed members, suffering a significant decline from 18 countries, compared to 2011, which ranked 95-th³⁷². According to this survey it is clear that Albania country have moved backward in this fight against corruption, being classified as among the most corrupt country in Europe. Corruption risks can be found in every level of education and research systems, from procurement of resources to procedures on hiring professors, etc.. Transparency International defines corruption as 'the abuse of entrusted power for private gain'. Global Corruption Report concludes

³⁷² <http://www.transparency.org/cpi2012/results>

International, T. (2012). *Corruption perception index*. Pg2.

that corruption can be found in every level of education and research systems, even before you enter the doors of the school till to obtain scientific degrees.

This paper led students through a questionnaire designed to identify, what is corruption in education, what are the consequences of corruption in education, if does corruption in education affects the lives of citizens and the fate of the future of society, and how to fight it.

This paper issues the conclusion that from the global to the local level, corruption in education should be seen as an obstacle to realize right education and safe development.

Key words: education; corruption; surveys; quality.

Hyrje

Fillesat e korrupsionit datojnë që me lindjen e organizimit shoqëror, ata kanë qenë dhe janë bashkudhëtar me njëri-tjetrit. Ai është i pranishëm në çdo vend të botës, kështu që nuk kishte se si Shqipëria të kishte imunitet ndaj kësaj dukurie. Korrupsioni shihet më shumë si një problem alarmant në vendet postkomuniste se sa në shtetet perëndimore. Kalimi i Shqipërisë nga shoqëri komuniste në një shoqëri demokratike, bëri të mundur, që korrupsioni të shfaqej në të gjitha format e tij dhe të prekë të gjitha institucionet pa përjashtim. Duke kaluar në një periudhë tranzicioni shumë të gjatë, Shqipëria shihet si një vend, që është e zhytur në korrupsion dhe që po përmbetet prej tij çdo ditë e më tepër.

Korrupsioni është një dukuri negative, e cila pengon zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të një vendi. Kjo dukuri me të drejtë quhet “kancer i shoqërisë”, sepse një njeri i prekur nga kanceri e humb imunitetin, ndërsa një shtet me shkallë të lartë të korrupsionit humb besueshmërinë e qytetarëve.³⁷³ Siç thekson edhe TIA, Shqipëria po bën hapa prapa në luftën kundër korrupsionit, duke u bërë shteti me i korruptuar në Evropë.³⁷⁴

Duke analizuar këto që thamë më sipër, lind pyetja çfarë është korrupsioni? Korrupsioni është një fjalë shumëdimensionale, dhe për të janë dhënë shumë përkufizime. Trasparency Internacional e përkufizon korrupsionin si “*abuzimi me pushtetin, që i është dhënë, besuar një personi,*

³⁷³ Anechiarico, F., & Jacobs, J. B. (1996). Towards an absolute integrity: How corruption control makes government of non-effective. *Chicago Press*. pg 11.

³⁷⁴ <http://tia.al/> “CPI 2012”

i cili këtë pushtet të besuar e përdor për përfitime personale, vetiake”.³⁷⁵ Çdo kush që i shërben vetes në mënyrë jomorale dhe joetike, është i korruptuar. Me fjalë të tjera, korrupsioni blen apo shet vendime, duke shkelur drejtësinë. Drejtësia mund të marrë ose formë ligjore (kur shkelet një normë e shkruar) ose një formë morale (kur nuk ka standarde të vendosura të mirësjelljes, por që ekziston ndjenja e përbashkët se një vepër e tillë është e padrejtë).

Në këtë punim ne kemi analizuar korrupsionin në arsimin e lartë. Kemi zgjedhur të bëjmë një analizë të kësaj teme për arsyen. E drejta për arsim është një e drejtë themelore e njeriut, e cila mbrohet nga kushtetuta. Korrupsioni dhe qeverisja jo e mirë, bëjnë të mundur që kjo e drejtë themelore e njeriut të mos realizohet ashtu siç duhet për të arritur objektivat e saj. Arsimi shërben si një mjet për të forcuar integritetin personal të çdo njeriu, ai gjithashtu është çelësi i krijimit të një të ardhmeje më të mirë. Në çdo ditë e më tepër po shohim degradimin e arsimit të lartë shqiptar dhe masat e marra për këtë gjë janë shumë të pakta. Po shohim se si çdo ditë po shkatërrohen vlerat dhe po ngrihet në këmbë fuqishëm një sistem antivlerash. Korrupsioni ka hyrë shumë thellë në arsim. Atë e gjejmë, që pa hyrë ne dyert e universiteteve. Në universitetet publike, progresi akademik dhe cilësia që ato kanë, lënë shumë për të dëshiruar. Këtë gjë po e dëshmojnë çdo ditë e më tepër diplomimet pa kriter që po bëhen, të cilat janë të pastudiura mirë në lidhje me kërkesat, që ka tregu aktual ekonomik i shoqërisë tonë dhe kjo gjë ka sjellë shumë probleme me papunësinë në Shqipëri.

Në këtë punim ne kemi analizuar korrupsionin në arsim, me anë të disa pyetësorve që kemi përgatitur dhe ia kemi drejtuar studentëve, sepse studentët janë viktimat e para të cilat preken drejtpërdrejt nga korrupsioni dhe kjo gjë ndikon fuqishëm në formimin e dinjitetit të tyre dhe bën që ata të demoralizohen. Në këtë punim ne kemi analizuar se, cilat janë shkaqet e shfaqjes të korrupsionit në arsim, cilat janë pasojat dhe masat, që duhen marrë për parandalimin dhe luftimin e tij.

Background teorik

▪ Përkufizimi i korrupsionit

Korrupsioni në sektorin e arsimit mund të përkufizohet si “*përdorim sistematik i zyrave publike për përfitime private, impakti i të cilit është*

³⁷⁵ http://www.transparency.org/whoweare/organisation/faqs_on_corruption/2/

*domethënës në vlefshmërinë dhe cilësinë e arsimit dhe si pasojë dhe në aksesin, cilësinë dhe barazinë në arsim*³⁷⁶.

▪ **Format e korrupsionit në sistemin e arsimit**

Korrupsioni në arsimin e lartë mund të shfaqet në forma të ndryshme. Ndër këto forma të shfaqjes së tij mund të përmendim³⁷⁷:

- Përvetësimin: vjedhjen e burimeve publike nga zyrtarët publikë.
- Rryshfetin: (pagesën në të holla) Si, p.sh., mund të përmendim marrjen e provimit duke paguar para, rekrutimin në punë (edhe në qoftë se ai nuk i përmbush kushtet e nevojshme për atë pozicion).
- Mashtrimin: llojin e krimit ekonomik, p.sh marrjen e një diplome fallco, ose ekzistencën e emrave të profesorëve joekzistentë në bordero.
- Favorizimin: mekanizmin, që përfshin rastet e nepotizmit, në të cilin një zyrtar publik, i jep përparësi pjesëtarëve të familjes së tij ose pjesëtarëve të fisit të tij. Kjo gjithashtu përfshin rastet e rekrutimit në një pozicion pune të atyre personave, të cilët janë militantë të qeverisë në fuqi.

▪ **Tipet e korrupsionit**

Korrupsioni, gjithashtu përfshin aktivitete të ndryshme, si: neopotizëm, favorizime dhe konflikte interesi, ku punët në sektorin publik ose përfitimet, janë të kanalizuar në mënyrë të paligjshme tek familja, miqtë ose përfitimet nga interesi i vetë vendimmarrësit.

Në institucionet publike mund të dallojmë dy kategori të korrupsionit (Fig. 1): niveli i lartë - “*upper level*” dhe niveli më i ulët - “*lower level*”.³⁷⁸



Figure : Kategorite e korrupsionit

³⁷⁶ Hallak, M., & Poisson, J. (2007). Corrupt school, corrupt universities: What can be done? Pg.29.

³⁷⁷ Madhusudan Sharma Subedi. *Corruption In Nepal: An Anthropological Inquiry*. Pg 2-3.

³⁷⁸ Morris, S. D. (2/2011). *Forms of corruption*. CESifo DICE Report. Pg 10.

Niveli i lartë përfshin ministra, qeveritarë, zyrtarë të nivelit të lartë, rektorë e të tjerë zyrtarë, ndërsa në *nivelin e ulët*, korrupsioni lidhet me nënpunësit civilë, në rastin e sitemit të arsimit lidhet me dekanë; shefë departamentesh; administratë; pedagogë.

▪ **Korrupsioni në Shqipëri**

Vitet e fundit kemi dëgjuar, që korrupsioni ka kapur shifra të larta, duke sjellë një shqetësim të madh në mbarë botën. Sigurisht, shumë faktorë janë përgjegjës për këtë fenomen. Duke e parë që korrupsioni është universal, ky fenomen është një problem, si i vendeve që janë të zhvilluara gjithashtu dhe në ato vende që janë në zhvillim. Korrupsioni është një fenomen tejet i vështirë për t'u studiuar, e për më tepër matja e tij. Korrupsioni në arsimin e lartë është i vështirë për t'u përcaktuar. Ajo që është konsideruar të jetë një sjellje e korruptuar nga disa, mund të konsiderohet e pranueshme apo normale nga disa të tjerë. Ajo që mund të perceptohet si favorizim apo nepotizëm në një kulturë, mund të konsiderohet si mbështetje familjare, apo marrëdhënie miqësie në një kulturë tjetër.

Për herë të parë, në Shqipëri, fenomeni i korrupsionit në arsim është studiuar nga Banka Botërore në vitin 2006.³⁷⁹ Nga ky studim rezulton, që shkaqet e korrupsionit në arsimin e lartë në Shqipëri janë: keqfinancimi i fondeve, mosqeverisja e mirë, menaxhimi jo i mirë. Gjithashtu, janë kritere dhe standarde të paqarta në procedurat e konkurseve, emërimeve, promovimit, dhe në vlerësimin e performancës së mësimdhënies.

Korrupsioni në arsim në vendin tonë mund të shihet si një fenomen, i cili për vite me radhë është toleruar, megjithatë aspirata, që vendi ynë ka për të iu bashkuar BE-së, ka bërë që nga Ministria e Arsimit, të implementohen strategji të reja në lidhje me luftën ndaj korrupsionit. Kjo aspiratë, është në vetvete një presion për të zbatuar dhe për të implementuar reforma të reja, gjithashtu dhe mekanizma të posaçme për monitorimin në procesin e luftës kundër korrupsionit.

Ndër masat kryesore të strategjisë mendohet të jenë analizat periodike dhe krijimi i një sistemi eficient për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve për çdo rast të denoncuar, si dhe një hap shumë i rëndësishëm është largimi një herë e mirë i arsimit nga politika.

³⁷⁹ Korrupsioni ne arsim eshte studiuar per here te pare nga Banka Boterore ne Shqiperi ne 2006.

http://www.worldbank.org/404_response.htm/external/topics/extpublicsectorandgovernance/extpublicfinance/extpeam/0,,contentmdk:20235447~pagepk:210058~pipk:210062~thesitepk:384393.00.html>

Vlerësimi i deformuar i studentëve gjatë provimeve apo dhe shitblerjet e provimeve, janë korrupsioni më dëmprurës për cilësinë e dobët të të diplomuarve në universitetet shqiptare. Ndaj nevojitet një reformë e thellë, e cila kërkon pjesëmarrjen dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve dhe faktorëve në sistemin tonë universitar, si p.sh., konsumatorët e sistemit, qoftë studentët, qoftë prindërit. Në Programin e Qeverisë 2013-2017 (faqe 23)³⁸⁰ thuhet se “*Qeveria jonë do të intensifikojë ndjeshëm luftën kundër korrupsionit, duke çmontuar murin e paprekshmërisë e pandëshkueshmërisë*”.

Kërkimi dhe rezultatet

Metodologjia

Për realizimin e këtij pyetësoi janë përdorur të dhënat dytësore dhe të dhënat parësore.

Të dhënat dytësore, u referohen studimeve, sondazheve dhe publikimeve të ndryshme, të cilat kanë të njëtin subjekt studimi me punimin tonë.

Të dhënat parësore, janë realizuar nëpërmjet një anketimi me pyetësorë, ku si objekt anketimi kanë qenë studentët e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Në kuadër të këtij anketimi kemi përzgjedhur si ‘kampion’ studentë të viteve të treta të sistemit *bachelor* të 6-të fakulteteve të Universitetit të Shkodrës (Fakulteti i Shkencave Shoqërore; Shkencave të Natyrës; Shkencave të Edukimit; Ekonomik; Drejtësisë dhe Gjuhëve të Huaja), në mënyrë që mostra të jetë sa më përfaqësuese. Pyetësorët janë plotësuar gjatë muajit janar-shkurt, periudhë në të cilën studentët ishin në sezon provimesh. Janë shpërndarë 300 pyetësorë dhe po 300 janë plotësuar. Shpërndarja është bërë në auditoret e universitetit, jo në prezencë të pedagogëve, me studentë me nivele të ndryshme mesatareje. Pyetësorët kanë qenë gjysmë të strukturuar, me pyetje të mbyllura dhe pyetje të hapura.

Hipoteza

Korrupsioni në arsim sjell pasoja në zhvillimin e shoqërisë.

Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi është të evidentojmë nivelin e korrupsionit në sistemin e lartë universitar dhe të paraqesim pasojat, që sjell korrupsioni në zhvillimin e shoqërisë.

Objektivat mbi:

- ✓ Evidentimin e nivelit të korrupsionit në sistemin e lartë arsimor;


³⁸⁰ <http://www.mash.gov.al/LAJMET%20E%20DITES/konferenca-antikorrupsioni-ne-arsim.htm>

- ✓ Paraqitjen e pasojave, që ky fenomen i sjell arsimit;
- ✓ Studimin e pasojave që sjell korrupsioni në të ardhmen e shoqërisë;
- ✓ Nxitjen e politikave antikorrupsion në sektorin e arsimit;
- ✓ Paraqitjen e rekomandimeve për ta luftuar korrupsionin në arsimin e lartë.

Analizë pyetësori

Siç theksohet edhe gjatë punimit, ky studim ka si subjekt, analizimin e nivelit të korrupsionit në sistemin e lartë. Si rast studimi /anketimi, janë marrë studentë nga të gjashtë fakultetet e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Të gjithë studentët e anketuar kanë dalë nga sistemi i maturës shtetërore, projekt i cili ka hyrë në Shqipëri në vitin 2005, si një sistem i menduar për të bërë kategorizimin e nxënëve sipas vlerave. Kur studentët pyeten nëse realisht ato mendojnë se ky sistem është i rregulluar mirë për të shfaqur meritokracinë e çdo nxënësi, 67% e studentëve të pyetur mendojnë se, matura shtetërore nuk është një sistem i rregulluar mirë për të shfaqur meritokracinë e çdo studenti për të hyrë në universitet. Grafiku nr.1:




Por, pa dashur të ndalemi në analizimin e pikave të forta dhe të dobëta të këtij sistemi, ne u jemi drejtuar studentëve vetëm me pyetjen se, nëse ky sistem u ka lejuar atyre të fitojnë degën që kanë dëshiruar? 53% e studentëve na përgjigjen po dhe 47% jo.

Por, a fillon manipulimi apo dhe korrupsioni, që në momentin, që këto nxënës aderojnë të jenë studentë të një fakulteti? Edhe pjesa më e madhe e studentëve, rreth 75% përgjigjen jo, nuk besojmë se 25% e atyre që përgjigjen po është një përqindje e vogël, ku të dy format në të cilën përpjesëtohet kjo përqindje janë: 3% duke paguar dhe 22% ndihmesë nga të afërm/ të njohur.

Studentët e shohin arsimimin e tyre në universitet si rrugën kryesore, që ata duhet të ndjekin për të ardhmen e tyre. Por, a është kjo

rrugë vërtet aq e drejtë sa ata e presin? Zhgënjimi shfaqet, që në momentin kur ato shohin të ulur pranë tyre shokë, që nuk i njohin (thjesht janë njohur me emrat e tyre në regjistër), apo edhe që qartazi janë të njohur me faktin, që shoku ka kaluar 25% e mosprezencës në orët mësimore të detyrueshme.

Gjithë qëllimi i këtij studimi ka qenë evidentimi i faktit nëse ekziston korrupsioni në universitet dhe në çfarë niveli. Kur, studentëve iu drejtohet kjo pyetje, rezultati nuk qëndron larg anketimeve të mëparshme, apo dhe të pritshmërive tona. Ky rezultat shihet i shprehur në grafikun nr.2.



Studentët të cilët pohojnë faktin që ka korrupsion në marrjen e provimeve në fakultetet që ata studiojnë, selektojnë se forma më e përhapur në marrjen e provimeve, është nëpërmjet lekëve 45%; 30%, nëpërmjet ndërhyrjes së miqve; 18% pranojnë, se meritokracia është vlerë e paevitueshme dhe 7% nga kurse private me pedagogun.

Edhe pse rëndon të thuhet, 68% e studentëve pranojnë, që kanë paguar të paktën një herë për një provim dhe ku vlera mesatare e pagesës rezulton të jetë rreth 15 mijë lekë, tarifë kjo, që varion shumë në bazë të krediteve të lëndës apo dhe të degës që ata studiojnë.

Pyetjes nëse kërkesa për të blerë provimin vjen direkt apo indirekt nga pedagogu, 92% përgjigjen indirekt dhe 8% direkt. Shumë e rëndësishme të theksohet është dhe fakti se cilat janë arsyet, që çojnë drejt këtij fenomeni? 5% mendojnë se kjo vjen si rezultat i pagave të ulëta që pedagogët kanë, 23% të nxitur nga niveli i ulët i përgatitjes, që kanë studentët dhe 72% nga mungesa e mekanizmave të kontrollit të korrupsionit në universitete.

Duke u bazuar në të gjitha këto rezultate, rishtazi lind pyetja nëse duhet të pohojmë apo të bëjmë një përgjithësim, që të gjithë pedagogët janë të korruptuar? Këtu marrim një përgjigje paksa skeptike me rezultatet e sipërlistuara, sepse vetëm 20% mendojnë që po; 2% refuzojnë të përgjigjen

dhe 78% preferojnë të mos bëjnë një përgjithësim për profesorët e tyre. Një element shqetësues për studentët evidentohet të jetë fakti që shumë pedagogë po botojnë pa kriter literatura, duke e kthyer këtë në një biznes personal. Nga 300 studentët e anketuar, 100% e tyre pohojnë, që atyre iu kërkohet detyrimisht të blejnë librat/literatura/ leksionet, që ata kanë botuar-realizuar.

7% e studentëve na pohuan më sipër, që atyre iu kërkohet të bëjnë kurse private. Pjesa më e madhe e studentëve deklarojnë, që kjo mundësi krijohet nga vetë pedagogu, duke e lidhur indirekt këtë mundësi gjoja me vështirësinë e lëndës.

Dimë, që pedagogu ka një orar fleksibël mësimi, mundësi kjo, që i lejon të merren dhe me punë apo aktivitete të tjera. Por, a tregohen ato gjithmonë korrekt në paraqitjen në leksione/seminare? 20% e studentëve deklarojnë, që pedagogët mungojnë rrallë; 60% nganjëherë; 20% shpesh. Duhet theksuar, që ky rezultat varion në bazë të fakulteteve.

Nuk gabohemi nëse pohojmë, që korrupsioni mund të jetë një formë e një pedagogu, i cili dhe në postin vet është vendosur nga një formë e tillë. Ndaj kur studentëve u kërkohet të vlerësojnë aftësitë në mësimdhënie të pedagogëve në raport me pozicionin që ata mbajnë, rezultatet janë këto:


Garfik nr.3




E paraqitur dhe grafikisht shohim, që 45% mendojnë që pedagogu nuk është në atë pozicion falë aftësive dhe meritave të tij. Por, nëse një pedagog nuk është vendosur falë meritokracisë, cilat janë opsionet e nxënies së postit? 13% mendojnë, që duke paguar, 20% miqësi në rang rektorati apo ministror, 12% militantë partie.

Rishtazi dëgjojmë të flitet për denoncime, a kanë denoncuar studentët tanë padrejtësitë, që mendohet të iu jenë bërë në vlerësime ose për më tepër raste të korrupsionit?

Grafik nr.4



Argumentimi për mosdenoncim të pedagogëve shprehet me fatet, që edhe në rastet kur ka pasur denoncime, rezultatet kanë qenë gjithmonë në favor të pedagogut. Theksohen këtu raste të Fakultetit Juridik, ku edhe pse ka pasur dosje në prokurori apo edhe arrestime, profesorët vazhdojnë të mbajnë postet dhe denoncimet janë sheshuar me motivacionin mungesë provash.



Grafiku nr. 5

Disa nga format për minimizimin e korrupsionit sipas tyre mund të jenë nëpërmjet sekretimit të provimeve; kontrolleve të rrepta nga dekanati; rritjen e ndërgjegjësimit të vetë pedagogëve për dëmet që sjell ky fenomen

në brezat, të cilët ato nxjerrin; marrjen e masave drastike kundrejt pedagogëve në rast evidentimi të rasteve të tilla; përdorimin e pyetësorëve të fshehur çdo fund sezoni me subjekt nxjerrjen e emrave; nxitjen e studentëve në denoncimin e rasteve të tilla; korigjimin brenda ambienteve të universitetit të survejuara me kamera.

Përsa u përket opinionit të tyre mbi dëmet, që mund t'i sjellë ky fenomen të ardhmes së shoqërisë, studentët shprehen fuqishëm, se dëmet kanë vite, që kanë filluar dhe kjo manifestohet dukshëm nga shifrat e papunësisë, ku sipas një relacioni të nxjerrë nga Instat (2013), niveli i papunësisë mban shifrën 13.4% për vitin 2012 në rang kombëtar.³⁸¹

Pyetjes se kush mendon, që mund të marrë reforma kundrejt këtij fenomeni shqetësues: 25% universiteti/rektorati; 42% ministria e arsimit; 3% vetë pedagogët; vetë studentët. Nga studentët e intervistuar 67% u përkasin gjinisë femërore dhe 43% gjinisë mashkullore.

KONKLUZIONE

Ky studim është ndalur në studimin e nivelit të korrupsionit në sistemin e lartë universitar, si dhe në pasojat, që sjell korrupsioni në zhvillimin e shoqërisë.

Nga të dhënat dytësore ashtu si dhe nga ato parësore, nxjerrim si konkluzion, që niveli i korrupsionit në arsimin e lartë ka kapur shifra të larta, një fenomen shqetësues ky, si për vendet e zhvilluara ashtu edhe ato në zhvillim. Nga rezultatet e anketës shihet që problemet fillojnë, që nga sistemi i maturës shtetërore; sistemi *bachelor* e deri në marrjen e titujve shkencorë. Një fenomen shumë shqetësues është korrupsioni në marrjen e provimeve. Marrja e provimeve bëhet në mënyra të ndryshme. Shumica e studentëve pranojnë, që kanë paguar të paktën një herë për të marrë provimin dhe vlera varion në bazë të krediteve të lëndës apo dhe degës, që ata studiojnë. Provimi, gjithashtu merret me ndërhyrje, me miq dhe duke bërë kurse nga pedagogu. Një element tjetër shqetësues për studentët është edhe fakti se shumë pedagogë po botojnë pa kriter literatura, duke e kthyer këtë në një biznes personal. Nje numër i vogël studentësh kanë denuncuar korrupsionin, kjo sepse ata nuk kanë besim tek drejtësia dhe nuk mendojnë, që denoncimi është një mënyrë, që do të sillte rezultate.

Pasojat e korrupsionit janë shumë të dëmshme për shoqërinë. Kjo po evidentohet çdo ditë e më tepër në papunësinë, që ka kapluar mbarë vendin. Pjesa më e madhe e të papunëve janë persona që kanë mbaruar

³⁸¹ *Instat*. (2013). Retrieved from www.instat.gov.al

universitetin. Ministria e Arsimit duhet të marrë masa për minimizimin e korrupsionit, gjithashtu Universiteti, Rektorati, vetë pedagogët dhe vetë studentët.

REKOMANDIME:

Ndërmarrja e reformave antikorrupsion në arsim dhe krijimi i mekanizmave të posaçme për kontrollin kundër tij, janë masa parësore, të cilat duhen të ndërmerren. Gjithashtu, duhet që sistemi i drejtësisë të jetë i pavarur dhe të ketë një efikasitet të gjykatave në luftimin e korrupsionit, gjë që do t'i krijonte besim studentëve në denoncimin e rasteve. Organizatat ndërkombëtare, organizatat jofitimprurëse, si dhe gjithashtu mediat, luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Bashkëpunimi i këtyre do të bënte të mundur shkëmbimin e informacionit rreth indikatorëve të korrupsionit. Duhet të krijohet një organ i pavarur i studentëve në çdo universitet, për të monitoruar dhe për të raportuar rastet e korrupsionit në universitet.

Duhet të organizohen fushata antikorrupsion, për të arritur ndërgjegjësimin dhe njoftimin e publikut. Organizmi i seminareve dhe i workshopeve të ndryshme, në lidhje me pasojat që sjell korrupsioni në arsim dhe në shoqëri.

Edukimi i shoqërisë është çelësi kyç në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Është një pjesë integrale e ngritjes së vetëdijes së publikut nga pikëpamja e promovimit të integritetit personal, përgjegjësisë qytetare, të kuptuarit e të drejtave të njeriut dhe detyrave ndaj shtetit dhe të shoqërisë. Njohja me dukurinë e korrupsionit, me shkaqet, arsyet dhe pasojat e tij, si dhe luftimi i këtij fenomeni, janë përgjegjësi e çdo hallke të sistemit drejtues arsimor.

BIBLIOGRAFI:

1. Anechiarico, F., & Jacobs, J. B. (1996): *Towards an absolute integrity: How corruption control makes government of non-effective*. Chicago Press . Pg 11.
2. Hallak, M., & Poisson, J. (2007): *Corrupt school, corrupt universities: What can be done?* Pg. 26.
3. International, T. (2012): *Corruption perception index*. Pg.2
<http://www.transparency.org/cpi2012/results>
4. *Instat*. (2013): Retrieved from www.instat.gov.al
5. Morris, S. D. (2/2011): *Forms of corruption*. CESifo DICE Report. Pg 10.
6. Madhusudan Sharma Subedi. *Corruption In Nepal: An Anthropological Inquiry*. Pg 2-3.
7. <http://tia.al/> “CPI 2012”.
8. http://www.transparency.org/whoweare/organisation/faqs_on_corruption/2/

9. http://www.worldbank.org/404_response.htm/external/topics/extpublicsectorandgovernance/extpublicfinance/extpeam/0,,contentmdk:20235447~pagepk:210058~pipk:210062~thesitepk:384393,00.html>
10. <http://www.mash.gov.al/LAJMET%20E%20DITES/konferenca-antikorrupsioni-ne-arsim.htm>

MODELET E NDËRVARËSISË DHE ROLET ORGANIZACIONALE

Sanie Doda

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

ABSTRACT

The models of interdependence and organizational roles

The study aims to analyze the importance of human resources, patterns of interdependence and roles organizationle to identify important links between the firm's strategy, its human resources, and performance results. Many organizations have paid attention to the roles to improve organizational performance. In an organization, individuals must koperojnë between respecting their roles in the organization they represent.

Type of interdependence that unites individuals together in interpersonal relationships has several important managerial implications. The manager should be the one that helps employees to recognize their role and work based on tasks that designated organizations to achieve strategic objectives.

Communication can be a tricky concept to master within an organization, particularly one with complex levels and multiple issues. When all parts of the organization communicate smoothly, it can improve workflow and overall productivity. By making an effort to improve the communication processes, we can build a stronger company that will have staying power in the market.

Keywords: Role, human resource, communication, organization

1. Modelet e ndërvarësisë dhe rolet organizacionale

Individët në organizata ndajnë një varietet të pasur lidhjesh. Puna e tyre mund të kërkojë që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin si pjesë e rregullt

e performancës së punës³⁸². Ata duhet të lidhen së bashku dhe të ndajnë burime, siç është aksesimi në pajisjet e vlefshme ose burimet financiare, edhe kur puna e tyre nuk kërkon kontakt të drejtpërdrejtë mes individëve. Lidhjet e tilla i bëjnë marrëdhëniet ndërpersonale shumë të rëndësishme në jetën organizative. Ndërmjet individëve dhe grupeve, këto marrëdhënie marrin formën e modeleve ndërvarësore³⁸³.

Llojet e ndërvarësive³⁸⁴

Në vendin e punës, ndërvarësia zakonisht merr një nga katër format e mëposhtme:

- Në formë të grumbulluar.
- Në formë vijuese.
- Reciproke.
- Gjithëpërfshirëse.

Ndërvarësia grumbulluese, ndodh kur njerëzit hartojnë resurse nga një burim i ndarë, por kanë pak gjëra të përbashkëta. Resurset e grumbulluara së bashku në këtë mënyrë mund të përfshijnë para, paisje, materiale të papërpunuara, informacion ose ekspertizë. Si forma më e thjeshtë e ndërvarësisë, kjo kërkon pak ose aspak marrëdhënie ndërpersonale.

Ndërvarësia vijuese, konsiston në një zinxhir drejtimesh, ndërveprimesh, në të cilin njerëzit varen nga ata individë, të cilët paraprijnë në zinxhirë. Personat më të hershëm në zinxhirë qëndrojnë të pavarur nga ata që i ndjekin. Në këtë mënyrë marrëdhëniet në ndërvarësinë vijuese është e thënë të jetë asimetrike, pra që disa njerëz varen nga disa të tjerë që nuk varen nga ta. Për shembull, punonjësit që punojnë në një linjë montimi, ku manifakurojnë pajisje për zyra, janë të lidhur sipas formës vijuese. Punonjësit më të hershëm në linjë prodhojnë pjesë të montueshme që kompletohen më vonë në linjë.

Është shumë e natyrshme që ndërvarësia vijuese parandalon njerëzit në fund të zinxhirit të performojnë punën e tyre, nëse njerëzit në krye të këtij zinxhiri nuk e kanë përfunduar të tyre. Nga ana tjetër, njerëzit në fillim të zinxhirit, mund t'i kryejnë detyrat e tyre, pavarësisht se çfarë bëjnë personat në fund të tij. Kërkimet tregojnë se sisteme vijuese si ky janë

³⁸² Oakland, J.S. (2000). Total organizational excellence: Achieving world-class performance. Oxford: Butterworth-Heinemann, pp 246

³⁸³ Champoux, J. E. (1996). Organizational behaviour: Individual, groups, and processes. Minneapolis: West. pp. 12

³⁸⁴ Robert Grant and James C. Hayton, interdependencies between People in Organizations, *The Oxford Handbook of Human Capital*, 2011, pp 17-25

shumë të ndjeshëm si nga diferencat mes njerëzve në performancat e tyre³⁸⁵ (dy punonjës që operojnë me shpejtësi të ndryshme), ashtu edhe nga i njëjti person në kohë të ndryshme (një punëtor që operon më shpejt në mëngjes dhe më ngadalë mbasdite). Në këtë mënyrë, njerëzit e varur ndihen më të stresuar dhe më pak të fuqishëm në këtë marrëdhënie asimetrike se sa ata që nuk varen nga askush në zinxhirë.

Në ndërvarësinë reciproke, një rrjet pune me dy kahe marrëdhëniesh, lidh një koleksion njerëzish së bashku. Një shembull i mirë i kësaj ndërvarësie është marrëdhënia mes forcës shitëse dhe stafit të zyrës. Përfaqësuesit e shitjeve mbështeten tek punonjësit e zyrës në plotësimin e faturave, ndërsa punonjësit e zyrave varen nga shitësit në gjenerimin e shitjeve. Ndërvarësia reciproke ndodh gjithashtu ndërmjet antarëve të stafit të një spitali, ku doktorët varen nga infermieret në kontrollin e vazhdueshëm të pacientëve, administrimin e medikamenteve dhe në raportimin e simptomave alarmante. Kurse infermieret, varen nga doktorët në përshkrimin e medikamenteve dhe në specifikimin e natyrës së simptomave të lidhura me komplikacione potenciale.

Ndërvarësia reciproke gjithmonë përfshin një lloj ndërveprimi të drejtpërdrejt, si komunikimin ballë për ballë, bisedat telefonike, etj. Si rezultat, njerëzit që janë reciprokisht të ndërvarur janë të lidhur më ngusht se ata që bëjnë pjesë në ndërvarësinë grumbulluese ose vijuese. Ndërvarësia reciproke përfshin marrëdhënie me dy kahe, pra simetrike. Natyra simetrike e kësaj marrëdhënieje i bën njerëzit të ndihen më të barabartë mes tyre, si dhe ndikon në promovimin e një sjelljeje të vlefshme nga të dy krahët.

Ndërvarësia gjithëpërfshirëse, zhvillohet në një ambient të ngushtë të ndërvarësisë reciproke. Është forma më komplekse e ndërvarësisë, pasi çdo kush i përfshirë është reciprokisht i ndërvarur me të tjerët. Në ndërvarësinë reciproke, njerëzit që varen nga njëri-tjetri ndërverpojnë direkt, kurse në atë gjithëpërfshirëse, nga ana tjetër, këto ndërveprime tentojnë të jenë më frekvente, më intensive dhe me kohëzgjatje më të madhe se llojet e tjera të ndërvarësive.

Për shembull në grupin e menaxhimit të markave që vëzhgon zhvillimin e produkteve të reja në firma të tilla, si: Colgate-Palmolive dhe Procter & Gamble, dizenjuesit e produktit, kërkuesit e tregut, inxhinierët e prodhimit dhe përfaqësuesit e shitjeve, janë të gjithë të lidhur nga një rrjet pune totalisht marrëdhëniesh dy kahëshe. Dizenjuesit e produktit

³⁸⁵ Oakland, J.S. (2000). Total organizational excellence: Achieving world-class performance. Oxford: Butterworth-Heinemann pp 248.

ndërveprojnë me kërkuesit e tregut, inxhinierët e prodhimit dhe përfaqësuesit e shitjeve. Kërkuesit e tregut gjithashtu bashkëveprojnë me inxhinierët e produktit dhe stafin e shitjes, i cili në anën tjetër ndërvepron me njëri-tjetrin.

2. Implikimet e ndërvarësisë

Lloji i ndërvarësisë që bashkon njerëzit së bashku në marrëdhëniet ndërpersonale ka disa implikime menaxheriale të rëndësishme.

Së pari, një potencial i madh për konflikt rritet me rritjen e kompleksitetit të ndërvarësisë gjatë lëvizjes së saj nga ndërvarësi e tipit të grumbulluar në atë gjithëpërfshirëse. Ndarja e një numri të madh ndërveprimesh dhe të qenurit i lidhur ngusht, rrit gjasat që diferencat në opinione, qëllime, etj, të vihen re dhe të hapen debate. Kjo mund të jetë pjesërisht një çështje në vetëmenaxhimin e grupeve që nuk mund të drejtohen shumë thjesht tek një udhëheqës, i cili mund të zgjidhë këto mospajtime.

Në grupe të tilla, konflikte të vogla, shpesh mundet të përshkallëzohen me kalimin e kohës, duke çuar shpesh në konflikte të mëdha në të ardhmen.

Së dyti, humbja individuale si pasojë e xhiros bëhet më e rëndësishme me rritjen e intensitetit të ndërvarësisë. Nisja e një personi kërkon që disa marrëdhënie të rindërtohen nën kushtet e ndërvarësisë së grupuar apo vijuese. Në situata të karakterizuara nga ndërvarësi reciproke apo gjithëpërfshirëse, shumë më shumë marrëdhënie duhet të rihvillohen nëse një individ i ri i prezantohet sistemit. Në disa raste të ndërvarësisë ekstreme, humbja madje e vetëm një personi mund të bëjë që çdo kush të ketë një performancë nën mesataren dhe mund të duhet shumë kohë për të sjellë grupin në nivelin e mëparshëm.

Së treti, ndërvarësia gjithëpërfshirëse mund të simulojë fleksibilitet më të lartë dhe mund t'u bëjë të mundur grupeve të njerëzve të adaptohen më shpejt me ndryshimin e mjedisit se sa me grupet e unifikuara nga më pak forma komplekse të ndërvarësisë. Ky fleksibilitet kërkon që t'i kushtohet më shumë rëndësi mirëmbajtjes së vazhdueshmërisë së ndërvarësisë dhe mund të kontribuojë në procesin e humbjes dhe të reduktimit të produktivitetit nëse menaxhohet pa zgjuarsi.

Së katërti, lloji i ndërvarësisë ka implikime në dizejnimin e sistemit motivues. Nivel-grupet e qëllimit dhe nivel-grupet e feedback-ut, janë të lidhura me një performancë të lartë në organizatë, duke shfrytëzuar ndërvarësinë vijuese, reciproke ose gjithëpërfshirëse.

3. Marrja dhe dhënia e funksionit (rolit)

Ndërkohë që njerëzit e ndërvarur lidhen me njëri-tjetrin dhe mbledhin eksperiencë përmes marrëdhënieve ndërpersonale, presin edhe nga individë të tjerë të sillen në mënyra specifike. Këto pritshmëri mund të bazohen pjesërisht në një përshkrim formal pune që çdo person ka, por zakonisht i tejkalojnë përshkrimet e shkruara të punës. Pritshmëri të tilla dhe sjellja që ata presupozojnë, formon rolet që individët luajnë në marrëdhëniet ndërpersonale.

4. Procesi i komunikimit në marrëdhëniet e ndërvarura

Procesi i komunikimit ndahet në tri faza të përgjithshme: kodimin e informacionit në një mesazh, transmetimin e mesazhit në medime dhe çkodimin e informacionit nga mesazhi i marrë³⁸⁶. Për shkak të problemeve që mund të krijohen në çdo njëren nga këto faza, është e rëndësishme të kuptohet, se çfarë ndodh në secilën fazë, dhe si kjo mund të kthehet në kufijtë e komunikimit efektiv³⁸⁷.

Mesazhet e komunikimit

Kodimi është një proces me të cilin një ide abstrakte e komunikuesit, është përkthyer në simbole të gjuhës dhe këto në mesazhe, të cilat mund t'i transmetohen dikujt tjetër. Ideja është subjektive dhe e njohur vetëm për komunikuesin. Për shkak se angazhohet një sistem i përbashkët simbolesh, mesazhi mund të kuptohet nga individë të tjerë, të cilët e njohin gjuhën e komunikuesit.

Mediumi, ose mbajtësi i mesazhit, ekzistojnë jashtë komunikuesit dhe mund të përthithen nga të gjithë. Ne mund ta karakterizojmë median nga një kuptim njerëzor, ku në të vërtetë: fjalimi gojor, i cili përdor degjimin; dokumentacioni i shkruar, i cili përdor pamjen dhe preken; dhe komunikimi joverbal, i cili mund të përdorë 4 nga 5 shqisat.

Në asnjë vend tjetër, teknologjia nuk ka ndikim, sa ka në fushën e komunikimit të medias. Faks, e-mail, chat rooms, rrjetet sociale, celularët, kanë krijuar një menu gjithnjë e në rritje të opsioneve në gjetjen e medimeve më të mira për secilin mesazh. Kështu mësimi se si të krahasosh mediumet me mesazhe nuk ka qenë asnjëherë kaq sfiduese.

Komunikimi verbal mbështetet kryesisht në shqisën e dëgjimit; simbolet e tij janë bazuar në bisedat ballë për ballë, takimet dhe thirrjet

³⁸⁶ Richard Arvid Johnson (1976). *Management, systems, and society : an introduction*. Pacific Palisades, Calif.: Goodyear Pub. Co. pp. 142–148.

³⁸⁷ McPhee, R.; Zaug, P. (2000). "The Communicative Constitution of Organizations: A framework for explanation". *Electronic Journal of Communication/La Revue Electronique de Communication* 10 (1-2): pp. 1–16.

telefonike, të cilat janë format më të përdorshme të komunikimit në organizatë.³⁸⁸

Komunikimi gojor ofron avantazhin e shpejtësisë. Dikush mund ta kodojë shpejt informacionin dhe kthimi i feedback-ut do jetë i shpejtë. Nëse marrësit janë të paqartë në lidhje me mesazhin, ata mundet që menjëherë të kërkojnë për qartësim. Prezantimi i një propozimi gojarisht, për shembull, ofron më shumë mundësi për dhënien përgjigje të pyetjeve se sa hartimi i një raporti me shkrim. Mesazhet gojore janë përgjithësisht eficientë në përkujdesjen e problemeve të përditshme që lindin në organizata. Në funksion të kësaj, janë të nevojshme tregues dhe aftësi të mëdha historitreguese, të cilat ndihmojnë në transmetimin e mesazhit.

Ndonjëherë komunikimet e shkruara preferohen më shumë se ato të transmetuara gojarisht. Pavarësisht se mesazhet e shkruara kodohen me ngadalë se ato gojore, ato e lejojnë komunikuesin të përdorë gjuhën në mënyrë më të saktë. Një fjali në kontratën e punës, për shembull, mund të shkruhet shumë herë për t'u siguruar që gjithkush i përfshirë, e di ekzaktësisht se çdo të thotë. Qëllimi është të minimizohet mundësia e çdo konfuzioni që mund të lindë në të ardhmen, apo argumenti në lidhje me interpretimin. Materialet e shkruara gjithashtu ofrojnë një kopje permanente të komunikimit, e cila mund të ruhet për qëllime të mëvonshme. Për shembull, një supervisor mund të shkruajë një memo formale për një punonjës, duke shënuar se ai ka ardhur vonë në punë 10 nga 11 ditët e fundit dhe e paralajmëron se dështimi për të ardhur në kohë mund ta çojë deri në pezullim. Nëse sjellja vazhdon, supervizori e ka të dokumentuar provën që punonjësi mori si paralajmërim.

Një nga problemet e shkaktuara nga komunikimi mediatik siç janë e-maillet, është se njerëzit konfuzohen në lidhje me fuqitë dhe dobësitë e medias. Për shembull, shumica e njerëzve i trajtojnë e-maillet si të ishte një formë e komunikimit gojor, duke injoruar gramatikën, stilin e të shkruarit dhe formën në këmbim të një komunikimi të shpejtë joformal. Shumë e-maile hartohen me nxitim, pa u menduar gjatë në lidhje me përmbajtjen e tyre. Gjithsesi, e-mail është në fakt një formë e komunikimit të shkruar që luan edhe rolin e letrës, duke ofruar kështu dokumentim të shkruar të ideve që mund të nevojiten më vonë.

Në shtesë të komunikimit oral dhe atij të shkruar, falë historisë sonë të gjatë evolutive, njerëzit kanë zhvilluar mënyra joverbale të komunikimit dhe këto mesazhe joverbale janë shpesh të nënvlerësuara. Kur dy njerëz

³⁸⁸ David, Werner. *Managing Company-Wide Communicaton*. London: Chapman & Hall, 1995. pp 30-32.

janë të interesuar në bashkëbisedim, shpesh i parashikojnë mendimet e njëri-tjetrit dhe përgjigjen shpejt, shpesh duke kompletuar fjalitë e njëri-tjetrit. Ritmi i ngadaltë në një bisedë, nga ana tjetër, është shenjë e mungesës së interesit ose kuptueshmërisë. Ngjashmërisht, ashtu si paraardhësit tanë, njerëzit shfaqin mimikë ndaj njëri-tjetrit në biseda ku ka interes të lartë dhe adoptojnë lëvizjet e duarve dhe kokës nga njerëz që ata admirojnë. Dështimi në shfaqjen e mimikës, përfshin mungesën e vëmendjes ose të respektit dhe është shenjë që dikush nuk po krijon impaktin e dëshiruar në audiencë³⁸⁹.

Për të kompletuar procesin e komunikimit, mesazhi i dërguar duhet të jetë i çkodueshëm, proces në të cilin mesazhi përkthehet në mendjen e marrësit³⁹⁰. Kur e gjitha funksionon mirë, ideja rezultuese ose imazhi mental, korrespondon me idenë e dërguesit. Fatkeqësisht, një pafundësi gjërash mund të shkojnë keq dhe ta bëjnë komunikimin joefektiv. Termi zhurmë i referohet faktorëve, të cilët mund ta shtrembërojnë mesazhin. Zhurma mund të ndodhë në çdo fazë të procesit dhe është veçanërisht problematike, kur dy njerëz u përkasin kulturave të ndryshme.

Barrierat e një komunikimi efektiv

Një varietet faktorësh organizacional, ndërpersonal dhe individual, mund të pengojnë komunikimin brenda grupit të organizatës. Konkretisht, natyra e hapësirës fizike të zënë nga mbajtësit e punës ndikon pashmangshmërisht modelet e komunikimit³⁹¹. Nëse një organizatë dëshiron të promovjë zhvillimin e marrëdhënieve ndërpersonale, i duhet t'i vendosë njerëzit në kushte më të afërta fizike³⁹². Njerëzit që punojnë së bashku (jo larg njëri-tjetrit), kanë më shumë mundësi të ndërveprojnë, si dhe të krijojnë marrëdhënie më afatgjata se sa njerëzit që janë fizikisht të distancuar nga njëri-tjetri. Kjo është e vërtetë edhe nëse njerëzit, të cilët janë fizikisht larg mund të komunikojnë në mënyrë frekvente me anë të medias elektronike. Për këtë arsye, shumë organizata investojnë në pasurimin e medias të komunikimit elektronik, siç janë video-konferencat

³⁸⁹ Hybels, S., & Weaver, H.R. (2001). *Communicate effectively*. 6th Ed. Boston: McGraw-Hill, pp 5-12.

³⁹⁰ Miller, K. (1999). *Organizational communication: Approaches and process*. 2nd ed. Belmont: Wadsworth pp. 35-38.

³⁹¹ Miller, K. (1999). *Organizational communication: Approaches and process*. 2nd ed. Belmont: Wadsworth pp. 35-38.

³⁹² Johnson, J. David. *Organizational Communication Structure*. Norwood, NJ: Ablex Publishing, 1993 pp 20.

që u lejojnë njerëzve të shikojnë njëri - tjetrin³⁹³. Megjithëse i nevojshëm në termat e zhvillimit të lidhjes dhe besimit komunikimi elektronik nuk duket se është një zëvendësues total i komunikimit ndërpersonal ballë për ballë.

Pavarsisht nëse qëllimi i komunikimit është të informoi ose të bind, besueshmëria e burimit do të përcaktojë edhe rolin që fsheh mesazhi. Besueshmëria i referohet gradës në të cilën informacioni i ofruar nga burimi është i besueshëm dhe është funksion i tre faktorëve:

1. Ekspertizës, ose njohurinë e burimit të çështjes.
2. Besueshmërisë dhe vlefshmërisë, ose gradës në të cilën marrësi beson se komunikuesi nuk ka motive të fshehta.
3. Konsistenca mes fjalëve dhe akteve.

Besueshmëria është e ulët kur burimi i komunikimit është i painformuar, jo i besueshëm, ose veprimet bien ndesh me fjalët. Një fuqi e mosbalancuar mes një caktuesi roli dhe një zbatuesi roli, mund të pengojë komunikimin në organizatë.

PERFUNDIME DHE REKOMANDIME:

Shoqëria jonë nuk mund të përmirësohet pa një rrjedhë të qëndrueshme të menaxherëve për të udhëhequr organizatat.

Roli i menaxhimit është që të lëvizë një organizatë drejt qëllimeve apo synimeve të saj, duke caktuar aktivitetet që kryejnë anëtarët organizatë. Nëse menaxhimi siguron që të gjitha aktivitetet janë të dizenuara në mënyrë efektive, çdo punonjës do të kontribuojë në arritjen e qëllimeve organizative

Konflikti në vendin e punës mund të çojë në humbjen e punonjësve të talentuar. Menaxhimi i konfliktit sjell të gjitha palët së bashku për të diskutuar dallimet e tyre në një mjedis të sigurt, është një funksion i rëndësishëm i komunikimit organizativ. Ky lloj i komunikimit zakonisht përfshin të tri drejtimet e komunikimit dhe pse diskutimet mund të jenë joformale, vendimet përfundimtare zakonisht komunikohen zyrtarisht.

Komunikimi është thelbësor për ndërtimin e marrëdhënieve në mes të anëtarëve të stafit dhe në mes të niveleve të të punësuarve, si në nivel profesional ashtu dhe social. Komunikimi redukton keqkuptimet dhe shkurton shpenzimet lidhur me gabimet.

³⁹³ Poertner, Shirley, and Karen Massetti Miller. *The Art of Giving and Receiving Feedback*. Amer Media, 1996 pp 82.

Menaxherët në Shqipëri duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi llojeve të ndërvarësisë në vendin e punës.

Lloji i ndërvarësisë që bashkon individët së bashku në marrëdhëniet ndërpersonale, ka disa implikime menaxheriale të rëndësishme. Punonjësit e ndërvarur duhet të lidhen me njëri-tjetrin dhe të mbledhin eksperiencë përmes marrëdhënieve ndërpersonale.

BIBLIOGRAFI:

1. Champoux, J. E. (1996): *Organizational behaviour: Individual, groups, and processes*. Minneapolis: West, pp 12
2. Oakland, J.S. (2000): *Total organizational excellence: Achieving world-class performance*. Oxford: Butterworth-Heinemann, pp 246-248
3. Hybels, S., & Weaver, H.R. (2001). *Communicate effectively*. 6th Ed. Boston: McGraw-Hill, pp 5-12
4. Miller, K. (1999): *Organizational communication: Approaches and process*. 2nd ed. Belmont: Wadsworth pp. 35-38
5. McPhee, R.; Zaig, P. (2000): "The Communicative Constitution of Organizations: A framework for explanation". *Electronic Journal of Communication/La Revue Electronique de Communication* 10 (1-2): pp. 1-16.
6. David, Werner. *Managing Company-Wide Communication*. London: Chapman & Hall, 1995. pp 30-32
7. Johnson, J. David. *Organizational Communication Structure*. Norwood, NJ: Ablex Publishing, 1993 pp 20.
8. Poertner, Shirley, and Karen Massetti Miller. *The Art of Giving and Receiving Feedback*. Amer Media, 1996 pp 82.
9. Richard Arvid Johnson (1976): *Management, systems, and society : an introduction*. Pacific Palisades, Calif.: Goodyear Pub. Co. pp. 142-148. ISBN 9780876205402.
10. Robert Grant and James C. Hayton, interdependencies between People in Organizations, *The Oxford Handbook of Human Capital*, 2011, pp 17-25

ISSN 2221-6871

*Doli nga shtypi dhjetor, 2014 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x 250 mm.
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*

